



Universiteti
Europian i
Tiranës



Po vjen një epokë e re. Bëhu gati!



Bledar **MUSTAFARAJ** / Mirgen **PRENÇE** / Brikena (Buda) **DHULI** /
Endira **BUSHATI** / Edi **SPAHO** / Iriqi **TOPALLI** / Shukrje Stublla-**SHABANI**
/ Eureka **MUJAJ** / Valentina **MEMINI** / Adelina **RAKAJ** / Besim **KELMENDI**
/ Etleva **BABAMETO** / Çlirim **GJATA** / Moikom **ZEQO**

JUS & JUSTICIA NR 11/2015

REVISTË SHKENCORE E FAKULTETIT JURIDIK

Kryeredaktor PROF. ASOS. DR. MIGENA LESKOVIKU ISSN 2223-8654

Bordi Editorial

PROF. DR. KSENOFON KRISAFI

PROF. DR. FERIT DUKA

PROF. DR. ROMEO GURAKUQI

PROF. DR. SKËNDER KAÇUPI

PROF. DR. XHEZAIR ZAGANJORI

DR. ÇLIRIM GJATA

DR. SOKOL SADUSHI

DR. NEBI BARDHOSHI

Redaktore

MARSILDA NDINI

Arti grafik

BESNIK FRASHNI

Jeni të mirëpritur të dërgoni shkrime, recensa librash, përmbledhje punimesh shkencore, monografi apo studime të ndryshme në redaksinë e revistës "Jus&Justicia".

Redaksia do t'i shqyrtojë me objektivitet, rigorozitet shkencor dhe konsideratë.

Materialet mund të dërgohen në formën Word, në adresën e mëposhtme:

migena.leskoviku@uet.edu.al

UNIVERSITETI EUROPIAN I TIRANËS / TIRANË
Bulevardi "Gjergj Fishta" / www.uet.edu.al / info@uet.edu.al



© UET Press 2015
Të gjitha të drejtat për këtë botim janë të rezervuara.
Asnjë pjesë e këtij libri nuk mund të riprodhohet
përmes çdo mënyre ose mjete pa leje paraprake.

Punimet e paraqitura shprehin mendimet dhe qëndrimin personal të
autorëve. Redaksia nuk mban përgjegjësi për sa autorët kanë shprehur në
shkrimet e tyre.

Rruga: Bulevardi "Gjergj Fishta", Nd.70, H.1, Tiranë, Albania
Kodi Postal: 1023
Tel: +355 4 2421 806
Web: <http://www.uet.edu.al>

përmbajtja

ARTIKUJ DHE STUDIME

<i>Mbrojtja e te miturve në legjislacionin ndërkombëtar</i>	<i>5</i>
Dokt. Bledar Mustafaraj & Dr. Mirgen Prençe	
<i>Barazia gjinore si një gur themeli në procesin e zhvillimit të vendit</i>	<i>21</i>
Brikena (Buda) Dhuli	
<i>Pagimi i padetyruar sipas Kodit Civil Shqiptar dhe praktikës gjyqësore. Një analizë krahasimore.....</i>	<i>30</i>
Prof. Asoc. Dr. Endira Bushati	
<i>Tregu i letrave me vlerë në Shqipëri dhe Ballkan</i>	<i>45</i>
Prof. Asoc. Dr. Edi Spaho	
<i>Roli i së Drejtës Natyrore pas Luftës së Dytë Botërore (Rasti i Gjyqit të Nurembergut)</i>	<i>59</i>
Dokt. Irisi Topalli	
<i>Kontrolli parlamentar ndaj qeverisë në komisionet e Kuvendit të Republikës së Kosovës.....</i>	<i>70</i>
Msc. Shukrije Stublla-Shabani	
<i>Ajenti i infiltruar në dhomat e "chat"- it.....</i>	<i>82</i>
Dokt. Eurela Mujaj	

<i>Shërbimi përmbartimor privat përkundrejt shërbimit përmbartimor shtetëror</i>	92
Dokt. Valentina Memini	
<i>Pozita e kryerësve të veprave penale me çrregullime mendore, sipas Kodit Penal të Kosovës</i>	102
Msc. Adelina Rakaj	
<i>Të drejtat e dëmtuarve në procedurën penale, aspekte krahasuese Shqipëri-Kosovë. Vështrim i posaçëm për viktimat e trafikuar</i>	123
Dokt. Besim Kelmendi	
<i>Politika e Britanisë së Madhe në Shqipëri gjatë Luftës së Dytë Botërore</i>	143
Dokt. Etleva Babameto	
OPINION	
<i>Reforma në drejtësi duhet të kalojë nëpërmjet një kushtetute të re</i>	157
Dr. Çlirim Gjata	
RECENSË	
<i>Për librin “Për Tokën dhe Detin e Shqipërisë – qasje juridiko-ndërkombëtare” të autorit Ksenofon Krisafi</i>	170
Moikom Zeqo	
ABSTRACTS	173

ARTIKUJ DHE STUDIME

Mbrojtja e të miturve në legjislacionin ndërkombëtar _____

_____ **Dokt. Bledar Mustafaraj** _____

FAKULTETI JURIDIK, UNIVERSITETI EUROPIAN I TIRANËS. PROKUROR PRANË PROKURORISË SË RRETHIT GJYQËSOR ELBASAN.

_____ **Dr. Mirgen Prençe** _____

PEDAGOG NË DEPARTAMENTIN E TË DREJTËS PUBLIKE, FAKULTETI JURIDIK, UNIVERSITETI EUROPIAN I TIRANËS.

Abstrakt

*K*ohët e fundit gjithnjë e më shumë po i kushtohet një vëmendje e veçantë fëmijërisë dhe të drejtave të saj. Në fund të shekullit XIX dhe në fillim të shekullit XX, shkencat humane si pedagogjia, psikologjia, sociologjia, u ndërgjegjësuat dhe pohuan se kjo fazë e jetës luan një rol tejet të rëndësishëm në zhvillimin e njeriut e mbi të gjitha arritën në përfundimin që edhe fëmija është një individ njerëzor. Për shumë shekuj, i mituri ka zënë të njëjtin pozicion me atë të grave, të sëmurëve dhe të të burgosurve: “subjektet e dobëta” të shoqërisë. Mjafton të mendosh se gjatë Revolucionit francez dhe në Deklaratën e 1789, për njeriun ekzistonte kjo ide: njeriu i lirë i Revolucionit ishte një qytetar mashkull dhe pronar, në këtë kuptim “subjektet e dobëta” nuk mund t’i gëzonin të drejtat dhe liritë pasi përjashtoheshin nga e drejta e pronësisë.

Në shoqërinë aktuale mendimi i të rriturve për fëmijët ka ndryshuar rrënjësisht dhe, të paktën me fjalë, janë të gatshëm të pranojnë se fëmija, njësoj si i rrituri, është një person dhe si i tillë mbajtes i të drejtave. Duke nisur që nga shekulli i kaluar u pa e nevojshme të flitej lidhur me domosdoshmërinë e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve, sidomos në nivel ndërkombëtar. Më hollësisht problemi i mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve në nivel ndërkombëtar u has gjatë periudhës së industrializimit, meqenëse lidhej ngushtë me problemin e shfrytëzimit në punë të fëmijëve. Duke nisur nga ky moment, i mituri u bë pikë referimi e akteve politike të organizmave

ndërkombëtare, rajonale ose botërore, nëpërmjet të cilave mund të shihet një rrugë e ngadaltë dhe e lodhshme që fëmijët në mënyrë progresive të bëheshin subjekte të së drejtës.

Fjalë kyçe: Fëmijë, proces, mbrojtje, e drejtë ndërkombëtare, KDF, interesi më i lartë i fëmijës, e drejta e të miturve.

Lindja e të drejtës së të miturve në legjislacionin ndërkombëtar

Vëmendja ndaj të drejtave të fëmijëve është një prirje relativisht e re. Gjatë fundit të shekullit XIX dhe në fillim të shekullit XX, shkencat humane u ndërgjegjësuat dhe nxorën në pah rëndësinë tepër të madhe që ka kjo fazë e jetës në zhvillimin e qenies njerëzore dhe i vunë theksin faktit se edhe fëmija është një person. Termi “person” sot paraqet rëndësi juridike, por nuk duhet harruar se nga pikëpamja gjuhësore ka lindur nga gjuha e teatrit: është maska latine. Termi tregon rolin brenda një shoqërie që nuk i njihete të drejtat vetjake, përderisa i vetmi subjekt juridik ishte familja dhe *Pater – familias* që e përfaqësonte¹. Për shekuj me radhë i mituri zinte të njëjtin vend në shoqëri me gratë, të sëmurët, të burgosurit: “*subjektet e dobët*” të shoqërisë. Përgjatë revolucionit francez dhe në Deklaratën e vitit 1789 ideja e njeriut nuk ishte aspak universale: njeriu i lirë i Revolucionit ishte qytetari mashkull dhe pronar, në këtë kuptim “*subjektet e dobët*” nuk gëzonin të drejta e liri përderisa ishin të përjashtuar nga e drejta e pronësisë.

Historiku i fëmijërisë lidhet me dhunën dhe me abuzimet e të rriturve ndaj fëmijëve. Bibla rrëfen për masakra ndaj fëmijëve: Për shembull në Ungjillin sipas Mateut tregohet sesi mbreti Herod, u zemërua keqas dhe urdhëroi vrasjen e të gjithë fëmijëve meshkuj nga mosha 0 - 2 vjeç që gjendeshin në Betlehem dhe në rrethina.² Deri në shekullin XIX braktisja e fëmijëve, ndëshkimet trupore ndaj tyre, kanë qenë dukuri shumë të përhapura dhe të pranuar moralisht në shoqëri. Është i njohur shfrytëzimi i punës së fëmijëve në bujqësi dhe në fabrika në shekujt XVII dhe XVIII.³

Në shoqërinë aktuale mendimi i personave madhorë ndaj fëmijërisë ka ndryshuar rrënjësisht dhe, së paku me fjalë, ata janë të prirur të njohin se fëmija, sikundër i

rrituri, është një person dhe si i tillë mbajtes i disa të drejtave. Duke nisur që nga shekulli XIX u pa e nevojshme të flitej lidhur me domosdoshmërinë e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve, sidomos në nivel ndërkombëtar. Më hollësisht problemi i mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve në nivel ndërkombëtar u has gjatë periudhës së industrializimit, meqenëse lidhej ngushtë me problemin e shfrytëzimit në punë të fëmijëve. Nga ky moment e në vijim i mituri u bë pikë referimi i akteve politike të organizmave ndërkombëtarë, rajonale ose universale, nëpërmjet të cilëve u vu në lëvizje një proces tejet i ngadaltë, i lodhshëm e shpesh i kundërshtuar, me anë të të cilit të miturit nisën të njihen si subjekte të së drejtës. Figura e qytetarit të mitur është lënë gjithnjë në hije, qoftë për mbrojtjen e tij, qoftë për sa i përket personalitetit të tij: i mituri është ai, i cili nuk është në gjendje të veprojë në mënyrë të pavarur për mbrojtjen e të drejtave të tij.⁴ Kjo gjendje lidhej me kushtet familjare, ku i mituri jetonte brenda familjes, ndaj të cilës duhet të përmbushte një sërë detyrimesh, sidomos ndaj kreut të familjes që duhej ta edukonte atë në përputhje me normat e paracaktuara të shoqërisë.

Është mjaft interesant evolucioni që ka pësuar në kohë gjuha ndërkombëtare e instrumenteve juridike e politikë të organizmave të ndryshëm për të përshkruar figurën e qytetarit të mitur.⁵

Para se të kalojmë në analizimin e instrumenteve ndërkombëtare për mbrojtjen e të miturve, duhet të nënvizojmë se procesi i njohjes në rang ndërkombëtar të të drejtave të fëmijëve ecën paralel, e ndonjëherë identifikohet, me procesin e ndërkombëtarizimit të të drejtave të njeriut. Edhe ky proces është relativisht i hershëm, pasi deri para pak kohe këto të drejta ishin në varësi të procesit të civilizimit të brendshëm të shteteve, pra ishin një shprehje tipike e sovranitetit të çdo shteti dhe kishin fare pak rëndësi në marrëdhëniet ndërshtetërore. Nëpërmjet procesit të ndërkombëtarizimit të të drejtave të njeriut iu imponohen shteteve standarde të reja të mbrojtjes dhe detyrimi për zbatimin e tyre.⁶ Megjithatë, edhe sot, marrëdhëniet ndërkombëtare kushtëzohen mjaft nga marrëdhëniet ndërshtetërore që lidhen me parimet e sovranitetit, reciprocitetit, mosndërhyrjes në punët e brendshme e kështu me radhë, por pavarësisht këtyre kushtëzimeve është bërë mjaft në këtë drejtim.⁷ Tek ky proces evolues, që çoi në lindjen dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut në shkallë ndërkombëtare, mund të dallohen

¹ Pushteti i *pater – familias*, i cili në të drejtën romake përfaqësonte familjen, përshkruante babain si mbajtësin e vetëm të të drejtave: “*Ius vitae et necis*,” të drejtën e jetës dhe të vdekjes, për rrjedhojë kishte të drejtë të braktiste të porsalindurit, të tjetërsonte “*filii familias*,” duke i shitur ose dhënë me qira; vetëm pas vitit 374 e. s. marrja e jetës së një fëmije u konsiderua vrasje. Familja romake ishte në thelb një organizëm i qeverisur nga një kryetar që kishte mbi anëtarët e grupit pushtetin më të lartë shtrëngues, ndëshkues dhe sovran. Material i konsultuar nga: *Minori, bioetica e norme standards*, nën kujdesin e Maria Rita Saulle, Edizioni Scientifiche Italiane, Napoli, 1995, p. 98.

² Mateu, II, 16.

³ Historiani Lawrence Stone lidhur me punën e fëmijëve në Angli vë në dukje se, për të qenë të sigurt se vajzat e moshës 5 - 6 vjeç të punësuar në qëndistari dhe punimet me kashtë do të punonin sa më shumë, i detyronin që “të linin zbuluar qafën dhe krahët që t’i godisnin më lehtë me pëllëmbë.”

⁴ “Traditionally a child has been defined as a comparative negative: a child is an individual who is not yet an adult. It is a definition which is laden with religious, cultural, physical and psychological practices and beliefs,” Geraldine von Bueren, *The international law on the rights of the child*, London, Martinus Hijoff Publishers, 1995, p. 33.

⁵ Francesco Milanese, *La tutela non giurisdizionale del minore*, Padova, CEDAM, 1999, f. 29.

⁶ F. Milanese, vep. cit, f.15.

⁷ “Ndërkombëtarizimi i të Drejtave të Njeriut është një proces mjaft i gjerë pasojat e të cilit në thelb, më tepër se risi, vihen re njëkohësisht në marrëdhëniet ndërkombëtare dhe në brendësi të secilit Shtet. Kushtetutat kombëtare dhe legjislacionet e çdo vendi, duhet të rilexohen sot nën dritën e të drejtës ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.” F. Milanese, vep. cit, f. 15, shënimi 10.

*tre faza*⁸. Në fazën e parë, komuniteti ndërkombëtar pranoi se të gjithë individët, përfshi dhe fëmijët, janë objekt i ligjeve ndërkombëtare dhe kërkojnë mbrojtje juridike ndërkombëtare. Në fazën e dytë, që po zhvillohet ende, po i jepen individit, përfshi të miturit, disa të drejta substanciale të veçanta. Në fazën e tretë, edhe kjo në zhvillim e sipër, individit i njihet mundësia të ushtrojë drejtpërsëdrejti të drejtat themelore që i janë njohur dhe të veprojnë për mbrojtjen e tyre me kusht që të ketë fituar zotësinë procedurale për ta bërë këtë.

Procesi i ndërkombëtarizimit të të drejtave të fëmijës nuk mund të përputhet me atë të sipërpërmendur për sa i përket fazës së dytë dhe të tretë. Edhe pse pranohet në parim se fëmijët janë titullarë të gjithë gamës së të drejtave civile, në praktikë këto nuk u jepen atyre nga shtete të veçanta ose nga gjykatat ndërkombëtare. Ky mohim nga ana e komunitetit ndërkombëtar ka të bëjë me mendimin se i mituri nuk ka zotësinë procedurale për të mbrojtur interesat e veta. Ky qëndrim tradicional filloi të lëkundej sidomos nga koha e hartimit të Konventës së Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Fëmijës së vitit 1989, që tentoi t'i japë fund dallimit mes teorisë dhe praktikës, në këtë linjë do të gjejë trajtim edhe ky punim.

Aktet ndërkombëtare në mbrojtje të të miturve

Këto ndahen në akte me *karakter universal* dhe me *karakter rajonal*.

Aktet ndërkombëtare me karakter universal

Dokumenti i parë që i paraprin instrumenteve ndërkombëtare për mbrojtjen e të miturve u shfaq në konferencën e Hagës të së drejtës ndërkombëtare private (1902) ku u miratua "Konventa për të rregulluar mbrojtjen e të miturve"⁹. Ajo rregullonte kryesisht aspektet juridiksionale për të ushtruar mbrojtjen mbi të miturin e huaj duke vendosur që, ndaj të miturit i cili kishte nevojë për mbrojtje, do të zbatohet ligji i shtetësisë së tij. Pra, kjo Konventë njeh "*parimin e shtetësisë*" në kuptimin që mbrojtja e të miturit do të përqendrohet në ligjin e përkatësisë së tij shtetërore. Vetëm në raste të veçanta, kur është e pamundur të sigurohet ndihma sipas rregullimit të shtetit të origjinës, autoritetet e shtetit ku ai ka vendbanimin mund ta sigurojnë atë në bazë të legjislacionit të tyre¹⁰. Kjo Konventë i mëshon idesë së mbylljes në vend të asaj të hapjes së mbrojtjes personale të fëmijës, megjithatë

⁸ Sipas G. Von Bueren, vep. cit, f.1.

⁹ Teksti i Konventës mund të konsultohet në faqen e Internetit www.hcch.net.

¹⁰ "Në fillim të shekullit e drejta ndërkombëtare private e shihte "kombësinë" si të dhënë në më të rëndësishme të individit, sepse konsiderohej si më e përshtatshme për të mbajtur lidhjet me Shtetin e origjinës: ishte pra e logjishme që Konventa e vitit 1902 të adoptonte parimin e shtetësisë," Maria Rita Saulle, *La Convenzione dei diritti del minore e l'ordinamento italiano*, Napoli, Edizioni Scientifiche Italiane, 1994, f.100.

mbetet një përpjekje e parë për ta nxjerrë fëmijën jashtë mbrojtjes familjare¹¹.

Më pas, falë Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ONP) u hartuan një sërë traktatesh lidhur me marrjen dhe vendosjen e të miturit në ambientin e punës. Që me aktin e themelimit të ONP-së në 1919, u hap për ratifikim *Konventa Nr.5* që caktoi, për herë të parë, moshën minimale të marrjes në punë të fëmijëve në fushën e industrisë (14 vjeç); kjo moshë u rrit në 15 vjeç me Konventën *Nr.59* të vitit 1937. Po në 1919 kemi Konventën *Nr.6* për ndalimin e punës së natës për të miturit e moshës 18 vjeç; në 1920 me dy konventa të ndryshme u caktua moshë minimale e marrjes në punë në fushën detare (14 vjeç) dhe në bujqësi (14 vjeç)¹².

Ndërhyrja e parë në nivel ndërkombëtar që u mor me problemin e mbrojtjes së të miturit si, subjekt i pavarur dhe me zhvillimin e personalitetit të tij, është *Deklarata për të drejtat e fëmijës* e miratuar në Gjenevë nga Lidhja e Kombeve më 24. 09. 1924. Ky dokument shpall për herë të parë disa të drejta themelore që duhen zbatuar për të pasur një zhvillim njerëzor të përshtatshëm të të miturit dhe ngarkon komunitetet ndërkombëtare për të bërë këtë zbatim. Në të përcaktohet se fëmija duhet ushqyer, pranuar dhe ndihmuar; të ndihmohet për të punuar duke e mbrojtur nga çdo lloj shfrytëzimi; në raste fatkeqësish duhet të jetë i pari që do ndihmohet e kështu me radhë. Flitet për të miturin si subjekt atëherë kur ai ndjek rrugë të gabuar, të kthehet në rrugën e drejtë "*me qëllim që të vërë zotësitë e tij në shërbim të njerëzve të tjerë*" (parimi V).

Me këtë Deklaratë filloi procesi i dhënies së të drejtave të fëmijëve që deri në atë kohë bartnin vetëm detyrime¹³.

Më 20.11.1959 u miratua nga Asambleja e OKB-së, *Deklarata e të drejtave të fëmijës*. Ajo e saktëson dhe e zgjeron përmbajtjen e Deklaratës së 1924 duke parashikuar që në preambul mbrojtjen e gjerë të fëmijës¹⁴. Të dy Deklaratat

¹¹ Problemet që lindën në zbatimin e Konventës sollën të nevojshme rishikimin e saj; "*Konventa mbi kompetencën e autoriteteve dhe ligjit të zbatueshëm lidhur me mbrojtjen e të miturve*" u nënshkrua në 1961. Në datë 19 Tetor, 1996, u nënshkrua në sesionin e 18-të të Konferencës së Hagës për të drejtën ndërkombëtare private, Akti Final që ka të bëjë me projektin e *Konventës lidhur me kompetencën, ligjin e zbatueshëm, ekzekutimin dhe bashkëpunimin në fushën e përgjegjësisë prindërore dhe të masave mbrojtëse për të miturit*. Marrë nga: Paolo Picone, "*La nuova Convenzione dell'Aja sulla protezione dei minori*" në Rivista di diritto internazionale privato e processuale, 1996, f. 705.

¹² Tekstet e këtyre konventave mund të konsultohen në faqen e Internetit www.ilo.org.

¹³ F. Milanese, vep. cit, f. 30.

¹⁴ Për sa i përket saktësisht përmbajtjes së saj duhet thënë se është e ndarë në 10 parime që lidhen me: 1) mos diskriminimin në kuptimin më të gjerë të fjalës; 2) mbrojtjen më të përshtatshme për të lejuar zhvillimin fizik, intelektual, moral, shpirtëror dhe shoqëror; 3) të drejtën e emrit dhe të kombësisë; 4) të drejtën për siguri sociale, përkujdesjes mjekësore, për shëndet; 5) mundësinë që fëmija, për shkak të kushteve të caktuara fizike, mendore ose shoqërore, të marrë trajtimin, edukimin dhe përkujdesjen për të cilën ka nevojë; 6) të drejtën për t'u rritur nën kujdesin dhe përgjegjësinë e prindërve dhe, në çdo rast, në një atmosferë të ngrohtë e të sigurt materiale e morale dhe për të mos u ndarë nga nëna; 7) të drejtën për edukim që, në nivelin elementar, duhet të jetë falas dhe i detyrueshëm si dhe të drejtën që të drejtohet nga ata të cilët kanë përgjegjësinë e edukimit të tij; 8) të drejtën për mbrojtje dhe ndihmë me përparësi; 9) të drejtën për të qenë i mbrojtur nga çdo formë neglizhence, trajtimi të egër dhe shfrytëzimi; 10) të drejtën për t'u mbrojtur nga çdo praktikë diskriminuese për arsye racore, fetare ose të tjera.

nuk kishin vlerë detyruese për Shtetet dhe shtetasit e tyre, megjithatë ato janë domethënëse në planin juridik. “*Parimet shprehin qartë vlera që duhet të futeshin në sistemet juridike dhe të orientonin legjislatorin, interpretuesin e së drejtës dhe që të detyronin praktikën që të mos u vinte në kundërshtim me to. Ndërkaq këto deklarata i hapën rrugë miratimit të Konventave që do të përmbanin norma të detyrueshme juridikisht*”¹⁵. Ndërkohë lindën disa konventa e traktate që synonin të mbronin probleme specifike si rregullat për birësimin, njohja e fëmijëve natyralë, marrja e padrejtë e të miturit, trajtimi i të miturit në konflikt, etj.

Në të vërtetë, në kuptimin juridik janë instrumentet e përgjithshme si Deklarata e 1959, nenet 23 e 24 të **Paktit mbi të drejtat civile e politike** dhe neni 10 i **Paktit mbi të drejtat ekonomike, sociale e kulturore**¹⁶ që shënuan lindjen e së drejtës ndërkombëtare **për të miturit** e jo **mbi të miturit**. Këto akte vendosin detyrime juridike për Shtetet palë që të përshtatin legjislacionin e tyre me përmbajtjen e këtyre dokumenteve. Në bazë të këtyre instrumenteve, fëmija ka të drejtë për masa mbrojtëse nga ana e familjes, shoqërisë dhe shtetit. Ka të drejtën për të pasur një emër, shtetësi, pa asnjë lloj diskriminimi, dhe në rast shpërbërjeje të familjes duhet t’i sigurohet mbrojtja e duhur (nenet 23 e 24 të Paktit mbi të Drejtat civile e politike). Në fushën penale, përveç ndalimit të dënimit me vdekje për të miturit nën 18 vjeç, janë parashikuar garanci të veçanta në fushën procedurale penale dhe atë të riedukimit shoqëror. Pakti mbi të drejtat ekonomike, sociale e kulturore ku këtu parashikon mbrojtjen e familjes, të nënave, dhe të fëmijëve nga shfrytëzimi ekonomik e shoqëror.

Gjithashtu kanë ndryshuar dhe termat, ku i mituri devijant përfaqëson dështimin e procesit të rritjes së fëmijës dhe këtu shoqëria duhet të marrë përsipër përgjegjësitë e veta. Në përputhje me idenë e përshtatjes së të miturit me shoqërinë ku ka mendime të rëndësishme që synojnë mbrojtjen e fetusit dhe të nënës, t’i garantojnë të miturit një zhvillim të harmonishëm. Shfaqen koncepte të reja si e drejta për të luajtur, për t’u arsimuar dhe të drejta të tjera civile. Kjo rrugë e lodhshme e shprehjes së personalitetit të të miturit plotësohet dhe gjen një përcaktim të drejtë në Konventën ndërkombëtare që do të marrim në shqyrtim më poshtë.

Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës (KDF)

Kjo Konventë u miratua nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, më 20.11.1989 në New York. Ajo përfaqëson një etapë historike për fëmijët dhe të drejtat e tyre, një përmbledhje ligjesh ndërkombëtare të plotë për mbrojtjen e fëmijës. Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës e konsideron fëmijën si subjekt i të drejtave themelore

¹⁵ Alfredo Carlo Moro, *Manuale di diritto minorile*, Bologna, Zanichelli Editore, 1996, f. 9.

¹⁶ Të dy këto pakte janë ratifikuar nga Shqipëria më 4 Tetor, 1991.

dhe jo vetëm si objektet e një mbrojtjeje të veçantë në marrëdhëniet familjare dhe jashtë familjare. Kjo Konventë ka si karakteristikë kryesore rëndësinë që i jep interesave të fëmijës, kurse në konventat e tjera kishte më shumë rëndësi interesi i prindërve ose pasuria e fëmijës. Karakteristikat e Konventës janë:

- Është i pari dokument ndërkombëtar që përqendrohet mbi të drejtat civile e politike, ekonomike sociale e kulturore të marra së bashku;
- është dokumenti i parë që bën një përkufizim të qartë të fëmijës, pra ai që nuk ka mbushur moshën 18 vjeç, përveç rasteve kur në bazë të ligjeve të shtetit të tij është madhor më parë;
- është i vetmi dokument ndërkombëtar i ratifikuar nga të gjithë shtetet me përjashtim të dy prej tyre: Shtetet e Bashkuara (kanë bërë vetëm nënshkrimin) dhe të Somalisë;
- është një dokument me të vërtetë ndërkombëtar. Nënvizohen nevojat materiale të fëmijëve; i kushtohet rëndësi bashkëpunimit ndërkombëtar në mbështetje të politikave për fëmijët në vendet e varfra; përmenden dhe forma të veçanta të parashikuara nga e drejta islamike, si për shembull familjet e mëdha.

Konventa është një instrument i rëndësishëm i së drejtës ndërkombëtare, ajo është e detyrueshme juridikisht dhe në këtë pikë dallon nga Deklarata që nuk përbën një normë juridike dhe nuk ka fuqi detyruese. Me anë të ligjeve të ratifikimit, parimet dhe normat e Konventës bëhen pjesë e së drejtës së brendshme dhe vetë konventa bëhet vepruese në vende të ndryshme (Shqipëria e ka ratifikuar Konventën më 27 Shkurt, 1992¹⁷).

Në këtë pikë duhet të bëjmë dallimin mes normave menjëherë të zbatueshme, të qarta, të sakta, që nuk bien në kundërshtim me normat e brendshme dhe që mbushin një boshllëk ligjor. Kemi norma menjëherë të zbatueshme, të qarta e të sakta që bien në kundërshtim me normat e brendshme dhe që sjellin si pasojë shfuqizimin e këtyre të fundit. Janë dhe normat *non self-executing*¹⁸ që duhen integruar nëpërmjet nxjerrjes së ligjeve. Këto norma të fundit kërkojnë gjithashtu dhe caktimin e atij organi shtetëror që do të jetë kompetent *ratione personale* për të nxjerrë dispozitat specifike përkatëse¹⁹.

Legjislacioni shqiptar i ngarkon autoritetet shtetërore me detyrimin për të zbatuar marrëveshjet ndërkombëtare.

Në fakt, Kushtetuta e vitit 1998, në nenin 5 shprehet se “*Republika e Shqipërisë zbaton të drejtën ndërkombëtare të detyrueshme për të*”.

¹⁷ Numri i Ligjit të ratifikimit dhe i Fletores Zyrtare ku është botuar nuk dihen.

¹⁸ “... norma që nuk parashikojnë të gjitha detajet e faktit që përpigjen të rregullojnë, duke kërkuar një veprim integruar nga ana e organeve shtetërore,” Benedetto Conforti, *Diritto internazionale*, Napoli, Editoriale Scientifica, 1997, f. 287.

¹⁹ A. C. Moro, vep. cit, f. 10.

Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës bën pjesë tek marrëveshjet ndërkombëtare dhe në bazë të Kushtetutës gjen zbatim në Republikën e Shqipërisë. Për këtë duhet që të jenë ndjekur rregullat e shpallura nga e drejta ndërkombëtare, pra ndjekja e procedurave të ratifikimit, gjë që është plotësuar.

Në këtë mënyrë, neni 116 i Kushtetutës parashikon se marrëveshjet ndërkombëtare bëjnë pjesë në burimet normative të Republikës së Shqipërisë kur ato janë të ratifikuara. Në bazë të nenit 122/1, kjo Konventë pasi është botuar dhe në Fletoren Zyrtare është pjesë e sistemit të brendshëm juridik dhe sipas paragrafit të 2 të po të këtij neni ajo ka epërsi mbi ligjet e vendit që nuk pajtohen me të. Kështu, Konventa është plotësisht aktive për sistemin shqiptar me qëllimin për të mbrojtur interesat e fëmijëve dhe për të garantuar të drejtat e tyre. Gjithashtu, çdo ligj i brendshëm që bie në kundërshtim me të duhet të shfuqizohet si antikushtetuese dhe për më tepër, shteti duhet të impenjohet që të përshtatë legjislacionin në përputhje me standardet e kërkuara prej saj dhe të krijojë dhe strukturat përkatëse për realizimin në praktikë të tyre.

Me këtë Konventë dhe me zotimin e Shteteve për të marrë masat e duhura juridike me karakter legjislativ që ajo të bëhet e ekzekutueshme, zhvillohet një standard universal i mbrojtjes dhe i jepet pavarësi degës së të drejtës së të miturve²⁰.

Kjo Konventë e OKB-së shënon hapin më të fundit në rrugën e njohjes së të drejtave të të miturve si të drejta njerëzore. Gjithë ky proces ka ndjekur në kah të kundërt në krahasim me procesin e ndjekur nga të rriturit: fëmijëve iu njohën së pari të drejtat sociale dhe ekonomike dhe tani ato kulturore, civile dhe politike²¹. Këtu qëndron një ndryshim mjaft i madh, sepse nga ky çast flasim për të miturin si për një **subjekt të së drejtës**: të miturit i njihet një *status i tij, i përcaktuar dhe i pavarur*. Kështu, Konventa e konsideron fëmijën si mbajtës të të drejtave të veta: shndërrimi i të miturit nga një **objekt i thjeshtë** i mbrojtur në marrëdhëniet juridike familjare në një **subjekt titullar në situata subjektive juridike**, i detyron Shtetet dhe prindërit që të mos konsiderohen më titullarë të të "drejtave të familjes" mbi të miturit. Mund të thuhet se, deri në miratimin e Konventës i mituri nuk mund të ishte një subjekt në gjendje për të bërë zgjedhje të pavarura, në kushte të caktuara, që të respektoheshin dhe të kishin vlerë. Natyrisht, njohja e këtyre të drejtave krijon nivele të ndryshme përgjegjësie: në radhë të parë prindërit dhe familjen, në radhë të dytë shtetin, në radhë të tretë komunitetin ndërkombëtar, nëpërmjet një sistemi mbrojtjeje dhe mekanizmave të kontrollit.

²⁰ F. Milanese, vep. cit, f. 28.

²¹ Në të vërtetë Konventa "shfaqet si një mjet shumë më i rafinuar nga aktet e mëparshme të të drejtave të njeriut. Pikësepari bëhet fjalë për një instrument të vetëm që përmbledh bashkë të drejtat civile, politike dhe ato ekonomike, shoqërore e kulturore, duke përveçësuar kështu interpretimin që Asambleja e OKB-së i ka bërë të drejtave të njeriut. Ajo përfshin dhe i referohet tërësisë së normave ndërkombëtare në fuqi duke i bërë pjesë në një farë mënyre të së njëjtës normë mbrojtëse. Së dyti, teksti përcakton qartë në funksion të efikasitetit të normave, përtej të drejtave të të miturit, detyrimet që duhet të marrë Shteti për t'i përmbushur" F. Milanese, vep. cit, f. 33.

Parimi i përgjithshëm që udhëheq interpretimin e normave dhe instituteve juridike për mbrojtjen e të miturve dhe me të cilin duhet të jenë në përputhje të gjitha ndërhyrjet administrative, sociale ose gjyqësore, është **interesi më i lartë i fëmijës**. Interesi i të miturit përputhet me vënien në jetë të së drejtës së tij për edukim, ose për krijimin e kushteve që të lehtësojnë zhvillimin e plotë dhe të gjerë të personalitetit të tij. Në këtë mënyrë, gjithë organet e administratës duhet të specializohen dhe të përmirësojnë cilësinë e shërbimeve të tyre për të garantuar këtë interes. Duke marrë në shqyrtim këtë Konventë dallojmë në to katër sfera kryesore veprimi²²:

- **Pjesëmarrjen** (Participation) e të miturit në vendimet që kanë të bëjnë me të;
- **Mbrojtjen** (Protection) e të miturit nga çdo formë diskriminimi dhe shfrytëzimi;
- **Parandalimin** (Prevention) e dëmeve ndaj të miturit dhe
- **Sigurimin e burimeve** (Provision) për të miturit në rrezik duke iu siguruar përkujdesjen e duhur.

Për sa u tha më sipër, për interpretimin e Konventës dhe për hartimin e programeve kombëtare në këtë fushë shërbejnë *katër parime themelore*:

- a. *Parimi i parë* është ai i mos diskriminimit, sipas të cilit çdo shtet duhet të sigurohet që të gjithë fëmijët që gjenden në territorin e tij të gëzojnë të njëjtat të drejta pa u diskriminuar.
- b. *Parimi i dytë* lidhet me interesin më të lartë të fëmijës. Të gjitha institucionet, publike dhe private, gjykatat, organet administrative dhe organet legjislativë duhet të mbajnë parasysh se interesi i fëmijës ka përparësi sipas të drejtave dhe detyrimeve që njeh kjo Konventë.
- c. Më pas, njihet e drejta e jetës, për mbijetesë dhe për zhvillim që duhet të garantohet "*në masën më të gjerë të mundshme*". Në Konventë termi zhvillim ka kuptim të gjerë dhe përfshin përveç shëndetit fizik edhe zhvillimin psikik, emocional, shpirtëror, social e kulturor.
- d. *I fundit* parim është ai i detyrimit për të dëgjuar mendimin e fëmijës. Kjo duhet të ndodhë në çdo çështje ku përfshihet fëmija, edhe gjatë procedurave gjyqësore ose administrative duke mbajtur gjithnjë parasysh moshën dhe shkallën e pjekurisë.

Për sa i përket strukturës së Konventës, ajo përbëhet nga 54 nene, ndahet në një Preambul dhe tre pjesë. Në Preambul shpallen të drejtat e fëmijëve dhe ndihma që u duhet dhënë familjeve si njësi bazë e zhvillimit të të miturve.

²² Zakonisht në literaturë dhe trajtime të ndryshme juridike të disa gjuhëve përdoren termat: **Participation, Protection, Prevention** dhe **Provision**.

Të drejtat e njohura nga Konventa. Të drejtat e mbrojtura nga Konventa mund të grupohen në tre tituj kryesorë. Janë ato që kanë të bëjnë me të drejtat dhe liritë themelore, si p.sh e drejta e jetës, për barazi, për një emër dhe shtetësi, liria e ndërgjegjes dhe e fesë. Më pas, janë ato që kanë të bëjnë me mbrojtjen e fëmijëve nga rreziqet që mund t'iu kanosen si abuzimet fizike ose psikologjike, keqtrajtimet, trafiket e paligjshme (neni 35), shfrytëzimi ekonomik ose seksual (neni 34), përfshirja në konfliktet e armatosura (neni 38). Neni 37 përjashton dënimet dhe trajtimet mizore, çnjerëzore, degraduese për ata që kanë kryer një vepër penale gjatë moshës së mitur e për më tepër i mituri nuk mund të dënohet me vdekje as me burgim të përjetshëm.

Dënimi duhet të jepet duke mbajtur parasysh moshën e subjektit dhe të jetë i orientuar drejt nga ana pedagogjike duke pasur si qëllim përfundimtar integrimin social, krijimin e ndjenjës së dinjitetit dhe të vlerave tek të miturit. Kjo shprehet në nenin 40 të Konventës, i cili rendit dhe garancitë themelore nga mund të përfitojë i mituri i akuzuar, i pandehur ose i dënuar.

Së fundi, janë ato që përpiqen të nxisin zhvillimin e fëmijës nëpërmjet arsimimit, informimit, argëtimit, lojës dhe veprimtarive kulturore.

Konventa Nr. 138 e ONP-së mbi moshën minimale në punë (1973)²³

Në këtë Konventë është përcaktuar se mosha minimale e marrjes në punë nuk mund të jetë më e vogël se mosha e parashikuar për mbarimin e arsimit të detyruar dhe në çdo rast jo më e vogël se 15 vjeç. Mosha minimale për punët e rrezikshme ose të dëmshme për shëndetin është 18 vjeç, përveç rasteve përjashtimore. Lejohet punësimi i personave të moshave 13 deri 15 vjeç në punë të lehta me kusht që të mos rrezikohet shëndeti, të mos pengohet arsimimi dhe as formimi profesional i të miturit.

Konventa Nr. 182 e ONP-së lidhur me ndalimin e formave më të rënda të punës së të miturve (1999)²⁴

Kjo Konventë përcakton dallimin ndërmjet punës së të miturve dhe formave më të rënda të saj, që janë:

- a. të gjitha format e skllavërisë ose praktikave të ngjashme me skllavërinë si shitja ose trafikimi i të miturve, puna e detyruar, përfshi rekrutimin e detyruar të të miturve me qëllimin për t'i përfshirë në konfliktet e armatosura;
- b. punësimi, pajtimi ose ofrimi i të miturve me qëllim prostituimi, prodhimi i

²³ Ratifikuar nga Shqipëria me Ligjin Nr.8086, datë 13.03.1996, botuar në Fletoren Zyrtare Nr.6, fq. 261.

²⁴ Ratifikuar nga Shqipëria me ligjin Nr.8774, datë 23.04.2001, botuar në Fletoren Zyrtare Nr.23, fq. 708.

- c. materialeve pornografike ose të spektakleve pornografike;
- c. punësimi, pajtimi ose ofrimi i të miturve në veprimtari të paligjshme sidomos për prodhimin dhe trafikimin e narkotikëve, siç edhe përcaktohen në traktatet ndërkombëtare përkatëse;
- d. çdo lloj tjetër pune që, për shkak të natyrës së saj ose të rrethanave ku kryhet, rrezikon të dëmtojë shëndetin, sigurinë ose moralin e të miturit.

Protokolli shtesë i Konventës së OKB-së kundër krimit të organizuar ndërkombëtar për parandalimin, zhdukjen dhe ndëshkimin e trafikimit të qenieve njerëzore, në veçanti të grave dhe fëmijëve (2000)²⁵

Në këtë protokoll përcaktohet:

- a. parandalimi dhe lufta ndaj trafikimit të njerëzve, me kujdes të veçantë për gratë dhe fëmijët;
- b. mbrojtja dhe ndihma ndaj viktimave të këtyre trafikëve duke respektuar të drejtat e njeriut;
- c. informimi i publikut mbi trafikimin dhe mbi rrjedhojat negative që ai sjell si për trafikantët ashtu dhe për viktimat;
- d. nxitja e bashkëpunimit mes shteteve anëtare për arritjen e këtyre qëllimeve.

Protokolli shtesë i Konventës mbi të Drejtat e Fëmijës kundër shitjes së fëmijëve, prostitucionit dhe pornografisë femërore

Ky Protokoll sanksionon në mënyrë zyrtare se Shtetet anëtare të OKB-së duhet të ndalojnë shitjen e fëmijëve, prostitucionin dhe pornografinë femërore. Ata duhet gjithashtu t'i informojnë fëmijët që janë viktimat të kësaj tregtie mbi të drejtat e tyre, t'u sigurojnë shërbime të përshtatshme ndihme, të mbrojnë jetën private dhe identitetin, sigurinë e familjeve të tyre.

Rregullat në minimum për administrimin e drejtësisë për të miturit (Rregullat e Pekinit)

U miratuan në New York më 29.11.1985 dhe përbëjnë shpalljen e parë të parimeve lidhur me të drejtën e procedurës penale për të miturit. Dokumenti i referohet

²⁵ Konventa për Luftën kundër Krimit Ndërkombëtar të Organizuar dhe Protokollet shtesë janë ratifikuar nga shteti shqiptar me ligjin Nr.8920, datë 11.7.2002, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 41, fq. 119.

fazave të ndryshme të procedimit. Neni 2 i fton shtetet të krijojnë një sistem ligjesh specifike për të miturit dhe agjencitë mbikëqyrëse. Objektivat e aktit janë: mbrojtja e të miturit dhe ruajtja e rendit shoqëror (neni 1), pra parashikimi i masave ndëshkuese në përputhje me rrethanat e kryerjes së veprës penale e të personalitetit të autorit të veprës penale (neni 5).

Nenet 17, 18, 19, 20 përcaktojnë kriteret që duhet të ndjekë gjyqtari për masat që do të merren ndaj të miturit të deklaruar fajtor dhe që mund të përmblihen si më poshtë:

- proporcionaliteti dhe individualizimi i dënimit;
- kufizimi i lirisë vetjake vetëm në rastet e dhunës ndaj personit, recidivitetit;
- moszbatimi i dënimit me vdekje dhe dënimeve trupore;
- mundësia për ta mbyllur procesin në mënyrë të ndryshme e fleksibile;
- vendosja në institucione si masë e fundit dhe për një kohë sa më të shkurtër;
- shpejtësia në ekzekutimin e trajtimit të vendosur.

Direktivat e OKB-së për parandalimin e kriminalitetit të të miturve (Direktivat e Riadit)

U miratuan me Rezolutën 45/112 të 14.12.1990 të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së. Dokumenti përcakton disa parime themelore ku i pari ka të bëjë me parandalimin e kriminalitetit të të miturve si një pjesë thelbësore e parandalimit të krimit në shoqëri. Për këtë, adoleshentët duhet t'i drejtohen veprimtarive të dobishme larg sjelljeve kriminogjene (pika 1). Që të realizohen këto objektiva, Direktivat vendosin disa linja të parandalimit të përgjithshëm që duhet të ndiqen nga qeveritë. Vëmendje e veçantë i kushtohet proceseve të socializimit ku i mituri përfshihet më tepër si familja, arsimimi, komuniteti, mjetet e komunikimit. Duhet të hartohen politika të përshtatshme sociale të shoqëruara nga një legjislacion e organe të drejtësisë për të miturit që të njohin mirë problemet e të drejtat e tyre.

Rregullat e OKB-së për mbrojtjen e të miturve të privuar nga liria

U miratuan me Rezolutën 45/113 të 2. 4. 1991 nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së. Dokumenti ka si qëllim respektimin e të drejtave, sigurisë dhe mirëqenies fizike e mendore të të miturve. Të miturit do t'i privohet liria si masë e fundit dhe për raste të veçanta (pikat 1 e 20). Trajtohen të drejtat e të miturve që në rast se parburgosen ose burgosen të mbajnë kontakt me mbrojtësit (pika 18/a), të ndjekin proceset edukative (pika 18/b), etj. Përcaktohen në mënyrë të hollësishme mënyrat e trajtimit të tyre në përputhje me karakteristikat individuale, e drejta

për t'u arsimuar, për kontroll mjekësor, për t'u argëtuar, për të zhvilluar veprimtari fetare, për të pasur marrëdhënie me familjarët e me botën e jashtme. Qëllimi përfundimtar i punës së personelit të specializuar dhe i gjithë ambientit do të jetë riintegrimi i tyre në shoqëri.

Aktet ndërkombëtare me karakter rajonal

- I. **Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (1950), me Protokollet shtesë²⁶.** Normat e Konventës mund të ndahen në dy pjesë, e para (nenet 1 - 18) me karakter substancial, e dyta (nenet 19 - 56) me karakter procedural. Në të parën përfshihet katalogu i të drejtave dhe lirive themelore që çdo shtet Palë merr përsipër t'ua sigurojë “*të gjithë personave që gjenden nën juridiksionin e tij*” (neni 1). Vetëm dy nene i referohen drejtpërdrejt të miturve: neni 5 lidhur me *ndalimin* dhe neni 6 lidhur me *karakterin publik të procesit*. Të drejtat e të miturve parashikohen dhe në nenin 2 të Protokollit të parë shtesë (20 Mars 1952) që i referohet edukimit: “*Shteti duhet të respektojë të drejtën e prindërve për të siguruar edukimin dhe arsimimin në përputhje me bindjet e tyre fetare dhe filozofike*”.
- II. Gjithnjë në nivel evropian, mes akteve për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, është **Karta sociale evropiane** e 18 tetorit 1961, nenet 7, 16, 17 dhe 19 të cilës i njohin të drejtat e fëmijëve dhe të adoleshentëve për një mbrojtje speciale nga rreziqet psikike që mund t'u kanosen.
- III. Një akt tjetër i rëndësishëm është **Konventa Evropiane për ushtrimin e të drejtave të fëmijës** e Strasburgut (25 Janar 1996). Kjo Konventë merr shkas nga Konventa e OKB-së mbi të Drejtat e Fëmijës duke i siguruar të miturit zotësinë për të vepruar në gjykim. Konventa ka si fushë zbatimit procedimet në të drejtën familjare, përfshi këtu dhe çështjet që kanë të bëjnë me pushtetin prindëror dhe të drejtën e vizitës së njërës prej prindërve.
- IV. **Rekomandimi i Këshillit të Evropës mbi përgjigjet e shoqërisë ndaj kriminalitetit të të miturve**, R(87) 20, Strasburg, 17 Shtator 1987. Me anë të Rekomandimit N. (87) 20 mbi përgjigjet sociale ndaj kriminalitetit të të miturve, ku u identifikuan tre drejtme kryesore dhe ku të përqendroheshin ndërhyrjet që janë *parandalimi, dalja jashtë rrethit gjyqësor, ndreqja e konflikteve, drejtësia për të miturit*. Lidhur me pikën e parë, Këshilli i Evropës synon të fuqizojë strukturat shkollore dhe shoqërore (klube sportive, qendra argëtimi, etj.) në mënyrë që të rinjve t'u hapen horizonte të reja dhe të merren me veprimtari që i largojnë nga situatat e rrezikshme dhe që bëjnë të mundur përfshirjen e tyre në shoqëri. Dalja jashtë rrethit gjyqësor, sipas udhëzimeve të Këshillit të Evropës, duhet të bëhet me anë të teknikave fleksibile: nga një anë duke hequr skemat procedurale të ngurta dhe nga ana tjetër duke rivendosur

²⁶ Ratifikuar me ligjin Nr.8137, datë 31.07.1996 botuar në Fletoren Zyrtare Nr.20.

paktin social falë ndreqjes së konfliktit që arrihet nëpërmjet përkrahjes së të miturit dhe bashkëpunimit të familjes së tij, duke respektuar gjithashtu të drejtat e viktimës ose të dëmtuarit nga vepra penale (neni 3). Pika e tretë është në përputhje me udhëzimet e formuluar në New York më 1985, megjithatë ia vlen të përqendrohet vëmendja mbi dy pika domethënëse: neni 15 e neni 16. *Rregulli i parë*, që tregon nevojën e eliminimit në mënyrë progresive të burgimit dhe zbatimin e masave zëvendësuese (neni 14), vë në dukje përdorimin e formave që ndihmojnë përmirësimin e të miturit. Për këtë duhet të zhvillohen veprimtari edukuese që do të mbikëqyrin sjelljen e tij, që të parashikojnë shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga i pandehuri i mitur dhe mundësinë e të miturit që të veprojë në të mirë të komunitetit. Neni 16 përfaqëson një risi në parimet e kësaj fushe, pasi synon në krijimin e mundësive për të krijuar një sistem dënimi të pavarur për të miturit. Ai do të karakterizohet si i tillë jo vetëm nga mënyrat e ekzekutimit dhe të zbatimit më të favorshme në krahasim me ato që parashikohen për të rriturit, por mbi të gjitha për elasticitetin e tij.

Duke e mbyllur, mund të themi se gjatë viteve të fundit, e drejta ndërkombëtare ka nxitur zhvillimin e një kulture mbi fëmijërinë që bazohet mbi njohjen e dinjitetit të çdo qenieje njerëzore pavarësisht nga mosha dhe gjendja e tij duke favorizuar krijimin e linjave drejtuese për mbrojtjen e të miturve. Në fushën e kriminalitetit të të miturve, ka theksuar rëndësinë për t'i kushtuar edhe këtu vëmendje “interesit të të miturit”. Në këtë drejtim bëhet fjalë, në mënyrë parësore për të drejtën dhe për edukimin si kusht për zhvillimin e plotë të personalitetit. Gjithashtu, janë vënë bazat e një drejtësie që ka si drejtime kryesore *garancinë, minimalizimin dhe mosdënimin*.

Konkluzione

Punimi u përpoq të vërë në dukje etapat e një procesi i cili, nga shekulli XIX deri më sot, po sjell realizimin e një mbrojtjeje gjithnjë e më konkrete të figurës së të miturit, tashmë i njohur si subjekt i të drejtave. Bëhet fjalë për një proces të vështirë që fillimisht gjeti terren zhvillimi në kontekstin ndërkombëtar e komunitar dhe më pas u imponua në legjislacionin e brendshëm të shteteve të veçanta. Trajtimi i akteve kryesore ndërkombëtare në mbrojtje të të miturve u bë duke mbajtur parasysh sidomos nenin 3 të Konventës mbi të Drejtat e Fëmijës që shprehet se “*në të gjitha ndërhyrjet lidhur me fëmijët, institucionet e asistencës sociale, private dhe publike, gjykatat, autoritetet administrative, organet legjislative, interesit më i lartë i fëmijës merr rëndësi të dorës së parë*”. Pranimi i faktit se i mituri është titullar i të drejtave subjektive përbën një hap përpara në drejtim të mbrojtjes së personalitetit në formim, por ende nuk siguron gjithçka që i duhet fëmijës për mirëritje të harmonishme. Mbetet mjaft i rëndësishëm fakti se në nivel komunitar

dhe ndërkombëtar është njohur e drejta e të miturit për të marrë pjesë aktivisht në të gjitha procedimet që prekin interesat e tij dhe kjo pjesëmarrje ka të bëjë me të drejtën e të miturit për t'u dëgjuar, për t'u informuar e kështu me radhë. Mbrojtja e të drejtave të të miturve në fushën e drejtësisë është shndërruar në një prioritet për komunitetin ndërkombëtar dhe evropian. Shqipëria ka ratifikuar pjesën më të madhe të akteve ndërkombëtare në këtë drejtim. Me qëllim përmirësimin e trajtimit të të miturve, është e nevojshme të shqyrtohen përvojat e vendeve të zhvilluara e sidomos atyre evropiane, të ratifikohen disa akte ndërkombëtare mjaft të rëndësishme në mbrojtje të të miturve dhe të zbatohen më mirë konventat e ratifikuara deri më tani.

Bibliografia

Akte ndërkombëtare

Deklarata e të drejtave të fëmijës e vitit 1959.

Pakti mbi të drejtat civile e politike.

Pakti mbi të drejtat ekonomike, sociale e kulturore.

Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës.

Konventa për Luftën kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar dhe 2 Protokollet shtesë.

Konventa nr.138 e ONP-së për kufirin e moshës minimale në punë.

Konventa nr.182 e ONP-së mbi format më të rënda të punës së të miturve.

Protokolli shtesë i Konventës mbi të Drejtat e Fëmijës lidhur me shitjen e fëmijëve, prostitucionin dhe pornografinë femërore.

Rezoluta A/RES/49/166 e Asamblesë së Përgjithshme e OKB-së për trafikimin e grave dhe të fëmijëve.

Rregullat minimum të Kombeve të Bashkuara për administrimin e drejtësisë për të miturit (Rregullat e Pekinit).

Rregullat e Kombeve të Bashkuara për mbrojtjen e të miturve të privuar nga liria.

Direktivat e Kombeve të Bashkuara për parandalimin e kriminalitetit të të miturve (Direktivat e Riadit).

Karta sociale Europiane.

Konventa Europiane e të drejtave të njeriut.

Konventa Europiane për ushtrimin e të drejtave të fëmijës.

Konventa e Hagës për mbrojtjen e të miturve dhe për bashkëpunimin në fushën e birësimit ndërkombëtar.

Rezoluta e Parlamentit Europian mbi trafikimin e fëmijëve dhe për fëmijët ushtarë.

Rekomandimi i Këshillit të Europës nr.87 (20) mbi përgjigjet e shoqërisë ndaj problemit të kriminalitetit të të miturve.

Rekomandimi i Këshillit të Europës nr.11 (91) mbi shfrytëzimin seksual, pornografinë, prostitucionin dhe trafikimin e fëmijëve e të adoleshentëve.

Tekste:

Lawrence Stone, *The causes of the English Revolution, 1529-1642*, Routledge, 2002, Great Britain.

- Bibla, Diodati i Ri, 1991-1994, La buona novella, Brindisi, Italy.
Minori, bioetica e norme standards, nën kujdesin e Maria Rita Saulle, Edizioni Scientifiche Italiane, Napoli, 1995.
Geraldine von Bueren, *The international law on the rights of the child*, London, Martinus Hijoff Publishers, 1995.
Francesco Milanese, *La tutela non giurisdizionale del minore*, Padova, CEDAM, 1999.
Maria Rita Saulle, *La Convenzione dei diritti del minore e l'ordinamento italiano*, Napoli, Edizioni Scientifiche Italiane, 1994.
Paolo Picone, *La nuova Convenzione dell'Aja sulla protezione dei minori* në Rivista di diritto internazionale privato e processuale, 1996.
Benedetto Conforti, *Diritto internazionale*, Napoli, Editoriale Scientifica, 1997.
Alfredo Carlo Moro, *Manuale di diritto minorile*, Bologna, Zanichelli Editore, 1996.

Gjatë punimit u konsultuan faqet e Internetit:

www.cm.coe.int
www.echr.coe.int
www.ilo.org
www.unhcr.ch
www.unicef.org
www.europa.eu.int
www.hcch.net

Barazia gjinore si një gur themeli në procesin e zhvillimit të vendit

Brikena (Buda) Dhuli

UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS,
KENADHULI@YAHOO.COM

Abstrakt

Studime të ndryshme kanë trajtuar dhe analizuar të dhëna mbi familjen, bërthamën e shoqërisë. Në këtë punim do të parashtrijmë në këndvështrimin kritik të dhëna ekzistuese gjinore për familjen të klasifikuar sipas kategorive të mëposhtme: mjedisi politik; mjedisi institucional.

I gjithë sistemi ligjor shqiptar është bazuar në parimin e barazisë dhe të mos diskriminimit. Jeta, martesja, familja gëzojnë mbrojtje të veçantë nga ana e shtetit. Ligji "Për barazinë gjinore në shoqëri" ka paraqitur vështirësi për zbatimin e tij në praktikë në lidhje me mekanizmat institucionalë dhe përgjegjësitë e tyre. Mundësitë për t'u ankuar në rastin e një diskriminimi gjinor dhe në aspekte të tjera, ndonëse parashikon si detyrë të qeverisë dhe të administratës publike nxjerrjen e statistikave gjinore në të gjithë administratën publike dhe në sektorin privat, ai nuk përcakton strukturat e caktuara shtetërore për kryerjen e kësaj detyre dhe afatet kohore të realizimit të saj. Për zbatimin e një politike të ndërgjegjshme nga pikëpamja gjinore, kërkohet një mjedis institucional i ndërgjegjshëm ndaj plotësimit të nevojave të veçanta të djemve dhe vajzave. Pra, sa i ndërgjegjshëm është ky mjedis për të zbatuar tashmë programe që adresojnë pabarazitë gjinore dhe promovojnë barazinë. Institucionet sociale përbëjnë bazat mbi të cilën ngrihet jeta sociale. Ato janë rregullatore jetike të marrëdhënieve që krijojnë qeniet njerëzore me njëra tjetrën me anë të të cilëve sigurohet vazhdimësia e brezave (Anthony Giddens). Një kusht strukturor që dëmton fuqinë e gruas në familje dhe kontribuon në fuqinë e burrit të saj dhe familjes së tij është praktika e përhapur e patrikalishtit, në të cilën gruaja e re lëviz në shtëpinë e burrit.

Fjalë kyç: Mjedis politik, sistem ligjor, mos diskriminim, mjedis institucional.

Hyrje

I gjithë sistemi ligjor shqiptar është bazuar në parimin e barazisë dhe të mos diskriminimit. Barazia gjinore është një gur themeli në procesin e zhvillimit të vendit. Për ta arritur atë, duhen shqyrtuar shkaqet e pabarazisë që ndeshen në familje, në komunitet, në tregun e punës dhe në përgjithësi në shoqërinë shqiptare. Ndarja e punës sipas gjinive krijon ngarkesa (të matura sipas kohës dhe energjive), shkallë të njohjes (të prestigjit), si dhe pushtete të ndryshme për gratë dhe burrat. Pabarazia gjinore ndikon negativisht baraspeshimin ndërmjet mundësive, kushteve të jetesës dhe statusit shoqëror e politik të grave e vajzave dhe të burrave e djemve. Në të gjithë botën jeta është e ndryshme për burrat dhe gratë. Zakonisht, gratë kanë shumë më pak të drejta dhe burime të ardhurash. Këto pabarazi kufizojnë mundësitë dhe arritjet e grave dhe kontribuojnë në një zhvillim të pabarabartë, e si rrjedhojë përjetësojnë statusin e ulët të gruas në shoqëri. Shoqëria shqiptare është patriarkale, me pritshmëri të ndryshme për sa i përket sjelljes së duhur dhe roleve të pranueshme për burrat e gratë.

Ekzistojnë mjaft stereotype për gratë, për shembull gratë konsiderohen inferiore ndaj burrave, arsimimi i grave vlerësohet më pak, gratë janë të destinuara vetëm për t'u martuar, e kështu me radhë. Si rezultat, gratë kanë fuqi të vogël për sa i përket burimeve ekonomike, kanë nivel më të lartë të papunësisë sesa burrat, që bien viktimë e çdo lloj dhune dhe përfshihen në mirësi të vogla të cilësisë së jetës së tyre, megjithë përpjekjet e tyre të pareshtura për zhvillim. Megjithatë, marrëdhëniet gjinore ndryshojnë nga njëra krahinë në tjetrën dhe janë mjaft të dukshme në zonat rurale të Shqipërisë. Pabarazia gjinore në shoqërinë shqiptare nuk është vetëm një çështje e të drejtave të njeriut por edhe një çështje zhvillimi. Integrimi i perspektivës gjinore është një punë e vështirë. Integrimi gjinor ka të bëjë me ndryshimin e qëndrimeve për sa i përket roleve, vlerave dhe statusit të burrave e grave së bashku. Ndryshimi politik e social i kërkuar nga integrimi gjinor është një proces i gjatë por me vlera. Synimi është që politikë-bërësit shqiptarë të hartojnë politika e programe të cilat do të sigurojnë barazinë ndërmjet burrit e gruas në jetën e tyre. Boshitet kryesore që kanë të bëjnë me ndryshimin e qëndrimeve ndaj ndarjes në mënyrë të barabartë të përgjegjësisë, ndërhyrjeve dhe kontrollit të burimeve dhe vendimmartjes janë:

Mjedisi politik

Aktet normative për mbrojtjen nga dhuna në familje. Vështrim i përgjithshëm

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë është akti ligjor më i lartë, i cili sanksionon parimin e barazisë dhe të mos diskriminimit, si parim përkrahës i të gjithë

legjislativ. Ajo i ka hapur rrugë zhvillimit të së drejtës së brendshme në përfaqje me standardet ndërkombëtare. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë ndalon diskriminimin për shkak të gjinisë (neni 18/2). Kjo shprehet qartë kur i referohesh terminologjisë që përdoret në të. Në terminologjinë e Kushtetutës shqiptare nuk ka kategorizime apo "etiketime gjinore". Në këtë dokument të rëndësishëm përdoren përemra të tillë, si: "të gjithë," "kushdo," "askujt," "kujtëdo," "secili" etj. dhe kjo për të treguar se bashkësia njerëzore së cilës i drejtohet dispozita, nuk bën asnjë përjashtim. I gjithë sistemi ligjor shqiptar është bazuar në parimin e barazisë dhe të mos diskriminimit. Gjithashtu, mbrojtja dhe respektimi i dinjitetit, i të drejtave dhe lirive të njeriut përbën detyrim kushtetues. Jeta, martesë, familja gëzojnë mbrojtje të veçantë nga ana e shtetit. Kushtetuta nuk e përjashton mbrojtjen e familjes edhe në rastet kur nuk është e krijuar me martesë. Fëmijët, të rinjtë, gratë shtatzëna dhe nënat e reja kanë të drejtën e një mbrojtjeje të veçantë nga shteti. Gjithashtu këto afirmime të Kushtetutës parashtrajnë detyrime për ligjvënësin. Ligji "Për barazinë gjinore në shoqëri" ka paraqitur vështirësi për zbatimin e tij në praktikë në lidhje me mekanizmat institucionalë dhe përgjegjësitë e tyre. Mundësitë për t'u ankuar në rastin e një diskriminimi gjinor dhe në aspekte të tjera, ndonëse parashikon si detyrë të qeverisë dhe të administratës publike nxjerrjen e statistikave gjinore në të gjithë administratën publike dhe në sektorin privat, ai nuk përcakton strukturat e caktuara shtetërore për kryerjen e kësaj detyre dhe afatet kohore të realizimit të saj. Herë pas here, ligji ka natyrë përkrahëse dhe nuk përcakton detyra të qarta për respektimin e barazisë gjinore. Të gjitha këto probleme kanë bërë që të ndërmerren nisma për amendimin e tij.

Mekanizmi shtetëror për barazinë gjinore në Shqipëri

Shqipëria është mjaft e pasur me strategji dhe dokumente për integrimin gjinor, por kjo nuk është e mjaftueshme pasi stereotipet e roleve gjinore dhe natyra patriarkale e shoqërisë u identifikuan si pengesat kryesore për të arritur përputhjen *de facto* me *de jure*. Shumë femra dhe meshkuj nuk e njohin diskriminimin gjinor si të tillë, por në fakt e shohin atë thjesht si një "mënyrë jetese". Pabarazia është veçanërisht e dukshme në tre fusha: politikë (udhëheqje dhe vendim-bërje), ekonomi (punësim dhe gjenerim i të ardhurave), dhe marrëdhëniet në martesë dhe familje.

Roli i së drejtës ndërkombëtare në luftën kundër diskriminimit dhe dhunës ndaj grave (me theks në dhunën në familje)

Deri në mes të shekullit XX, shtetet dhe organizatat ndërkombëtare janë konsideruar si aktore kryesore të së drejtës ndërkombëtare. Individët kishin status të veçantë dhe të rastit, si aktorë të së drejtës ndërkombëtare, kur kishin karakteristika grupi, si refugjatët dhe azilkërkuësit. Individët hynë në fokusin e së

drejtës ndërkombëtare pas krijimit të Kombeve të Bashkuara dhe pas miratimit të Kartës së saj dhe Kartës Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut, dokumente që janë piketa të së drejtës moderne ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.

E drejta ndërkombëtare e të drejtave të njeriut

Të drejtat e njeriut janë të drejta që çdo qenie njerëzore ka të drejtë të gëzojë, thjesht nga virtyti i të qenit njerëzor. Ato janë mbështetur në parimin themelor që të gjitha qeniet njerëzore zotërojnë një dinjitet njerëzor të brendshëm dhe ato janë të barabarta, të autorizuar për të gëzuar të drejtat e tyre, pavarësisht seksit, racës, ngjyrës, gjuhës, origjinës kombëtare, moshës, klasës ose besimit fetar a politik dhe lirive themelore të caktuara. Të drejtat e njeriut janë universale, zbatohen në mënyrë të barabartë dhe pa diskriminim për të gjithë njerëzit. Ato janë të patjetërsueshme – askujt nuk mund t'i hiqen të drejtat njerëzore përveçse në një situatë të veçantë. Ato janë gjithashtu të pandashme, të ndërlidhura dhe të ndërvarura. Dhunimi i një të drejte shpesh dëmton respektimin e disa të drejtave të tjera. Të drejtat e njeriut kanë qenë formuluar në norma ligjore të detyrueshme që mbrojnë individët dhe grupet kundër veprimeve që cenojnë dinjitetin njerëzor dhe liritë themelore. Dokumentet themelore janë quajtur Karta Ndërkombëtare e të Drejtave të Njeriut dhe konsistojnë në: Kartën e Kombeve të Bashkuara, Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut (UDHR), konventën ndërkombëtare “Për të drejtat civile dhe politike” (ICCPR) dhe konventën ndërkombëtare “Për të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore” (ICESCR).

Të drejtat themelore të grave

Diskutimi i të drejtave të njeriut në lidhje me pozicionin dhe çështjet e grave fillimisht ishte i pandjeshëm. Ai buronte nga koncepti dhe rregullat e së drejtës ndërkombëtare tradicionale të formuluar nga burrat. Për shkak të roleve të ndërvarura sociale të grave, ato nuk ishin të pranishme në këtë proces. Për më tepër, edhe vetë frymëzuesit dhe hartuesit e instrumenteve kryesore ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, ndërsa i drejtohen barazisë dhe mos diskriminimit, “kanë harruar” të përdorin gjuhën e ndjeshme gjinore. Historia e zhvillimit të së drejtës dhe të të drejtave të njeriut tregon se çështjet e ashtuquajtura të grave janë bërë të dukshme për shkak të rritjes së aktivitetit të grave në arenën ndërkombëtare. Karta e Kombeve të Bashkuara vendosi elemente të reja reale të një rëndësie të madhe për gratë. Kombeve të Bashkuara iu dha mandati të promovonin progresin dhe zhvillimin ekonomik e social dhe të krijonin organizma ndihmës. Organizatat e Grave e shfrytëzuan këtë mundësi. Puna e tyre dhe përpjekjet e avokatisë kontribuuan dukshëm në njohjen e të drejtave të grave, si të drejta të njeriut. Rol të madh në këtë proces luajti Komisioni i Kombeve të Bashkuara për Statusin e

Grave (themeluar në vitin 1947), i cili midis të tjerave hartoi CEDAW dhe ishte nismëtar i katërt i konferencave botërore për gratë (në Meksiko, Kopenhagën, Najrobi dhe Pekin). Këto konferenca rezultuan në dokumente të nënshkruara nga shumica e vendeve anëtare të Kombeve të Bashkuara. Me kalimin e viteve, të drejtat njerëzore të grave fituan respektin dhe njohjen që ato meritojnë, jo vetëm si tërësi e veçantë e së drejtës por edhe si pjesë integrale e të gjitha të drejtave të njeriut. Si në Konferencën Botërore të të Drejtave të Njeriut, në Vjenë, në vitin 1993, ashtu edhe në Konferencën Botërore në Pekin, të drejtat e grave u njohën si të drejta të njeriut. Për herë të parë, artikulli i tyre u pranua si aspekt i së drejtës ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Kjo njohje lehtësoi hyrjen e të drejtave të grave në kuadrin e së drejtës ndërkombëtare dhe të politikës ndërkombëtare, rajonale dhe kombëtare të të drejtave të njeriut. Miratimi i CEDAW-t u shoqërua me një numër të madh instrumentesh ndërkombëtare dhe rajonale të të drejtave të njeriut dhe dokumentesh të politikës, që detyruan qeveritë të ndërmarrin hapa në politikat kombëtare me synim mbrojtjen, përmbushjen dhe zbatimin e të drejtave të grave. Në takimet globale të Pekinit +5 (2000) dhe Pekin +10 (2005) si edhe në konferencën MILENIUM të Kombeve të Bashkuara (2000) dhe në Konferencën Botërore kundër Racizmit, Diskriminimit Racial, Ksenofobisë dhe Intolerancës (në vitin 2001), shtetet anëtare të Kombeve të Bashkuara kanë ritheksuar angazhimin e tyre për të forcuar kapacitetin e tyre në nivel vendi për të zbatuar parimet dhe praktikatat e të drejtave njerëzore të grave.

Të drejtat e grave dhe dhuna kundër grave

Të gjitha format e dhunës kundër grave shkojnë përtej sjelljes shtypëse ose diskriminimit në përgjithësi dhe përbëjnë dëm, i cili rezulton nga forca ose detyrimi. Ato janë shoqëruar me pabarazi midis burrave dhe grave dhe strategji që përjetësojnë ose rrënojnë atë pabarazi. Kështu, dhuna kundër grave është një shfaqje e pozicioneve themelore të pabarabarta, midis burrave dhe grave dhe përbën një formë të diskriminimit kundër grave.

Megjithëse instrumentit më të rëndësishëm ndërkombëtar në lidhje me gratë, CEDAW i mungon vëmendja e qartë për dhunën kundër grave, një numër i madh dokumentesh të tjera ligjore dhe të politikës së Kombeve të Bashkuara si dhe dokumente ndërkombëtare dhe rajonale argumentojnë që dhuna gjinore është formë dalluese e diskriminimit e cila përbën një dhunim të së drejtës ndërkombëtare të të drejtave njerëzore, në vetvete. Ky fakt u bë prezent për herë të parë në Konferencën e Parë Botërore për Gratë, në Najrobi, në vitin 1985. Dokumenti përmbyllës “Strategjitë e së ardhmes, Najrobi”, lidh barazinë dhe dhunën kundër grave duke pohuar se dhuna kundër grave është pengesë për barazinë dhe paqen. Qeverive iu rekomandua të intensifikonin përpjekjet për të vendosur ose për të forcuar format e ndihmës për viktimat e dhunës përmes sigurimit të strehëzave,

mbështetjes, shërbimeve ligjore dhe të tjera dhe të rritnin ndërgjegjësimin publik për dhunën ndaj gruas, si problem shoqëror. Në rekomandimin e përgjithshëm Komiteti CEDAW njeh dhunën kundër grave, duke përfshirë dhunën në familje, si formë të diskriminimit. Ai pohon që ndalimi i përgjithshëm i diskriminimit gjinor në konventë përfshin “dhunën gjinore, që është dhunë e drejtuar kundër një gruaje, sepse ajo është grua ose që ndikon mbi gratë në mënyrë disproporcionale”. Kështu, përcaktimi i diskriminimit në nenin 1 të CEDAW përfshin edhe dhunën kundër grave. Kjo do të thotë se dhuna kundër grave mund të jetë dhunim i dispozitave të veçanta të CEDAW-t. Ndërsa aktet e dhunës janë kryer në të gjithë sektorët e shoqërisë, dhuna gjinore, si dhuna në familje, është drejtuar kryesisht tek gratë me qëllim që t’u heqë atyre një gamë të drejtash dhe të ruajë varësinë e tyre si grup.

Në deklaratën “Për eliminimin e dhunës kundër grave miratuar në vitin 1993, shtetet anëtare të Kombeve të Bashkuara e njohën dhunën kundër grave si një “shfaqje të marrëdhënieve historikisht të pabarabarta të fuqisë midis burrave dhe grave, të cilat kanë çuar në sundimin dhe diskriminimin kundër grave nga burrat dhe në parandalimin e përparimit të plotë të grave”. Kjo njohje u përsërit në dokumentet e politikës të Kombeve të Bashkuara, si: Platforma për Veprim e Pekinit (1995); dokumenti përfundimtar i Asamblesë së Përgjithshme, i sesionit të veçantë të 23-të, në vitin 2000, i njohur si Pekin +5; në rezolutën 2003/45 dhe në një seri raportesh të relatorit special për dhunën kundër grave, autorizuar nga Komisioni i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut. Organizatat rajonale, gjithashtu, njohin dhunën kundër grave si dhunim të të drejtave njerëzore të grave, duke kërkuar veprime të shteteve. Në deklaratën e tij të vitit 1993, Këshilli i Europës pohon se eliminimi i dhunës kundër grave është aspekt kyç i kundërvënies ndaj pabarazisë strukturore midis burrave dhe grave. Komiteti i Ministrave, gjithashtu, ka treguar se marrëdhëniet e pabarabarta të fuqisë midis burrave dhe grave dhe struktura patriarkale e familjes janë faktorë që kontribuojnë në dhunën në familje. Në rezolutën e 1997-ës, Parlamenti Europian pohon se dhuna kundër grave është “pa kurrfarë dyshimi e lidhur me një pabarazi të fuqisë midis sekseve në sferën sociale, ekonomike, fetare dhe politike, pavarësisht shpalljes së barazisë në legjisllacionin kombëtar dhe ndërkombëtar”. Trajtimi i dhunës kundër grave si formë diskriminimi është i pranishëm edhe në nivelin kombëtar. Në disa sisteme ligjore kombëtare, forma të caktuara të dhunës kundër grave i janë nënshtruar rishikimit gjyqësor në përputhje me legjisllacionin përkatës jo diskriminues.

Dhuna në familje, si dhunim i të drejtave njerëzore të grave

Dhuna në familje është një nga format më të përhapura të dhunës dhe të diskriminimit kundër grave. Pavarësisht nga treguesit e përhapjes së kësaj forme dhune, deri së fundmi ajo nuk njihet si dhunim i të drejtave njerëzore të grave.

Dhunën në familje, si dhunim të të drejtave njerëzore të grave, për herë të parë e njohu Konferenca e Dytë Botërore e Grave në Kopenhagë (1980). Konferenca miratoi një rezolutë “Për gratë e dhunuara dhe dhunën në familje” dhe iu referua dhunës së ushtruar në shtëpi në raportin e saj final. Kjo u shtjellua në dy rekomandime të përgjithshme të Komitetit CEDAW për dhunën kundër grave. (Rekomandimi i përgjithshëm nr.12, 1989 dhe rekomandimi i përgjithshëm nr.19, 1992), ku Komiteti autorizon shtetet anëtare “të mbrojnë gratë kundër dhunës së çdo lloji, të ndodhur brenda familjes, në vendin e punës ose në ndonjë fushë tjetër të jetës sociale”. Shteteve u është kërkuar të sigurojnë informacion në lidhje me legjisllacionin dhe masa të tjera për të kundërvepruar ndaj dhunës kundër grave.

Dështimi i shteteve për t’iu adresuar dhunës në familje si dhunim i të drejtave njerëzore të grave i është atribuar ndarjes së sferës publike dhe private dhe sistemit qendror shtetëror të së drejtës ndërkombëtare. Të gjitha të drejtat njerëzore dhe liritë e listuara njihen gjerësisht nga komuniteti ndërkombëtar. Sipas Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut (UDHR): “Çdo njeri gëzon të drejtën e rendit shoqëror dhe ndërkombëtar, në të cilin të drejtat dhe liritë e parashtruara në këtë deklaratë mund të realizohen plotësisht” (neni 28). Shumica e dispozitave të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut janë bërë detyruese, si pjesë e së drejtës ndërkombëtare zakonore. Vendet veprojnë sikur dispozitat e saj të ishin ligj, duke e bërë kështu UDHR-në një ligj. Shumë vende kanë integruar të drejtat njerëzore të sipërpërmendura në dispozitat e tyre kushtetuese, duke garantuar kështu lirinë e grave nga dhuna në familje. Si ligj suprem i një shteti, një kushtetutë deklaron vlerat më të thella të shtetit dhe deklarata e shtetit që abuzimi i grave cenon vlerat e tij më të thella, është e rëndësishme. Gratë duhet të jenë të afta t’i përdorin këto deklarata kushtetuese për të bërë presion për ndryshim legjisllativ dhe për të kërkuar dëmshpërbim për dështimin e shtetit për të mbrojtur gratë në familje. Në vitin 1985, Asambleja e Përgjithshme miratoi rezolutën e parë për dhunën në familje, bazuar në një rekomandim të Komisionit për Statusin e Grave të Këshillit Ekonomik dhe Social dhe në rezultatin e Kongresit të 6-të të Kombeve të Bashkuara për Parandalimin e Krimit dhe Trajtimin e Kundërvajtësve.

Mjedisi institucional

Për zbatimin e një politike të ndërgjegjshme nga pikëpamja gjinore, kërkohet një mjedis institucional i ndërgjegjshëm ndaj plotësimit të nevojave të veçanta të djemve dhe vajzave. Pra, sa i ndërgjegjshëm është ky mjedis për të zbatuar tashmë programe që adresojnë pabarazitë gjinore dhe promovojnë barazinë. Në aspektin natyror njeriu është pjesë e botës së gjallë, si qenie biologjike kurse në aspektin shoqëror njeriu është qenie shoqërore. Faktori kryesor që ndikoi në ndarjen e njerëzve nga bota shtazore ishte puna, gjerësisht puna e organizuar, e

planifikuar dhe racionale Njeriu dhe shoqëria janë dy anë të të njëjtit nocion. Nuk ka shoqëri pa njerëz, sikurse nuk ka njerëz jashtë shoqërisë. Njeriu nuk jeton vetëm si anëtarë i bashkësisë më të gjerë. Ai gjithashtu themelon edhe grupe të ngushta në të cilat harxhohet aktiviteti i tij i përditshëm. Në mesin e këtyre grupeve të ngushta është edhe familja si grup shoqëror dhe si element i fuqishëm i strukturës globale të shoqërisë, sepse njeriu nuk jeton vetëm në shoqëri por edhe në familje. Pra, shoqëria dhe familja janë dy anë të jetës së përditshme të njeriut. Edhe vetë familja në njëfarë mënyre paraqet shoqërinë në miniaturë. Familjen shpesh na e kanë paraqitur si shoqëri familjare. Gjatë jetës së tij njeriu e kalon një pjesë mjaft të madhe të kohës në familje, një pjesë të madhe të aktiviteteve i zhvillon në familje. Pra, tërësia e ushtrimit të funksioneve familjare është arsyetimi i ekzistencës së tij si individ dhe qenie shoqërore. Familja si grup shoqëror primar dhe bio-social përcaktohet nga zakonet, rregullat kulturore dhe morale dhe në çdo rast ka detyra dhe funksione të caktuara. Nëse shoqëria kuptohet si sistem i marrëdhënieve mes njerëzve, familja në atë sistem zë vend mjaft të rëndësishëm. Në aspektin sociologjik nuk janë të rëndësishme vetëm marrëdhëniet të cilat lindin, mbahen ose ndryshojnë në “shoqërinë familjare”, por edhe marrëdhëniet mes shoqërisë si tërësi në njërin anë dhe elementeve të cilat e përbëjnë strukturën e saj ku padyshim bën pjesë edhe familja në anën tjetër. Kontaktimi dhe gërshetimi i funksioneve familjare me ato shoqërore vjen në shprehje veçanërisht në familjen bashkëkohore dhe në shoqërinë e zhvilluar industriale, e cila karakterizohet me zhvillim tekniko-teknologjik të lartë. Kur bëhet fjalë për raportin e familjes me shoqërinë globale duhet marrë parasysh kufiri kohor dhe hapësinor. Familja si institucion dhe ndërveprimi i saj me institucione të tjera përbëjnë bazat mbi të cilën ngrihet jeta sociale. Ato janë rregullatore jetike të marrëdhënieve që krijojnë qeniet njerëzore me njëra-tjetrën me anë të cilëve sigurohet vazhdimësia e brezave (Anthony Giddens). Sipas sociologëve institucionet shoqërore i përgjigjen nevojave bazë dhe kanë attribute të përbashkëta si p.sh: përgjithësisht janë të paplanifikuara dhe zhvillohen gradualisht, janë konservative; ndryshojnë por gradualisht janë të ndërvarura; për këtë arsye ndryshimet në njërin prej këtyre institucioneve ka tendencë të sjellë ndryshime tek të tjerat, së fundmi statuset, rolet, vlerat dhe normat mund të sjellin ngjashmëri dhe tek institucionet e tjera.

Bibliografia

Kushtetuta e Shqipërisë 1946;
 Kushtetuta e Shqipërisë 1976
 Kushtetuta e Shqipërisë 1998
 Kodi i familjes i RSH
 Ligji nr. 9198, datë 01.07.2004, Për një shoqëri gjinore të barabartë.
 CEDAW - Konventa për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj gruas.

Protokolli shtesë i CEDAW (1978), Ratifikuar nga Kuvendi i Shqipërisë 1993, me Ligjin nr.7767, datë 09.11.1993.

Anastasi, A. (2010): Të drejtat e gruas në legjislacionin shqiptarë.

Zaçe, V.(1999): Marrëdhëniet martesore sipas legjislacionit shqiptar.

HDPC.(2002): Shqipëria dhe objektivat e zhvillimit të mijëvjeçarit.

INSTAT.(2005):Femrat dhe meshkujt në Shqipëri.

QNL.(2006): Institucionet shqiptare për mbrojtjen e gruas në familje.

UNDP. (2014) Dhuna me bazë gjinore.

Pagimi i padetyruar sipas Kodit Civil Shqiptar dhe praktikës gjyqësore. Një analizë krahasimore

Prof. Asoc. Dr. Endira Bushati

LEKTORE, DEPARTAMENTI I SË DREJTËS PRIVATE,
FAKULTETI JURIDIK, UET.

Vështrim i përgjithshëm

Pagimi i pa detyruar është njëri nga rastet më të rëndësishme të kalimit të pajustificuar të pasurisë, si dhe një nga të parët që është njohur dhe studiuar. Instituti është sidomos evident në vendet e *Civil Law*. Që nga e drejta romake, kur nuk ekzistonte akoma një mjet i përgjithshëm për të rregulluar kalimet e pajustificuara të pasurisë, ishte parashikuar dhe disiplinuar një mjet specifik për të vendosur detyrimin e kthimit të asaj që ishte paguar pa shkak.¹ Edhe në *Common Law*, një nga paditë e para të njohura në fushën e *law of restitution* ishte padia *money had and received*, që kishte për qëllim kërkimin e kthimit të shumave të parave të marra në mënyrë të pa detyruar.² Ndërkohë që në *Civil Law*, koncepti i pagimit të pa detyruar nuk i referohet vetëm pagimit të shumave të parave, por në përgjithësi për çdo lloj sendi, tek *Common Law*, fusha e veprimit të mjetit *money had and received* është rigorozisht e kufizuar vetëm për shumat e parave. Në fakt, ndryshimi është formal. Edhe në *Common Law* është gjerësisht e parashikuar mundësia për të kërkuar vlerën jo vetëm të parasë, por edhe të sendeve të tjera dhe të punëve të kryera në mënyrë të pa detyruar. Ndryshimi i vetëm është që juristët e *common law* nuk kanë përpunuar një koncept unik të pagimit të pa detyruar të ngjashëm me atë të *civil law*, por janë kufizuar të trajtojnë ndarazi hipotezat e ndryshme sipas rastit nëse ka për objekt shuma parash (*money had and received*), sende të ndryshme nga paraja (*quantum valebat*), ose aktivitete punuese (*quantum meruit*).

¹ Giulio Levi, *Il pagamento dell'indebito*, Giuffrè Editore, Milano 1989, f. 11.

² Eliyahu Hirschberg, *The impact of inflation and devaluation on private legal obligations, legal aspects of contemporary monetary problems*, Bar-Ilan University Ramat-Gan, Israel 1976, f.48.

Juristët kontinentalë janë mësuar me kohë ta shohin pagimin e pa detyruar si një figurë specifike shumë të kufizuar. Gjatë periudhës mesjetare dhe fazave të para të së drejtës moderne, figurat unike të “quasi” kontratës të njohura ishin, pagimi i pa detyruar ose më saktë *condictiones* të ndryshme, *actio de in rem verso* dhe zgjerimi i punëve³. Edhe kur padia e begatimit, deri në ato momente e fshehur tek zgjerimi i punëve në kuptimin objektiv, u nda përfundimisht nga ky mjet, disa autorë vazhduan të përjashtojnë që pagimi i pa detyruar mund të bashkohet me figurën e begatimit pa shkak. Shumë autorë të tjerë kanë shprehur një opinion ndryshe, dhe pse padia e begatimit është njohur pas asaj të pagimit të pa detyruar, nuk kanë hezitur të ndërtojnë në terma unitarë dy institute dhe ta drejtojnë në veçanti detyrimin për të kthyer atë që është marrë në mënyrë të pa detyruar tek parimi i përgjithshëm, që ndalon të begatohesh pa shkak në dëm të tjetrit.⁴ Ky opinion i dytë është përqafuar në radhë të parë në Gjermani, ku neni 812 i BGB-së disiplinon në mënyrë të vetme pagimin e pa detyruar dhe begatimin pa shkak. Ajo më shumë është përqafuar në vendet e *Common Law*, ku tentohet të ndërtohet në një institut jo vetëm pagimi i pa detyruar dhe begatimi pa shkak, por edhe zgjerimi i punëve.

Edhe pse pagimi i pa detyruar nuk përbën një figurë në vetvete, por është shprehje e parimit të përgjithshëm që ndalon të begatohesh në dëm të tjetrit, diskutimi nuk mund të ndalet. Në fakt pagimi i pa detyruar nuk është një figurë unike. Edhe romakët dallonin në fushën e *condictio* një sërë hipotezash: *condictio indebiti*, *condictio causa data, causa secuta*, *condictio ob turpem vel injustam causam* etj. Ky klasifikim që shfaqet edhe tek BGB-ja, është braktisur nga doktrina më e fundit. Mund të thuhet që tashmë është i vjetërsuar. Ndarjet më të fundit moderne dallojnë mbi të gjitha sipas rastit kur, pagimi i pa detyruar i referohet një borxhi të vet apo të tjetrit. Në rastin e parë flitet për pagim të pa detyruar objektiv, në të dytin për subjektiv. Dallimi është i justifikuar, jo vetëm për arsye sistematike, por edhe nga ndryshimet në disiplinë që ndodhin në të dy fushat; p.sh. në Itali ndërkohë që parimisht nuk është e nevojshme prova e gabimit të *solvens* (debitor) me qëllim kërkesën për kthim të asaj që është paguar në mënyrë të pa detyruar, një provë e tillë kërkohet nga vetë kodi për pagimin e pa detyruar subjektiv (neni 2036). Kjo ndarje për pagimin e pa detyruar është tashmë përgjithësisht e pranuar.

Ka autorë që tek pagimi i pa detyruar objektiv nuk shohin një figurë unike⁵. Pagimi, në fakt mund të rezultojë i pa detyruar për dy arsye shumë të ndryshme. Rasti më i shpeshtë është ai i zbatimit të një kontrate me një ves origjinar apo të ndodhur më vonë. Natyrisht në radhë të parë i referohemi rasteve të zbatimit të një kontrate nul. Probleme të ngjashme shtrohen edhe kur, duke vazhduar tek kategoritë

³ Pietro Serena, *La gestione di affari altrui*, G. Giappichelli Editore-Torino 2000, f.56.

⁴ Alain Benabent, *Droit civil, Les obligations*, Montchrestien 2003, f. 356.

⁵ Paolo Gallo, *L'arricchimento senza causa e quasi contratti*, I rimedi restitutori, në *Trattato di diritto civile*, Utet, Torino 1996, f.650.

italiane, në rastet e anulimit dhe zgjidhjes së një kontrate. Në të gjitha këto raste nëse kontrata zbatohet (p.sh. dorëzimi i një sasive malli në zbatim të një kontrate shitblerjeje nul), lind problemi të përcaktohet cilat janë mjetet e përdorshme për të marrë kthimin e vetë sendeve në natyrë, ose në mënyrë alternative të vlerës së tyre.

Këtu dallohen ndryshime të mëdha në sisteme të ndryshme. Në të drejtën romake në këto raste përdorej *condictio*, po kështu dhe në Gjermani, ku vazhdon të zbatohet sistemi romak. Sistemit romak dhe gjerman mund t'u afrohet ai anglo-amerikan. Në vendet *Common Law*, edhe pse nuk ekziston *condictio*, në këto raste mjeti për t'u përdorur i përket *law of restitution*, me ndryshimin e vetëm në krahasim me vendet *Civil Law* që nuk çon parimisht tek kthimi i vetë sendit në natyrë, por tek vlera e tij.

Shumë e ndryshme shfaqet situata sidomos në Francë, por edhe në Itali. Mbi këtë çështje, sistemi francez është larguar nga tradita romake: në këto raste nuk përdoret më *condictio*, apo më saktë korresponduesi i tij modern, d.m.th. padia e pagimit të pa detyruar, por padia e pavlefshmërisë, që në këtë fushë ka zëvendësuar tashmë krejtësisht *condictio*. Akoma më e ndryshme shfaqet situata në Itali, ku një evolucion i tillë nuk ka përfunduar akoma. Në Itali nuk ka ndodhur absorbimi i *condictio* në padinë e pavlefshmërisë, me pasojën kështu që padia e pavlefshmërisë, nëse ngrihet, nuk çon tek kthimi i sendit. Për këtë qëllim, përkrah padisë së pavlefshmërisë, duhet të përdoret një padi e përshtatshme për kthimin, normalisht *condictio*, por edhe *revindica*. Ka vendime që kanë identifikuar konceptin e pagimit të pa detyruar me atë të zbatimit të një kontrate nul *ab initio* ose të anuluar. Megjithatë këto nuk janë hipotezat e vetme të pagimit të pa detyruar. Ka raste kur pagimi i pa detyruar ndahet krejtësisht nga prania e faktorëve të mësipërm. Në rastin kur, një shoqëri sigurimesh, e cila pasi ka lidhur një kontratë të vlefshme sigurimi, paguan në bindjen e gabuar që ka ndodhur ngjarja që prodhon lindjen e përgjegjësisë së saj, bëhet fjalë për një pagim të pa detyruar që lë vend për kthimin. Problemi që shtrohet është, se cilin mjet përdor sistemi në këto raste për të vendosur kthimin e asaj që është paguar pa të drejtë. Në pamje të parë përgjigja dihet. Duke u bërë fjalë për një rast normal të pagimit të pa detyruar, do të duhet të përdoren mjetet e parashikuara nga sistemi në këto raste, pra të njëjtat mjete që shërbejnë për të kërkuar atë që është dhënë në zbatim të një kontrate nul, d.m.th. *condictio* dhe mjetet korrisponduese anglo-amerikane. Kjo përgjigje sigurisht që është korrekte, por nuk mban parasysh faktin që ka sisteme, në të cilat për të marrë atë që është dorëzuar në ekzekutim të një marrëveshjeje nul, nuk përdoret *condictio*, por padia e pavlefshmërisë. Fenomeni është veçanërisht i qartë në Francë ku, në fushën kontraktore padia e pavlefshmërisë ka tashmë krejtësisht absorbuar *condictio*⁶. Po kështu është e perceptueshme edhe në sistemet e tjera, ku dallohen ndryshime të dukshme të kushteve, sipas rastit nëse bien ose jo në fushën kontraktore. Dhe është pikërisht prania e ndryshimeve të tilla të regjimit

⁶ Jacques Ghestin, *Traite de droit Civil, la formation du contrat*, L. G. D. J. 1993, f.734.

që justifikon dallimin mes rasteve të pagimit të pa detyruar në kuptimin e ngushtë dhe pretendimeve për kthim që rrjedhin nga zbatimi i një kontrate me ves.⁷

Vështrim historik në legjislacionin shqiptar

Kodi Civil i Zogut

Kodi Civil i vitit 1929, u hartua nën ndikimin e drejtpërdrejtë të modeleve romaniste të së drejtës private, me ndikim të qartë italo-francez.⁸ Vetë Kodi, ka në fund të tij një *Tabelë Konkordimi midis Kodit Civil Shqiptar dhe kodeve të huaja*, ku duket qartë referimi tek Kodi Civil Italian, francez, zviceran, gjerman, egjiptian, dispozitat paraprake të Kodit Civil Italian dhe Projekti i përbashkët italo-francez mbi obligimet⁹.

Kodi Civil i Zogut e parashikonte institutin e begatimit pa shkak tek Libri i Katërt "Mënyrat e fitimit dhe të transmetimit të zotërimit dhe të drejtave të tjera mbi sendet", në Titullin II *Obligimet dhe Kontratat përgjithësisht*, seksioni V. Neni 1148 i Kodit përcakton: *Ai që begatohet pa shkak në dam të një personi tjetër, asht i detyruar, brenda kufijve të begatimit, me shpërblye atë person për sa asht varfënuar*. Kështu, ai i jep parimin e përgjithshëm, duke përcaktuar a) ekzistencën e dëmit; b) mungesën e shkakut; c) detyrimin për kthim në kufijtë e begatimit. Kodi mjaftohet vetëm me këtë nen, mbi *begatimin pa shkak*.

Ndërkohë, në Seksionin III, nenet 1136-1140, trajtohen nga *zgjerimi i punëve*, pa harruar dhe përkthimin në frëngjisht të termit (*gestion d'affaires*), duke dëshmuar qartë ku ishte bazuar legjislatori.

Kodi vazhdon në Seksionin IV, (nenet 1141-1147) duke trajtuar *Pagimin e pa detyruar*. Në nenin 1141 jepet përcaktimi: "*Çdo pagim supozon një detë: kur një gja asht paguar pa qenë e detyruar, mund të kërkojë kthimi i saj. Nuk pranohet kërkimi për kthimin e një gjaje të dhanë kundrejt një obligimi natyral që asht ekzekutue me dashje*". Në nenet e mëpasme trajtohen hipoteza të ndryshme.

Neni 1142 përcakton: të drejtën për të kërkuar kthimin e asaj që ka paguar për atë "*që lajthimisht i ka paguar një personi që nuk ishte kreditor i tij*. Në rastin kur ai që mendon se është debitor, "*paguen kreditorin e vërtetë, nuk e ka atë të drejtë në rast që kreditori, duke qenë në mirëbesim, asht privue nga titulli i kredisë ose ka heqë dorë nga garancitë e kësaj. Në këtë rast ai që ka paguar, ka të drejtë kthimi kundra debitorit të vërtetë*".

Neni 1143 trajton rastin kur personi që ka marrë "gjanë" e pa detyruar është në keqbesim. Në këtë rast, "*detyrohet me kthye si kryegjanë, ashtu dhe kamatat ose frytet që prej ditës së marrjes*". Ndërsa "*Në qoftë se ai që ka marrë një gja të pa detyruar, ka*

⁷ Grup autorësh, *Risarcimento del danno contrattuale ed extracontrattuale*, Giuffrè Editore 1999, f.367.

⁸ Veprimet juridike, Ardian Nuni, Tiranë, 2001, Julvin, f.9-18.

⁹ Shih Kodi Civil i 1929, botimet Toena 1998, f.549.

qenë i pazoti, nuk detyrohet veçse brenda kufijve të begatimit, edhe sikur të ketë qenë në keqbesim”.

Neni 1145 përcakton kthimin e “gjasë” së marrë në natyrë, n.q.s. ajo ekziston. Ndërsa “Në qoftë se ka marrë gjanë me keqbesim dhe kjo ka humbë, ose asht cenue qoftë dhe prej rasti fator, detyrohet me kthye vleftën e gjasë simbas çmimit që ka gjaja ditën e kërkesës; por ai që ka dhanë gjanë e pa detyrueme ka të drejtë, në vend të vleftës, me kërkuje vetë gjanë e cenueme dhe një shpërblim për pakësimin e vleftës”.

Në rastin kur sendi i marrë në mirëbesim është tjetërsuar para se të dihet detyrimi për kthim, “detyrohet me kthye ekuivalentin që ka marrë ose me cedue të drejtën e padisë për kërkimin e sendit. Në qoftë se jetërsimi asht ba me titull darovor, vetësuesi (acquireur) i tretë asht i obliguem brenda kufijve të begatimit të tij, kundrejt atij që ka pague pa qenë i detyruem.” Ai që ka ditur për detyrimin për kthim dhe e ka tjetërsuar “gjanë” e marrë me mirëbesim, “detyrohet me kthye gjanë në natyrë ose vleftën e saj simbas çmimit të ditës, në të cilën asht vënë në morë për kthim; por ai që ka pague gjanë e padetyrueme ka të drejtë me kërkuje o ekuivalentin e marrë për jetërsim, ose cedimin e së drejtës së padisë”.

Në rastin kur “jetërsimi asht ba me titull darovor dhe jetërsuesi nuk kthen gjanë, vetësuesi asht i obliguem brenda kufijve të begatimit të tij, kundrejt atij që ka pague gjanë e padetyrueme¹⁰.”

Neni 1147 përcakton detyrimin e personit që i kthehet “gjaja” “me i rimbursue poseduesit, edhe sikur ky të jetë në keqbesim, shpenzimet e nevojshme që ka ba. Në qoftë se shpenzimet janë të dobishme, ka tagrin me rimbursue shumën e shpenzimeve ose me pague shtesën e vleftës (la plus-value) të gjasë”.

Kodi i vitit 1929, nuk mund të trajtonte më gjerësisht figurat e pagimit të pa detyruar dhe zgjerimit të punëve të tjetrit, edhe pse për sa i përket begatimit pa shkak është kufizuar vetëm ta shpallë si parim të përgjithshëm.

Ligji nr. 2359, datë 15.11.1956 “Mbi veprimet juridike dhe detyrimet”

Ligji “Mbi veprimet juridike dhe detyrimet” e vitit 1956, në përputhje të plotë me frymën e regjimit të vendosur, në nenin 33 përcaktonte: “Detyrimet lindin nga aktet e planifikimit të ekonomisë popullore, nga veprimet juridike të parashikuara në ligje dhe veçanërisht nga kontratat, si dhe nga shkaktimi i dëmit dhe nga begatimi pa shkak”, duke e renditur kështu begatimin pa shkak si burim të lindjes së detyrimeve.

Detyrimet që lindin nga begatimi pa shkak trajtohen në kapitullin XXIX, në nenet 501-504. Në nenin 501 jepet përkufizimi: “Personi që ka fituar ose ka kursyer diçka në dëm të një personi tjetër, pa ndonjë shkak të ligjshëm, ose për një shkak që nuk është vërtetuar, ose është zhdukur më pas, detyrohet të kthejë atë që ka fituar ose ka kursyer në dëm të tjetrit”.

¹⁰ Neni 1146, Kodi Civil 1929.

Për sa i përket padisë, sipas nenit 504 padia mund të ngrihet vetëm për atë kërkim ku, nuk është e mundur të ngrihet nga një padi tjetër. Afati i parashkrimit fillon që nga dita që i dëmtuari ka ditur ose duhej të dinte për fitimin ose kursimin pa shkak të tjetrit.

Në Kapitullin XXI parashikohet “Veprimtaria në dobi të një personi tjetër pa porosinë e tij”, në nenet 385-389. Legjislatori nuk e ka quajtur “të arsyeshme” ta cilësojë zgjerim të punëve të tjetrit.

Neni 385 përcakton: “Personi që vepron për të ndaluar një dëm që u kanoset interesave pasurore të një personi tjetër, pa porosinë e këtij, ka të drejtë të kërkojë që t’i paguhen shpenzimet e nevojshme që ka bërë për këtë qëllim. Personi që ka vepruar në dobi të një personi tjetër pa porosinë e tij është i detyruar t’i dorëzojë këtij personi gjithçka ka marrë për shkak të kësaj veprimtarie.” Ndërkohë, në literaturë trajtoheshin si raste të begatimit pa shkak: a) pagimin e pa detyruar, b) ekzekutimin e detyrimit të një veprimi juridik të pavlefshëm, c) marrja e asaj që nuk është e detyruar kur mes palëve ekzistojnë marrëdhënie kontraktore.

Kodi Civil 1981

Kodi Civil i vitit 1981 në Kreun V, nenin 140, përcakton burimet e lindjes së detyrimeve.

“Detyrimet lindin edhe nga veprimet juridike të parashikuara nga ligji dhe veçanërisht nga kontrata, nga shkaktimi i dëmit dhe nga përfitimi pasuror pa të drejtë.”

Në Kreun IX, neni 350 përcakton Detyrimet që lindin nga përfitimi pasuror pa të drejtë: “Personi që ka përfituar ose ka kursyer një pasuri në dëm të një personi tjetër pa ndonjë shkak të ligjshëm ose për shkak që nuk është vërtetuar ose është zhdukur më pas detyrohet të kthejë atë që ka përfituar ose kursyer në dëm të tjetrit.

Në nenin 64 përcaktohet: “Nuk mund të kërkohet kthimi i sendeve ose i të hollave që një person ka dhënë vullnetarisht për përmbushjen e një detyrimi, i cili, megjithëse i pa kërkueshëm, nuk është i pavlefshëm, ose që ka dhënë për përmbushjen e një detyrimi të veçantë për të në pajtim me rregullat e moralit socialist”.

Ndërkohë, ky kod “nuk e ka parë të arsyeshme” të rregullojë institutet e pagimit të pa detyruar dhe të zgjerimit të punëve.

Pagimi i pa detyruar në Kodin Civil Shqiptar. Praktika gjyqësore shqiptare

Pagimi i pa detyruar parashikohet në Titullin VI në nenet 653-654 të Kodit Civil. Literatura jonë e cilëson pagimin e pa detyruar si rast të begatimit pa shkak.¹¹ Çdo

¹¹ A. Nuni, A. Vokshi, I. Mustafaj, E drejta e detyrimeve, 2008, f.187. A. Sallabanda, E drejta e detyrimeve, 1962, f.368.

pagesë prezumon ekzistencën e një detyrimi, dhe marrjen e diçkaje për të cilën nuk ekzistonin detyrimet, cilësohet begatim pa shkak. Po kështu pranohet që jemi para rastit të pagimit të pa detyruar, kur personi vepron në gabim, pra, paguan diçka të pa detyruar dhe këtë nuk e di. Dijenia apo padijenja e personit që përfiton pagesën lidhet me qenien e tij në mirë apo keqbesim. Neni 653 përcakton: “*Cilido që ka bërë një pagim të pa detyruar, ka të drejtë të kërkojë kthimin e asaj që ka paguar, si dhe të gëzojë frytet dhe kamatat nga dita e pagimit, nëse personi që ka marrë pagesën është në keqbesim, dhe nga dita e kërkesës për kthim, kur personi është në mirëbesim.*”

Në çështjen *Alban Tirana Nascendo Al sh. p. k. v. Procredit Bank sh. a.*¹², paditësi pretendonte bazuar në nenin 653 KC, se në rastin e likuidimit të kredisë para afatit të përcaktuar në kontratë, ai ka paguar një gjobë prej 8869 Euro, si rezultat i zbatimit të rregullores së bankës, e cila ishte miratuar pas lidhjes së kontratës së huasë. Paditësi kishte lidhur me të paditurin një kontratë huaje, në të cilën parashikohej se shlyerja e kredisë para afatit nuk lejohet dhe në rast të kundërt, huamarrësi do të paguajë një gjobë në përputhje me rregulloren e brendshme të huadhënësit. Paditësi e ka njoftuar të paditurin se do të paguante para afatit, i paguari e ka njoftuar për gjobën që do të paguante në këtë rast dhe për këtë është lidhur një akt-marrëveshje. Gjykata e rrëzon padinë me arsyetimin: “*palët në akt-marrëveshjen... janë marrë vesh për pagimin e gjobës, shumën e gjobës dhe të gjitha kushtet e tjera të shlyerjes së parakohshme të kredisë dhe me vullnetin e tyre të lirë kanë kryer veprimin juridik për shlyerjen... Marrëveshja është e vlefshme, është shkak i ligjshëm dhe e detyron paditësin të kryejë pagesat konform përcaktimeve të saj. Pranimi i shlyerjes së kredisë para kohe është një veprim juridik i ri dhe për aplikimin e gjobës do të zbatohet rregullorja që ishte në fuqi në kohën e kryerjes së këtij veprimi juridik. Zbatimi i kësaj rregulloreje... është pranuar me vullnetin e lirë të paditësit.*”

Në një rast tjetër, në çështjen *Telesport sh. p. k. v. Dega e Doganës Tiranë*, paditësi është regjistruar si person juridik për transmetime radiotelevizive e mediave lokale. Për këtë ka importuar disa pajisje televizive dhe për të cilat ka paguar taksën doganore prej 4.0003.439 lekë. Paditësi i është drejtuar të paditurit administrativisht që t'i kthejë shumën e paguar si TVSh, sepse në bazë të një Vendimi të Këshillit të Ministrave, ai përjashtohet nga një pagesë e tillë, por përgjigjja ka qenë negative. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë konkludon se vendimet e gjykatave të shkallës së parë dhe apelit që kanë pranuar padinë, janë të drejta dhe të bazuara në ligj, duke i lënë këto në fuqi. Neni 654 parashikon: “*Personit që i ka paguar detyrimin e një tjetri duke besuar se ishte debitor, në bazë të një lajthitjeje të kryer pa faj, mund t'i kthehet ajo që ka paguar, me kusht që kreditori të mos jetë privuar në mirëbesim prej titullit dhe garancive të kredisë*”. Kthimi i pagesës duhet të shoqërohet me frytet dhe kamatat sipas parashikimit në nenin 653.

¹² Vendim nr.3126, datë 1.6.2006 i Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.

Në çështjen *S. D.V. Eurogas sh. p. k.*¹³, kërkohet detyrimi i të paditurit të paguajë shumën prej 1084499 lekë si pagim i pa detyruar dhe kamatat mbi këtë shumë. Gjykata e shkallës së parë e ka pranuar padinë, Apeli ka lënë në fuqi vendimin. Rezulton se paditësi ka punuar pranë të paditurit, i cili merrej me mbushje e tregtim gazi të lëngët. Pala e paditur përbëhej nga tre ortakë dhe një administrator. Sipas autorizimit nga administratori, paditësi ka qenë i përfshirë në listën e personave që mund të kryenin zhdoganimin e autoboteve me gaz që vinin nga Greqia, autorizim ku shprehej se për kryerjen e zhdoganimit, veprimet do të kryhen nga arka e firmës. Paditësi pretendon se në 6 raste të shkëputura, ka paguar, në mirëbesim me paratë e tij personale për zhdoganimin për llogari të të paditurit, me qëllim për të mos penguar veprimtarinë e kësaj të fundit. Për këtë arsye kërkon kthimin, si pagim i pa detyruar, bazuar në nenin 653 KC. I padituri ka prapësuar se, kjo shumë është tërhequr nga arka e saj prej ortakut N.P., i cili ka qenë personi i ngarkuar për të bërë tërheqjen e parave nga arka e shoqërisë për zhdoganimet dhe për veprimet e kryera nga ky ortak me të tretët, ajo nuk mban përgjegjësi. Ky ortak ishte larguar nga shoqëria.

Gjykata e Lartë ka çmuar: “*Me arsyetimin se, paditësi nuk kishte ndonjë detyrim ligjor ose kontraktor ndaj palës së paditur për të bërë zhdoganimet me paratë e tija personale dhe këto para pala e paditur nuk ia ka kthyer, gjykatat ia kanë pranuar atij padinë për detyrimin e palës së paditur për këtë pagim të pa detyruar. Në këtë rast gjykatat, duke e interpretuar gabim përmbajtjen e nenit 653 të KC, ku e ka bazuar padinë paditësi, për pasojë e kanë zbatuar keq atë dispozitë. Gjykatat kanë arsyetuar se... paditësi e ka bërë për llogari të palës së paditur... dhe me kusht që pala e paditur t'ia kthente ato më pas, megjithëse për këtë nuk kishte ndonjë marrëveshje mes tyre.*” Vërtet paditësi përfshihej në listën e personave të autorizuar... për të kryer veprime zhdoganimi, por jo me paratë e tij personale. Këto veprime ai mund t'i kryente me paratë e tërhequra nga arka e palës së paditur. Aq më tepër që ai kishte statusin e të punësuarit... dhe nuk kishte pse të bënte pagesa për llogari të saj me paratë e tij. “*Pagimi i pa detyruar lidhet me përmbushjen e një detyrimi juridiko-civil, sikurse është rasti kur kërkohet detyrimi i dhënë në ekzekutim të një kontrate, që më vonë konstatohet nul ose shpallet e pavlefshme dhe pala që e ka plotësuar këtë detyrim kërkon rikthimin e asaj që ka dhënë, ose në rastet kur janë përmbushur detyrimet që janë të parashkruara, etj., pra, për të pasur pagim të pa detyruar kërkohet si element thelbësor që të jetë përmbushur një detyrim civil. Në rastin në gjykim nuk del që të ekzistojë ky detyrim për paditësin. Element tjetër për ekzistencën e një detyrimi të tillë është shtimi i pasurisë së palës që ka përfituar nga pagimi i pa detyruar në atë masë që i është pakësuar pasuria palës që ka paguar detyrimin. Në rastin në gjykim del që, pala e paditur i ka nxjerrë nga arka ato para për zhdoganimin e autoboteve me gaz dhe për rrjedhojë nuk e ka përfituar atë shumë.*”

¹³ Vendim i Gjykatës së Lartë nr.402, datë 26.4.2002.

Kushtet për pagimin e pa detyruar

Një pikë mbi të cilën ka një marrëveshje në të gjitha sistemet, është që, pagimi mund të jetë i pa detyruar vetëm në qoftë se nuk ekziston detyrim për t'u përmbushur. Marrëveshja pushon në këtë pikë. Në veçanti, sistemet ndahen në dy grupe, sipas faktit nëse pagimi i pa detyruar presupozon vetëm inekzistencën e detyrimit apo edhe kritere të tjera, si p.sh. gabimin e *solvens*¹⁴. Mund të thuhet që kjo zgjidhje, në bazë të së cilës nuk është e mjaftueshme prova e thjeshtë e inekzistencës së detyrimit, duket se është më e përhapura, e cila në përputhje me traditën romake, ku kërkohet prova e gabimit të *solvens*, është përfaqëuar si në Francë dhe Gjermani dhe në *Common Law*. Në këtë kuadër duket se largohet vetëm Italia, ku tashmë mbizotëron ideja se, është e mjaftueshme prova e inekzistencës së detyrimit. Në të vërtetë, kjo kundërshti është më shumë në dukje sesa reale. Edhe në sistemet e tjera, kërkesa ose kriteri i gabimit tenton në praktikë të zbehet gjithnjë e më shumë, me pasojën që në planin operativ nuk dallon ndryshime me rëndësi as në Itali, as në vendet e *Civil Law*, as në vendet e *Common Law*.

Në *Common Law*, sipas juristëve anglezë, për pagimin e pa detyruar, nuk është e mjaftueshme inekzistenca e borxhit, por kërkohet prova e gabimit të *solvens*. Në fillimet, jo çdo lloj gabimi linte vend për pagimin e pa detyruar. Ishte i dukshëm konfuzioni që ekzistonte akoma në këtë sektor në fillim të shekullit dhe nga ku rridhte ngatërrimi i etikës me të drejtën dhe argumentimet juridike me ato të rregullave morale. Arsyet e këtij fenomeni mund të shpjegohen me përpunimin e pakët për të mos thënë inekzistent doktrinal në fushë. Në Angli, vetëm në 1966 doli botimi i parë i traktatit mbi *Law of Restitution* e Goff dhe Jones. Pikërisht gjyqtari Goff bëri një reformë dhe thjeshtim në çështjen *Barclay's Bank Ltd. V. W. J. Sims & Son* (1979).¹⁵ Si në *Common Law*, ashtu dhe në kontinent, zakonisht përjashtohet detyrimi për kthim në rastet kur personi *solvens* e ka paguar shumën e kreditorit të gabuar ose për të shuar një borxh inekzistent, në rastin kur ekziston normalisht një raport tjetër që mund të justifikojë vetë pagesën. Në *Common Law* nuk është e

¹⁴ Ai që kryen pagimin e një detyrimi. *Accipiens* ai që merr pagimin, zakonisht kreditori.

¹⁵ Një bankë për shkak të gabimit të bërë nga një vartës që nuk kishte marrë parasysh një urdher për pezullimin e një pagese, kishte paguar një çek. Pasi zbuloi gabimin, banka paditi përfituesin duke e fituar çështjen. Gjatë procesit, pala kundërshtarë ishte munduar të mbrohej duke iu referuar jurisprudencës së mëparshme, e cila në raste të atilla kishte mohuar kthimin për sa kohë që gabimi nuk ishte shkaktuar nga *accipiens*, por gjyqtari Goff vendosi në favor të bankës. Ky vendim nuk është i rëndësishëm vetëm për këtë, por mbi të gjitha sepse ky gjyqtar formuloi një parim gati të përgjithshëm, në bazë të të cilit kushdo që kryen një pagesë gabimisht, pavarësisht nga lloji i gabimit, me kufizimin e vetëm që duhet të bëhet fjalë për një gabim fakti, duhet në parim ta kthejë. Me fjalë të tjera, prezumohet e drejta e tij që të kërkojë pagimin e padetyruar deri në një provë të kundërt. Ky prezumim mund të bjerë, n.q.s. vërtetohet: a) që personi *solvens* në çdo rast synonte të paguante; b) nuk bëhej fjalë për një pagim të padetyruar; c) ose duke treguar ekzistencën e ndonjë fakti pengues, si p.sh. *change of position*.

mjaftueshme inekzistenca e borxhit, por kërkohet edhe vesi i konsensusit: gabim (*mistake*), mashtrim (*misrepresentation*) ose dhunë (*duress*).

Situata është e ngjashme në Gjermani dhe në Francë. Kodi i Napoleonit ka përfaqëuar një konceptim rigorozisht objektiv të pagimit të pa detyruar, duke mos kërkuar provën e gabimit për kthimin, dhe duke u kufizuar të sanksionojë që çdo pagim i pa detyruar i lë vend kthimit (neni 1235). Prova e gabimit kërkohet vetëm në rastin e pagimit të borxhit të tjetrit (neni 1377). Menjëherë pas daljes së kodit, doktrina në mënyrë unanime iu përmbajt gjithsesi traditës romane, në bazë të së cilës kush paguan me vetëdije një borxh inekzistent kryen në fakt një dhurim. Edhe jurisprudenca, pas daljes së kodit ka vazhduar të bënte atë që bënte më përpara, d.m.th. të zbatonte të drejtën komune, në bazë të së cilës në mungesë të gabimit bie në skemën e dhurimit. Ky rregullim ka filluar të rivihet në diskutim edhe në Francë. Në Francë kthimi lidhet jo vetëm me gabimin, por më shumë, me vese tradicionale të vullnetit, d.m.th. gabimi në deklarimin e vullnetit dhe dhuna. Madje është diskutuar nëse, mund të pranohet dhe rëndësia e gjendjes së vështirë shpirtërore, si p.sh. dhimbja për vdekjen e një personi të dashur. Është e qartë se si edhe në Francë, nuk konsiderohet e mjaftueshme prova e thjeshtë e mungesës së borxhit, por kërkohet më tepër një tjetër ves i konsensusit, parimisht gabimi, por edhe vese të tjera.

Situata shfaqet e ngjashme dhe në Gjermani, ku është vetë kodi që përjashton mundësinë për kthim “*nëse kush ka paguar e dinte që nuk ishte i detyruar për pagimin*”, sipas parimit *nemo potest contra factum proprium venire* (neni 814 BGB). Në këtë kuadër, i vetmi sistem që ndryshon duket Italia ku, doktrina dhe jurisprudenca duken tashmë unanime kur pohojnë që për kthimin e asaj që është paguar e pa detyruar, është e mjaftueshme prova e thjeshtë e mungesës së vetë borxhit.¹⁶ Ka një kundërshti të pastër mes sistemeve që kërkojnë vetëm provën e inekzistencës së borxhit dhe sistemeve që kërkojnë gjithashtu provën e një vesi të vullnetit: *gabimi*

¹⁶ E vërteta nuk ka qenë gjithmonë kështu në Itali. Kodi i vjetër Italian i 1865, në mënyrë jo të ndryshme nga ai francez, kufizohej të kërkonte gabimin për pagimin e borxhit të tjetrit (neni 1146). Në doktrinën diskutohej nëse, gabimi ishte apo jo një kriter për kthimin e asaj që ishte paguar pa qenë i detyruar edhe jashtë kësaj hipoteze. Autorët ndaheshin në mbështetës të tezës subjektive apo objektive, pra autorë që kërkonin në çdo rast provën e gabimit dhe autorë që anasjellas i përmbaheshin më shumë fjalë për fjalë kodit, duke kërkuar një provë të tillë vetëm në rastin e pagesës së borxhit të tjetrit. Në jurisprudencë mbizotëronte në fakt opinioni, në bazë të së cilit një pagim i bërë me vetëdije binte në skemën e dhurimeve dhe nuk linte vend për kthim. Me shekullin e ri situata duket se ndryshon. Si në doktrinë, ashtu dhe në jurisprudencë, fillon të mbizotërojë teza shtrënguese, në bazë të së cilës gabimi është një kusht për kthimin vetëm në rastin e pagimit të pa detyruar subjektiv. Kjo tezë ishte e destinuar të mbizotëronte. Kodi i ri ka sanksionuar në terma shumë të përgjithshëm parimin që kushdo që ka kryer një pagim të pa detyruar, ka të drejtë t'i kthehet ajo që ka paguar (neni 2033). Prova e gabimit kërkohet vetëm për rastin subjektiv (neni 2036), parime këto që, pas kodifikimit janë përfaqëuar përgjithësisht si në doktrinë, dhe jurisprudencë, dhe nuk u vunë më në diskutim.

dhe *dhuna*. Të gjitha sistemet e konsideruara me përjashtim të Italisë, duket se e kanë përqaftuar zgjidhjen e dytë. Studimi i kazuistikës vërteton që kundërshtia nuk është reale, por në dukje.

Tërësia e rasteve në të cilat kryhet pagimi në mënyrë të vullnetshme, pavarësisht mungesës së gabimit, është shumë më e gjerë se rastet në të cilat qëllimi i pagesës është dhurimi.

Rasti i dhurimeve nuk është në fakt i vetmi në të cilin është përjashtuar kthimi i asaj që është paguar pa shkak. E drejta në fakt mundet ta respektojë pagimin e bërë pa shkak (dhe ta bëjë ireversibël), jo vetëm sepse ka leverdi morale (detyrim natyral në kuptimin e gjerë francez), ose leverdi ekonomike (kontrata është nul, por mbase de facto arrihet në kundër shpërblim). Në këto raste nuk do të jetë i mundur kthimi, jo aq shumë sepse nuk ka gabim, por sepse është vepruar në liri të plotë, ose sepse të lëvizur nga arsye të leverdisë morale ose ekonomike në kuptimin e mësipërm, ose akoma, sepse është dashur të kryhet një transaksion e kështu me radhë. Në të kundërt, do të jetë gjithashtu e vërtetë që, prova e thjeshtë e mungesës së gabimit nuk është në vetvete e mjaftueshme për të përjashtuar kthimin, nëse nuk bie në një nga rastet e ndryshme si më sipër në të cilat është e përjashtuar (dhurimi, detyrimi natyral e kështu me radhë).¹⁷ Duket qartë që, lidhja me ekzistencën ose jo të gabimit është një kriter i ashpër për ta zgjidhur çështjen. Nuk është në fakt mungesa e gabimit që përjashton kthimin, por prania e ndonjë faktori të konsideruar të përshtatshëm nga sistemi, d.m.th. prania e një dhurimi, të një detyrimi natyror, etj. Këto janë raste, në të cilat të gjitha sistemet e konsideruara, përfshirë edhe Italinë, është vendosur përjashtimi i detyrimit për kthim. Si në Francë, edhe në *Common Law*, kthimi i asaj që është paguar në zbatim të një kontrate nul, përjashtohet në çdo rast nga prova e gabimit të *solvens*. Për këtë qëllim është fakt i mjaftueshëm të vërtetohet inekzistenca e borxhit, pra vesi që e bën nul kontratën. Qëllimi për të zbatuar një kontratë, edhe pse me ves përjashton në vetvete qëllimin liberal, ose më saktë çon logjikisht në një përmbysje të barrës së provës. Në rastet e ekzekutimit të një kontrate nul prezumohet deri në provë të kundërt, karakteri i pa detyruar i pagimit, përveç provës nga *accipiens* që personi *solvens* kishte ndërmend të vepronte me dëshirën e vet. Italia duket se është sistemi i vetëm në të cilin prova e gabimit nuk kërkohet. Arsyet e këtij ndryshimi në rregullim gjendet tek fakti që në Itali dhurimi manual (neni 783 KCI), si dhe ndreqja e dhurimit të pavlefshëm përmes ekzekutimit (neni 799), është pranuar në terma shumë të ngushtë, sigurisht shumë më të ngushtë nga sa është pranuar në Gjermani, Francë dhe vendet e *Common Law*, me pasojën që ekzistojnë probleme më të vogla interference mes disiplinës së kthimit të pagimit të pa detyruar dhe asaj të dhurimeve. Pavarësisht këtyre ndryshimeve, është e qartë që edhe në Itali, prania e lirisë për të paguar vlen në çdo rast për të përjashtuar kthimin.¹⁸ Fenomeni

¹⁷ Jean Carbonnier, Droit civil, Les obligations, bot.11, Paris 1982, f.496.

¹⁸ Giulio Levi, Il pagamento dell'indebito, Giuffrè Editore, Milano 1989, f.48.

është i dukshëm në fushën e marrëdhënieve mes familjarëve. Është e qartë që kush kryen një dhurim, edhe me vlerë të vogël në kuptim të nenit 783 KCI, nuk mundet që më pas thjesht të ndryshojë mendim në një moment të mëvonshëm, duke kërkuar kthimin përmes disiplinës së pagimit të pa detyruar. Një diskutim i ngjashëm mundet të përsëritet dhe për detyrimet natyrore, që sigurisht dhe në Itali vlejnjë për të përjashtuar lindjen e detyrimit (neni 2034 KCI). Është meritë e doktrinës italiane që arrijtjet e para në konkluzionin e përjashtimit a priori të rëndësisë së gabimit, duke e eliminuar atë dhe duke tejkaluar një keqkuptim, origjinat e fundit të të cilit humbin të drejtën romake. Tashmë edhe në sistemet e tjera, evolucioni ka çuar në rezultate thelbësisht të ngjashme. Në Gjermani, tashmë ka kohë që gabimi nuk konsiderohet me fakt konstitutiv të kërkesës, por ndalues, barra e provës e së cilës, i takon të paditurit. Po kështu dhe në Francë, gabimi tenton të jetë i prezumuar mbi bazën e natyrës thjesht të pa detyruar të pagimit. I takon të paditurit barra për t'u aktivizuar për të vërtetuar ndonjë faktor të konsideruar të përshtatshëm për ta bërë pagimin të pakthyeshëm.

Kur ka ndërhyrje të një personi të tretë, jemi para rastit të pagimi të pa detyruar subjektiv. Kemi pagim të pa detyruar subjektiv, në radhë të parë kur një person paguan një borxh të tjetrit (pagim i pa detyruar subjektiv *ex latere solventis*). Në këtë fushë mund të verifikohen dy hipoteza të dalluara mirë: a) mundet që i treti i huaj ta ketë paguar borxhin e tjetrit spontanisht, pra me vetëdijen se po paguan borxhin e një personi tjetër; b) mund të ndodhë që kush ka kryer pagimin të ketë vepruar gabimisht, pra në bindjen e gabuar që është i detyruar personalisht të shlyejë borxhin. Në rastin e dytë nuk shtrohen probleme të veçanta. Në të gjitha sistemet e konsideruara, është në fakt e qartë që, pagimi gabimisht i borxhit të një tjetri nuk ka efikasitet shues në raport me borxhin, me pasojën që, nga njëra anë, debitori i vërtetë do të vazhdojë të jetë i detyruar të kryejë pagimin, dhe nga ana tjetër *solvens indebiti* mund të kërkojë sa ka paguar pa shkak. Megjithatë, në të gjitha sistemet e konsideruara, është thelbësor gabimi i *solvens*¹⁹.

Shumë më problematike është çështja nëse, gjithmonë, në rastet e pagimit gabimisht të borxhit të tjetrit, kush ka kryer pagimin mund të veprojë, përveç kundër përfituesit të vetë pagimit, edhe direkt kundër vetë debitorit. Një zgjidhje e tillë do të paraqiste avantazhe të sigurta në këndvështrim të ekonomisë procesuale. Nëse *solvens indebiti* mund të vepronte direkt në gjyq kundër debitorit të vërtetë, do të shmangej nevoja e dy padive (*short circuit*). Në raste të tilla, *solvens indebiti* do të duhej të kufizohej të vepronte në gjykim kundër *accipiens indebiti*, dhe ky i fundit do të duhej nga ana e tij të vepronte në gjykim kundër debitorit të vërtetë. Pranimi i mundësisë së një padie direkte të *solvens indebiti* kundër debitorit efektiv,

¹⁹ Neni 467 KC shqiptar: "Debitori që ekzekuton një detyrim ndaj një personi, i cili sipas rrethanave të padyshtimita duket se është i autorizuar ta pranojë atë, shkarkohet nga detyrimi në qoftë se provon se ka qenë në mirëbesim. Personi që ka pranuar ekzekutimin e detyrimit, është i detyruar t'i kthejë kreditorit të vërtetë, atë që ka marrë nga ekzekutimi i detyrimit."

do ta bënte në fakt të mjaftueshme një padi të vetme. Një mundësi e tillë mund të kundërshtohet me karakterin personal të padisë për pagimin e pa detyruar, dhe eventualitetin që pasuria e debitorit të vërtetë është e vogël. Për ta kaluar këtë kundërshtinë e dytë, do të ishte e mjaftueshme t'i njihet *solvens indebiti*, fakulteti i zgjedhjes për të vepruar kundër *accipiens indebiti*, apo direkt kundër debitorit të vërtetë. Është fakt që, një mundësi e tillë e padisë direkte (*short circuit*) është gjerësisht e pranuar sidomos në SHBA.²⁰ Gjetja e një mundësie të tillë pikërisht në SHBA nuk habit. Ajo është, në fakt, në përputhje me pragmatizmin dhe mënyrën e procedimit jo dogmatik, që ka si qëllim në çdo rast zgjidhjen më të shpejtë dhe ekonomike të problemit, tipike për juristët amerikanë.

Shumë më e ndryshme është situata si në Angli, ashtu dhe në kontinent. Juristët anglezë kufizohen të pranojnë që në rastet e pagimit gabimisht të borxhit të një tjetri, përveç ratifikimeve nga ana e debitorit të vërtetë, pagimi nuk ka efikasitet shues të borxhit, me pasojën që nga njëra anë kreditori mundet në çdo rast të pretendojë akoma pagimin, dhe nga ana tjetër *solvens indebiti* mund të veprojë kundër tij për të arritur kthimin e asaj që është paguar pa shkak.

Në kontinent problemi është diskutuar, sidomos, nga doktrina gjermane që, në raste të ndryshme ka arritur të pranojë dhe të theksojë mundësinë e një padie direkte të *solvens indebiti*. Kjo tezë, pavarësisht avantazheve të dukshme të shpejtësisë dhe praktikitetit, është deri në këto momente mohuar nga jurisprudenca jo vetëm gjermane, por edhe italiane dhe franceze, e cila është shfaqur gjithmonë shumë e prerë për karakterin ngushtësisht personal të padisë për pagimin e pa detyruar.

Pagimi i borxhit të tjetrit mund të mos ketë ndodhur gabimisht, por të jetë kryer spontanisht, pra me vetëdijen e karakterit jo të detyruar të pagimit²¹. Në këto raste në të gjitha sistemet e konsideruara, përjashtohet mundësia të veprohet kundër përfituesit të pagesës për të marrë kthimin e saj.²² Megjithatë në sistemet kontinentale pranohet mundësia për të vepruar kundër debitorit të vërtetë. Në Itali dhe Francë flitet për *zëvendësim ligjor* në të drejtat e kreditorit. Rasti i pagimit vullnetar të borxhit të tjetrit në çdo rast integron një rast tipik shembull të zgjerimit të punëve të tjerëve, me pasojën që nuk do të jetë e vështirë të vendosësh një detyrim për kthim edhe në mungesë të një norme të shprehur. Pikërisht kjo zgjidhje gjendet në Gjermani.

Çështje tjetër është kur një person, efektivisht debitor i një shume parash, kryen pagimin e personit të gabuar (*indebito ex later accipientis*). Në këto raste nuk ka dyshime rreth mundësisë së *solvens indebiti* për të pretenduar kthimin e asaj që është paguar pa shkak. Shumë më problematike është në fakt nëse kreditori mund të veprojë direkt kundër përfituesit të pagimit të pa detyruar për të marrë shumën (*short circuit*). Një mundësi e tillë është e pranuar në *Common Law*. Problemi

²⁰ Dawson, Indirect Enrichment, 1969, f.139.

²¹ Neni 460, 496 të Kodit tonë Civil.

²² Neni 1377 Kodi i Napoleonit, Neni 2036 KCI.

shtrohet konkretisht për qiratë e paguara të personit të gabuar. Në herën e parë që një rast i tillë ka shkuar për gjykim, është pranuar mundësia për *solvens indebiti* të kërkojë ai vetë sa i është paguar personit të gabuar.²³ Pak vite më vonë u pranua dhe mundësia për titullarin e vërtetë të qirasë të veprojë direkt kundër personit të cilit i ishte derdhur shuma e pa detyruar për të marrë personalisht kthimin.²⁴ Kështu në rastet e cilësuar *indebito ex latere accipientis*, tashmë është njohur mundësia për kreditorin e vërtetë të pretendojë personalisht në gjykim e në pagimin e qirasë.

E ndryshme është situata në vendet e *Civil Law*. Autorë të veçantë kanë sugjeruar që t'i njihet kreditorit mundësia për të vepruar direkt kundër *accipiens indebiti*, por një mundësi e tillë, pavarësisht avantazheve të dukshme për sa i përket shpejtësisë dhe praktikitetit, ka gjetur përqaftim të pakët në jurisprudencë.

Konkluzione

Për të pasur *pagim të pa detyruar* nuk janë të mjaftueshëm elementët objektivë dhe subjektivë, d.m.th. inekzistenca e borxhit dhe gabimi në ato sisteme ku kërkohet, por duhet në çdo rast një tjetër element subjektiv, d.m.th. qëllimi për të shlyer një borxh, borxh i cili është në fakt inekzistent. Nuk ka rëndësi cili është burimi i borxhit të prezumuar. Çdo fakt që mbahet i përshtatshëm nga sistemi për të krijuar detyrime (kontrata, veprimi i paligjshëm, ligje, vendime, akte administrative, etj.) mund të shtrojë një problem të pagimit të pa detyruar çdo herë që *solvens* shlyen një borxh realisht inekzistent. Për figurën e *pagimit të pa detyruar* është thelbësore prania e elementit subjektiv, d.m.th. qëllimit për të shuar një borxh, nuk ka rëndësi nëse *ex contractu*, *ex lege*, apo i prodhuar nga çfarëdolloj burimi, në realitet inekzistent. Nëse mungon ky qëllim, dilet jashtë pagimit të pa detyruar për të rënë në figura të tjera. Për të sqaruar konceptin, është i domosdoshëm një shembull: një person që shpërndan në një tokë që nuk i takon, plehrat organike. Rastet që mund të paraqiten janë tre, shumë të ndryshëm nga njëri-tjetri. Mundet në fakt, kush ka shpërndarë plehun ka vepruar me qëllimin për të përmbushur një kontratë, edhe pse të pavlefshme. Por mund të ketë vepruar i nisur nga dëshira e mirë, pra pa qëllimin për t'u paguar. Së fundmi mund të ketë vepruar në interesin ekskluziv të vetin, në bindjen e gabuar se është ai pronari i tokës. E njëjta sjellje mund të lindë përgjegjësinë e pagimit të pa detyruar për atë që ka përfituar, një begatim për pronarin efektiv të tokës, ashtu dhe ekstremet në rastin e dëshirës. Vetëm në hipotezën e parë kemi figurën e pagimit të pa detyruar. Linja e ndarjes që dallon rastet e pagimit të pa detyruar nga ato të begatimit e të dhurimeve është kështu padyshim shumë e hollë, meqë e njëjta sjellje materiale mund të lindë si një rast pagimi të pa detyruar, si një rast begatimi, si një rast dhurimi. Dallimi mes *pagimit*

²³ Bonnel V. Foulke (1657).

²⁴ Arris V. Stukely (1678).

të pa detyruar dhe begatimit pa shkak, mund të ketë një rëndësi më shumë sesa teorike, po të kihet parasysh që pagimi i pa detyruar është një figurë e veçantë që të çon tek parimi i përgjithshëm që ndalon të begatohesh pa shkak. Në konfirmim të kësaj, përmendim të gjitha ato sisteme ku pagimi i pa detyruar dhe begatimi pa shkak janë të disiplinuar organikisht. I referohemi Gjermanisë dhe vendeve të *Common Law*. Në Gjermani, kodi disiplinon njësoj rastet e pagimit të pa detyruar dhe të begatimit pa shkak, por fenomeni është akoma më evident në *Common Law*, ku jo vetëm nuk ekziston dallimi mes pagimit të pa detyruar dhe begatimit pa shkak, por as ajo mes begatimit dhe zgjerimit. Të gjitha këto institute trajtohen së bashku në *law of restitution*. Në veçanti, ato mjete që pamë se operojnë në fushën e pagimit të pa detyruar (*money had and received, quantum meruit, quantum valebat, constructive trust* etj.) janë adoptuar dhe shtrirë më vonë edhe në rastet që juristët kontinentalë do t'i cilësojnë përkatësisht begatimit pa shkak dhe zgjerim të punëve të tjetrit.

Nga studimi i praktikës së pakët gjyqësore shqiptare në këtë fushë, rezulton që, në më të shumtën e rasteve, gjykata nuk e dallon dot fijen e hollë që ndan begatimin pa shkak nga pagimi i pa detyruar, madje, shpesh herë i koncepton si një figurë e vetme, pa i dhënë ndonjë rëndësi emrit të padisë së përdorur.

Bibliografia

1. Istituzioni di diritto private, Grup autorësh, G. Giappichelli Editore-Torino 2005.
2. Enciclopedia del diritto, Le garzantine, Garzanti 2001.
3. Les principes de la responsabilite civile, Patrice Jourdain, Dalloz 2000.
4. La gestione di affari altrui, Pietro Sirena, G. Giappichelli Editore-Torino 2000.
5. Il pagamento dell'indebito, Giulio Levi, Giuffrè Editore-Milano 1989.
6. E drejta e detyrimeve dhe kontratave, Marjana Semini, Afërdita, 1998.
7. Kodi Civil i vitit 1929, botimet Toena 1998.
8. Andon Sallabanda, E drejta e detyrimeve (Pjesa e përgjithshme), 1962.
9. E drejta e detyrimeve, Tiranë 2008, A. Nuni, A. Vokshi, I. Mustafaj.
10. Paolo Gallo, Grandi sistema giuridici, Giappichelli, Torino, 1997.
11. Unjust enrichment, Peter Birks, Oxford university press, bot. 2, 2005, f.360.
12. An introduction to the Law of Restitution, Peter Birks, Oxford university press USA, bot. 2, 1989.
13. Goff and Jones, The law of restitution, Sweet&Maxwell, bot.6, 2002, f.1040.
14. The use and abuse of unjust enrichment, Jack Beatson, Oxford university press, 1991.
15. The principles of the law of restitution, Graham Virgo, Oxford University Press, 1999.

Tregu i letrave me vlerë në Shqipëri dhe Ballkan

Prof. Asoc. Dr. Edi Spaho

LEKTOR, FAKULTETI JURIDIK, UET

Hyrje

Në kuptimin e saj të mirëfilltë, tregu i letrave me vlerë në Ballkan çelët me Bursën e Beogradit, e cila u rikrijua në 1989, në bazë të ligjit për tregun e kapitaleve dhe atë të parasë. Bursa e Bullgarisë - Sofia AD (BSE) u rihap në vitin 1991, pas miratimit të Ligjit Tregtar. Krijimi i bursës u lidh ngushtë me ndryshimet e thella strukturore ekonomike dhe sociale në vend, që nga viti 1989. Në Kroaci janë krijuar dy bursa: Bursa e Zagrebit (ZSE) dhe Bursa e Varazhdinit (VSE). Bursa më e madhe është ZSE, e cila është rikrijuar në vitin 1991 dhe shërben si një platformë tregtimi për anëtarët e saj dhe klientët e tyre. Bursa e Malit të Zi u krijua në qershor të vitit 1993 nga katër banka, në bazë të ligjit për tregun e kapitaleve dhe atë të parasë. Ajo u licencua nga Ministria Federale e Financave për tregtimin e titujve afatshkurtër të Bankës Qendrore të Jugosllavisë si dhe nga Komisioni Federal i Letrave me Vlerë për tregtimin e titujve afatgjatë. Bursa e Maqedonisë (MSE) u krijua në 13 shtator 1995 dhe filloi zyrtarisht veprimtarinë e saj në 28 mars 1996, si tregu kryesor i organizuar i letrave me vlerë dhe i pari në historinë e Maqedonisë. Bursa e Rumanisë (BSE) u rihap zyrtarisht në 21 prill të vitit 1995, si një institucion publik. Tregtimi në BSE kryhet mbi një platformë moderne elektronike si dhe mbi një komplet të zgjeruar rregullash dhe procedurash, të lidhura me tregtimin, pastrimin, rregullimin e llogarive dhe regjistrimin e letrave me vlerë. Në këtë arkitekturë të sistemit dhe infrastrukturës financiare, ajo që ekziston e ngritur thjesht si skemë institucionale është Bursa e Tiranës, e projektuar për të shërbyer si një treg i organizuar letrash me vlerë në Shqipëri që në vitin 1996. Edhe pse pas kaq vitesh pas hapjes zyrtare të saj ajo nuk ka arritur të ofrojë shërbimin që një bursë normale letrash me vlerë do të duhej të ofronte: shitblerjen e aksioneve të shoqërive tregtare shqiptare, pa folur për funksionimin e saj si platformë tregtimi dhe për obligacionet apo titujt afatgjatë.

Bursa e Tiranës (BT), si e para bursë në Shqipëri në sistemin e saj financiar, u hap në 2 maj 1996, në formën e një departamenti të Bankës së Shqipërisë, si pjesë integrale e saj.

Përvoja dhe praktika të zhvillimit të tregjeve të letrave me vlerë në rajonin e Ballkanit

Bullgaria

Bursa e Bullgarisë - Sofia AD (BSE) u rihap në vitin 1991, pas miratimit të Ligjit Tregtar. Krijimi i bursës u lidh ngushtë me ndryshimet e thella strukturore ekonomike dhe sociale në vend, që nga viti 1989. Gjatë periudhës 1992-1994 u krijuan rreth njëzet bursa rajonale, të cilat vepronin në një mjedis të parregulluar. Në korrik të vitit 1995, miratohet ligji për letrat me vlerë, bursat dhe shoqëritë e investimeve, sipas të cilit u krijua Komisioni i Letrave me Vlerë dhe Bursave, ndërsa nga fundi i vitit 1995 u shkrinë të gjithë bursat e krijuara dhe mbeti në funksionim vetëm Bursa e Bullgarisë. Institucioni tjetër kryesor në treg, Depozita Qendrore e letrave me vlerë (CDAD) u krijua si shoqëri aksionere në vitin 1996.

Deri në vitin 1996 shoqëritë e kuotuar në Bursën e Bullgarisë nuk ishin të detyruara të botonin prospekt, ky dokument u bë i detyrueshëm pas këtij viti. Sesioni i parë i tregtimit në BSE, si treg i rregulluar, u krye në 21 tetor të vitit 1997, por dyshemeja zyrtare u hap në 12 janar 1998, me listimin e aksioneve të "Elkabel", shoqëria më e madhe e prodhimit të kabllove. Në fund të vitit 1999 ishin të listuara 32 shoqëri në segmentin zyrtar dhe rreth 1.000 shoqëri në tregun e lirë (OTC). Këto shoqëri rezultuan nga procesi i privatizimit masiv.¹

Në BSE pranohen për tregtim: aksionet, letrat me vlerë të borxhit të emërtuara nga Qeveria (obligacionet qeveritare) dhe letrat me vlerë të borxhit të emërtuara nga shoqëritë anonime. Banka Kombëtare e Bullgarisë shërben si depozitues për letrat me vlerë të borxhit qeveritar, përveç CDAD, që shërben si depozitues për letrat me vlerë të shoqërive aksionere.

Kroacia

Në Kroaci janë krijuar dy bursa: Bursa e Zagrebit (ZSE) dhe Bursa e Varazhdinit (VSE). Bursa më e madhe është ZSE, e cila është rikrijuar në vitin 1991 dhe shërben si një platformë tregtimi për anëtarët e saj dhe klientët e tyre. Tregtimi i letrave me vlerë kryhet nëpërmjet sistemit elektronik MOST. ZSE nuk ka dysheme fizike tregtimi, pasi brokerat dhe tregtarët janë të lidhur elektronikisht me njëri-tjetrin.

¹ <http://www.bse-sofia.bg/?page=AboutBSE&PHPSESSID=310e731d4b935319b5caddb12d5c5d959>.

Tregtimi kryhet çdo ditë nga ora 10:00-16:00. Instrumentet e tregtueshme në ZSE janë: aksione, letra me vlerë të borxhit qeveritar dhe letra tregtare. Si depozitues për bonot e thesarit shërben Ministria e Financave, ndërsa për letrat e tjera me vlerë si depozitues shërben agjencia e depozitimit të letrave me vlerë (SDA).²

Mali i Zi

Bursa e Malit të Zi u krijua në qershor të vitit 1993 nga katër banka, në bazë të ligjit për tregun e kapitaleve dhe atë të parasë. Ajo u licencua nga Ministria Federale e Financave për tregtimin e titujve afatshkurtër të Bankës Qendrore të Jugosllavisë si dhe nga Komisioni Federal i Letrave me Vlerë për tregtimin e titujve afatgjatë. Aktualisht, në Bursën e Malit të Zi janë të kuotuar 433 shoqëri aksionere dhe 13 obligacione qeveritare.³

Maqedonia

Bursa e Maqedonisë (MSE) u krijua në 13 shtator 1995 dhe filloi zyrtarisht veprimtarinë e saj në 28 mars 1996, si tregu kryesor i organizuar i letrave me vlerë dhe i pari në historinë e Maqedonisë. Ajo u krijua fillimisht si një shoqëri aksionere jofitimprurëse nga 19 anëtarë: 13 banka, 3 shoqëri kursimi dhe 3 shoqëri sigurimesh. Nga qershori i vitit 2001, MSE-ja filloi të vepronte si shoqëri aksionere fitimprurëse dhe aktualisht ka 20 aksionerë (8 shtëpi brokerimi, 8 banka, 1 shoqëri sigurimesh dhe 3 investitorë privatë).

Instrumentet e tregtueshme në MSE janë: aksionet dhe obligacionet qeveritare të shoqërive aksionere. Tregu është i organizuar në dy segmente: Tregu Zyrtar dhe Tregu Jozyrtar. Tregtimi i letrave me vlerë në MSE kryhet nëpërmjet një sistemi plotësisht elektronik të drejtuar nga porosia, i quajtur BEST (Bourse Electronic System for Trading). Ky është një sistem elektronik në distancë (pa dysheme fizike tregtimi), cili është i hapur 4 herë në javë, nga ora 09:00-12:00.

Si depozitues i letrave me vlerë shërben Qendra e Depozitës së Letrave me Vlerë (CSD), që mban regjistrime për të gjithë shoqëritë aksionere në vend, rreth 750 shoqëri aksionere. Aktualisht, në MSE janë të kuotuar 46 shoqëri aksionere dhe 5 obligacione qeveritare.⁴

Rumania

Bursa e Rumanisë (BSE) u rihap zyrtarisht në 21 prill të vitit 1995, si një institucion publik. Tregtimi në BSE kryhet mbi një platformë moderne elektronike si dhe

² http://en.wikipedia.org/wiki/Zagreb_Stock_Exchange.

³ <http://www.montenegroberza.com/code/navigate.asp?Id=59>.

⁴ http://en.wikipedia.org/wiki/Macedonian_Stock_Exchange.

mbi një komplet të zgjeruar rregullash dhe procedurash, të lidhura me tregtimin, pastrimin, rregullimin e llogarive dhe regjistrimin e letrave me vlerë. Sesioni i parë i tregtimit u krye në 20 nëntor 1995. Përveç BSE-së, në Rumani u vu në funksionim dhe RASDAQ, një sistem elektronik tregtimi i ngjashëm me NASDAQ, me synim sigurimin e një platforme tregtimi për letrat me vlerë të shoqërive aksionere të dala nga programi i privatizimit masiv. Në RASDAQ tregtohen mbi 2.300 aksione, kurse në BSE mbi 98 aksione. Tregtimi i letrave me vlerë në BSE organizohet në tre nivele, gjithashtu, ekziston një segment për tregtimin e aksioneve të palistuar, ose tregu jozyrtar. Aktualisht në BSE rreth 40 aksione tregtohen në segmentin jozyrtar, 40 në segmentin e dytë dhe vetëm 18 në segmentin e parë.

Në BSE, si instrumente të pranura për tregtim janë: aksionet, obligacionet qeveritare dhe të shoqërive aksionere, obligacionet e pushtetit lokal dhe bonot e thesarit. Si depozitues letrash me vlerë janë: Banka Kombëtare e Rumanisë për bonot e thesarit dhe obligacionet qeveritare; për titujt e tjerë si depozitues shërben SNCDD (Shoqëria Kombëtare e Pastrimit, Rregullimit dhe Depozitimit të Letrave me Vlerë).⁵

Serbia

Bursa e Beogradit u rikrijua në 1989, në bazë të ligjit për tregun e kapitaleve dhe atë të parasë. Gjatë viteve 1992-1995, veprimtaria e saj u dëmtua rëndë nga paqëndrueshmëria politike dhe ekonomike e vendit. Gjatë kësaj periudhe në të u tregtuan tituj afatshkurtër, kryesisht letra tregtare të bankave. Në shtator 2002, fillon për herë të parë tregtimi në obligacionet qeveritare ndërsa në mars të vitit 2003, futet metoda e tregtimit të pandërprerë për këto obligacione. Në mars të vitit 2004, zbatohet sistemi elektronik i tregtimit në distance (pa dysheme fizike tregtimi) dhe në tetor të po këtij viti aplikohet metoda e tregtimit të pandërprerë të aksioneve. Në Bursën e Beogradit tregtohen: aksione, obligacione, certifikata depozitash dhe produkte derivate financiare. Aktualisht në segmentin e tregut të lirë të parregulluar kuotohen 1.233 ndërmarrje, ndërsa asnjë ndërmarrje nuk është kuotuar në segmentet zyrtare.⁶

Bursa e Tiranës

Një historik i shkurtër

Në këtë arkitekturë të sistemit dhe infrastrukturës financiare, ajo që ekziston e ngritur thjesht si skemë institucionale është Bursa e Tiranës, e projektuar për të

⁵ http://en.wikipedia.org/wiki/Bucharest_Stock_Exchange.

⁶ http://en.wikipedia.org/wiki/Belgrade_Stock_Exchange.

shërbyer si një treg i organizuar letrash me vlerë në Shqipëri që në vitin 1996. Edhe pas kaq vitesh pas hapjes zyrtare të saj ajo nuk ka arritur të ofrojë shërbimin që një bursë normale letrash me vlerë do të duhej të ofronte: shitblerjen e aksioneve të shoqërive tregtare shqiptare, pa folur për funksionimin e saj si platformë tregtimi dhe për obligacionet apo titujt afatgjatë.

Bursa e Tiranës (BT), si e para bursë në Shqipëri në sistemin e saj financiar, u hap në 2 maj të 1996, në formën e një departamenti të BSH-së, si pjesë integrale e saj. Ajo përbëhej nga Sektori i Tregut, Sektori i Listimit, i Anëtarësimit, Zyra e Pastrimit dhe e Rregullimit të Llogarive. Autoriteti drejtues i bursës ishte Bordi Mbikëqyrës i saj i përbërë nga: Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, Kryetari i Bordit, Drejtori i Departamentit të Bursës së Tiranës, një anëtar i emëruar nga Ministri i Financave dhe dy anëtarë të përzgjedhur midis agjentëve të tregut të letrave me vlerë dhe të caktuar nga Guvernatori i Bankës së Shqipërisë.⁷

Hapja e saj pranë BSH-së nuk ishte e rastësishme. Si në të gjitha vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore, me një të kaluar të ngjashme me Shqipërinë, shteti u përpoq dhe vendosi të ishte promotori dhe mbështetësi kryesor i krijimit të bursës. Megjithatë, në Shqipëri u ndoq një rrugë e ndryshme nga ai i përvojës së të gjitha këtyre vendeve, pasi u vendos që BT-ja të krijohet në administrimin e BSH-së. Arsyet e kësaj zgjedhjeje ishin:

- Mungesa e një tradite të mëparshme në këtë drejtim,
- Gama shumë e kufizuar e instrumenteve financiare pra, rrjedhimisht, mungesa e aksioneve dhe titujve nga sektori privat,
- Prania e një sektori privat shumë më të dobët sesa ai i vendeve të tjera të Evropës Qendrore e Lindore,
- Mos fillimi ende i privatizimit të ndërmarrjeve strategjike,
- Shanset e vogla të sigurimit, brenda një periudhe afatshkurtër, të efeciencës ekonomike të këtij institucioni të ri,
- Mungesa e ekspertëve dhe e përvojës përkatëse të mjaftueshme jashtë institucioneve shtetërore të sferës financiare dhe kryesisht jashtë BSH-së.

Të ndërgjegjshëm se veprimtaria e kësaj burse, për një periudhë afatmesme, nuk do të ishte tregtimi i aksioneve, Qeveria, në bashkëpunim me BSH-në vendosën të organizojnë pranë BT-së, tregun parësor dhe dytësor të bonove të thesarit. Pavarësisht se këto veprimtari nuk ishin me natyrë të mirëfilltë burse, e cila u bë e mundur:

- Krijimi i një tradite të funksionimit dhe veprimtarisë operacionale të BT-së;
- Kryerja e një marketingu pa kosto të shprehur dhe edukimit të publikut dhe institucioneve mbi funksionimin e Bursës, investimit në Bursë dhe funksionimit të ndërmjetësve financiarë;

⁷ Banka e Shqipërisë – “Historia e Bankës Qendrore të Shqipërisë”, Tiranë, 2003.

- Grumbullimi nga stafi ekzistues i BT-së, i përvojës së nevojshme mbi parimet e tregtimit, pastrimit dhe rregullimit të transaksioneve në letra me vlerë;
- Përgatitja graduale teorike dhe praktike e këtij stafi, për të përballuar më tej angazhimin e BT-së në veprimtaritë e reja në të ardhmen.⁸

Me pak fjalë, qëllimi i Qeverisë shqiptare ishte krijimi, mbështetja dhe zhvillimi i një institucioni që, pavarësisht se ekonomia private dhe forcat e tregut nuk e mbështesin dhe e zhvillonin dot për momentin, në të ardhmen do të kthehet në një institucion të rëndësishëm kombëtar, që do t'i shërbejë jo vetëm Shtetit, për arritjen e objektivave të tij strategjike për zhvillimin e ekonomisë së tregut, por dhe biznesit privat, duke e orientuar dhe inkuadruar atë drejt institucioneve të sistemit financiar.

Organizmi i BT-së

BT-ja u organizua fillimisht si një treg ankandi, me të thirrura, i drejtuar nga porosia. Sesionet e tregtimit zhvilloheshin dy herë në javë, të hënave dhe të enjteve, duke filluar në orën 10:00. Pastrimi dhe rregullimi i llogarive kryhej nga BT-ja, me datë valute dy ditë pune, pas datës së transaksionit. Instrumentet e pranueshme për tregtim ishin kufizuar vetëm në tre: bonot e thesarit me afat fillestar maturimi 12 muaj, 5 seri obligacionesh qeveritare, të emëtuara për ristrukturimin e huave të këqija të ish-kooperativave bujqësore si dhe Bonot e Privatizimit. BT-ja ka operuar gjithnjë si një treg pjesor paraje me një kuadër jo të plotë instrumentesh të tij dhe si një treg tepër të ngushtë dhe jo likuid kapitalesh i përfaqësuar nga obligacionet qeveritare.

BT-ja shërbeu dhe si treg parësor për shitjen e bonove të thesarit të Qeverisë, funksion që e kreu deri në 1 gusht 1998, kur ky treg kaloi përfundimisht pranë Departamentit të Operacioneve Monetare të BSH-së. Ndërsa viti 1996 është viti ku në BT shënohet shpërndarja më e rregullt, sipas muajve, e transaksioneve të kryera, ku për çdo muaj janë kryer transaksione. Gjithashtu, ky është i vetmi vit ku mund të thuhet se BT-ja ka funksionuar dhe si treg kapitali, pasi janë kryer 2 transaksione në obligacionet qeveritare me një vlerë tërësore prej 800 milionë lekësh.⁹

Viti 1997, do të shënohet si viti i problemeve serioze në të gjithë ekonominë shqiptare, ndikuar nga kriza e rëndë politike. Një situatë e tillë do të ndjehej detyrimisht dhe në veprimtarinë e BT-së. Konkretisht, gjatë vitit 1997, për rreth tetë muaj nuk u realizua asnjë transaksion në sesionet e bursës.

Bonot e Privatizimit janë instrumenti tjetër i pranuar juridikisht si objekt tregtimi në BT, por ato nuk u kthyen asnjëherë në objekt real tregtimi dhe nuk

⁸ Id.

⁹ Bursa e Tiranës- "Raporti Vjetor 1996", Tiranë, 1997.

pati asnjë transaksion të kryer në lidhje me to. Në këtë rezultat ndikuan jo vetëm disa nga faktorët e mosfunksionimit të fondeve të investimeve, por edhe skema e papërshtatshme e tregtimit në BT. Në thelb, në sesionet e BT-së nuk ofrohej asgjë karakteristike apo e veçantë, që do ta bënte tregtimin e këtyre bonove më komod apo më të lehtë se ai që kryhej në tregun jozyrtar.

Nga sa u tha më lart, në mënyrë të përmbledhur mund të pohohet se, pavarësisht se BT-ja u krijua dhe u mbështet fillimisht në krijimin e saj, nuk u bë pothuajse asgjë për mbështetjen e mëtejshme, si për futjen e produkteve të reja, ashtu dhe për zhvillimin dhe konsolidimin e atyre ekzistuese. Faktorët kryesorë jo favorizues për këtë zhvillim të BT-së janë:

Qëndrueshmëria politike

Ky faktor mund të konsiderohet dhe si më i rëndësishëm, sepse ndryshimet demokratike në vendin tonë janë karakterizuar nga një rrezik dhe mungesë e theksuar e qëndrueshmërisë politike. Duke përmbledhur të gjitha llojet e zgjedhjeve dhe të votimeve që janë bërë në Shqipëri gjatë kësaj periudhe, rezulton se është shkuar para kutive të votimit 11 herë, ku 2 prej tyre kanë qenë zgjedhje të parakohshme. Një peshë e tillë e faktorit politik, i kuptueshëm, do të ushtronte një trysni të madhe mbi ekonominë, sistemin financiar dhe besueshmërinë përkatëse mbi to. Gjithashtu, klima politike në vend vazhdimisht mbetet e tensionuar midis grupimeve dhe palëve kundërshtarë politike. Ky tension përcillet dhe pasqyrohet, në mënyrë të prekshme, në të gjitha mjediset e tjera jashtë politikës.¹⁰

Kuadri rregullator dhe zbatueshmëria ligjore

Niveli i zbatueshmërisë ligjore në Shqipëri nuk është në nivele të kënaqshme. Pavarësisht se, Shqipëria ka një legjislacion modern dhe të tipit perëndimor, përvoja e deritanishme dhe jeta e përditshme është tregues i qartë se zbatueshmëria e ligjit në përgjithësi është e dobët. Kjo vjen kryesisht nga:

- Mosha relativisht e re e institucioneve të zbatimit të ligjit dhe rimodelimi i tyre tërësor, në përgjigje të sistemit të ri politik, ekonomik dhe social në vend;
- Dobësia e strukturave funksionale të tyre;
- Kuadri ligjor disa herë kontradiktor dhe mungesa e përcaktimit të qartë të kompetencave midis institucioneve;
- Mungesa e një modeli të qenësishëm e të qëndrueshëm, mbi të cilin të mund të ngrihen dhe formatohen këto institucione. Pjesërisht, kjo vjen nga

¹⁰ IMF - "Albania: Financial System Stability Assessment, including Reports on the Observance of Standards and Codes on the Following Topics: Banking Supervision and Payment System Series: Country Report no.05/274", August, 2005.

trashëgimia e dobët institucionale në vend, por dhe nga mungesa e referimit drejt një boshti apo modeli unik institucional ndërkombëtar. Modelimi i institucioneve dhe strukturave përbërëse të tyre ndjekin, në jo më pak raste, modele të shteteve të ndryshme, sipas llojit dhe shtetësisë së asistencës së huaj të ofruar, duke krijuar mungesën e koordinimit, mospërputhjes dhe nivelit të ulët të bashkëveprimit dhe rakordimit ndërinstitucional;

- Qarkullimi disi i shpeshtë i stafit profesional, në përgjigje të ndryshimeve respektive politike në qeverinë qendrore;
- Nivel i dobët i kulturës së dhënies dhe marrjes së informacionit ligjor;
- Prania e një sistemi inefficent gjyqësor, që i zgjidh mosmarrëveshjet midis palëve ngadalë.

Mjedisi ekonomik

Mjedisi ekonomik i Shqipërisë është një grup i mpleksur faktorësh dhe inefficiencash që e bëjnë të vështirë funksionimin normal të tregut të letrave me vlerë në vend. Faktor kryesor mund të cilësohet madhësia modeste e ekonomisë sonë kombëtare, ku deri në fund të vitit 2007, PPB i vendit arriti në shifrën 9,14 miliard USD, ose 2.855 USD për frymë. Në Shqipëri ka një popullsi prej rreth 3,2 milion banorë dhe praktikisht vendi ynë përbën një ekonomi të vogël. Faktor tjetër mund të konsiderojmë edhe *mungesën e vizionit dhe të strategjisë globale të zhvillimit ekonomik*.

Mosfunksionimi praktik i BT-së gjatë dhjetëvjeçarit të fundit, me përjashtim të tre viteve të para, kur ajo funksiononte si një treg i pastër paraje dhe platforme tregtimi për bonot e thesarit, gjykoj se nuk është i lidhur thelbësisht me faktorë të brendshëm të kuadrit të mangët të organizimit të saj institucional apo mungesës së njohurive të posaçme për menaxhimin efektiv të saj nga pikëpamja tregtare. Përkundrazi, janë pikërisht faktorët e jashtëm ata që kanë plazmuar bllokimin që në embrion të funksionimit, qoftë dhe modest, të bursës së letrave me vlerë në Shqipëri.

Padyshim që faktori më i rëndësishëm dhe më me ndikim është mungesa e një strategjie kombëtare afatgjatë për zhvillimin ekonomik të vendit dhe për zhvillimin e sistemit financiar në veçanti. Faktikisht, nga qeveria është miratuar dhe promovuar Strategjia Kombëtare e Zhvillimit Ekonomik dhe Social (SKZHES), strategji kjo që në thelb ka një plan të zgjeruar dhe ndër dikasterial pune, e trupëzuar në një matricë komplekse kohore dhe përgjegjësish, por vizioni i kësaj strategjie nuk ka si përbërëse të tij vendosjen e zhvillimit ekonomik mbi një sistem modern dhe të plotë financiar. Më shumë në këtë strategji theksohet nevoja për thellimin e reformave të tranzicionit dhe përsheptimin e procesit reformues, ku si pjesë e këtij të fundit gjykohet dhe konsolidimi i reformave në sistemin financiar.

Mundësitë për zhvillimin e bursës së kapitaleve dhe letrave të tjera në Shqipëri

Përpara se të përcaktohet rruga më e mirë e mundshme për zhvillimin e bursës së kapitaleve dhe të letrave të tjera me vlerë në Shqipëri, do të ishte me shumë vlerë analizimi i të gjitha alternativave të mundshme që ekzistojnë për zhvillimin e saj në vend. Këto mundësi janë si më poshtë:

Zhvillimi i vetvetishëm i tregut të letrave me vlerë

Ky është realiteti aktual në të cilin gjendet dhe është lënë BT-ja prej shumë vitesh. Ky model në vetvete nuk përmban ndonjë element zhvillimi tregu real kapitalesh apo letrash të tjera me vlerë. Në këtë rast, ashtu sikundër dhe në realitetin e sotëm, BT-ja mbetet një institucion vegjetues, pa rol në ekonomi e pa vlerë të shtuar për biznesin shqiptar. Sipas këtij opsioni, i lihet tërësisht në dorë interesit spontan të bizneseve shqiptare për të kërkuar listim të letrave të tyre me vlerë, pavarësisht se në realitet ka pak gjasa që të jetë pikërisht biznesi privat ai që do të ndërmarrë i pari hapin e listimit të aksioneve në BT. Qëndrimi mbizotërues i biznesit privat është shmangia e rrezikut të hedhjes së hapit të parë drejt listimit nga vetë ky biznes dhe pritja për ofrimin nga ana e qeverisë të paketës së aksioneve të ndonjë shoqërie aksionere shtetërore.¹¹

Nëse do të ndiqet kjo rrugë, e ardhmja e BT-së është e pasigurtë dhe me mundësi shumë të madhe për t'u mbyllur, si një institucion jo eficient. Mbyllja e BT-së do të përbente një njollë të errët në sistemin financiar shqiptar dhe do të jepte një sinjal negativ për gjithë ekonominë shqiptare.

Treg ndërinstitucional i ndërmjetësve financiarë

Sipas këtij opsioni, ndërmjetësit financiarë, bankat, *brokerat* dhe tregtarët e letrave me vlerë mund të tregtojnë midis njëri-tjetrit, duke përdorur një sistem elektronik, telematik e duke krijuar kështu një platformë tregtimi ndër-institucionale, të ngjashme me platformat REUTERS, BLOOMBERG, ose GLOBEX.

Mund të mendohet se dalja në skenë e rrjeteve elektronike të komunikimit ndërkufitar mund të zbehë dhe nxjerrë jashtë loje rolin e bursave kombëtare. Megjithatë, kjo ka pak gjasa, pasi këto rrjete funksionojnë jashtë bursave kombëtare. Hyrja në tregjet kombëtare nëpërmjet këtyre rrjeteve apo bursave të automatizuara në distancë kontrollohet nga secili treg, me shumë kujdes dhe rast pas rasti. Edhe tregjet më të hapura, si ato në SHBA, vendosin kufizime të rrepta mbi anëtarësimin në distancë apo për krijimin e bursave brenda juridiksionit të tyre.

¹¹ Bursa e Tiranës: "Strategjia e zhvillimit të Bursës së Tiranës si treg letrash me vlerë", shtator, 2011.

Treg jozyrtar i tipit “mbi-banak” jashtë juridiksionit të një burse të organizuar

Sipas këtij opsioni, do të funksiononte një treg jozyrtar, i tipit “mbi-banak”, shumë i ngjashëm me tregun e lirë të shkëmbimit valutor. Gjithsesi, ky do të ishte një treg “jashtë tregut”, krejtësisht i parregulluar, jo transparent, që nuk i jep asnjë besueshmëri apo garanci për investitorët dhe emetuesit. Ky do të ishte një treg informal dhe abuziv, me jo pak kosto politike dhe ekonomike për Qeverinë Shqiptare dhe frymën institucionale që duhet të promovohet në ekonominë kombëtare.

Bursa e Tiranës bëhet Degë e një Burse më të Zhvilluar në Rajon

Bursa të tilla si ajo e Athinës, Lubjanës apo e Zagrebit janë bursa të zhvilluara dhe mund të ofrojnë një platformë tregtimi, pastrimi dhe rregullimi llogarish për letrat shqiptare me vlerë. Ndër avantazhet kryesore të këtij opsioni do të ishin: likuiditeti më i madh, krahasuar me opsionin e një burse kombëtare shqiptare, efeciencë më të lartë të përpunimit të të dhënave e për rrjedhojë, kosto më të ulëta për pjesëmarrësit e tregut, të kombinuara me një transparencë më të madhe, veçanërisht në kuptimin e një zbulimi real të çmimeve të letrave me vlerë.¹²

Argumenti, ose avantazhi i likuiditetit nuk është i realizueshëm, të paktën në një periudhë afatshkurtër, sepse, minimalisht investitorëve në Bursën e Athinës apo të Milanos u duhet kohë të informohen mbi letrat shqiptare me vlerë dhe të kuptojnë rreziqet dhe fitimet përkatëse që lidhen me to. Në periudhën afatshkurtër, pjesa dërrmuese e letrave shqiptare me vlerë kanë pak gjasa të tërheqin ndonjë kërkesë të madhe nga ana e investitorëve të huaj. Gjithashtu, kërkesa për këto letra me vlerë do të kufizohet thuajse krejtësisht tek investitorët shqiptarë.

Një problem tjetër është ai i përshtatjes së legjislacionit shqiptar të letrave me vlerë dhe rregulloreve e praktikave të BT-së me kuadrin ligjor të këtyre bursave të huaja, me të cilat ajo mund të lidhet. Një fakt i tillë mund të sjellë vendosjen e kriterëve më të rrepta, p.sh lidhur me përgatitjen e prospektit dhe detyrimet për informim të emetuesve, krahasuar me kriteret e zbutura, që do të vendoseshin fillimisht nga BT-ja, për të nxitur emetuesit shqiptarë të listoheshin në të.

Edhe nëse rregullat e BT-së, do të përputheshin me ato të një burse të huaj dhe nëse emetuesit e mundshëm arrijnë t'i përmbushin standardët e kësaj të fundit, nuk është e sigurtë nëse ndonjë subjekt në ndonjë vend jashtë Shqipërisë do të kishte ndonjë interes real për të përmbushur dhe mbështetur nevojat e pjesëmarrësve nga një treg i vogël, me interes jo të madh strategjik. Në këtë rast, bursa e huaj do të kërkonte të vendoste komisione më të larta për ta listuar këtë emetues e për

¹² Id.

rrjedhojë, të eklipsonte tërësisht një nga qëllimet dhe përfitimet kryesore të këtij opsioni.

Bursa e Tiranës mund të bashkohet me një Bursë Rajonale Ballkanike

Opsion tjetër për zhvillimin e bursës së kapitaleve në Shqipëri do të ishte që të pritej derisa të themelohej një bursë rajonale ballkanike. Në këtë bursë mund të inkuadroheshin Bursa e Lubjanës, Bursa e Zagrebit, Bursa e Maqedonisë, Bursa e Beogradit si dhe Bursa e Tiranës. Vlen të theksohet se kjo mundësi po diskutohet në nivele qeveritare dhe jo rrallëherë sugjerohet si mundësi dhe nga institucionet ndërkombëtare.

Efektivisht, kjo është një mundësi tërheqëse në disa aspekte, por fatkeqësisht, gjykoj se do të mbetet si mundësi teorike, për një kohë të pacaktuar, për faktin se Ballkani ende nuk është stabilizuar politikisht në një nivel të tillë, që të mundësojë një zhvillim të avancuar lirë shkëmbimesh tregtare, ekonomike dhe njerëzore e aq më pak të pretendohet për krijimin e shpejtë të një platforme të përbashkët tregtimi për letrat me vlerë të shteteve të ndryshme.¹³

Zhvillimi i Bursës së Tiranës

Një mundësi tjetër është sigurimi i vijueshmërisë së zhvillimit të tregut të kapitaleve bazuar në zhvillimin e BT-së. Kjo mundësi siguron disa avantazhe kundrejt mundësive të mësipërme, si:

- Mbrojtjen më të mirë të interesave kombëtare. Ajo mund t'u shërbejë më mirë emetuesve vendas, përfshirë këtu dhe qeverinë qendrore dhe vendore, si dhe investuesve për të mobilizuar kapitalet e tyre.
- BT-ja aktualisht është një institucion i ngritur, ka një status ligjor, staf punonjësish si dhe është i vetmi treg i licencuar letrash me vlerë në Shqipëri. Për rrjedhojë, mund të thuhet që Bursa e Tiranës përfaqëson qartësisht mundësinë më të shpejtë për ngritjen dhe funksionimin e tregut të kapitaleve në Shqipëri.
- BT-ja ofron mundësinë e një tregu të rregulluar, nga ana juridike e institucionale, në ndryshim të thellë nga zgjidhja e bazuar vetëm në një “treg-mbi-banak”. Prania e një tregu zyrtar, të ngritur siç duhet dhe me të gjithë parametrat dhe të mbikëqyrur me efektivitet nga AMF minimizon rreziqet e skandaleve dhe kolapsin e besimit të investuesve, lidhur me frikën e ripërsëritjes së skandalit të skemave informale të huamarrjes të vitit 1997.
- Ka gjasa që emetuesit dhe investuesit vendas të jenë më të gatshëm të përdorin shërbimet e tregut shqiptar të kapitaleve, sesa ato të një burse të

¹³ Id.

huaj. Në këto kushte, do të mund të kufizohej disi rreziku i eksportimit të kapitalit shqiptar jashtë vendit, në një kohë kur Shqipërisë i nevojitet një fluks i qëndrueshëm investimesh të huaja dhe jo emigrim i kapitalit vendas.

- Sistemi financiar i vendit do të mund të zhvillohej në mënyrë më të baraspeshuar, duke u siguruar investuesve dhe njësive ekonomike konkurrencë më të lartë dhe kosto kapitali më të ulët për kryerjen e investimeve afatgjata. Gjithashtu, sistemi financiar do të bëhej më i thellë, pasi në treg do të hynin dhe instrumente të reja të tregut të parasë, të kapitalit dhe të borxhit.
- Në tregun financiar do të rritej pesha ekonomike dhe administruese e skemave afatgjata të kursimeve, si: fondet e pensioneve dhe skemat kolektive të investimeve, si lojtarët kryesorë në tregjet e letrave me vlerë dhe atyre të kapitaleve.
- Do të mund të krijoheshin mundësitë për futjen e investuesve ndërkombëtarë të portofolit në Shqipëri. Kjo do të sillte një fluks të ri kapitali në vend si dhe një vlerësim, sipas parimeve të tregut, të bizneseve shqiptare të kuotuar në bursë.
- Me kalimin e kohës, BT mund të ofrojë mundësi për krijimin e një segmenti të veçantë për listimin e shoqërive shqiptare me kapitalizim të vogël tregu. Pa BT këto shoqëri rrezikojnë të mos përdorin shërbimet dhe lehtësitë që u ofron tregu i kapitaleve.
- Zhvillimi i BT-së do t'i mundësojë stafit të BT-së dhe AMF-së të fitojnë përvojë të vlefshme, për funksionimin dhe rregullimin e tregut të kapitaleve në tërësi. Përveç përfitimeve që ka tregu shqiptar, ky fakt do të forcojë pozitën negociuese të Shqipërisë, kur të fillojnë përpjekjet për t'u lidhur dhe bashkuar me bursat e tjera. Opsioni i zhvillimit të BT-së i le të hapura mundësitë për krijimin e këtyre lidhjeve.

Për sa i përket më lart, konkludohet se, aktualisht Shqipërisë i nevojitet bursa e kapitaleve. Ky është një konkluzion tashmë i nxjerrë nga të gjitha tryezat e diskutimeve dhe debateve, të zhvilluara brenda dhe jashtë Shqipërisë.

Qendra e Regjistrimit të Aksioneve

Qendra e Regjistrimit të Aksioneve (QRA) u krijua në 23.03.1996, mbi bazën e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.112, datë 19/02/1996, si një shoqëri aksionere ku shteti, i përfaqësuar nga Ministri i Ekonomisë Publike dhe i Privatizimit, ishte i vetmi aksioner në të.

Ajo u krijua si pjesë e Programit të Privatizimit Masiv (PPM) në Shqipëri, si rezultat i të cilit u krijuan rreth 100 shoqëri aksionere e për rrjedhojë, lindi nevoja

e ngritjes së një institucioni të specializuar, që do të shërbente për të mbajtur regjistrat e aksionerëve të këtyre shoqërive të sapo privatizuara.

Shërbimet kryesore që synoi dhe që aktualisht ofron QRA janë:

- mbajtja e regjistrave të aksionerëve të shoqërive, si në letër ashtu edhe në database;
- përditësimi i vazhdueshëm i këtyre regjistrave pas kryerjes së transaksioneve;
- mbikëqyrja e vazhdueshme mbi sasinë e aksioneve në qarkullim;
- ruajtja e informacionit konfidencial të emetuesit dhe të aksionerit;
- thirrja e asamblesë së përgjithshme të aksionerëve të shoqërisë;
- lëshimi i konfirmimeve mbi numrin e aksioneve të zotëruara nga aksionerët.

Nga 100 shoqëri aksionere të lindura nga Procesi i Privatizimit Masiv, vetëm 81 prej tyre kanë detyrimin ligjor të mbajnë regjistrat e tyre të aksioneve pranë QRA-së. Aktualisht vetëm 48 nga këto shoqëri kanë zbatuar ligjin. Si pasojë, QRA-ja ka të hapura aktualisht rreth 7.500 llogari aksionerësh. Vëllimi i transaksioneve në aksione ka qenë i konsiderueshëm, veçanërisht gjatë 3-4 viteve të para të veprimtarisë së QRA-së, me një mesatare prej 35.000 aksionesh të transferuara në muaj. Duhet theksuar se QRA-ja deri më sot shërben si stacioni i fundit i një tregu “mbi banak” jozyrtar për tregtimin e aksioneve në Shqipëri.

Ndërmjetësit e specializuar në Bursën e Tiranës

Ndërmjetësit e specializuar i kanë fillesat e tyre që me hapjen zyrtare të Bursës së Tiranës. Në këtë pozicion, fillimisht shërbyen:

- Bankat e nivelit të dytë: Banka e Kursimeve, Banka Kombëtare Tregtare, Banka Italo-Shqiptare dhe Banka Tregtare Agrare,
- Banka e Shqipërisë,
- INSIG si dhe
- dy individë privatë, që synonin shitblerjen e bonove të privatizimit.

Veçantia e tyre ishte se ato nuk ofruan asnjëherë shërbime ndërmjetësimi për të tretet (brokerim), por kryen transaksione vetëm për llogari të tyre në bono thesari dhe në obligacione qeveritare. Në vitin 2001 krijohet shoqëria e parë private *broker-dealer* për letrat me vlerë “Ballkan-Group”. Lindja e shoqërive private të brokerimit erdhi si përgjigje e përpjekjeve të vazhdueshme të Bankës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Financave për shkëputjen e Departamentit të Bursës së Tiranës nga BSH dhe themelimin e saj si shoqëri anonime.

Më vonë, në vitin 2002 krijohen shoqëritë e brokerimit “Triumpf Group” dhe “Action Capital”. Këto shoqëri private nuk janë aktualisht anëtare të Bursës së Tiranës. Ndërmjetësit aktual të specializuar në Bursën e Tiranës janë:

- Banka “Societe Generale Albania”, Banka Kombëtare Tregtare dhe Banka Raiffeisen-RBI,
- Shoqëria Komisionere “Kapital Invest” sh. a. me licencën Nr. 9, datë 25.06.2009.

Të gjitha këto shoqëri private dhe banka nuk kanë kryer asnjë transaksion të mirëfilltë brokerimi, për llogari të tyre ose për të tretët. Ndër argumentet kryesore të moskryerjes së transaksioneve nga këto shtëpi brokerimi janë: ekzistenca e një tregu tepër minimal sekondar për bonot e thesarit; ofrimi i mekanizmit të shitblerjes së tyre pranë sporteleve të bankave të nivelit të dytë në vend dhe decentralizimi i ofrimit të shërbimit të regjistrimit të bonove të thesarit, që penalizon kryesisht brokerat jo bankarë.

Bibliografia

- Bursa e Tiranës: “Strategjia e zhvillimit të Bursës së Tiranës si treg letrash me vlerë”, shtator 2011.
 Banka e Shqipërisë - “Historia e Bankës Qendrore të Shqipërisë”, Tiranë 2003.
 IMF - “Albania: Financial System Stability Assessment, including Reports on the Observance of Standards and Codes on the Following Topics: Banking Supervision and Payment System Series: Country Report no. 05/274”, August, 2005.
 Bursa e Tiranës - “Raporti Vjetor 1996”, Tiranë, 1997.
<http://www.bse-sofia.bg/?page=AboutBSE&PHPSESSID=310e731d4b935319b5caddb12d5c5d959>
http://en.wikipedia.org/wiki/Zagreb_Stock_Exchange.
<http://www.montenegroberza.com/code/navigate.asp?Id=59>.
http://en.wikipedia.org/wiki/Macedonian_Stock_Exchange.
http://en.wikipedia.org/wiki/Bucharest_Stock_Exchange.
http://en.wikipedia.org/wiki/Belgrade_Stock_Exchange.

Roli i së Drejtës Natyrore pas Luftës së Dytë Botërore (Rasti i Gjyqit të Nurembergut)

Dokt. Irisi Topalli

DOKTORANTE NË UET.

AS/PEDAGOGJE PRANË “AKADEMISË PROFESIONALE TË BIZNESIT”.

Abstrakt

E drejta natyrore është një grup i të drejtave të natyrshme dhe të bazuar në natyrën dhe ekzistencën e çdo njeriu. Gjithkush ka të drejta natyrore të barabarta (të tilla si: të drejtën për të jetuar dhe paprekshmërinë fizike apo lirinë personale) pavarësisht nga gjinia dhe mosha e tij, pozitën në shoqëri, koha, vendi, shteti ku ai jeton. E drejta natyrore është universale, e zbatueshme për të gjithë njerëzit dhe të gjitha kohërat. Të drejtat natyrore janë lindur me njeriun dhe shteti duhet t’i zbatojë, dhe për këtë arsye ajo konsiderohet e patjetërsueshme dhe e “përhershme”. Ato ndryshojnë nga ligji dhe normat e tjera juridike, që kanë ndryshuar historikisht, të vendosura nga shteti (e drejta pozitive). Në këtë punim do të ndalemi për të parë ndikimin e ligjit natyror, pas Luftës së Dytë Botërore, pasi kjo është periudha në të cilën ai kishte një ndikim të madh, veçanërisht në lidhje me doktrinën e së drejtës ndërkombëtare dhe të drejtave të njeriut. Fokusi i punimit do të jetë roli i të drejtës natyrore në gjykatat kombëtare të pasluftës dhe sidomos rasti i Gjykatës Ndërkombëtare të Nurembergut.

Fjalë kyç: Morali, të drejtat e njeriut, e drejta natyrore, e drejta pozitive.

Rëndësia e rilindjes së të drejtës natyrore në shek. XX

Mendimin filozofik të së drejtës natyrore e gjejmë që në fazat më primitive të zhvillimit shoqëror e deri në ditët e sotme, mendim ky i përfaqësuar nga teoria e së drejtës natyrore. Element thelbësor i kësaj teorie është se ka

karakter dualist, që do të thotë se përfaqësuesit e saj, ndryshe nga shumica e pozitivistëve, pranojnë ekzistencën e dy të drejtave dhe duke i vendosur ato në një rend hierarkik, përcaktojnë se e drejta pozitive duhet të jetë konform të drejtës natyrore. Për rrjedhojë sistemi pozitiv që nuk përkon me këtë të drejtë nuk ka forcë juridike detyruese. Gjithashtu ligjet pozitive duhet të kenë edhe funksionin për të bërë efektive përmes detyrimit urdhërat e kësaj të drejte (Troper, 2003, fq.10).

Përfaqësuesit, idetë, mendimet, klasifikimet, format e shfaqjes së teorisë natyrliste janë të shumta. Kështu është e njohur ndarja që i bëhet kësaj teorie në teori teologjike, e cila fokusohet te lidhja e së drejtës, moralit, e rendit hyjnor apo kozmik, dhe në teori laike e cila kufizohet në lidhjen e moralit me të drejtën. Një klasifikim më recent është ai që e ndan teorinë e natyralizmit në klasik dhe modern. Por pavarësisht klasifikimeve të ndryshme, që një jurist të jetë përfaqësues i natyralizmit juridik, duhet që teoria e tij të pranojë dy teza kryesore:

- a. ekzistojnë parime morale dhe të drejtësisë përgjithësisht të vlefshme dhe të kapshme nga arsyeja njerëzore;
- b. një sistem normativ apo një normë nuk mund të quhen juridike nëse janë në kundërshtim me këto parime morale dhe të drejtësisë (Nino, 1996, fq.24).

Teoria e së drejtës natyrore ka kaluar në disa faza ku secila prej tyre mbart me vete karakteristikat e epokës përkatëse, duke treguar lidhjen e ngushtë midis së drejtës dhe zhvillimit të shoqërisë. Kështu shek.XIX karakterizohet nga rritja e qëndrimit pozitivist ndaj së drejtës dhe rënia e natyralizmit.

Në këtë periudhë është pikërisht pozitivizmi ai që paraprin dhe një nga përfaqësuesit më të njohur të tij, John Austin, argumentonte se: “ për të kuptuar mirë të drejtën, duhet ta shqyrtojmë veças nga morali pasi ato janë dy institute të dallueshme nga njëri-tjetri” (Ikonomi, 2006, fq.40). Pozitivizmi ligjor shfaqet në variante të ndryshme, por ndikimin më të madh e pati varianti ideologjik me tezën sipas së cilës: “ cilado qoftë përmbajtja e normave të së drejtës pozitive, ato kanë vlefshmëri apo fuqi detyruese dhe dispozitat duhen zbatuar patjetër nga qytetarët dhe duhen aplikuar nga gjyqtarët, pavarësisht nga skrupujt e tyre moral” (Nino, 1996, fq.110). Kjo është teza për të cilën, pozitivizmi është kritikuar në vazhdimësi nga natyralizmi juridik i cili duke e konsideruar si thelbin e pozitivizmit ligjor e ka akuzuar atë si një doktrinë që ka shërbyer për justifikimin e regjimeve të forta, pasi ka krijuar kuadrin teorik brenda të cilit mund të justifikohen regjime të tilla si ai nazist.

Gjatë shek. XX pati një rilindje të teorisë natyrore, megjithëse situata nuk ishte kudo e njëjtë. Për shembull, në Angli nuk u shfaq ndonjë interes për të deri pas Luftës së Dytë Botërore, ndërsa në SHBA juristët i drejtoheshin shpesh kësaj të drejte kur interpretonin kapitullin e të drejtave themelore të Kushtetutës amerikane.

Por pavarësisht tendencave të ndryshme, disa nga faktorët që çuan në rilindjen e së drejtës natyrore në shumë vende, sidomos pas dy luftërave botërore janë:

- Rënia e stabilitetit ekonomik dhe social në mbarë botën;
- Zgjerimi i veprimtarisë së institucioneve qeveritare, veçanërisht ndërhyrja gjithnjë e më e madhe e institucioneve shtetërore në jetën private të qytetarëve nëpërmjet ligjeve;
- Zhvillimi i armëve të shkatërrimit masiv dhe përdorimi i tyre në luftërat në shkallë botërore;
- Dyshimet gjithnjë e më të mëdha për suksesin e shkencës për identifikimin dhe zgjidhjen e problemeve të njerëzimit (Ikonomi, 2006, fq.41).

Të gjitha këto treguan se pozitivizmi, veçanërisht varianti ideologjik i tij, nuk mund të bëjë asgjë për të kapërcyer apo për të përmirësuar situata të tilla, si ato ku u gjend shoqëria gjatë kësaj periudhe. Në mënyrë të veçantë, Lufta e Dytë Botërore vuri në dukje se ndarja e ligjit nga morali krijon mundësi për regjime totalitare dhe dhunim masiv të të drejtave të njeriut. Në këtë kuadër rivlerësimi i mendimit pozitivist dhe i së drejtës natyrore gjatë shek. XX është në mënyrë të konsiderueshme rezultat i tiranisë dhe i paqëndrueshmërisë politike në këtë periudhë, e sidomos nga refleksioni *eks post facto* i juristëve mbi historinë e së drejtës në Gjermaninë naziste. Përkrahësit e natyralizmit duke marrë shkak nga përvoja naziste e konsiderojnë ndarjen e ligjit nga morali dhe pozitivimin në tërësi, si një armë në duart e tiranit. Në këtë periudhë ndodhi ajo që Kelzen shpreh në përpjekje për të parashtruar një teori të kulluar të së drejtës: “Shkenca ligjore pozitiviste, e pastruar nga politika, sociologjia, psikologjia, është e sukseshme vetëm në periudha të ekuilibrit social. Ndërsa në rastet e mungesës së ekuilibrit publik duhet të drejtohem te teoria e së drejtës natyrore”.

Ndër përfaqësuesit kryesor të epokës së Rilindjes të së drejtës natyrore përmendim Fuller dhe Radbruch. Fuller, një nga filozofët më në zë të shek. XX, solli një kontribut origjinal në mendimin për të drejtën natyrore, duke u larguar nga teoria klasike e duke ofruar një teori të re të përpunuar, ku theksi nuk vihej në parimet supreme me origjinë hyjnore apo natyrore, por në procedurat ligjore të drejta dhe transparente. Në veprën e tij më të rëndësishme “Moralit i ligjit”, ai e sheh moralin si karakteristikë të ligjit dhe thotë se e drejta duhet të ketë një përmbajtje minimale morale dhe se morali i së drejtës ka karakter procedural, që do të thotë se është i lidhur me mënyrën se si ligji krijohet, shpallet, interpretohet dhe zbatohet. Ky moral procedural i së drejtës apo moral i brendshëm përbëhet nga disa parime që theksojnë faktin se e drejta duhet të përbëhet nga rregulla me karakter të përgjithshëm dhe se këto rregulla duhet të shpallen, të jenë të qarta e të kuptueshme, të mundshme e të realizueshme dhe të mos ndryshojnë në mënyrë të shpeshtë. Duke analizuar procesin ligjvënës në Gjermaninë naziste, Fuller deklaroi

se sistemi ligjor nazist dështoi në zbatimin e këtyre parimeve, për pasojë nuk mund të quhet fare sistem ligjor. Sot parimet procedurale të Fullerit gjenden pothuajse në gjithë legjislacionet moderne, përfshi edhe legjislacionin tonë shqiptar.

Padyshim pati ndikim në mendimin e kësaj periudhe filozofi gjerman Radbruch, i cili u konvertua nga pozitivist në natyralist. Duke analizuar periudhën naziste ai pa se ishte abuzuar me konceptin e bindjes ndaj ligjit, në emër të sloganit “ligji është ligj” dhe kjo sipas tij kontribuoi fuqishëm në aktet çnjerëzore të nazizmit. Ai deklaroi se parimet e moralit njerëzor janë pjesë e vetë konceptit të së drejtës dhe se asnjë ligj, statut apo ndonjë tjetër akt normativ nuk është i vlefshëm nëse nuk respekton parimet e moralit (Dramrosch dhe Henkin, 2001, fq.405).

Rilindja e së drejtës natyrore në këtë periudhë pati rëndësi edhe për ridimensionimin e së drejtës ndërkombëtare, madje pjesa më e madhe e natyralistëve mendojnë se kjo rrymë gjen më tepër fushë zbatimi në të drejtën ndërkombëtare. Këtu bëjnë pjesë disa përfaqësues si Giorgio Del Vecchio, Roberto Ago apo Alfred Verdross, që mendojnë se e drejta natyrore është bazë e së drejtës në përgjithësi dhe e së drejtës ndërkombëtare në veçanti (Puto, 2012, fq.511). Kjo pikë, për rëndësinë që paraqet do të trajtohet si çështje më vete.

Ndikimi i së drejtës natyrore në Gjyqin e Nurembergut dhe gjykatat kombëtare të pasluftës

Pas Luftës së Dytë Botërore, proceset gjyqësore për krimet e luftës, baza ligjore ku u mbështetën këto gjykata, parimet që ndoqën për të gjykuar të pandehurit, padyshim që u ndikuan nga idetë natyraliste të rilindura në këtë epokë duke vënë në dyshim vlerat e pozitivizmit ligjor. Debat midis pozitivistëve dhe autorëve të së drejtës natyrore shndërrohet në një debat që ka të bëjë me konceptin e sundimit të së drejtës dhe raportin e drejtë - moral. Dy pyetje u ngritën në këtë periudhë:

- a. A duhet të pranojmë idenë pozitivistë se në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve duhet të mënjanojmë të gjitha standartet morale?
- b. A duhet qëllimet moralisht të pranueshme të udhëheqin vendimet politike?

Ky debat si dhe roli e ndikimi i së drejtës natyrore pas Luftës së Dytë Botërore, manifestohet më së miri përmes Gjyqit Ndërkombëtar të Nurembergut, i cili ishte arena e kthimit të së drejtës natyrore në debatin filozofiko-juridik.

Më 20 nëntor 1945 Forcat Aleate (SHBA, BS, BM, Francë) të dala fituese nga Lufta e Dytë Botërore, mblidhen në qytetin gjerman të Nurembergut (simboli i nazizmit dhe persekutimit të hebrenjve) në Pallatin e Drejtësisë, për të zhvilluar të parin gjyq në historinë e njerëzimit nga një Gjykatë Ndërkombëtare Penale e krijuar *ad hoc*, si rezultat i Marrëveshjes së Londrës, më 8 gusht 1945 (Mayda, 1972, fq.22).

Nga kjo marrëveshje u krijua Statuti apo Karta e Londrës, e cila i dha juridiksion Gjykatës, për gjykimin e krimeve kundër paqes, krimeve të luftës, krimeve kundër njerëzimit, duke krijuar një ligj *post factum* që hidhte bazat e përgjegjësisë individuale penale, për akte që në kohën kur ishin kryer, kishin shkelur të drejtën ndërkombëtare të asaj periudhe, konkretisht Pakti Brian-Kellog, Konventa e Gjenevës, Traktati i Sevres. Këtu e kanë bazën edhe një nga kritikantët më të shpeshta që i bëhet Gjyqit të Nurembergut, si pasojë e shkeljes së parimit të mosprapaveprueshmërisë së ligjit penal. Por në raste të tilla, duhet të kemi parasysh se përdorimi i një ligji me fuqi prapavepruese sado i keq të jetë, është gjithsesi më i ndershëm.

Njihën gjithsej 13 procese të Nurembergut, të ndara në dy grupe, ku padyshim procesi i parë ishte ai që pati ndikimin më të madh në opinionin publik ndërkombëtar. Në këtë proces u gjykuan nga Tribunali Ushtarak i Nurembergut 24 ndër gjeneralët dhe krerët më famëkëq të Gjermanisë Naziste, si dhe 6 organizata kriminale mes të cilave SS dhe Gestapo.

Trupi gjykues përbëhej nga gjykatës të Forcave Aleate. Të akuzuarve nuk ju lejua që të kontestonin përbërjen e tij, dhe si për ironi të fatit, ata që për vite me radhë kishin shkelur të drejta e parime morale, dilnin tashmë me tezën se duhej zbatuar parimi moral i universalitetit ku të akuzuar dhe akuzues, duhet të jenë subjekte për të njëjtat standarte. Akuzat ishin:

1. Konspiracion, përgatitja e një plani të përbashkët për kryerjen e krimeve të mëvonshme;
2. Krime kundër paqes, për drejtimin e luftërave agresive kundër shteteve të tjera duke shkaktuar Luftën e Dytë Botërore e duke shkelur 34 Traktate Ndërkombëtre;
3. Krimet e luftës, për shkeljen e së Drejtës Ndërkombëtare të Luftës, përmes trajtimit çnjerëzor të civilëve e të burgosurve të luftës, tortura, skllavëri, grabitje;
4. Krime kundër njerëzimit, për kryerjen e akteve ekstreme kundër kundërshtarëve politikë, minoriteteve racore e grupeve etnike (genocidi i hebrenjve).

Akuza e përbërë edhe kjo nga prokurorë të shteteve fituese gjatë gjithë procesit ilustroi 12 vitet e një regjimi makabër, në të gjitha detajet e tmerrshme të tij përmes provave të dokumentuara ku ishin (rreth 2500) dhe qindra dëshmitarë okularë. Provat e sjella në këtë proces dëshmonin për shifra e akte nga më të tmerrshmet e rrëqethëset: ku 50 000 000 njerëz prisnin drejtësi! E pikërisht përballë këtyre fakteve, megjithëse u zbatua parimi i kontradiktoritetit, mbrojtja nuk pati shumë për të debatuar.

Më poshtë do të trajtohen në një interpretim filozofiko-juridik përmes raportit natyralizëm- pozitivizëm, e drejtë - morale, tezat e akuzës dhe të mbrojtjes.

Kështu vihen përballë avokatët e mbrojtës me prokurorët e çështjes, të cilët në fakt janë shprehje e përballjes në vazhdimësi mes dy teorive, natyralizmit juridik e pozitivizmit ligjor. Mbrojtja nuk mohonte faktet mbi të cilat mbështetej akuza, por kontestonte kualifikimin juridik të saj. Sipas saj, të akuzuarit kishin kryer akte që pavarësisht vlerës së tyre morale apo jo kishin qenë tërësisht të ligjshme në përputhje me legjislacionin e kohës dhe vendit ku ishin kryer. Ata kishin vepruar në përputhje të plotë me normat juridike të nxjerra nga organe të ligjshme të shtetit Nacional-Socialist. Ata jo vetëm kishin qenë të autorizuar të bënin atë që kishin bërë, por në disa raste kishin qenë juridikisht të detyruar ta bënin. Si rrjedhim në bazë të “bindjes ndaj kryetarit të shtetit” që kishte ndërtuar një autokraci nga e cila ishte e pamundur të dilje, të akuzuarit nuk duhej të shpallehin të fajshëm, pasi kishin qenë thjesht ekzekutues të urdhërave të dhëna nga lart. I vetmi fajtor i barbarizmave të fashizmit ishte Hitleri! Gjithashtu mbrojtja kujtonte një parim bazë të drejtësisë i pranuar prej shumë kohësh dhe që vetë sistemi nazist nuk kishte njohur: *nullum crimen, nulla poena sine lege praevia*. Kështu ata pretendonin se nëse do të dënoheshin të akuzuarit do të shkelej ky parim liberal, pasi aktet dhe objektet e gjykimit nuk ishin të dënueshme sipas së drejtës në kohën dhe vendin ku ishin kryer.

Në kundërshtim me këtë tezë, akuza në terma natyraliste, argumentonte se të flitej për të drejtë dhe sistem juridik ishte e tepërt, pasi nuk ndodhemi para një sistemi të tillë sa herë që një grup njerëzish arrijnë të inponojnë disa rregulla në një shoqëri të caktuar dhe ato përdornin forcën për zbatimin e tyre pavarësisht vlerës morale që ato kanë. Ky koncept sipas saj, kishte çuar në moton e gabuar “ligji është ligj”. Gjithashtu ajo kujtonte se mbi normat e nxjerra nga njerëzit ekzistojnë disa parime universalisht të vlefshme e të pandryshueshme, të cilat krijojnë kritere drejtësie dhe të drejta themelore ekzistuese në vetë natyrën njerëzore: e drejta për jetë, integritet fizik, liria e mendimit, e ndërgjegjes dhe e fesë, liria e shprehjes, e drejta për mosdiskriminim, e drejta për një proces të rregullt ligjor. Tërësia e këtyre parimeve përbën atë që quhet e “drejtë natyrore”, e drejtë kjo që është e pranishme si në të drejtën kombëtare, ashtu edhe në atë ndërkombëtare. Normat pozitive të nxjerra nga njerëzit përbëjnë të drejtën vetëm nëse janë në përputhje me këto parime. Duke qenë se rregullat e regjimit nazist nuk janë norma juridike, ato nuk vlejnë për të legjitimuar aktet e kryera në përputhje me to. Ato dhunojnë parimet më elementare të së drejtës natyrore, një e drejtë që ekzistonte në kohën kur ato u kryen, ekziston sot dhe do të ekzistojë përgjithmonë. Prandaj rezulton absurd pretendimi se të dënosh të pandehurit do të çonte në shkelje të “*nullum crimen, nulla poena sine lege praevia*”. Nga ana tjetër të pandehurit kishin shkelur të drejtën ndërkombëtare prandaj duheshin dënuar.

Më 1 tetor 1946, pas 218 ditëve, u shpall vendimi, i cili përkrahu fuqishëm akuzën, dhe ku përveç të tjerash u shpallën 11 dënime me vdekje. Pavarësisht kritikave që ju bënë Gjyqit të Nurembergut, sidomos në aspektin procedural

dhe për faktin se ky Tribunal shërbeu më shumë si hakmarrje e Aleatëve duke gjykuar nën frymën e “drejtësisë së fituesve”, është e padiskutueshme vlera morale që pati ai për ndëshkimin e disa mizorive që nuk duhet të harrohen kurrë! Gjyqi i Nurembergut është ndër proceset më të rëndësishme në historinë e njerëzimit pasi shënon shprehjen e ndërgjegjes universale. Idetë natyraliste të rilindura ndikuan në këtë proces për të hedhur poshtë të drejtën naziste, dhe për të rivlerësuar të drejtat natyrore të njeriut. Në lidhje me karakteristikat e sistemit ligjor gjerman dhe me faktin nëse ndodhemi para një legjislacioni të vlefshëm apo jo është interesante të citohet pikëpamja e përfaqësuesve të epokës së rilindjes të së drejtës natyrore. Sipas Fuller ligjet naziste, ishin sekrete dhe e bënin të pamundur për qytetarët njohjen e bazës ligjore ku mbështetnin veprimtarinë organet shtetërore. Ai argumentonte se sistemi nazist ishte jo vetëm jo eficient, por i mungonin të gjitha standartet procedurale të drejtësisë dhe të transparencës. Sipas tij shkelja e standarteve procedurale shpie në miratimin e ligjeve moralisht të padrejta dhe se këto shkelje ishin aq serioze në Gjermaninë e asaj kohe, saqë mund të themi se i gjithë sistemi ligjor pushoi së ekzistuari si i tillë. Si rezultat gjykatat e pasluftës nuk duhet ta njihnin ligjin nazist.

Pretendimi për mos ekzistencën e ligjit në Gjermaninë naziste ishte një përfundim në të cilin kishin arritur edhe juristë të tjerë përkrahës të natyralizmit, mes të cilëve edhe Franz Neumann, jurist i njohur që punoi në Gjermani gjatë kohës që, gradualisht, po vinin në pushtet nazistët. Ai shkroi se: “Nuk ekziston ndonjë mbretëri e ligjit në Gjermani, pavarësisht se ekzistojnë mijëra rregulla teknike të numërueshme”. Ai argumentonte se një sistem i tillë është manipulim i masave të gjëra të popullit me anë të terrorit. Ligji sipas tij karakterizohet nga *voluntas* (shprehje e pushtetit të sovranit) dhe *ratio* (shprehje e arsyes apo e parimeve racionale të trupëzuara në postulatet e përgjithshme etike).

Debati natyralizëm-pozitivizëm dhe triumfi i doktrinës të së drejtës natyrore, vazhdoi edhe në praktikën e gjykatave gjermane të pasluftës, nën ndikimin e gjyqit të Nurembergut, duke treguar se dallimet mes pozitivizmit dhe të drejtës natyrore nuk kanë karakter të thjeshtë teorik, por kanë ndikim të konsiderueshëm në praktikën e gjykatave. Në këtë drejtim, përveç versionit të parashtruar nga Fuller e Neumann, një rëndësi të madhe pati dhe qëndrimi i juristit gjerman Gustav Radbruch. Kështu ai thotë se çdo jurist apo gjyqtar duhet të denoncojë çdo normë ligjore që shkel parimet bazë të moralit, jo me argumentin e thjeshtë se është e pamoralshme, por se është e pavlefshme, pra se nuk ka vlefshmëri ligjore dhe, për pasojë, nuk duhet të merret fare në konsideratë në çështjet konkrete individuale. Për Radbruch, një ligj është i vlefshëm në rast se ai:

- a. kalon testet formale të vlefshmërisë ligjore të një sistemi të caktuar dhe, më e rëndësishmja,
- b. nuk dhuron parimet bazë të moralit.

Qëndrimi i Radbruch u konkretizua nga praktika e gjykatave në Gjermaninë e pasluftës ku, në shumë raste, kriminelë të luftës, spiunë apo informatorë u ndëshkuan në bazë të ideve të tij. Një rast i tillë është ai i informatores naziste. Kështu në vitin 1944, një grua e cila “dëshironte të hiqte qafe” burrin e saj, e denoncoi atë tek autoritetet naziste, duke informuar se, ai kishte bërë deklaramë fyese ndaj Hitlerit. Gruaja nuk kishte ndonjë detyrim ligjor për të raportuar këtë akt, megjithëse deklaratat e të shoqit ishin haptaz në kundërshtim me statutin nazist të asaj kohe që konsideronte të paligjshme deklaratat që propagandonin kundër fuqisë dhe pushtetit të Rajhut të Tretë. Mbështetur në këtë bazë ligjore i shoqi u arrestua dhe u dënua me vdekje. Në vitin 1949, bashkëshortja u akuzua në një gjykatë të Gjermanisë Perëndimore për veprën penale “heqje e paligjshme e lirisë së tjetrit”. Kjo veprë ishte e dënueshme nga Kodi Penal i vitit 1871, që ishte në fuqi që nga koha e miratimit të tij. Përpara gjykatës, gruaja argumentoi se vepra e saj ishte në përputhje me statutin nazist dhe, për pasojë ajo nuk kishte kryer ndonjë krim. Gjykata e Apelit, e cila mori në shqyrtim çështjen, e konsideroi gruan fajtores për heqjen e lirisë së tjetrit duke argumentuar se: “Statuti ishte në kundërshtim me ndërgjegjen e shëndoshë dhe konceptin e drejtësisë për të gjitha qëniet njerëzore normale”. Kjo do të thotë se statuti ishte i pavlefshëm në vitin 1994, kur ndodhi ngjarja, pasi ishte i pamoralshëm, për pasojë, gruaja do të ndëshkohej nga Kodi i vitit 1871 për heqje të padrejtë të lirisë së tjetrit.

Ky arsyetim është pasuar edhe nga të tjera çështje, të cilat janë konsideruar si triumf i doktrinës të së drejtës natyrore.

Influenca në doktrinën e së drejtës ndërkombëtare dhe të drejtat e njeriut

Influencën e të drejtës natyrore, e gjejmë padyshim edhe në doktrinën e së drejtës ndërkombëtare, madje mund të themi se ky është ndikimi më i rëndësishëm që ka ajo sot.

Pas Luftës së dytë Botërore u përhap ideja e “primatit” apo e “epërsisë” të së drejtës ndërkombëtare mbi atë të brendshme, si dhe ideja e afirmimit të një të “drejte botërore” që i përket së ardhmes. Këto ide kanë mbërritur deri në ditët tona dhe janë karakteristike për pjesën më të madhe të juristëve. Sot parimet abstrakte të së drejtës natyrore shërbejnë për të ridimensionuar parimin e sovranitetit shtetëror, në emër të një rendi që është i organizuar në shkallë botërore dhe në emër të një ideali që është i mbështetur mbi një të drejtë universale.

Këtu vlen të përmendet ideja e juristit italian Del Vecchio i cili thotë se paqja e përhershme arrihet nëpërmjet “vëllazërimit të të gjithëve” dhe këtë vëllazërim ai e mbështet në një rend superkombëtar. Del Vecchio quan si bazë të çdo të drejte, pra edhe të së drejtës ndërkombëtare, “arsyen natyrore”.

Një tjetër jurist italian, Roberto Ago, përhap idenë e së “drejtës spontane” si një variant i së drejtës natyrore. Kjo e drejtë sipas tij nuk rrjedh nga një burim formal, por lind vetvetiu në ndërgjegjen e njerëzve duke gjetur më shumë zbatim në të drejtën ndërkombëtare, pasi këtu nuk ka organe të posaçme për nxjerrjen e normave.

Rëndësi në arsenalin e së drejtës natyrore të sotme ka edhe pikëpamja e juristit austriak Verdross i cili shikonte Kartën e OKB-së si dhe dokumentet e mëvonshme të të drejtave të njeriut si mundësi për ndryshimet esenciale për krijimin e një të drejte supershtetërore.

Një etapë të re në zhvillimin e së drejtës ndërkombëtare shënoi padyshim edhe vendimin e Tribunalit të Nurembergut. Kjo konkretizohet në “Principet e së Drejtës Ndërkombëtare të njohura nga Statuti dhe nga Sentenca e Tribunalit të Nurembergut”, i mbajtur në 1950 nga Komisioni i së Drejtës Ndërkombëtare të OKB-së. Këtu u vendos përmbledhja në një projekt-kod i parimeve të rëndësishme lidhur me krimet e luftës, krimet kundër paqes dhe krimet kundër njerëzimit, duke ngarkuar me përgjegjësi penale individin. Gjithashtu u hodh ideja jo vetëm për hartimin e kodeve ndërkombëtare penale, por edhe për krijimin e një Gjykate të Përhershme Ndërkombëtare Penale. Po ashtu Statuti i Gjykatës si dhe Karta e OKB-së përcaktojnë se në rast se lufta bëhet fakt i kryer, megjithë masat që merren për parandalimin e saj, duhet të mos lejohet që ajo të kthehet në një sistem kriminaliteti, por përkundrazi palët ndërluftuese duhet të vihen përpara detyrimit që t’u përmbahen normave humane të së drejtës ndërkombëtare. Të gjitha këto zhvillime, pasojë e Gjyqit të Nurembergut, nën influencën e të drejtës natyrore, patën një ndikim të madh në zhvillimet e mëtejshme të së drejtës ndërkombëtare, e në veçanti në kuadër të të drejtave të njeriut, duke i dhënë botës një dimension të ri, më human.

Në lidhje me rëndësinë që morën të drejtat e njeriut në këtë periudhë përmendim idetë e Ronald Dworkin. Ai është portretizuar shpesh si përfaqësues i së drejtës natyrore, megjithëse nuk është shumë e qartë nëse vetë Dworkin e ka identifikuar veten tërësisht me një rrymë apo me një tjetër. Për më tepër, ai kritikon, si të drejtën natyrore ashtu edhe pozitivizmin, duke u pozicionuar në një vend të mesëm midis këtyre dy rrymave, apo, siç është quajtur shpesh, si përfaqësues i një teorie të tretë që ka të bëjë më shumë me të drejtat e njeriut sesa me moralin apo me sanksionin. Gjithsesi do të ndalemi tek ato ide që ai i ka të përbashkëta me natyralizmin. Kështu, kur Dworkin flet për pozitën dhe veprimtarinë e gjyqtarit thotë se ai mund t’i ndryshojë rregullat në emër të të drejtave, duke u mbështetur tek parimet. Sipas tij këto parime trupëzojnë përgjithësisht bazën morale të një sistemi ligjor të posaçëm. Parimet sipas tij janë pjesë e çdo sistemi. Sipas Dworkin, roli funksional i gjykatave është zbatimi i ligjeve në emër të të drejtave.

Idetë e Dworkin janë vetëm një nga shembujt që tregojnë se një nga zhvillimet më domethënëse të së drejtës natyrore në doktrinën e së drejtës ndërkombëtare,

është padyshim mbrojtja e të drejtave të njeriut. Lidhur me këtë duhet përmendur, pikë së pari, angazhimi i OKB-së në këtë fushë me akte të tilla si vetë Karta e OKB-së e vitit 1945, Deklarata universale e të drejtave të njeriut e vitit 1948, Pakti për të drejtat civile dhe politike i vitit 1966, Pakti për të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore, i po këtij viti, apo dhe angazhimi i Evropës me Konventën Europiane të të drejtave të njeriut, e vitit 1950.

Brian Bix, studiues i së drejtës, kur flet për rolin dhe rëndësinë e të drejtës natyrore shprehet kështu:

“Teoria e së drejtës natyrore ka luajtur një rol qendror në zhvillimin e teorisë politike moderne dhe në të drejtën ndërkombëtare. Nuk është e rastësishme që Deklarata e Pavarësisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, në vitin 1776, e pretendon autoritetin e saj nga “ligjet e natyrës” dhe u referohet “të drejtave të patjetërsueshme” të jetës, lirisë dhe arritjes së lumturisë. Po në mënyrë analoge, Deklarata Franceze për të Drejtat e Njeriut, 1789, deklaron të drejtat natyrore, të patjetërsueshme, dhe hyjnore të njeriut”.

Kështu, do të mund të vazhdonim arsyetimin e tij, me Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut, ku në nenin 1 të saj thuhet se:

“Të gjitha qeniet njerëzore lindin të lira e të barabarta nga pikëpamja e dinjitetit dhe e të drejtave. Ato janë të pajisura me arsye dhe ndërgjegje dhe duhet të veprojnë njëra ndaj tjetrës në një frymë vëllazërie”.

Ndërkohë që në nenin 3, 4, 5, thuhet se çdo njeri ka të drejtën e jetës, lirisë, sigurisë, dhe se askush nuk mund të mbahet në skllavëri, apo t’i nënshtrohet torturës, dënimeve, apo trajtimeve mizore, çnjerëzore ose degraduese.

Për të vazhduar me Preambulën e Paktit për të drejtat ekonomike, shoqërore, kulturore, si dhe Paktin për të drejtat civile e politike, ku thuhet se:

“... në përputhje me parimet e shpallura në Kartën e Kombeve të Bashkuara, njohja e dinjitetit që u përket të gjithë pjesëtarëve të familjes njerëzore dhe e të drejtave të tyre të barabarta e të patjetërsueshme, përbën themelin e lirisë, drejtësisë dhe të paqes në botë,.....këto të drejta burojnë nga dinjiteti i pandarë që i përket çdo njeriu”.

Gjithashtu Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut në nenin 2 shpall të drejtën për jetë, neni 3 ndalon torturën, dhe neni 4 ndalon skllavërinë dhe punën e detyruar.

Këto janë vetëm disa nga aktet më të rëndësishme të cilat së bashku me një sërë aktesh të tjera, përbëjnë sot bazën e legjislacionit ndërkombëtar për të drejtat

e njeriut, duke realizuar kështu “pozitivizimin” e të drejtës natyrore. Ndikimi i saj në këtë drejtim është shumë i rëndësishëm, dhe që i shprehur përmes Gjyqit Ndërkombëtar të Nurembergut, i cili edhe pse kritikave të shumta, si një proces më shumë moral se sa juridik, bën diçka shumë të rëndësishme...zgjedh të ardhmen!

Bibliografia

- Alfieri, L. (2003) *Filosofia e politica dei diritti umani nel terzo millennio*. Milano: Giuffrè Editore.
 Damrosch, L. F. & Henkin, L. (2001) *International law, cases and materials*. Minn.: West Group, St. Paul.
 Ikononi, L. (2006) *Filozofia e së drejtës*. Tiranë: Ekspres.
 Mayda, G. (1972) *Il processo di Norimberga*. Milano: Arnoldo Mondadori Editore.
 Nino, C. S. (1996) *Introduzione all' analisi del diritto*. Torino: G. Giappichelli Editore.
 Puto, A. (2012) *E drejta ndërkombëtare publike*. Tiranë: Dudaj.
 Troper, M. (2003) *Cos'è la filosofia del diritto*. Milano: Giuffrè Editore.

Hyrje

Ndarja e pushteteve është ndër parimet kryesore të shtetit të së drejtës, sepse ky parim përbën një nga themelet bazë të çdo demokracie me qëllim të kontrollit dhe balancës ndërmjet degëve të pushtetit, e cila u ofron pavarësi organeve shtetërore në ushtrimin e kompetencave të tyre, por mundëson edhe punën sa më efikase nga ana e tyre për shkak të kontrollit që ushtrohet nga organet e tjera shtetërore. Funksionin mbikëqyrës e ushtrojnë vetëm parlamentet e shteteve me sistem parlamentar, ngaqë në këto shtete organi ekzekutiv është i zgjedhur nga parlamenti, andaj nga këtej buron e drejta e Kuvendit për të ushtruar kontroll të vazhdueshëm si dhe për ta shkarkuar Qeverinë në rastet e caktuara. Në çdo shtet me demokraci përfaqësuese të zhvilluar, organet legjislativë kanë mekanizma të veçantë përmes të cilëve mbikëqyrin punën e institucioneve ekzekutive. Mbikëqyrja parlamentare përkufizohet si kontroll i cili ushtrohet nga ana e parlamentit ndaj organeve të tjera. Kuvendi si institucioni më i lartë ligjvënës ushtron kontroll mbi ekzekutivin si dhe ndaj institucioneve të tjera kushtetuese për të verifikuar nëse janë duke u zbatuar dispozitat ligjore të miratuara prej tij. Mbikëqyrja parlamentare realizohet me mjete juridike të përcaktuara me aktet juridike më të larta të Kuvendit siç bie fjala Kushtetuta, Rregullorja e Brendshme e Kuvendit etj. Termi kontroll apo mbikëqyrje rrjedh nga fjala franceze *controle* që në gjuhën shqipe ka kuptimin e kontrollit-mbikëqyrjes ndaj organeve të tjera. Kontrolli i brendshëm është kur mbikëqyrja realizohet nga organet më të larta ndaj organeve më të ulëta p.sh. qeveria mbikëqyr ministritë, ministritë departamentet etj. Ndërsa kontrolli i jashtëm është kontroll i cili ushtrohet nga një organ i përgjithshëm shtetëror ndaj organeve të tjera si p.sh. nga Parlamenti. Organet shtetërore ndaj të cilave ushtrohet mbikëqyrja parlamentare janë ato organe që për punën e tyre përgjigjen para Parlamentit, Ekzekutivi duke filluar nga Kryeministri dhe Ministrat e caktuar në kuadër të Qeverisë të cilët përgjigjen para Parlamentit për punën e tyre, Presidentit që së paku njëherë në vit i obligohet që ti drejtohet Kuvendit dhe me vetë faktin se Presidenti si në Kosovë ashtu edhe në Shqipëri zgjidhet dhe mund të shkarkohet nga Kuvendi me një peticion të një numri të caktuar deputetësh nënkupton që kemi të bëjmë me një mbikëqyrje parlamentare edhe ndaj Presidentit.

Kontrolli parlamentar në komisione

Funksioni i kontrollit parlamentar është atribut i rëndësishëm kushtetues i institucionit të Parlamentit ngaqë është një atribut që i kontribuon sendërtimit të demokracisë së një vendi. Mbikëqyrja parlamentare realizohet në funksion të informimit mbi punën e qeverisë rreth zbatimit të ligjeve dhe mënyrës së realizimit të politikave shtetërore. Parlamenti ka pushtetin që të mbikëqyrë qeverinë nëpërmjet

Kontrolli parlamentar ndaj qeverisë në komisionet e Kuvendit të Republikës së Kosovës

Msc. Shukrije Stublla-Shabani

ASISTENTE EKZEKUTIVE E MINISTRIT TË ARSIMIT,
TË SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Abstrakt

Parlamenti si një organ i zgjedhur nga populli është bartësi kryesor i funksioneve më të rëndësishme shtetërore dhe politike të shtetit. Parlamenti është institucioni ku zhvillohen diskutimet dhe votimet e ligjeve, miratimi i buxhetit të shtetit, nga i cili zgjidhen anëtarë të organeve të tjera, si dhe mbikëqyrjet puna e qeverisë. Historikisht është e njohur tendenca e parlamenteve për të zgjeruar kompetencat kundrejt pushtetit ekzekutiv, mirëpo në ditët tona parlamentarizmi është më shumë një formë e regjimit përfaqësues në të cilin parlamenti konsiderohet institucioni kryesor në raport me institucionet e tjera, por gjithmonë brenda kornizave kushtetuese dhe ligjore. Paralel me funksionin përfaqësues dhe ligjvënës, mbikëqyrja e Qeverisë dhe mbajtja e saj përgjegjëse konsiderohet si një nga përgjegjësitë kryesore të parlamenteve demokratike. Funksionin mbikëqyrës në komisione parlamentare e ushtrojnë vetëm parlamentet e shteteve me sistem parlamentar, ngase në këto shtete organi ekzekutiv është i zgjedhur nga parlamenti, andaj nga këtej buron e drejta e Kuvendit për të ushtruar kontroll të vazhdueshëm si dhe për ta shkarkuar Qeverinë në rastet e caktuara. Komisionet parlamentare janë mekanizma që bëjnë amendamentin e projektligjeve, kontrollin e veprimtarisë së qeverisë dhe institucioneve tjera, si dhe ndërveprojnë me publikun.

Fjalë kyç: Kontrolli parlamentar, parlament, pushtet ekzekutiv, komisione parlamentare, kushtetutë, ligj.

një numri të madh mjetesh dhe mekanizmash të parashikuara me kushtetutë dhe rregullore të brendshme të parlamentit, duke filluar nga ato instrumente që vënë në pikëpyetje përgjegjësinë e qeverisë e deri te ato me karakter thjesht informativ. Qeveria jep llogari para parlamentit për punën e saj sepse qeveria është organ i krijuar nga parlamenti dhe për këtë është edhe e obliguar të japë përgjegjësi qoftë si tërësi apo edhe të ndonjë anëtar të caktuar të saj, por edhe për arsyen se qeveria është e obliguar të zbatojë ligjet dhe aktet tjera të miratuara nga parlamenti. Kemi dy lloje mjetesh të mbikëqyrjes parlamentare: mjetet e rregullta juridike (miratimi i buxhetit, paraqitja e raporteve periodike të qeverisë në parlament) dhe mjetet e jashtëzakonshme juridike (pyetjet e deputetëve, interpelanca parlamentare, debatet parlamentare, instituti i votëbesimit të qeverisë, shkarkimi i qeverisë si dhe komisionet parlamentare hetimore). Në këtë drejtim të mbikëqyrjes parlamentare rol të rëndësishëm luajnë komisionet parlamentare qoftë ato të përhershme apo *ad hoc*. Mund të themi që kontrolli më i rëndësishëm dhe i vazhdueshëm realizohet në komisionet parlamentare, kjo për shkakun sepse komisionet parlamentare janë një instancë që e lehtësojnë kontrollin sa më të detajuar të projektligjeve, kontrollin e veprimtarisë së qeverisë dhe ndërveprimin me publikun, si dhe me organe të tjera që janë nën kontrollin e kuvendit. Komisionet i ofrojnë kuvendit dhe deputetëve mundësi më të fuqishme kontrolli, ngaqë pjesa më e madhe e veprimtarive parlamentare në ditët e sotme zhvillohet në komisione sesa në seanca plenare. Komisionet janë trupa punuese në kuadër të kuvendit, që përbëhen prej një numri të caktuar të deputetëve dhe zakonisht pasqyrojnë edhe përbërjen e spektrit politik në Kuvend. Secili prej komisioneve mbulon një fushë të caktuar qoftë politike, ekonomike, ligjore etj. Ndër të tjera komisionet janë përgjegjëse edhe për:

- Shqyrtimin dhe amendamentin e projektligjeve nga fushëveprimtaria e tyre,
- Mbikëqyrjen e zbatueshmërisë së ligjeve,
- Mbikëqyrjen e punës së organeve ekzekutive dhe institucioneve të tjera të pavarura,
- Si dhe shqyrtimin dhe miratimin e dokumenteve të tjera të rëndësishme.

Në kuadër të parlamentit funksionojnë komisionet e përhershme dhe komisionet *ad hoc* që krijohen për trajtimin e vetëm të një çështjeje konkrete për afatin e caktuar kohor. Në përgjithësi parlamentet kanë një numër komisionesh të përhershme që përfshijnë fusha të kompetencës së ministrive. Ndër kompetencat e tyre është se mund të kontrollojnë më shumë se një ministri, çfarë e zgjeron aktivitetin e komisioneve në mbikëqyrjen e ekzekutivit. Komisionet e përhershme kompetenca kryesore kanë shqyrtimin e nismave ligjore por njëkohësisht kompetencë shumë të rëndësishme kanë edhe kontrollin mbi ministrinë përkatëse. Komisionet luajnë rol kyç në proceset demokratike përmes shqyrtimit të projektligjeve nën për nen, konsultimeve me publikun e gjerë, thirrjen e Ministrave dhe zyrtarëve të Qeverisë

për të raportuar për punën e tyre, dhe angazhimin e ekspertëve të ndryshëm gjatë shqyrtimit të legjislacionit.¹ Ndërsa për sa i përket përbërjes së komisioneve dimë se komisionet janë reflektim i përbërjes së parlamentit, që nënkupton që secili grup parlamentar përfaqësohet në komisione në përputhje me numrin e deputetëve që ka në parlament, pra komisionet parlamentare kanë përfaqësim proporcional të deputetëve përmes përfaqësuesve të Grupeve të tyre Parlamentare.

Për të ushtruar funksionin mbikëqyrës, komisionet kanë mjete dhe procedura të ndryshme, si: Organizimi i seancave dëgjimore me përfaqësues të institucioneve, organizatave të shoqërisë civile, mediave, ekspertëve të pavarur, qytetarëve etj. Organizimi i vizitave në terren, për të parë nga afër punën e institucioneve ekzekutive apo duke u paraqitur në vendin e ngjarjes për të parë për së afërmi çështjet specifike që monitorohen; Koordinimi me institucionet e tjera të pavarura mbikëqyrëse, si Auditori i Përgjithshëm, Avokati i Popullit, organizatat e shoqërisë civile, etj.²

Baza ligjore për funksionin mbikëqyrës të komisioneve në Kuvendin e Kosovës parashihet në Kushtetutë dhe në Rregulloren e Punës së Kuvendit. Këto dy dokumente bazike ofrojnë një sërë mjetesh të cilat u mundësojnë komisioneve të ushtrorjnë në mënyrë efikase funksionin mbikëqyrës. Kështu në Kushtetutën e Kosovës, parashihet, Kuvendi i Kosovës i cili emëron komisione të përhershme, komisione funksionale dhe komisione *ad hoc*, që pasqyrojnë përbërjen politike të Kuvendit.³ Kuvendi, me kërkesën e një të tretës (1/3) së të gjithë deputetëve të tij, cakton komisione për një çështje të veçantë, duke përfshirë edhe çështje hetimore.⁴ Pushtetet dhe procedurat e komisioneve përkufizohen me Rregulloren e Punës të Kuvendit. Në bazë të Rregullores së Punës, komisionet mund të kërkojnë informacione me shkrim nga ministrinë, por edhe të thërrasin ministrat për të raportuar, për çështjet të cilat janë duke u trajtuar nga komisioni. Zakonisht, komisionet themelojnë nën komisione apo grupe punuese të veçanta të cilat angazhohen në mbikëqyrjen specifike të çështjeve nën juridiksionin e komisionit. Secili komision, brenda fushës së përgjegjësisë të tij, është i autorizuar ta mbikëqyrë zbatimin e ligjit nga Qeveria, përkatësisht nga ministria.⁵ Komisionet parlamentare kanë këto autorizime lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve nga Qeveria, përkatësisht ministria e caktuar:

- a. Kontrollojnë dhe studiojnë efektivitetin e ligjeve në fuqi në kuadër të fushëveprimit të tyre, zbatimin e tyre dhe propozojnë masa për rastet konkrete.

¹ NDI - National Democratic Institute, "Vlerësim i punës së Kuvendit të Kosovës me rekomandime për zhvillim të mëtejshëm", Prishtinë 2008, fq. 27.

² Kuvendi i Republikës së Kosovës, Doracak "Funksioni Mbikëqyrës i Komisioneve Parlamentare", Prishtinë 2012, fq. 8.

³ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 77, par.1, fq. 27.

⁴ Po aty, neni 77, par. 2.

⁵ Rregullorja e Punës së Kuvendit të Kosovës, neni 73, par.1.

- b. Përgatisin listën, që përmban: datën e shpalljes së ligjit, datën e publikimit të ligjit në Gazetën Zyrtare, listën e dispozitave të ligjit, që duhet të zbatohen nga Qeveria, listën e vendimeve të Qeverisë se këto dispozita zbatohen.
- c. Bëjnë kontrollimin e veprimtarisë së përgjithshme të ministrisë përkatëse dhe
- d. Raportojnë me shkrim dhe me gojë një herë në vit në mbledhjet plenare të Kuvendit.⁶

Por në rast se ministria nuk raporton ose nëse raportimi i saj konsiderohet jo i plotë, me kërkesë të komisionit çështja hyn në rendin e ditës së mbledhjes tjetër plenare. Komisionet nga praktika e deritanishme, zakonisht takohen dy herë në muaj, por në raste të caktuara mund të takohen edhe më shpesh. Në parim një deputet mund të jetë anëtar i vetëm i një komisioni, por mund të marr pjesë edhe në mbledhjet e komisionit tjetër por pa të drejtë vote. Anëtar i një komisioni mund të jetë edhe deputeti që nuk i përket asnjë grupi parlamentar, mirëpo pa të drejtë vote. Në Kuvendin e Kosovës kemi katër komisione të përhershme si dhe dymbëdhjetë komisione funksionale. Komisionet e përhershme në Kuvendin e Kosovës: 1. Komisioni për Buxhet dhe Financa, 2. Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe për Kthim, 3. Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi dhe 4. Komisioni për Integritet Evropian. Komisionet funksionale në Kuvendin e Kosovës janë këto: 1. Komisioni për Punë të Jashtme, 2. Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion, 3. Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, 4. Komisioni për Arsimit, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sporte, 5. Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, 6. Komisioni për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media, 7. Komisioni për Punë të Brendshme dhe Siguri, 8. Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione, 9. Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, 10. Komisioni për Mbikëqyrjen e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë, 11. Komisioni për Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës, 12. Komisioni për Mandat, Imunitet dhe Rregullore të Kuvendit.

Raportimi i qeverisë në komisionet parlamentare

Komisionet parlamentare kanë të drejtën e shqyrtimit të raporteve të paraqitura nga ana e qeverisë, por gjithashtu komisionet mund të kërkojnë nga ministrat e ministrive përkatëse të shpjegojnë raportet e tyre e të japin informacione plotësuese për çështjet e trajtuara. Komisionet në mbledhjet e tyre mund të kërkojnë që të jenë të pranishëm edhe nga anëtarët e qeverisë, gjë që u mundëson të ushtrojnë kontrollin më efikas. Në rastet kur vlerësohet se nevojitet të jetë i pranishëm ministri përkatës, atëherë thirrja bëhet nga ana e kryetarit të atij komisioni. Në këtë mënyrë duke

⁶ Po aty, neni 73, paragrafi 3.

pasur të pranishëm ministrin apo zëvendësministrin, komisionet arrijnë të marrin sqarimet e detajuara lidhur me veprimtarinë e qeverisë. Përmes këtyre diskutimeve të zhvilluara, komisionet kërkojnë llogari nga anëtarët e qeverisë lidhur me aktivitetet e ministrive të tyre, por gjithashtu këto takime mund të jenë edhe thjesht me karakter informues për komisionin lidhur me aktivitetin e një ministrie.

Në Rregulloren e Kuvendit të Kosovës në nenin 73, paragrafi 2, përcaktohet që ministria përkatëse i raporton komisionit funksional në lidhje me zbatimin e ligjit pa kërkesën e komisionit, së paku një herë në vit. Kjo pikë obligon ministrin që të raportojnë për zbatueshmërinë e ligjeve nën juridiksionin e tyre në komisionet përkatëse parlamentare së paku një herë në vit. Mirëpo me Rregullore të Kuvendit nuk përcaktohen edhe afatet se në cilën periudhë kohore ministria është e obliguar të paraqesë raport para komisionit, por kjo mbetet që me marrëveshje në mes të komisionit përkatës dhe ministrisë përkatëse të përcaktohet periudha kohore kur ministria do të raportojë. Në rast se ministria nuk raporton ose nëse raportimi i saj konsiderohet jo i plotë, me kërkesë të komisionit çështja hyn në rendin e ditës së mbledhjes tjetër plenare.⁷ Në bazë të planit të veprimit, grupi punues për mbikëqyrje të zbatimit të ligjit, mund të ftojë ministrin apo zyrtarin përgjegjës të raportojë me shkrim dhe me gojë në njërin nga mbledhjet e komisionit parlamentar për nivelin e zbatimit të ligjit përkatës. Një raport i paraqitur nga ministria duhet të përmbajë:⁸

- Datën e fillimit të implementimit të ligjit;
- Masat që ka ndërmarë Qeveria për të zbatuar ligjin që nga data e hyrjes së tij në fuqi;
- Numrin e akteve nënligjore të miratuara dhe procesi i hartimit të akteve të tjera nënligjore të cilat parashihen me ligj;
- Krijimi i organeve të reja (borde, departamente) të cilat parashihen me ligj;
- Kostoja financiare reale e zbatimit të ligjit (nëse kjo është e ndryshme nga Vlerësimi i Ndikimit Financiar, i përlllogaritur në kohën kur projektligji është proceduar në Kuvend);
- Problemet e hasura në zbatim: vështirësitë e jashtme (pengesat në terren) apo vështirësitë e brendshme (mungesa e kapaciteteve për zbatim apo paqartësitë në interpretimin e dispozitave të ligjit);
- Planet e ministrisë për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit.

Kontrolli i zbatimit të buxhetit të shtetit

Kuvendi dhe komisionet parlamentare kanë të drejtën e shqyrtimit dhe aprovimit të buxhetit të shtetit, mirëpo krahas këtyre Kuvendi dhe komisionet kanë të drejtën edhe

⁷ Rregullorja e Punës së Kuvendit të Kosovës, neni 73, paragrafi 4.

⁸ Po aty, fq.20.

të kontrollit të zbatimit të buxhetit shtetëror. Kontrolli buxhetor është një funksion kryesor i komisioneve parlamentare, sepse shumica e programeve qeveritare zbatohen mbi bazën e buxhetit të miratuar nga ana e Kuvendit. Kuvendi përmes ligjeve në fuqi, obligon Qeverinë dhe organizatat e tjera buxhetore që të raportojnë në baza të rregullta për shpenzimet dhe të hyrat buxhetore. Pasi që të miratohet përfundimisht buxheti nga ana e Kuvendit, komisionet parlamentare janë të obliguara të mbikëqyrin zbatueshmërinë e buxhetit shtetëror, duke u bazuar në raportet e qeverisë. Raportet dorëzohen në bazë të tre mujorit të parë, gjashtë mujorit, nëntë mujorit dhe raporti përfundimtar vjetor i buxhetit. Kontrolli i zbatimit të buxhetit të shtetit, përveç që ka karakterin e informimit rreth shpenzimeve nga ana e qeverisë, ka karakterin edhe të ndihmës së komisionit që gjatë përgatitjes së raportit buxhetor për vitin e ardhshëm, të jetë më i përgatitur rreth nevojave buxhetore të atij institucioni. Për sa i përket kontrollit të zbatimit të buxhetit të shtetit nga qeveria shumica e kuvendeve të vendeve demokratike kanë krijuar komisione të veçanta parlamentare përgjegjëse për të mbikëqyrur integritetin, ekonomitetin, efikasitetin dhe efektivitetin e menaxhimit të financave nga ana e Qeverisë, përmes ekzaminimit të dokumenteve financiare dhe shqyrtimit të raporteve të zyrës së Auditorit të Përgjithshëm.⁹ Edhe Kuvendi i Kosovës, ka ndjekur një praktik të tillë kur më 2009, ka themeluar Komisionin për Mbikëqyrjen e Financave Publike, i cili kryesisht ka rol mbikëqyrës. Sipas Ligjit mbi buxhetin dhe ligjet e tjera mbi financat publike rregullohen procedurat e kontrollit të zbatimit të buxhetit të shtetit. Gjatë monitorimit të zbatueshmërisë së buxhetit, komisioni parlamentar duhet të ketë parasysh këto aspekte:

- A është arritur plani i të hyrave vjetore buxhetore? Nëse jo, cilat janë pengesat e mos realizimit të të hyrave të parapara buxhetore?
- Si është shpenzuar buxheti sipas kategorive, si: kategoria e pagave, mallrave dhe shërbimeve, investimeve kapitale?
- A shpenzohet buxheti i njëtrajtshëm përgjatë tërë vitit, apo ka periudha kohore kur buxheti shpenzohet më shumë se në periudhat tjera (siç është rasti i shpenzimeve për kategorinë e investimeve kapitale)?
- A është i mjaftueshëm buxheti i ndarë apo kërkohet buxhet shtesë për vitet në vijim?
- Në rast të tepricave buxhetore, një gjë e tillë ndodh si pasojë e paaftësisë së institucionit për të menaxhuar me buxhetin e saj, apo institucioni mund të funksionoj me më pak buxhet vjetor?
- Cilat janë të gjeturat kryesore në raportin e Auditorit Gjeneral dhe çfarë thonë raportet e Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike për institucionin?¹⁰

⁹ Kuvendi i Republikës së Kosovës, Doracak “Funksioni Mbikëqyrës i Komisioneve Parlamentare”, Prishtinë 2012, fq.35.

¹⁰ Kuvendi i Republikës së Kosovës, Doracak “Funksioni Mbikëqyrës i Komisioneve Parlamentare”, Prishtinë 2012, fq.35.

Për të arritur që kontrolli i zbatimit të buxhetit të jetë sa më efikas, që të mos ketë praktika të keq menaxhimit të parasë publike, duhet që komisionet të ushtrojnë rolin e tyre kushtetues për të mbikëqyrur zbatueshmërinë e buxhetit. Meqenëse procesi buxhetor është mjaft i komplikuar dhe është pothuajse e pamundur që secili nga komisionet parlamentare të punësojnë në stafin e tyre ekspert nga lëmija e financave, të cilët do të ishin përgjegjës për të ndihmuar komisionin e caktuar rreth zbatueshmërisë së buxhetit nga një institucion i caktuar, në këtë drejtim në ndihmë u vinë ekspertizat dhe mbështetjen nga Komisioni për Buxhet dhe Financa, Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, Drejtorja për Hulumtime Parlamentare si dhe te OJQ-të e ndryshme.

Seancat dëgjimore mbikëqyrëse

Seancat dëgjimore mbikëqyrëse të komisioneve parlamentare janë treguar shumë efikase në ushtrimin e mbikëqyrjes ndaj veprimtarisë së ministrave përkatëse. Ato mund të përdoren si një formë konsultimi ose si një mjet që shërben për të marrë dëshmi ndërmjet komisionit parlamentar dhe ministrit apo zyrtarit të qeverisë. Ndonëse raportet dhe deklaratat e ministrave përbëjnë një informacion të rëndësishëm për punën mbikëqyrëse të komisioneve, komisionet shpesh kanë nevojë të marrin edhe informacione të drejtpërdrejta në seanca dëgjimore prej ministrave apo zyrtarëve përgjegjës dhe për zbatimin e programeve specifike qeveritare.

Rregullorja e Kuvendit të Kosovës nuk i parasheh dëgjimet mbikëqyrëse si një kategori të veçantë, ndonëse neni 73 u ofron komisioneve autoritet të gjerë në mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve dhe politikave qeveritare. Në bazë të këtij neni komisioneve u mundësohet të organizojnë dëgjime të karakterit mbikëqyrës, të ftojnë ministrat, zëvendës ministrat, si dhe udhëheqësit apo zyrtarët e institucioneve të tjera shtetërore, për të ofruar shpjegime dhe informacione në lidhje me zbatimin e programeve qeveritare, problemeve të evidentuara në zbatimin e ligjeve, problemeve të ndjeshme politike apo çështjeve të tjera që ndërlidhen me përgjegjësitë e tyre.¹¹ Neni 66 i Rregullores specifikon qartë që komisionet mund të mbajnë dëgjime për të marrë informacione rreth çështjeve që janë në shqyrtim e sipër, nga ekspertë të pavarur, përfaqësues të grupeve të interesit dhe persona të tjerë relevantë.¹² Për sa i përket procedurave të zhvillimit të dëgjimeve të komisioneve rregullohen me Doracakun e Kuvendit të Kosovës për dëgjimet e komisioneve. Sipas Flet notimit të KDI-së të periudhës janar-qershor 2013, dëgjimet publike po e reflektojnë edhe anën negative të komisioneve. Shumica e ligjeve kalojnë nga komisionet pa organizim të dëgjimeve

¹¹ Kuvendi i Republikës së Kosovës, Doracak “Funksioni Mbikëqyrës i Komisioneve Parlamentare”, Prishtinë 2012, fq.17.

¹² Rregullorja e Kuvendit të Kosovës, neni 66.

publike, edhe pse një gjë e tillë është në mandatin e komisioneve. Kjo formë e injorimit që komisionet po i bëjnë përfshirjes së qytetarëve, palëve të interesit dhe institucioneve të interesuara gjatë proceseve të shqyrtimit dhe analizimit të projektligjeve, me të drejtë shpeshherë ka nxitur reagimin e shoqërisë civile. Nga gjashtëmujori i dytë i vitit 2012, kur kishte vetëm 12 dëgjime publike, në gjashtëmujorin e parë të vitit 2013, ku ka pasur vetëm një më shumë, përkatësisht 13 dëgjime publike. Ndërkohë, gjatë kësaj periudhe komisionet kanë shqyrtuar afër 30 projektligje.¹³

Raportet e kontrollit të komisioneve

Pas përfundimit të shqyrtimit të një çështje të caktuar, komisioni harton një raport që përfshin të gjitha hetimet dhe studimet e bëra prej tij si dhe shpreh konkluzionet e tij, këto quhen raporte kontrolli ose studimi. Grupet punuese të komisioneve të cilat përpunojnë të gjitha informatat e grumbulluara nga aktivitetet e realizuara, të cilat më pas edhe i selektojnë dhe kategorizojnë për t'i përfshirë në raportin përfundimtar. Për t'u miratuar një raport i komisionit, është e nevojshme të votohet nga shumica e anëtarëve. Më pas raporti i përcillet seancës plenare, e cila debaton rreth përmbajtjes dhe konkluzioneve të paraqitura në të. Raporti shërben edhe për aktivitetet e ardhshme të komisionit për këtë çështje ose për çështjet që trajtohen aty, por raporti mund të shqyrtohet edhe nga komisionet e tjera parlamentare dhe deputetët që nuk janë anëtarë të këtij komisioni. Raportet e kontrollit të komisioneve munden gjithashtu t'i jepen qeverisë dhe të bëhen publike për të informuar për punën e komisionit të qeverisë, në mënyrë që qeveria edhe të mundet të reagojë rreth këtyre raporteve të komisioneve. Përmbajtja e një raporti të komisionit përgjithësisht përfshin¹⁴:

- Qëllimin,
- Përmbledhjen e konkluzioneve të komisionit,
- Shqyrtimin e arsyeve përse paraqiten këto konkluzione,
- Konkluzionet,
- Procesverbalin analitik të debatit,
- Dëshmitë e mbledhura dhe komunikimet gojore.

Në nenin 67 të Rregullores së Kuvendit të Kosovës përcaktohet që "Raportet e komisioneve për Kuvendin bëhen me shkrim. Raporti i komisionit përgjegjës raportues mund të plotësohet me gojë nga kryetari ose raportuesi i komisionit përgjegjës raportues".¹⁵ Por gjithashtu raporti duhet t'i përmbajë rekomandimet

¹³ Instituti Demokratik i Kosovës, Fletë notimet për Kuvendin e Kosovës. Prishtinë, Janar-Qershor, 2013.

¹⁴ Les outils du controle parlementaire, Publie par l'Union interparlementaire, Geneve, 2007, p.36.

¹⁵ Rregullorja e punës së Kuvendit të Kosovës, neni 67.

e komisionit, bashkë me arsyetimin përkatës. Fillimisht përgatitet drafti i parë i raportit në bazë të informacioneve të nxjerra, për të cilin raport më pas mbahet takimi i grupit punues ku diskutohet për draft raportin në përgjithësi, më pas drafti me plotësimet përpunohet dhe forma përfundimtare e raportit hidhet në votimin nga grupi punues i komisionit. Forma përfundimtare i paraqitet në njërën prej mbledhjeve të rregullta të komisionit dhe për vlefshmërinë e raportit duhet që raporti të miratohet nga shumica e anëtarëve të rregullt të komisionit. Më pas raporti i miratuar nga komisioni parlamentar i paraqitet Kryesisë së Kuvendit për të cilin raporti zhvillohet edhe seanca plenare. Raportin në emër të komisionit e prezanton kryetari i komisionit ose kryesuesi i grupit punues, dhe më pas fjalën e marrin shefat e grupeve parlamentare kurse të drejtën e kanë edhe deputetët që të diskutojnë rreth raportit. Gjatë shqyrtimit të raportit për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit në seancë plenare duhet të jetë prezent edhe ministri përgjegjës për implementimin e ligjit. Në fund të diskutimeve raporti me rekomandimet dhe vërejtjet hidhet në votim dhe miratohet me shumicën e votave të deputetëve në kuvend. Miratimi nga Kuvendi i raportit me rekomandime për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit paraqet detyrim për Qeverinë përkatësisht ministrin përkatës që në afatin e përcaktuar nga Kuvendi të zbatojë rekomandimet dhe të raportojë në Kuvend lidhur me zbatimin e tyre.¹⁶ Pasi të përfundojë afati i përcaktuar kohor nga Kuvendi për zbatimin e rekomandimeve, komisioni përgjegjës e fton ministrin apo zyrtarin përgjegjës të raportojë në komision lidhur me implementimin e rekomandimeve të miratuara në seancë plenare. Në rast se nuk janë të implementuar rekomandimet, komisioni mund të kërkojë për një afat tjetër të arsyeshëm kohor që të përmbushen rekomandimet e përcaktuara, por gjithashtu në këtë rast këtë çështje komisioni do ta ngrejë edhe në seancë plenare. Ky lloj i raportimit është tanimë duke u zbatuar në Kuvendin e Kosovës dhe Shqipërisë.

Komisionet hetimore

Komisionet hetimore janë instrumente të rëndësishme të Kuvendit për të ushtruar mbikëqyrje ndaj degës ekzekutive dhe për të hetuar çështje të caktuara me interes publik. Komisionet hetimore krijohen kryesisht në rastet e keqpërdorimit të pushtetit apo financave publike nga ana e zyrtarëve publikë, veçanërisht nga ata që gëzojnë imunitet.¹⁷ E drejta e hetimit realizohet brenda kompetencave kushtetuese që kanë parlamentarët në ushtrimin e kontrollit në sqarimin apo hulumtimin më

¹⁶ Kuvendi i Republikës së Kosovës, Doracak "Funksioni Mbikëqyrës i Komisioneve Parlamentare", Prishtinë 2012, fq. 29.

¹⁷ Kuvendi i Republikës së Kosovës, Doracak "Organizimi i Dëgjimeve në Komisionet Parlamentare", Prishtinë 2011, fq. 9.

të hollësishëm të çështjes konkrete, por njëkohësisht kjo e drejtë shërben edhe si një mjet kontrolli edhe për pakicën parlamentare për të ushtruar kontroll kundrejt ekzekutivit. Këto komisione dallojnë nga komisionet e përhershme parlamentare, që paraqesin trupa të rregullta punuese të parlamentit, ngaqë komisionet hetuese janë të natyrës “*ad hoc*” që formohen për raste konkrete ku duhen sqaruar faktet që vërtetojnë përgjegjësinë e qeverisë apo të ndonjërit prej ministrive të saj. Zhvillimi i debateve parlamentare, gjithmonë u paraprijnë krijimit të komisioneve hetimore, ngaqë debatet parlamentare nuk mund të vërtetojnë dyshimet e rasteve të ndryshme të keqpërdorimeve pra, nuk mund të vërtetohen akuzat e deputetëve, andaj në rast se këto dyshime janë të bazuara ngrihen komisionet hetimore që për një afat të caktuar kohor të arrijnë në rezultate konkrete për çështjen për të cilin edhe janë ngritur.

Krijimi i komisioneve hetimore nga Kuvendi i Kosovës parashihet në nenin 77.2 të Kushtetutës dhe specifikohet në nenin 71 të Rregullores të Kuvendit, ndërkohë që detajet e tjera rreth organizimit dhe funksionimit të komisioneve hetimore definojnë në Ligjin për hetim parlamentar. Kuvendi, me kërkesën e një të tretës (1/3) së të gjithë deputetëve të tij, cakton komisione për një çështje të veçantë, duke përfshirë edhe çështje hetimore.¹⁸ Kurse më tej është specifikuar në Rregulloren e Kuvendit të Kosovës në nenin 71, përcakton se Kuvendi mund ta formojë një komision *ad hoc* të përkohshëm, që e ka autoritetin e komisionit funksional të merret me shqyrtimin e një çështjeje të veçantë. Sipas Ligjit për hetimin parlamentar, komisioni themelohet për të hetuar probleme dhe çështje ku janë drejt për së drejti të përfshira përgjegjësitë qeveritare apo shtetërore; gjithashtu komisioni themelohet me qëllim të konstatimit, përkrahimit të rrjedhës së ngjarjeve me qëllim të qartësimit të asaj se çfarë ka ndodhur dhe të përcaktimit të përgjegjësisë së atyre që kanë qenë të involvuar; si dhe të komisioni ku themelohet me qëllim të informimit, rekomandimit, ushtrimit të mbikëqyrjes parlamentare dhe të arritjes së një përfundimi.¹⁹ Komisioni në fund të hetimit do të përgatitë raportin përfundimtar lidhur me hetimet brenda afatit të caktuar nga Kuvendi. Pasi që Kuvendi ta pranojë raportin nga Komisioni hetues, hap debatin parlamentar ku raporti prezantohet fillimisht nga kryetari i komisionit apo anëtari raportues, dhe më pas hapet diskutimi për të gjithë deputetët. Pas përmbylljes së debatit parlamentar lidhur me raportin e komisionit hetues, bëhet edhe votimi për këtë raport. Në rast se, aprovetur ky raport lidhur me përgjegjësinë e qeverisë në tërësi apo ministrisë së caktuar, ngrihet procedura e votëbesimit të qeverisë nga ana e Kuvendit. Pas votimit të raportit, komisioni përfundon punën dhe shpërndahet meqenëse është ngritur për çështjen që tashmë është përfunduar.

¹⁸ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 77 paragrafi 2.

¹⁹ Ligji për Hetim Parlamentar nr. 03/L-176, neni 2, paragrafi 2, 3, 4.

Përfundime

Funksioni i kontrollit parlamentar në komisione është atribut i rëndësishëm i kushtetues i institucionit të Parlamentit ngaqë është një atribut që i kontribuon sendërtimit të demokracisë së një vendi. Ky funksion është atribut kushtetues i institucionit të Parlamentit, ngaqë përcakton veprimtarinë politike të Parlamentit dhe përfshin një numër të madh instrumentesh të ushtrimit të kontrollit ndaj Qeverisë. Kuvendi si institucioni më i lartë ligjvënës ushtron kontroll mbi ekzekutivin si dhe ndaj institucioneve të tjera kushtetuese apo të krijuara në bazë të ligjit për të verifikuar nëse janë duke u zbatuar dispozitat ligjore të miratuara prej tij. Mbikëqyrja parlamentare në komisione realizohet në funksion të informimit mbi punën e qeverisë rreth zbatimit të ligjeve dhe mënyrës së realizimit të politikave shtetërore. Vlen të ceket se pavarësisht kompetencave kushtetuese që gëzonte Kuvendi i Republikës së Kosovës nuk ka gjetur ende forma dhe vullnet për ushtrimin e këtyre kompetencave në mënyrë të mirëfilltë, mund të vërehet se ka një mungesë të mbikëqyrjes efikase ndaj ekzekutivit. Seancat plenare të pyetjeve parlamentare shfrytëzohen mjaft shpesh, ndonëse mjaft shpesh kabineti qeveritar edhe i injoron ato. Gjithashtu hezitimi i ministrave të kabinetit qeveritar për t’iu përgjigjur pyetjeve parlamentare të deputetëve, hezitimi i tyre për të qenë prezent në seanca plenare kur trajtohen çështje që dalin nga fushë veprimtarie e tyre, mos përgjigjja ndaj ftesave të komisioneve parlamentare për të raportuar në mbledhjet e tyre e deri tek injorimi i rekomandimeve apo qëndrimeve që dalin nga institucioni më i lartë përfaqësues në Kosovë dhe Shqipëri, janë raste të cilat dëshmojnë qartë për pamundësi të ushtrimit të mirëfilltë të kompetencave kushtetuese të mbikëqyrjes së ekzekutivit nga ana e legjislativit.

Literatura

Kushtetuta e Republikës së Kosovës, 15 Qershor 2008.

Rregullorja e Republikës së Kosovës, Prishtinë 2010.

Ligji për Hetim Parlamentar nr. 03/L-176.

Les outils du controle parlementaire, Publie par l’Union interparlementaire, Geneve, 2007.

Ligji për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2014, Nr. 04/L- 233.

NDI - National Democratic Institute, “Vlerësim i punës së Kuvendit të Kosovës me rekomandime për zhvillim të mëtejshëm”, Prishtinë, 2008.

Kuvendi i Republikës së Kosovës, Doracak “Funksioni Mbikëqyrës i Komisioneve Parlamentare”, Prishtinë 2012.

Kuvendi i Republikës së Kosovës, Doracak “Organizimi i Dëgjimeve në Komisionet Parlamentare”, Prishtinë 2011.

KDI - Instituti Demokratik i Kosovës, Fletë notimi për punën e Kuvendit të Republikës së Kosovës për periudhën janar-qershor, 2013, Prishtinë, 2013.

Agjenti i infiltruar në dhomat e "chat"- it

Dokt. Eureka Mujaj

DOKTORANTE NË FAKULTETIN JURIDIK, UET,
PEDAGOGJE PRANË UNIVERSITETIT "GJON BUZUKU", SHKODËR.

Abstrakt

*M*e zbvillimin e internetit, krimi ka gjetur një tjetër formë shprehjeje, të panjohur më parë. Si çdo teknologji e re e vënë në dispozicion të një numri të madh përdoruesish, interneti paraqet jo vetëm të mira dhe përfitime, por në të njëjtën kohë dhe një sërë problemesh. Keqpërdorimi i saj nga elementë kriminal njihet me emrin krim kibernetik (cybercrime). Në praktikën e përditshme konstatohen dy lloj sjelljesh përballë fenomenit të krimit kibernetik. Nga njëra anë qëndrojnë përdoruesit e zakonshëm dhe indiferent, të cilët mendojnë se janë imun përballë këtij rreziku dhe nga ana tjetër qëndrojnë specialistët, të cilët analizojnë këtë fenomen me shumë kujdes, në mënyrë, që të kuptojnë mënyrën e funksionimit të tij. Scott Peck, një psikiatër i njohur amerikan dhe autor i suksesshëm librash shkruan: "E vetmja mënyrë për të pasur siguri në jetë është të njohësh pasigurinë".

Mes formave të shumta të shfaqjes të krimeve kibernetike, një terren të përshtatshëm për "kultivim" ka gjetur pedofilia. Por, duke qenë se teknologjitë e reja janë në evolucion të vazhdueshëm dhe rreziqet e lidhura me këtë teknologji evoluojnë në të njëjtën mënyrë, natyrshëm lind pyetja: A ecën me të njëjtin ritëm teknikat investigative, që mund të parandalojnë apo ndëshkojnë këtë krim?

Përmes këtij punimi synoj të bëj një analizë kriminologjike, të njëjës nga format e shfaqjes së krimit informatik, "Pedofilisë - online" dhe mjeteve investigative të përdorura nga vende të ndryshme të botës për ta parandaluar këtë krim. Bëhet fjalë pikërisht për një mjet relativisht të ri investigimi, i cili është infiltrimi i agjentit të fshehtë në dhomat e chat-it (chat room).

Fjalët kyç: Internet, krimi kibernetik, agjenti i infiltruar, pedofilia.

Hyrje

Konteksti dhe fushëveprimi i krimit kibernetik është i gjerë dhe i shumëllojshëm, por synimi i këtij punimi është të trajtojë pikërisht atë aspekt, që ka të bëjë me Pedofilinë-online. Kur flasim për pedofilinë on-line, i referohemi sjelljeve devijante të pedofilëve në moshë madhore, të cilët kërkojnë të hyjnë në kontakt me pedofilë të tjerë, përmes internetit (chat, forum etj). Këto takime ato i shfrytëzojnë si mënyrë për të ushqyer fantazitë e tyre seksuale, përmes gjurmimit dhe shkëmbimit të materialeve pornografike.

Materialet pornografike konsistojnë në fotografi apo në video pedopornografike, që mundësojnë me pas takimin apo hyrjen në kontakt me të miturit, të cilët gjenden në rrjet. Bazuar në statistikat e institucioneve shtetërore të vendeve të zhvilluara, arrijmë të përcaktojmë një trend, gjithmonë e më në rritje, për sa i përket përhapjes së këtij fenomeni.

Ku qëndron vështirësia në identifikimin, procedimin dhe më pas gjykimin e këtij krimi?

Çfarë përbën problem në këtë drejtim, është vetë forma e shfaqjes së këtij krimi. Nga një këndvështrim legal, interneti është i konceptuar dhe funksionon në një mënyrë të tillë, që për të, nocioni i kufijve nuk ekziston. Në fushën juridike një krim në radhë të parë sanksionohet nga një ligj. Ky ligj i përket një shteti të caktuar dhe zbatohet nga një gjykatë kompetente e një shteti të caktuar. Nocioni i shtetit është i lidhur ngushtë me nocionin e territorit, pra me kufijtë shtetërorë. E shpjeguar më qartë, krimi kryhet në një juridiksion të caktuar, edhe pse, krimineli fizikisht ndodhet në një tjetër juridiksion. Kjo ndikon shumë në fazën e përndjekjes së këtij krimi.

Këto dhe të tjera çështje do të trajtohen më gjerësisht, gjatë këtij punimi, rezultatet e të cilit do të jenë pjesë integrale e temës time të doktoraturës.

Profili krimilogjik i pedofilëve

Pedofilët janë subjekte, të cilët karakterizohen nga kthjelltësi e plotë në të menduar. Ata pas një procesi të gjatë dhe kompleks të të menduarit, hyjnë në veprim për të gjurmuar të miturit.¹ Përgjithësisht, ata nuk veprojnë nën ndikimin e një vrulli të shfrenuar, por përkundrazi, janë subjekte që mendojnë, reflektojnë në mënyrë të qartë duke marrë parasysh të mirat dhe të këqijat që lidhen me ekzekutimin e sjelljeve kriminale dhe kënaqësive perverse.²

¹ Policia di stato-UACI (Unita di Analisi sui Crimini Informatici)-2004.

² Policia di stato-UACI (Unita di Analisi sui Crimini Informatici)-2004.

Veprojnë në fshehtësi të plotë. Në shoqëri janë thuajse të padukshëm, dhe sa të padukshëm aq dhe vrapar. Parashtruan sa thamë më sipër, për të kuptuar vështirësitë, që kanë të bëjnë me identifikimin e subjekteve të tilla kriminale në jetën tonë të përditshme, si dhe për t'u ndërgjegjësuar për rrezikun ndaj të cilit janë të ekspozuar minorenët në mbarë botën. Në bazë të statistikave, 12% e meshkujve dhe 17% e grave amerikane janë keqtrajtuar në fëmijëri dhe numri i rasteve të abuzimit seksual është rritur në mes të 1986 dhe 2003 me 120%.³ Ndikim në zgjerimin e këtij krimi, ka pasur zhvillimi i teknologjisë, i cili shndërrohet në një "armë të rrezikshme", në duart e gabuara. Pedofilët shfrytëzojnë burimet pafund, që ofron interneti, për të kapur "prenë" e rrallës. Ata konsiderohen si njohës të mirë të programeve kompjuterike dhe duke qenë të tillë, dinë të veprojnë pa lënë gjurmë dhe nëse dyshojnë se mund të identifikohen, dinë të tërhiqen në kohë.

Edukimi si masë mbrojtëse

Pedofilia është një rrezik real për fëmijët dhe ne nuk mund të pretendojmë, që ata të dinë si të vetëmbrohen. "Fëmija nuk mund të vetëmbrohet, pasi është tipike e periudhës së tyre të rritjes, mbajtja e një qëndrimi besues kundrejt botës së jashtme"⁴. Dhe pikërisht, kur ky besim goditet, marrëdhënia, që vendos më pas fëmija me botën e jashtme ndërpritet, duke ndikuar kështu negativisht në zhvillimin e tij psikologjik.

Ti mësoh fëmijët të mbrohen nuk do të thotë t'i mësoh të dyshojnë tek të gjithë, pasi të jetuarit në dyshime mund ta bllokojë fëmijën, duke i hequr dëshirën për të eksploruar botën, eksplorime këto, që e ndihmojnë të rritet. Liria, të jetuarit pa preokupime si dhe besimi janë të mira shumë të çmuara për t'u sakrifikuar nën altarin e frikës.⁵ Duke thënë se një fëmijë nuk mund të vetëmbrohet, nuk nënkupton se nuk mund të jetë i mbrojtur. Është shoqëria, që duhet ta mbrojë, është familja, është shkolla.⁶ Pa dyshim familja është struktura primare, që duhet t'i ofrojë fëmijëve mbrojtje, duke e këshilluar, duke i qëndruar afër apo duke i lënë fëmijët nën shoqërinë e një të rrituri gjatë orëve, që ai kalon në internet.⁷

Cilët janë programet më të përdorura nga pedofilët?

Peer-to-peer (P2P)

Shërbimi peer-to-peer (P2P) mundëson shkëmbimin e fotografive mes kompjuterave pa u lidhur me ndonjë faqe interneti (web site). Funkcioni kryesor i këtyre shërbimeve

³ Bruzzone, R., (2007) "Il profilo criminologico del pedofilo", Revista nr.III "ALTEREGO".

⁴ Pajardi, D. (1990) "Considerazioni sul danno psicologico in eta evolutiva, in d. pajardi, Danno biologico e danno psicologico" Milano: Giuffrè Editore, fq.72.

⁵ Andreoli, V. (2003) "Dalla parte dei bambini. Per difendere i nostril figli dalla violenza", Milano: Edizioni Superbur, fq. 173-174.

⁶ Gombia, A., (2002) "Bambini da salvare", Novara: Edizioni Red, fq.101.

⁷ "Le strategie di contrasto" <http://www.altrodiritto.unifi.it>

është të mundësojë shkëmbimin e të gjitha llojeve të dosjeve (file), nëpërmjet kompjuterave të përdoruesve të lidhur njëkohësisht me rrjetin të vendosura në të gjithë botën. Shumë nga sistemet peer-to-peer mundësojnë shpërndarjen e filmave, fotografive, muzikës, videove, librave etj. Duhet të kemi parasysh, që kjo është një prej mënyrave më të përdorura prej pedofileve për të shkëmbyer pamje apo video dhune dhe abuzimi, ndaj fëmijëve, madje edhe ndaj atyre në moshë fare të vogël. Shumë shërbime peer-to-peer inkurajojnë përdoruesit të shkarkojnë një numër të madh dosjesh (file). Mjafton një lidhje ADSL dhe pa asnjë pagesë shtesë, kompjuteri mund të lihet për orë të tëra duke shkarkuar kështu dhe duke shkëmbyer materiale pornografike.⁸

Duhet të reflektojmë mbi këtë fakt, pasi kompjuteri në këtë rast, na ekspozon përpara rreziqeve shumë të rënda, që lejojnë një qasje të lirë në kompjuterat tonë duke bërë kështu analogji me lënien e portës së shtëpisë hapur, pasi çdokush mund të marrë nga dosjet apo nga hard disku ynë atë që dëshiron.

Chatroom

Dhoma e chat, na mundësojnë një komunikim në kohë reale me njerëz nga e gjithë bota, duke përdorur kompjuterin tonë të lidhur me rrjetin. Shumë chat-e janë të organizuara në "dhoma", çdo dhomë ka një emër, që korrespondon me argumentin prevalues për të cilin po flasin personat në atë moment. Ne mund të shkruajmë në mënyrë publike, në mënyrë që, të gjithë të mund ta shohin atë që po shkruajmë ose mund të mbajmë një bashkëbisedim privat me një apo më shumë përdorues të chat-it. Duket argëtuese, por mund të jetë shumë e rrezikshme, nëse nuk kujdesemi për privatësinë (privacy) dhe për sigurinë tonë. Në fakt chat është një vend ku shumë njerëz kanë bindjen, se nuk është e rëndësishme të thuash të vërtetën, ka të rritur dhe djem, të cilët gënjëjnë në lidhje me identitetin e tyre, moshën, punën që bëjnë dhe mbi shijet e tyre. Disa argëtohen duke krijuar personazhe të ndryshëm nga realiteti, të tjerët mes të cilëve dhe abuzuesit seksual dhe pedofilët, përdorin chat për të hyrë në kontakt me fëmijët, për t'i dërguar pamje dhe video pornografike. Këto persona mund të diskutojnë rreth çështjeve, që lidhen me seksin dhe mund të bëjnë edhe kërcënime, apo dhe të thonë gjëra të pakëndëshme dhe të papërshtatshme për moshën e fëmijës. Për këtë arsye, asnjëherë nuk duhen dhënë të dhënat tona personale (emri dhe mbiemri apo numrat e telefonit qofshin ato celular apo telefon fiks), një të panjohuri përmes chat, edhe pse fillimisht na duket simpatik. Pasi këto të dhëna do t'i mundësojnë pedofilëve gjurmimin dhe gjetjen e të miturve.⁹

E-mail

Shërbimet e-mail, mundësojnë dërgimin e letrave miqve apo të afërmeve tanë pa përdorur stilolaps dhe letër, por thjesht me një klikim në kompjuterin tonë të lidhur me internet.

⁸ "Pedofilia-online", <http://www.commissariatodips.it>, datë 1.02.2013.

⁹ "Pedofilia-online", <http://www.commissariatodips.it>, datë 1.02.2013.

Persona dhe kompani dërgojnë çdo ditë në të gjithë botën qindra e-maile me ftesa për të blerë diçka apo për të vizituar ndonjë faqe interneti (web site). Kur është fjala për spamming në referohemi pikërisht këtij bombardimi të e-mailit, të padëshiruar, që sipas ligjeve të vendeve të zhvilluara, ajo është e paligjshme dhe për këtë arsye e ndaluar me ligj. Zgjedhja e adresës së e-mailit nuk duhet të përmbajë elemente, që duhet të japin udhëzime në lidhje me cilët jemi ne. P.sh. mund të ishte e përshtatshme zgjedhja e një adresë të postës elektronike të tipit: paperina15@...it, në vend të anarossi@...it, në mënyrë që të mund të mbrojmë identitetin tonë të vërtetë, nga persona që mund ta përdorin në mënyra të ndryshme, ndryshe nga çmendojmë ne. Njëkohësisht duhet pasur kujdes, për sa i përket mesazheve të marra nga individë të panjohur, asnjëherë nuk duhen hapur pasi mund të përmbajnë virus, spyware, apo pamje të padëshirueshme. Kur i përgjigjemi një e-maili, duhet pasur kujdes nëse përdorim funksionin "përgjigju" (reply), pasi kjo e nis automatikisht adresën tonë edhe të tjerëve, që nuk i njeh. Është mirë të evitohet dërgimin e fotove apo informacioneve private përmes e-mailit, pasi nuk mund të jemi të sigurt që miqtë tanë respektojnë privatësinë tonë.¹⁰

News group, forum, bbs

News groupet, forumet dhe Bbs, të mundësojnë të dërgosh dhe të lexosh mesazhe, të shkarkosh dhe të shkëmbelesh fotografi mes përdoruesve të rrjetit, në kohë reale dhe pastaj pasi mesazhi të jetë dërguar në forum mund të lexohet nga kushdo. Kjo është një mënyrë për të gjetur dhe për të shkëmbyer informacion mbi dëshirat dhe pasionet ku të cilët ato të ndajnë video, foto, programe të përdoruesve të tjerë. Të dërgosh mesazhe në news groups ose në forume përmban rreziqe, që duhen marrë në konsideratë, veçanërisht në lidhje me privatësinë dhe sigurinë tonë. Shumë shpesh dërgimi i një mesazhi në një forum apo news group, automatikisht bëhet i lexueshëm për të gjithë. Është e mundur, që dikush të përdorë për të na dërguar mesazhe të bezdisshme apo të papërshtatshme. Kështu që duhet të bëjmë kujdes të përdorim adresa e-maili, që nuk lejojnë të japin informacione mbi identitetin tonë të vërtetë. Disa news group apo forume i përkasin në mënyrë eksplicite seksit dhe pa dashur mund ta gjejmë veten përballë imazheve dhe videove mbresëlënëse, të padëshiruara apo dhe të paligjshme, nëse i përkasin skenave të të rriturve me të mitur nën 18 vjeç. Nëse rastësisht na ndodh të bëhemi dëshmitarë, të sjelljeve të paligjshme, menjëherë duhet të denoncojmë pranë autoriteteve përkatëse.¹¹

Instant messaging

Mesazhet e çastit (IM) është një shërbim i ofruar nga shumë shërbime të internetit, që na lejojnë të dërgojmë mesazhe me tekst të shkurtër, në telefonat celular ku

¹⁰ "Pedofilia-online", <http://www.commissariatodips.it>, datë 1.02.2013.

¹¹ "Pedofilia-online", <http://www.commissariatodips.it>, datë 4.02.2013.

ne dëshirojmë apo edhe drejt përdoruesve të tjerë të lidhur në rrjet në atë kohë. Menjëherë pas klikimit të dërgimit të mesazhit tonë, personi të cilit i kemi dërguar mesazhin mund ta lexojë.

Si duke përdorur chat-in, news group dhe mesazheve të çastit (IM), ne vëmë në rrezik privatësinë dhe sigurinë tonë. Para së gjithash nuk duhen dërguar mesazhe, që përmbajnë informacione mbi kush jemi dhe ku gjendemi, nëse nuk jemi të sigurtë 100% për qëllimin e mirë të atij që i merr këto informacione.¹²

Teknikat speciale investigative (hetimore) të parashikuara nga legjislacioni procedural penal shqiptar dhe zbatueshmëria e tyre

Prej disa vitesh legjislacioni penal i Republikës së Shqipërisë, ka rregulluar me ligj institutin e "Veprimeve simuluese" dhe atë të "Infiltrimit".¹³ Institute këto, që shërbejnë si mjete për marrjen e provave në proceset penale. Këto mjete janë parë të një rëndësie të veçantë, sidomos për sa i përket zbulimit dhe procedimit të personave, që kryejnë vepra penale komplekse, të rënda, të mirë organizuara dhe që paraqesin rrezikshmëri të madhe shoqërore. Të dy këto mjete hetimore përdoren nga policia, përmes veprimtarisë së fshehtë, por, që të japin rezultatin e duhur, duhen vënë në dorë të personave të kualifikuar dhe të përdoren me maturi.

Duke u bazuar në analizën e praktikave të ndryshme gjyqësore në Shqipëri, fatkeqësisht, vihet re një keqpërdorim, i këtyre mjeteve investigative (hetimore). Kjo, ka ardhur si pasojë e mungesës së përvojës dhe profesionalizmit nga ana e organeve proceduese, nën kontrollin dhe autorizimin e të cilëve, oficerët e policisë gjyqësore dhe agjente veprojnë.

Do të ishte e rastit, që ky mjet apo e thënë ndryshe, kjo "armë kundër kriminalitetit", të përdorej për të luftuar Pedofilinë-online. Vende të ndryshme duke përmendur këtu Italinë, e përdorin veprimtarinë e fshehtë, për të hyrë në kontakt me pedofilët, që ndodhen në rrjet. Chat-i është ai sektor, ku manifestohen më së shumti, rreziqet për të miturit. Një mjet i tillë komunikimi mundëson futjen në kontakt mes njerëzve pa dallim, moshe apo kulture, gjë, që në "jetën reale" do të ishte e limituar.¹⁴ E gjithë kjo, ndihmon pedofilët në fazën e parë të komunikimit me viktimat potenciale, për të mundësuar më pas një kontakt verbal apo një përmbushje të plotë të aktit kriminal, jashtë rrjetit.

Përfshirja apo futja e agjentëve të policisë në dhomat e chatit, do të bënte të mundur identifikimin dhe më pas procedimin e kësaj kategorie kriminelësh. Kontakti i parë me pedofilët do të ndodhte përmes veprimtarisë së fshehtë, në të

¹² "Pedofilia-online", <http://www.commissariatodips.it>, datë 4.02.2013.

¹³ Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë, neni 294/a dhe 294/b.

¹⁴ Spanti, A., "Tool e metodologie informatiche per il contrasto alla pedofilia online e alla pedo-pornografia", www.diritto.it.

cilën një agjent i infiltruar do të hiqej si i mitur dhe do të futej në kontakt me të, për të kuptuar më mirë qasjet e tij perverse.¹⁵ Agjentët në rolin e të miturit, do të kërkonin më pas të mundësonin një takim jashtë rrjetit.¹⁶ Por, brishtësia nga e cila karakterizohen veprimet simuluese dhe infiltrimi, kërkojnë profesionalizëm, pasi një provokim apo një joshje e tepruar nga ana e agjentëve, kundrejt "Pedofilin" të prezumuar, do të përbente një shkak për pavlefshmëri të rezultateve të këtij hetimi.¹⁷

Karakteret ndërkombëtar të krimit kibernetik dhe mekanizmat mbrojtës

Krimi kibernetik është një krim, që ka karakter ndërkombëtar, pasi veprimtaria kryhet në një territor dhe pasojat mund të vijnë në një territor tjetër. Nisur nga kjo, shqetësimi nuk kufizohet në një shtet të vetëm, por merr përmasa globale. Duke qenë i tillë, ky aktivitet kriminal, meriton vëmendjen e duhur për sa i përket miratimit dhe marrjes së masave të përshtatshme ligjore dhe implementimit të mjeteve efektive teknologjike dhe shtrënguese, që reduktojnë aktivitetin kriminal kibernetik. Përhapja e shpejtë dhe rritja e përdorimit të internetit ka mundësuar evoluimin e sistemeve kriminale, si dhe ka rritur kompleksitetin e hetimeve për këto çështje. Ky fakt ka shtyrë legjislatorin në parashikimin e dispozitave dhe normave të reja, që kanë të bëjnë me mjete moderne investigative. I referohemi këtu, dispozitave dhe normave, që rregullojnë veprimtarinë e fshehtë dhe infiltrimin, në fusha të ndryshme operative.¹⁸ Pasi është parë si mjeti më i përshtatshëm, që mund t'i përgjigjet më së miri krimit në fjalë.

Zhvillimi i vrullshëm i teknologjisë, ka prekur edhe vendin tonë, duke na bërë kështu përfitues të të mirave pafund, që teknologjia ofron, por dhe njëkohësisht duke na përballur me një sërë problematikash, të panjohura më parë.

- Natyrshëm lind pyetja, sa të përgatitur jemi ne, për t'u përballur me format të reja të shfaqjes së kriminalitetit?
- A janë bërë reforma legjislative dhe institucionale, nga Shteti Shqiptar, për të mundësuar, garantimin e një lundrimi të sigurt për fëmijët tanë?

Shqipëria, në kuadër të luftës kundër krimit kibernetik dhe krimit të organizuar, ka ratifikuar një sërë aktesh ndërkombëtare, ku ndër to mund të radhisim:

¹⁵ Spanti, A., "Tool e metodologie informatiche per il contrasto alla pedofilia online e alla pedo-pornografia", www.diritto.it.

¹⁶ Po, aty.

¹⁷ Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë, neni 294a, pika 3.

¹⁸ Guardia di finanza scuola di Polizia Tributaria "Tecniche Investigative Speciali per il Contrasto Patrimoniale alla Criminalita Organizzata", fq.31.

- Konventa mbi Krimin Kibernetik (ETS 185)¹⁹
- Protokoli Shtesë i Konventës për Krimin Kibernetik në lidhje me Konsiderimin si Vepra Penale të Akteve Raciste dhe të Ksenofobisë, të cilat kryhen nëpërmjet sistemeve kompjuterike (CETS no.189).
- Konventa Europiane "Për ndihmën e ndërsjellët juridike në fushën penale (ETS 030)."
- Protokoli shtesë i ETS 030 (ETS 099).
- Protokoli i dytë shtesë i ETS 030 (ETS 182).
- Konventa Europiane "Për transferimin e procedimeve në çështjet penale" (ETS 073).
- Konventa e Këshillit të Europës "Për mbrojtjen e Fëmijëve nga Abuzimi dhe Shfrytëzimi Seksual (CETS No.201)."
- Marrëveshja Europiane për Transmetimin e Kërkesave për Aplikimin e Ndhmës Ligjore (CETS No. 092).
- Protokoli Shtesë i Marrëveshjes Europiane për Transmetimin e Kërkesave për Aplikimin e Ndhmës Ligjore (ETS 179).
- Konventa Europiane për Vlefshmërinë e Vendimeve Gjyqësore të Huaja (ETS 070).
- Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Trafikimit të Paligjshëm të Substancave Narkotike dhe Psiko-trope.
- Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkufitar (UNTOC).
- Protokoli i UNTOC për Parandalimin, Goditjen dhe Ndëshkimin e Trafikimit të Personave, veçanërisht Grave dhe Fëmijëve.
- Protokoli i UNTOC kundër Kontrabandimit të Emigrantëve nëpërmjet Tokës, Detit dhe Ajrit-nënshkruar më 12.12.2000.
- Protokoli i UNTOC kundër Prodhimit të Paligjshëm dhe Trafikimit të Armëve të Zjarrit.

Konventat e ratifikuara nga Shqipëria, në bazë të nenit 122 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, bëhen pjesë e legjislacionit tonë të brendshëm dhe kanë epërsi mbi ligjet e vendit, që nuk pajtohen me to.²⁰ Ratifikimi i këtyre konventave, duhet të shoqërohet edhe me ndërhyrjen në legjislacionin tonë penal, duke nxjerrë ligje të veçanta, që do t'i vinin në ndihmë parandalimit të këtij fenomeni. Gjithashtu nevojitet ngritja e strukturave të specializuara shtetërore, që do të kishin si funksion monitorimin dhe hetimin e fenomenit në fjalë. Kjo, duke marrë shembull dhe nga Italia, si një nga vendet e zhvilluara, në të cilën ekzistojnë tashmë prej kohësh sektorë të veçantë pranë Policisë së Shtetit, të quajtura "Polizia Postale

¹⁹ Ligji Nr. 8888, Dt. Aktit: 25.04.2002, Për ratifikimin e "Konventës për krimin në fushën e kibernetikës", Dt. Miratimit: 25.04.2002, Flet. Zyrtare Nr.18, Fq.553.

²⁰ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 122.

delle Comunicazioni", që ushtron një aktivitet intensiv hetimor dhe monitorues, përmes një stafi të specializuar.

Konkluzione

Zhvillimi i shoqërisë së informacionit është shoqëruar me rritje të kriminalitetit në fushën e krimit kibernetikë, si pasojë e kësaj duhet të merren masa për parandalimin e rrezikut të shfaqur nga ky lloj kriminaliteti.

Krimi kibernetikë, veçanërisht aspekti, që ne trajtuam (pedofilia-online), përveç të qenit një fenomen social është edhe një fenomen juridik. Prandaj duke qenë i tillë, jemi të mendimit, që legjislacioni shqiptar në fushën e krimit kibernetikë duhet të përmirësohet dhe të plotësohet akoma më shumë.

Duhet zgjeruar baza ligjore, që ka të bëjë me mjetin më të ri investigativ të përdorur, që është infiltrimi i agjentit të policisë të dhomave të chatit, mjet ky që përdoret gjerësisht në vende të zhvilluara, ku mund të përmendim Italinë dhe që ka rezultuar shumë efikas në zvogëlimin e numrit të rasteve të pedofilisë. Duhet ngritur struktura të specializuara pranë policisë së shtetit, të cilat duhet të jenë të afta për të identifikuar, parandaluar dhe trajtuar rastet e pedofilisë përmes internetit. Ekzistenca e strukturave të tilla do të përbente një siguri më shumë, për të miturit dhe për prindërit e tyre.

Nevojitet informimi në shkallë të gjerë të shoqërisë civile, në lidhje me rrezikun, që paraqet lundrimi përmes internetit, për fëmijët e tyre. Duhet organizuar orë të veçanta mësimore, që do të informonin fëmijët e arsimit 9-vjeçar, si mosha më e ekspozuar ndaj këtij fenomeni në lidhje me rrezikshmërinë, që paraqet lundrimi i pakontrolluar në internet. Përmes specialistëve të informatikës, duhet dhënë informacione, të mjaftueshme rreth programeve kompjuterike, përmes të cilave penetron Pedofilët-online.

Referenca

- Andreoli, V., (2003), "Dalla parte dei bambini. Per difendere i nostril figli dalla violenza" Milano: Edizioni superbur, fq.173-174.
- Bruzzone, R., (2007) "Il profilo criminologico del pedofilo", Revista nr. III"ALTEREGO.
- Gombia, A., (2002), "Bambini da salvare", Novara: Edizioni Red, fq.101.Guardia di finanza scuola di Polizia Tributaria "Tecniche Investigative Speciali per il Contrasto Patrimoniale alla Criminalita Organizzata", fq.31.
- <http://www.poliziadistato.it>.
- Islami H., Hoxha A., Panda I.,(2003), "Procedura Penale", Tiranë: Shtëpia botuese Morava, fq.390.
- Kodi i Procedurës Penal të Republikës së Shqipërisë.

- Konventa Europiane "Për ndihmën e ndërsjellë juridike në fushën penale "(ETS 030).
- Konventa e "Konventës për krimin në fushën e kibernetikës"(ETS 185).
- Konventa Europiane "Për transferimin e procedimeve në çështjet penale"(ETS 073).
- Konventa e Këshillit të Europës "Për mbrojtjen e Fëmijëve nga Abuzimi dhe Shfrytëzimi Seksual "(CETS No.201).
- Konventa Europiane për Vlefshmërinë e Vendimeve Gjyqësore të Huaja (ETS 070).
- Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër "Trafikimit të Paligjshëm të Substancave Narkotike dhe Psikotrope."
- Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkufitar (UNTOC).
- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 122.
- "Le strategie di contrasto" <http://www.altrodiritto.unifi.it>
- Pajardi, D.,(1990), "Considerazioni sul danno psicologico in eta evolutiva", ind. pajardi, Danno biologico e danno psicologico, Milano:Giuffre Editore, fq.72.
- Ligji Nr.8888, Dt. Aktit: 25.04.2002, Për ratifikimin e "Konventës për krimin në fushën e kibernetikës", Dt. Miratimit: 25.04.2002, Flet. Zyrtare Nr.18, fq.553.
- Marrëveshja Europiane për Transmetimin e Kërkesave për Aplikimin e Ndhmës Ligjore (CETS No.092).
- "Pedofilia-online", <http://www.commissariatodips.it>, datë 1.02.2013.
- Policia di stato-UACI (Unita di Analisi sui Crimini Informatici) -2004.
- Pomante, G., (2002) "Diritto delle nuove tecnologie e dell'Internet", AA.VV., Ipsoa: Collana Diritto e Informatica.
- Protokolli Shtesë i Konventës për Krimin Kibernetik në lidhje me Konsiderimin si Vepra Penale të Akteve Raciste dhe të Ksenofobisë, të cilat kryhen nëpërmjet sistemeve kompjuterike (CETS no.189).
- Protokolli Shtesë i ETS 030 (ETS 099).
- Protokolli i dytë shtesë i ETS 030 (ETS 182).
- Protokolli Shtesë i Marrëveshjes Europiane për Transmetimin e Kërkesave për Aplikimin e Ndhmës Ligjore (ETS 179).
- Protokolli i UNTOC për Parandalimin, Goditjen, dhe Ndëshkimin e Trafikimit të Personave, veçanërisht Grave dhe Fëmijëve.
- Protokolli i UNTOC kundër Kontrabandimit të Emigrantëve nëpërmjet Tokës, Detit dhe Ajrit-nënshkruar më 12.12.2000.
- Protokolli i UNTOC kundër Prodhimit të Paligjshëm dhe Trafikimit të Armëve të Zjarrit
- Spanti, A., "Tool e metodologie informatiche per il contrasto alla pedofilia online e alla pedo-pornografia", www.diritto.it.
- Stop-it(2003), "Nella rete. Un anno di lotta alla pedo-pornografia on-line", Roma: Primo rapporto di Stop-It.
- Strategjia ndërsektoriale për shoqërinë e informacionit 2008-2013.

Shërbimi përmbarrimor privat përkundrejt shërbimit përmbarrimor shtetëror

Dokt. Valentina Memini

DOKTORANTE PRANË FAKULTETIT JURIDIK, UET

Abstrakt

Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore është dhe mbetet një nga elementët themelorë të shtetit të së drejtës, ku në mungesë të tij, personi fizik ose juridik (kreditori), nuk mund të realizojë të drejtat dhe interesat legjitime. Me qëllim përmirësimit e kuadrit ligjor që synon rritjen e numrit të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore, dhe të forcimit të imazhit publik të shërbimit përmbarrimor në Shqipëri, rritjes së efektivitetit, transparencës, profesionalizmit dhe të buxhetit financiar të këtij shërbimi, legjislatori shqiptar miratoi ligjin nr.10031, datë 11.12.2008 “Për shërbimin përmbarrimor gjyqësor privat”. Ky ligj prezanton sistemin e dyfishtë të ushtrimit të Shërbimit Përmbarrimor Gjyqësor, sipas të cilit funksioni përmbarrimor kryhet edhe nga operatorë privatë të testuar dhe certifikuar për këtë qëllim ose më saktë kemi ofrimin alternativ të shërbimit përmbarrimor privat krahas atij shtetëror. Koncepti i lejimit njëkohsisht si aktivitet privat dhe shtetëror sjell si pasojë që, kreditori ka të drejtën e zgjedhjes sipas bindjes së tij, pa asnjë kufizim, të kërkojë ekzekutimin nga një përmbarrues privat ose shtetëror, ashtu si dhe një përmbarrues privat është i lirë që të pranojë ose jo një çështje për ta ekzekutuar. Sigurimi i një sistemi sa më eficient për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore është një mjet efektiv i garantimit të aksesit në drejtësi, pasi ekzekutimi i vendimit është dhe rezultati i kërkuar nga individët që i drejtohen sistemit gjyqësor. Përgjegjësia fillon në momentin që lidhet kontrata, midis përmbarruesit dhe kreditorit dhe përfundon në momentin që titulli ekzekutiv është ekzekutuar.

Fjalë kyç: Shërbim përmbarrimor, ligj, debitor, kreditor, përmbarrues privat, përmbarrues shtetëror, titull ekzekutiv.

Hyrje

Rritja e qëndrueshme e nivelit të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore konform standardeve europiane, si edhe përmirësimi i cilësisë së shërbimit përmbarrimor, ndihmon në konsolidimin e shtetit demokratik bazuar në liritë themelore të individëve dhe, konkretisht, në të drejtën për një proces të rregullt gjyqësor. Oficeri (përmbarruesi) gjyqësor është një element thelbësor i një gjyqësori efektiv dhe funksional në çdo shtet që dëshiron të perceptohet si shtet i së drejtës¹. Shërbimi Përmbarrimor në Republikën e Shqipërisë organizohet në Shërbimin Përmbarrimor Gjyqësor Shtetëror dhe në Shërbimin Përmbarrimor Gjyqësor Privat. Sistemi i dyfishtë i Shërbimit Përmbarrimor Gjyqësor nënkupton që funksionet që ka Shërbimi Përmbarrimor Gjyqësor Shtetëror, të mund të kryhen edhe nga operatorë privatë të certifikuar, për këtë qëllim. Shërbimi i Përmbarrimit Gjyqësor Shtetëror organizohet sipas ligjit nr.8730/2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Përmbarrimit Gjyqësor”. Në nivelin vendor të organizimit, zyrat përmbarrimore, pranë çdo rrethi gjyqësor, marrin masat e nevojshme procedurale për ekzekutimin efektiv të titujve ekzekutivë, ç’ka do të thotë se veprimtaria e tyre është e kufizuar në një territor të caktuar. Shërbimi Përmbarrimor Gjyqësor Privat organizohet sipas ligjit nr.10031/2008 “Për Shërbimin Përmbarrimor Gjyqësor Privat” ku zbatohet për përmbarruesit gjyqësorë privatë, që kryejnë veprimet e tyre procedurale për ekzekutimin e detyrueshëm të titujve ekzekutivë. Përmbarruesi gjyqësor privat ose shoqëritë përmbarruese private ushtrojnë funksionet e tyre procedurale përmbarrimore në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Shërbimi i Përmbarrimit Gjyqësor ka për mision ekzekutimin e detyrueshëm të titujve ekzekutivë, në rastet e përcaktuara në Kodin e Procedurës Civile. Ligjshmëria dhe objektiviteti, si dhe respektimi i të drejtave dhe lirive të garantuara me ligj subjekteve që marrin pjesë në ekzekutim, janë parimet bazë të punës së Shërbimit të Përmbarrimit Gjyqësor. Zyra e Përmbarrimit është institucioni i ngarkuar me ekzekutimin e gjykimeve civile të lëshuara nga gjykatat, d.m.th. nëse një paditës civil merr një vendim në të holla, shuma mbledhet përmes procedurave të zbatuara nga Zyra e Përmbarrimit. Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore është i konceptuar si një detyrë e shtetit. Në një vend ku besimi për gjyqësorin dhe respekti për shtetin juridik është ende në zhvillim, ka pak, për të mos thënë aspak, zbatim të vullnetshëm të vendimeve gjyqësore. Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore si dhe i titujve të tjerë ekzekutivë, rregullohen në Kreun IV të Kodit të Procedurës Civile²

¹ <http://www.uihj.com/en/>, Kongresi i 21-të Botëror UIHJ i Përmbarruesve Gjyqësore, Cape Town, Afrika e Jugut, Maj 2012;

² Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë, Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare, Qershor 2010;

(nenet 510-617). Gjykata dhe përbaruesi gjyqësor, si zyrtarë ekzekutues, janë së bashku përgjegjës për ekzekutimin e një vendimi gjyqësor. Ekzekutimi i titujve ekzekutivë të tjerë është gjithashtu përgjegjësi e përbaruesit. Por për vënien në ekzekutim të detyrueshëm të titujve ekzekutivë është e nevojshme që të lëshohet urdhëri i ekzekutimit - *Urdhëri i ekzekutimit është një urdhër pa kushte i dhënë nga gjykata ose nga një organ tjetër posaçërisht i autorizuar nga Kodi i Procedurës Civile dhe i cili u drejtohet organeve që kanë për detyrë të ekzekutojnë një titull ekzekutiv*³.

Legjislacioni procedural civil ka ardhur gjithmonë duke u përmirësuar dhe me ndikim të dukshëm edhe në lidhje me ndërtimin dhe organizimin e përbaruesit gjyqësor gjatë procedurave përbarimore ekzekutive⁴. Ajo që vlen të përmendim është se si përbaruesi shtetëror ashtu dhe ai privat gjatë punës së tyre u referohen të njëjtave dispozitave të K. Pr. Civile, të cilët ekzekutojnë ata tituj ekzekutivë të përcaktuar në nenin 510⁵ të K.Pr.C, ku vihen në lëvizje vetëm me kërkesë të kreditorit (n. 511) etj, pavarësisht se rregullimi organizativ i tyre bëhet nga ligje të ndryshme ku në thelb mbetet e njëjta gjë.

Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore shpeshherë konsiderohet si pjesa më me pak vlera intelektuale të sistemit ligjor ose si diçka që i përket stafit administrativ dhe specialistëve të rëndomtë. Por një sistem përbarimor joefikas në ekzekutim të vendimeve gjyqësore mund të bëhet shkak për anulim të efekteve dhe të vendimeve gjyqësore më të kualifikuara dhe mund t'i kthente normat materiale në fjalë boshe⁶.

Shërbimi përbarimor shtetëror

Ligji nr.8730, datë 18.1.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit të përbarimit gjyqësor" vazhdon të zbatohet për atë pjesë të përbaruesve shtetërorë, dhe parashikon rregullat e organizimit, funksionimit, kriteret që duhet të përmbushin shtetasit që të emërohen përbarues, statusin dhe procedimin disiplinor, marrëdhëniet me institucionet shtetërore dhe me subjektet e tjera publike dhe private⁷. Sipas këtij ligji Shërbimi i Përbarimit Gjyqësor (Sh. P. Gj) ka organizim unik dhe të centralizuar, me shtrirje në të gjithë territorin e Republikës

³ Lamani A., Procedura Civile e Republikës Popullore të Shqipërisë, Tiranë, 1962;

⁴ Vasili J., Procedura Civile, Real-stamp, Tiranë 2010;

⁵ Kodi i Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë, n. 510, Janë tituj ekzekutivë: a) vendimet civile të formës së prerë të gjykatës, që përmban një detyrim, vendimet e dhëna prej saj për sigurimin e padisë, si dhe për ekzekutimin e përkohshëm; b) vendimet penale të formës së prerë në pjesën që bëjnë fjalë për të drejta pasurore; c) vendimet e gjykatave e të arbitrazheve të shteteve të huaja që u është dhënë fuqi sipas dispozitave përkatëse të këtij Kodi; d) vendimet e një gjykate arbitrazhi në Republikën e Shqipërisë; e) aktet noteriale që përmbajnë detyrim në të holla, si dhe aktet për dhënien e kredive bankare ose aktet për dhënien e kredive nga institucionet financiare jobankare; dh) kambialet, çeqet e letrat me urdhër që barazohen me ato; e) aktet e tjera që sipas ligjeve të veçanta quben tituj ekzekutivë dhe ngarkohet zyra e përbarimit për ekzekutimin e tyre.;

⁶ Simony A., Sadushi S., Çomo S., Vështrim Krahasues mbi Procedurën Civile, Tiranë, 2006.

⁷ Ligji nr.8730, datë 18.1.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit të përbarimit gjyqësor" Fletore Zyrtare nr. 36, 2001;

së Shqipërisë, ku përbaruesi gjyqësor gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij përfaqëson autoritetin shtetëror. Themi që ka organizim unik dhe të centralizuar për faktin se varet nga Ministri i Drejtësisë dhe organizohet në nivel qendror nga Drejtoria e Përgjithshme dhe në nivel vendor nga zyrat përbarimore, brenda juridiksionit të çdo rrethi gjyqësor të shkallës së parë. Përbaruesit gjithmonë janë perceptuar si pjesë e gjyqësorit megjithatë varësia e tyre nga ana e Ministrisë së Drejtësisë tregon të kundërtën.

Faza përbarimore është e ndarë nga gjithë procesi gjyqësor, pra konsiderohet si një fazë më vete e cila iniciohet nga ana e kreditorit për realizimin e interesave të tij mbi pasurinë e debitorit. Megjithatë në vendimet e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GjEDNj) ekzekutimi i një vendimi gjyqësor të formës së prerë është konsideruar pjesë e procesit të rregullt ligjor dhe mosekzekutimi i tij shkel të drejtat themelore të individit. Në rastin e mirënjohur Hornsby kundër Greqisë⁸, GjEDNj ka vendosur se përbarimi është pjesë përbërëse e së drejtës themelore në gjykim të drejtë brenda një kohe të arsyeshme, në pajtim me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut⁹. Që atëherë, gjykata vazhdimisht ka riafirmuar se shtetet anëtare kanë për detyrë të sigurojnë se të gjithë personat të cilëve u është dhënë një vendim gjykate i formës së prerë kanë të drejtë në përbarimin e tij dhe se e drejta e qasjes në gjykatë "do të ishte imagjinare nëse sistemi i drejtësisë së një shteti do të lejonte që një vendim i formës së prerë të mos hyjë në fuqi, duke shkuar kështu në dëm të njëjës palë"¹⁰.

Gjykata Kushtetuese, në jurisprudencën e saj të konsoliduar, ka theksuar se ekzekutimi, brenda një afati të arsyeshëm, i një vendimi të formës së prerë të gjykatës, duhet konsideruar si pjesë përbërëse e së drejtës për një proces të rregullt ligjor në kuptim të n. 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë¹¹ dhe n. 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Ekzekutimi i vendimit përbën një element thelbësor të shtetit të së drejtës e të vetë nocionit të gjykimit të drejtë. Ekzekutimi i vendimit të formës së prerë të gjykatës konsiderohet si faza përfundimtare e realizimit të një të drejte të fituar gjyqësisht. Vetëm pas realizimit të kësaj faze mund të konsiderohet se individi e ka vendosur plotësisht në vend të drejtën e tij të fituar. Procesi i vendosjes në vend të një të drejte të shkelur përfshin jo vetëm vendimmarrjen e gjykatave, por edhe veprimet konkrete të organeve përgjegjëse të ngarkuara me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Pa dyshim

⁸ <http://www.echr.coe.int/ECHR/EN/Header/Case-Laë/Decisions+and+judgments/HUDOC+database/>, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, çështja, Hornsby v. Greece (18357/91), 19 March 1997;

⁹ http://coe.al/index.php?faq=content/publication_read&pid=116, Këshilli i Evropës, Konventa e Mbrojtjes së të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore;

¹⁰ <http://www.coe.int/t/dghl/cooperation/capacitybuilding/publi/materials/1129.pdf>, E drejta e pronës sipas Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Udhërrëfyes për përdorimin e Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut;

¹¹ Kushtetuta e Shqipërisë, Alb Juris, Tiranë, 2008.

që një vonesë në ekzekutimin e një vendimi mund të justifikohet në rrethana të veçanta, por vonesa nuk mund të jetë deri në atë shkallë sa të dëmtojë thelbin e së drejtës. Pra, faza ekzekutive konsiderohet si fazë e mëtejshme e të njëjtit proces¹².

Në qoftë se do të analizonim varësinë e shërbimit përmbarimor nga ana e shtetit (Ministria e Drejtësisë) do të shohim një prej arsyeve për moszekutim të vendimeve gjyqësore, kur debitori është institucion apo organ shtetëror, pa shkëputur edhe arsyetimin nga ana e tyre për mungesën e fondeve. Shërbimi përmbarimor i gjetur përballë mungesës së fondeve ka pezulluar procedurat përmbarimore duke bërë që subjekti (kreditore) të përballë me vonesa të pajustificuara, të mos realizojë të drejtën e tij, të kthimit apo kompensimit të pronës, të drejtat e tij që rrjedhin nga marrëdhëniet e punës etj.

Ligji sanksionon se përmbaruesit gjyqësorë janë të detyruar të njohin, të respektojnë dhe të zbatojnë Kushtetutën, K. Pr. Civile, Kodin Civil dhe akte të tjera ligjore e nënligjore, që lidhen me veprimtarinë përmbarimore, si dhe urdhrat, udhëzimet dhe metodikat e Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit të Përmbarimit Gjyqësor, por jo vetëm ata duhet të përsosin aftësitë profesionale dhe të marrin pjesë në veprimtaritë trajnuese të organizuara për këtë qëllim.

Çdo veprim përmbarimor kryhet vetëm kundrejt pagimit të tarifave përkatëse të cilat përcaktohen me akt normativ të Ministrisë të Drejtësisë. Këtu do të shtonim - në rast se bëjmë një krahasim me tarifën që aplikohen nga shërbimi privat do të shohim se këto të fundit janë më të larta. Kreditore është ai që parapaguan për kryerjen e shërbimit përmbarimor. Nëse përmbaruesi nuk është i suksesshëm në ekzekutimin e detyrimit ligjor, mund të akuzohet se është i korruptuar dhe për të mënjeluar këtë hipotezë kreditore duhet të mbikqyrë veprimet e përmbaruesit dhe të shohë vetë se përse ekzekutimi nuk ishte i suksesshëm.

Kreditore siguron mjetet me të cilat ekzekutimi mund të kryhet dhe si rrjedhojë, kreditore pagan jo vetëm shpenzimin e ekzekutimit, por gjithashtu siguron mjetet e ekzekutimit. Padiësit, të cilët nuk janë në gjendje që të sigurojnë burime për Zyrën e Përmbarimit, edhe ato nuk janë në gjendje të ndihmojnë në ekzekutimin dhe për rrjedhojë ato nuk mund të përfitojnë nga shërbimi. Pra, mundësia për të vënë drejtësi varet nga burimet e kreditorit. Për një kreditore që nuk ka mjete për të siguruar burime të tilla, ekzekutimi ka më pak të ngjarë të dalë me sukses, sesa për dikë, i cili mund t'i sigurojë përmbaruesit mbështetje. Megjithatë në rastet e realizimit me sukses të vendimit, i kërkohet debitorit që të paguajë shpenzimet e ligjshme për ekzekutim¹³ të shoqëruara në sigurimin e mbështetjes ndaj përmbaruesit.

Ligji parashikon se pranimit në Sh. P. Gj bëhet me konkurs. Këshilli i Përmbarimit¹⁴ ndjek procedurat e paraqitjes, të përzgjedhjes dhe të vlerësimit të

¹² Gjykata Kushtetuese, Vendime: Nr.59, datë 24.12.2012, nr.12, datë 15.4.2011; nr. 35, datë 27.10.2010; nr. 23, datë 17.5.2010; nr.1, datë 19.1.2009;

¹³ Kodit të Procedurës Civile, n.525.

¹⁴ Këshilli i Përmbarimit përbëhet nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Drejtësisë, Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit të Përmbarimit Gjyqësor, Drejtori i Drejtorisë së Personalit, Organizimit dhe Shërbimeve në

kandidaturave dhe mendimin e vet ia paraqet Ministrinë të Drejtësisë i cili emëron konkurruesin fitues përmbarues gjyqësor. Përmbaruesi gjyqësor nuk mund të ushtrojë asnjë detyrë ose veprimtari tjetër publike, me përjashtim të atyre edukative e të mësimdhënies.

Shërbimi përmbarimor privat

Me Përmbarimin Gjyqësor Privat, kreditorët kanë mundësi që të pretendojnë ekzekutimin e të drejtave të tyre ndaj debitorëve, jo vetëm nëpërmjet përmbaruesve shtetëror, por edhe përmes përmbaruesve privat. Me qëllim rritjen e efektivitetit të sistemit të ekzekutimit të vendimeve të formës së prerë, ekzekutimit të kredive të pashlyera ndaj bankave apo dhe ekzekutimit të titujve të tjerë ekzekutivë legjislatori miratoi shërbimin përmbarimor privat. Ligji nr.10 031, datë 11.12.2008. "Për shërbimin përmbarimor gjyqësor privat"¹⁵, përcakton se funksioni përmbarimor kryhet edhe nga operatorë privatë të cilët do të testohen me anë të një provimi dhe do të licensohen për këtë qëllim. Fillimisht janë certifikuar nga Ministria e Drejtësisë rreth 70 përmbarues privat të cilët ushtrojnë funksionet e tyre konform përcaktimeve të bëra në ligjin nr. 10031/2008. Për të vazhduar në rrugën e nisur në mars 2012, Kuvendi miratoi një ndryshim në ligjin "Për shërbimin përmbarimor privat"¹⁶. Sipas këtij ndryshimi, personat, të cilët kanë qenë përmbarues gjyqësor në Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror në datë 30. 12. 2011 përjashtohen nga detyrimi i dhënies së provimit të kualifikimit. Ky ndryshim bazohet në faktin që në shërbimin përmbarimor gjyqësor shtetëror, ka përmbarues gjyqësor me eksperiencë të gjatë në detyrën e tyre, të cilët i janë nënshtruar kualifikimeve dhe trajnimeve të vazhdueshme. Pra, shihet se përmbarimi privat është i kompletuar me një staf të përgatitur si profesionalisht ashtu dhe nga ana praktike apo eksperiencia përmbarimore të viteve të kaluara.

Deri në maj 2012 raporti i përmbaruesve gjyqësorë privatë ndaj atyre shtetërorë ishte 33% ndaj 66% bazuar në numrin e 56 përmbaruesve privatë aktivë ndaj 130 përmbaruesve shtetërorë. Në maj 2012 u implementua faza e dytë e reformës sepse 50% të shërbimit shtetëror u liberalizuan, duke kaluar në tregun privat stafin e tij. Me certifikimin e majit 2012, aktualisht janë 117 përmbarues privatë të certifikuar, përballë 67 përmbaruesve shtetërorë. Raporti i tyre është 64 % me 36 % në favor të shërbimit përmbarimor privat¹⁷.

Ministri, Kryetari i Zyrës Përmbarimore të Tiranës dhe një Këshilltar i Ministrisë të Drejtësisë, n.13 i ligjit "Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit të përmbarimit gjyqësor".

¹⁵ Ligji Nr.10 031, datë 11.12.2008. "Për shërbimin përmbarimor gjyqësor privat", Fletore Zyrtare nr.190 dt.31.12.2008;

¹⁶ Ligji Nr.36/2012 datë 29.3.2012. Për një ndryshim në ligjin nr.10 031, datë 11.12.2008 "Për shërbimin përmbarimor gjyqësor privat", të ndryshuar, Fletore Zyrtare nr.34, 13 prill, 2012;

¹⁷ http://www.dsdc.gov.al/dsdc/pub/strategjia_reforma_në_fushë_e_të_drejtave_të_pronesisë_1192_1.pdf, Strategjia ndërsektoriale reforma në fushën e të drejtave të pronësisë 2012-2020.

Ligji Nr.10 031, datë 11.12.2008, Për shërbimin përmbarrimor gjyqësor privat (ndryshuar me ligjin nr.10 137, datë 11.5.2009 dhe ligjin nr.36/2012), zbatohet për përmbarruesit gjyqësorë privatë, që kryejnë veprimet e tyre procedurale për ekzekutimin e detyrueshëm të titujve ekzekutivë, sipas dispozitave të K. Pr. Civile, Kodit Civil, akteve të tjera ligjore dhe nënligjore, si dhe për subjektet e tjera private dhe shtetërore, që përfshihen në procesin e ekzekutimit. Pra veprimet përmbarrimore kryhen si nga individë, të pajisur me certifikatën e aftësisë profesionale të përmbarruesit gjyqësor privat, dhe nën përgjegjësinë vetjake të tyre ashtu dhe nga subjekte tregëtare. Shërbimi Përmbarrimor Gjyqësor Privat (Sh P Gj P) është një funksion i pavarur me karakter publik, i cili ushtrohet nga përmbarruesit gjyqësorë privatë dhe shoqëritë përmbarruese private të cilët i nënshtrohen zbatimit të dispozitave të K. Pr. C., Kodit Civil dhe ligjeve të tjera për ekzekutimin e titujve ekzekutivë. Përmbarruesit gjyqësorë privatë organizohen në shkallë vendi, nëpërmjet përfaqësimit profesional në Dhomen Kombëtare të Përmbarruesve Gjyqësorë Privatë. Dhoma Kombëtare e Përmbarruesve Gjyqësorë Privatë është person juridik, që ushtron veprimtarinë e saj në mënyrë të pavarur nga shteti.

E veçanta e këtij ligji është se përmbarruesi gjyqësor privat ose shoqëritë përmbarruese private ushtrojnë funksionet e tyre procedurale përmbarrimore në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë¹⁸. Pra, nuk do të ketë ndarje të juridiksionit sipas njësie vendore apo rretheve gjyqësore siç janë parashikuar në ligjin për përmbarrimin shtetëror, gjë që do të thotë se një përmbarrues privat në Korçë mund të ekzekutojë një titull ekzekutiv edhe në Lezhë apo në Tiranë. Gjithashtu ligji sanksionon se si personat fizike apo juridike, private apo shtetërore kanë detyrimin ligjor të japin të gjithë informacionin e nevojshëm të kërkuar prej përmbarruesit privat lidhur me gjendjen pasurore të debitorit dhe në raste të veçanta përmbarruesi privat ashtu si dhe përmbarruesi shtetëror, ka të drejtë të kërkojë asistencën e institucioneve shtetërore, Policinë e Shtetit, policitë private, për të mundësuar procedurat e ekzekutimit. Detyrimi i përmbarruesit privat dhe shtetëror është ruajtja e konfidencialitetit të të dhënave të subjekteve debitore dhe kreditore.

Përmbarruesi gjyqësor privat nuk mund të ushtrojë funksione publike, të praktikojë profesionin e noterit, avokatit ose çdo profesion tjetër, i cili është i papajtueshëm me ushtrimin e paanshëm të profesionit të tij. Shoqëritë përmbarruese private duhet të kenë si objekt të veprimtarisë së tyre tregtare vetëm ekzekutimin e titujve ekzekutivë. Megjithatë propozimi i Eueraliusit¹⁹ është se përmbarruesit mund të autorizohen edhe për të kryer veprimtari dytësore në përputhje me rolin e tyre, që synojnë ruajtjen dhe sigurimin e të drejtave të palëve dhe që synojnë përshtypimin e procesit gjyqësor ose reduktimin e ngarkesës së gjykatave. Mes të tjerash këto mund të jenë: *rikuperimi i borxhit; shitja vullnetare e pasurisë së luajtshme*

¹⁸ Ligji Nr.10 031, datë 11.12.2008. Për shërbimin përmbarrimor gjyqësor privat (ndryshuar me ligjin nr.10 137, datë 11.5.2009 dhe ligjin nr. 36/2012);

¹⁹ <http://www.eurallius.eu/>, Propozim për forcimin e përmbarruesve privatë në Shqipëri (Maj 2012);

apo të paluajtshme në ankand publik; sekuestrimi i mallrave; regjistrimi dhe raportimi i provave; ofrimi i shërbimit si ftues; dhënia e këshillimit ligjor; procedura falimentimi; kryerja e detyrave të tjera të ngarkuara nga gjykatat; përfaqësimi i palëve në gjykatë; hartimi i akteve dhe dokumenteve private; mësimdhënia.

Sistemi i ri i përmbarrimit privat ka filluar të funksionojë, por ende nevojiten përmirësime në menaxhimin e çështjeve për përmbarruesit²⁰. Vetë përmbarruesit privat përzgjedhin çështjet që duan të ekzekutojnë. Ky është një nga problemet që pritet të zmadhohet për faktin se, përmbarruesit privatë janë më tepër të interesuar për të ekzekutuar tituj ekzekutivë me vlera të mëdha dhe pa shumë kosto financiare, harxhim kohe etj. Një variant i tillë mund të ishte ndihmë për bankat por jo për individët që mund të pretendojnë ekzekutimin e një pensioni ushqimor, ekzekutimin në kryerjen apo moskryerjen e një veprimi²¹ etj.

Ekzekutimi i vendimeve të gjykatave vazhdon të jetë i dobët, veçanërisht në rastet ku institucionet shtetërore janë palë e paditur, pavarësisht punës së përmbarruesve privatë. Miratimi i udhëzimit për ekzekutimin e vlerave monetare të institucioneve buxhetore referon përcaktimin e mënyrës së ekzekutimit të detyrimeve monetare të institucioneve shtetërore të shpallura debitore nga vendimet gjyqësore dhe ndihmon në zgjidhjen e problematikave të hasura në këtë drejtim. Ky udhëzim detyron njësitë e qeverisjes së përgjithshme që çdo vit të parashikojnë fonde buxhetore të planifikuara për shpenzimet që do të kryejë institucioni për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Pra, udhëzimi u njehtë drejtën përmbarruesve që, në rast mosekzekutimi vullnetar nga njësi shpenzuese, llogaria e tyre të sekuestrohet²². Pavarësisht se përmbarruesi mund të vendosë sekuestro sipas këtij udhëzimi, kjo mund të hiqet nga drejtori i degës së thesarit në rast se nuk ka fonde të mjaftueshme dhe shlyerja do të bëhet me këste në vitet në vijim. Kemi një vazhdim të zvaritjes të mosekzekutimit të vendimeve gjyqësore kur debitori është institucioni shtetëror me justifikimin e mungesës së fondeve nga buxheti i shtetit. E gjitha kjo, e përmendur edhe më sipër, vjen në kundërshtim të hapur me vendimet e Gjykatës Kushtetuese (*Kohëzgjatja e arsyeshme e procedimeve, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, duhet të vlerësohet nën dritën e rrethanave të çështjes dhe duke marrë në konsideratë kompleksitetin e çështjes, sjelljen, interesin e kërkuar, si dhe sjelljen e autoriteteve përkatëse. Gjykata ka theksuar se përballë detyrimit për zbatim të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, të gjitha subjektet, qofshin këto private apo publike, duhet të përgjigjen njëjloj²³) apo dhe*

²⁰ http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2012/package/al_rapport_2012_en.pdf COMMUNICATION FROM THE COMMISSION TO THE EUROPEAN PARLIAMENT AND THE COUNCIL, Enlargement Strategy and Main Challenges 2012-2013.

²¹ Kodi i Procedurës Civile nr.605,606.

²² Udhëzim Nr.2, datë 18.8.2011 "Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të institucioneve buxhetore në llogari të thesarit", Fletore Zyrtare nr.133, 28 shtator 2011;

²³ Gjykata Kushtetuese, Vendime: nr.48, datë 26.7.2012, nr. 49, datë 26.7.2012, nr. 9, datë 1.4.2009; nr. 14, datë 15.4.2010; nr. 21, datë 3.6.2011; nr. 10, datë 1.3.2012;

vendimet e GjEDNj-së në lidhje me procesin e rregullt ligjor dhe ekzekutimin e vendimeve brenda një afati të arsyeshëm.

Ligji për shërbimin përmbarrimor privat ka parashikuar që tarifa për këtë shërbim të paguhet nga ana e debitorit, por paraprakisht për të vënë në lëvizje përmbarrimin duhet të parapaguhet një shumë nga ana e kreditorit, shumë e cila në rast të mosekzekutimit të detyrimit nga debitori nuk i kthehet kreditorit²⁴. Në dallim nga shërbimi përmbarrimor shtetëror do të shtonim se përmbarrimi privat ka të gjitha mundësitë për ti kryer vetë të gjitha veprimet pa ndihmën e kreditorit (përveç informacionit që duhet të japë) për të ekzekutuar titullin ekzekutiv kudo që të ndodhet debitori.

Konkluzione/Rekomandime

Rritja e qëndrueshme e nivelit të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore konform standardeve europiane, si edhe përmirësimi i cilësisë së shërbimit përmbarrimor, ndihmon në konsolidimin e shtetit demokratik bazuar në liritë themelore të individëve dhe, konkretisht, në të drejtën për një proces të rregullt gjyqësor.

Përmirësimi i nivelit të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore dhe titujve ekzekutivë, konsolidimi i performancës së shërbimit përmbarrimor gjyqësor shtetëror dhe privat, si dhe krijimi i kushteve të duhura për zbatimin me repretësi të të gjitha detyrimeve që rrjedhin nga kuadri ligjor, janë aspekte shumë të rëndësishme në respektim dhe mbrojtje të të drejtave dhe interesave të subjekteve kërkues për ekzekutimin e një titulli ekzekutiv.

Krijimi i sistemit të dyfishtë, përmbarrim privat dhe shtetëror, duhet të shkojë drejt rritjes së konkurrencës ndërmjet përmbarruesve duke çuar në realizimin më me efektivitet të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore si dhe të titujve ekzekutivë të parashikuar në Kodin e Procedurës Civile.

Konkurrenca ndërmjet shërbimit përmbarrimor shtetëror dhe përmbarruesve privatë lufton korrupsionin si dhe rrit nivelin e shërbimit ndaj klientit kreditor si person fizik apo juridik. Kjo mund të arrihet jo vetëm nëpërmjet përmirësimit të legjislacionit mbështetës përmbarrimor, por edhe rritjes së përgjegjësisë së institucioneve dhe zyrave apo organeve të tjera shtetërore.

Risia e ligjit për përmbarrimin privat është se përmbarruesi gjyqësor privat ose shoqëritë përmbarruese private ushtrojnë funksionet e tyre procedurale përmbarrimore në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë ç'ka do thotë se nuk ka ndarje të juridiksionit sipas njësive vendore apo rretheve gjyqësore siç janë parashikuar në ligjin për përmbarrimin shtetëror. Kjo sjell një përzgjedhje dhe akses më të madh kreditor për të realizuar të drejtat dhe interesat legjitime.

²⁴ Udhëzim Nr.1240/5, datë 15.9.2009, Për caktimin e tarifave për shërbimet e ofruara nga shërbimi përmbarrimor gjyqësor privat, Fletore Zyrtare nr.148, Nëntor 2009.

Bibliografia

- Kushtetuta e Shqipërisë, Alb Juris, Tiranë, 2008;
 Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë, Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare, Qershor 2010;
 Ligji nr.8730, datë 18.1.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit të përmbarrimit gjyqësor” Fletore Zyrtare nr.36, 2001;
 Ligji Nr.10 031, datë 11.12.2008, “Për shërbimin përmbarrimor gjyqësor privat”, Fletore Zyrtare nr.190 dt.31.12.2008;
 Ligji Nr.10 031, datë 11.12.2008, Për shërbimin përmbarrimor gjyqësor privat (ndryshuar me ligjin nr.10 137, datë 11.5.2009 dhe ligjin nr. 36/2012);
 Ligji nr.36/2012 datë 29.3.2012, Për një ndryshim në ligjin nr.10 031, datë 11.12.2008, “Për shërbimin përmbarrimor gjyqësor privat”, të ndryshuar, Fletore Zyrtare nr.34,13 prill 2012;
 Udhëzim Nr.2, datë 18.8.2011, “Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të institucioneve buxhetore në llogari të thesarit”, Fletore Zyrtare nr.133, 28 shtator 2011;
 Udhëzim Nr.1240/5, datë 15.9.2009, Për përcaktimin e tarifave dhe për shërbimet e ofruara nga shërbimi përmbarrimor gjyqësor privat, Fletore Zyrtare nr.148, Nëntor 2009;
 Simony A., Sadushi S., Çomo S., Vështrim Krahasues mbi Procedurën Civile, Tiranë, 2006;
 Lamani A., Procedura Civile e Republikës Popullore të Shqipërisë, Tiranë, 1962;
 Vasili J., Procedura Civile, Real-stamp, Tiranë 2010;
 Gjykata Kushtetuese, Vendime: Nr.59, datë 24.12.2012, nr.12, datë 15.4.2011; nr.35, datë 27.10.2010; nr.23, datë 17.5.2010; nr.1, datë 19.1.2009;
 Gjykata Kushtetuese, Vendime: nr.48, datë 26.7.2012, nr.49, datë 26.7.2012, nr.9, datë 1.4.2009; nr.14, datë 15.4.2010; nr. 21, datë 3.6.2011; nr.10, datë 1.3.2012;
http://www.dsdc.gov.al/dsdc/pub/strategjia_reforma_ne_fushe_e_te_drejtave_te_pronesise_1192_1.pdf, Strategjia ndërsektoriale reforma në fushën e të drejtave të pronësisë 2012-2020;
<http://www.eurallius.eu/>, Propozim për forcimin e përmbarruesve privatë në Shqipëri (Maj 2012);
http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2012/package/al_rapport_2012_en.pdf COMMUNICATION FROM THE COMMISSION TO THE EUROPEAN PARLIAMENT AND THE COUNCIL, Enlargement Strategy and Main Challenges 2012-2013.
<http://www.uilhj.com/en/>, Kongresi i 21-të Botëror UIHJ i Përmbarruesve Gjyqësore, Cape Town, Afrika e Jugut, Maj 2012;
<http://www.echr.coe.int/ECHR/EN/Header/CaseLaw/Decisions+and+judgments/HUDOC+database/>, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, çështja, Hornsby v. Greece (18357/91), 19 March 1997;
http://coe.int/index.php?faq=content/publication_read&pid=116, Këshilli i Evropës, Konventa e Mbrojtjes së të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore;
<http://www.coe.int/t/dghl/cooperation/capacitybuilding/publi/materials/1129.pdf>, E drejta e pronës sipas Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Udhërrëfyes për përdorimin e Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

Pozita e kryerësve të veprave penale me çrregullime mendore, sipas Kodit Penal të Kosovës¹

Msc. Adelina Rakaj

ASISTENTE E LËNDËVE TË LËMIT PENAL
PRANË KOLEGJIT FAMA NË PRISHTINË

Abstrakt

Ne etiologjinë kriminale bëjnë pjesë edhe çrregullimet mendore, përkatësisht sëmundjet psikike, shkaqe këto të cilat u japin një status të posaçëm personave që kryejnë vepra penale nën ndikimin e sëmundjeve psikike. Gjendja e posaçme mendore në të cilën gjenden kjo kategori e kryerësve të veprave penale e arsyeton përcaktimin e masave të posaçme ligjore përkatësisht me “Masat e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik” si reagim ndaj tyre për veprat penale që ata kryejnë. Gjithashtu, kushtet për shqiptimin e këtyre masave dhe mënyrën e ekzekutimit të tyre janë të kushtëzuara nga gjendja mendore e kryerësit të veprës penale. Evoluimi i të drejtës penale në përgjithësi dhe në aspektin e politikës ndëshkimore në veçanti, në drejtim të humanizimit të dënimit dhe përcaktimit të qëllimit që duhet të arrihen me anë të sanksioneve penale, ka nxjerrë në pah masat e posaçme të cilat u shqiptohen kryerësve të veprave penale, penalisht të papërgjegjshëm dhe me përgjegjshmëri esenciale të zvogëluar.

Meqenëse, kjo kategori e kryerësve të veprave penale, janë në një gjendje të posaçme psikike e cila i bën të papërgjegjshëm për sjelljet dhe veprimet e tyre, dhe pikërisht kjo gjendje paraqitet si shkaktar kryesor i kryerjes së veprës penale, atëherë trajtimi i tyre në procedurën penale dhe politika ndëshkimore ndaj tyre duhet të ndryshojë nga ajo që ndërmerrret ndaj kryerësve penalisht të përgjegjshëm. Në pajtim me zhvillimet demokratike shoqërore në përgjithësi dhe në përputhje me kërkesat e Akteve Ndërkombëtare, ka evoluar edhe E Drejta Penale e Kosovës, në aspektin e trajtimit të kryerësit të veprës penale. Përcaktimi i Masave të trajtimit të detyrueshëm

psikiatrik si sanksione të posaçme penale, që u dedikohen kryerësve të papërgjegjshëm, padyshim që paraqet një tregues të rëndësishëm të jetësimit të parimit të ligjshmërisë, humanizimit dhe parimit të individualizimit të sanksioneve penale. Padyshim që politika ndëshkimore orientohet në prevencion dhe represion dhe si e tillë duhet të zbatohet në përpikmëri dhe në përputhje me legjislacionin pozitiv për të realizuar qëllimin e saj në parandalimin e krimeve dhe ndëshkimin e kryerësve që t’i kthejë si persona të risocializuar dhe riedukuar, të aftë për të jetuar në pajtim me rregullat dhe ligjin. Mirëpo, është tejet e qartë se do të ishte e pamundur që ky qëllim të realizohet ndaj kryerësve penalisht të papërgjegjshëm, sepse zhvillimi i tyre mendor dhe gjendja e tyre psikike nuk ua mundëson që t’i kuptojnë dhe t’i kontrollojnë sjelljet e tyre, prandaj edhe shqiptimi i sanksioneve penale ndaj tyre do të ishte pa rezultat dhe nuk do të realizonte qëllimin e përcaktuar të sanksioneve penale.

Fjalë kyç: Trajtim i detyrueshëm psikiatrik, sanksione penale, Kodi Penal, papërgjegjshmëri, parandalim.

Shqyrtime të përgjithshme

Kryerësit me çrregullime mendore karakterizohen nga një gjendje e veçantë psikike, e cila i bën të papërgjegjshëm për sjelljet dhe veprimet e tyre, atëherë kuptohet që trajtimi i tyre në menyrë të njëjtë si kryerësit e përgjegjshëm penalisht do të ishte në kundërshtim me të drejtat e njeriut dhe me parimin e humanitetit, prandaj përcaktimi i masave të tilla paraqet një hap shumë të rëndësishëm në fushën e legjislacionit penal.

Kryerësit e veprave penale me çrregullime mendore, të cilët janë të papërgjegjshëm penalisht apo me përgjegjësi esenciale të zvogëluar, gjenden në rrethana të cilat kushtëzojnë që kësaj kategorie të kryerësve të veprave penale t’i sigurohet një trajtim i posaçëm gjatë procedurës penale, përzgjedhjes së masave ndëshkuese dhe gjatë ekzekutimit të këtyre masave.

Rrethanat të cilat e kushtëzojnë trajtimin e posaçëm të kësaj kategorie të kryerësve të veprave penale iu referohen zhvillimit të metë mendor të tyre, çrregullimit psikik apo sëmundjes mendore.

Duke iu referuar nenit 506 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, “**Çrregullim mendor**” do të thotë çdo paaftësi apo çrregullim i mendjes apo trurit qoftë i përhershëm apo i përkohshëm që rezulton me dëmtim apo çrregullim të funksionimit mendor.

Derisa person me çrregullime mendore është personi që : a) paraqet probleme të funksionimit mendor, të cilat në bazë të njohurive mjekësore, klasifikohen si çrregullime mendore dhe ekziston nevoja për trajtim të specializuar mjekësor; b) ka prapambetje mendore; dhe c) paraqet çrregullime psikosociale që kërkojnë trajtim

¹ Kodi Penal i Kosovës, Prishtinë, 2012.

të specializuar psikosocial.² Sipas këtij përcaktimi alternativ, personi konsiderohet person me çrregullime mendore nëqoftëse manifeston njëri nga këto shenja të çrregullimit mendor.

Përkufizimi i **paaftësisë mendore** bëhet sipas nenit 18 paragrafi 1 i Kodit Penal të Kosovës ku përcaktohet se: “*Personi i cili ka kryer veprë penale konsiderohet i paaftë mendërisht, nëse në kohën e kryerjes së veprës penale lëngonte nga një sëmundje mendore e përkohshme ose e përhershme, nëse kishte çrregullim mendor apo ngecje në zhvillimin mendor që e ka prekur funksionimin e tij mendor dhe si pasojë e kësaj, nuk ka qenë në gjendje të kuptojë natyrën dhe rëndësinë apo pasojën e veprimeve ose mosveprimeve të tij ose nuk ka qenë në gjendje t’i kontrollojë veprimet ose mosveprimet e tij apo të kuptojë se kryen veprë penale*” Siç shihet sëmundjet mendore na paraqiten si gjendje e cila nëse ekziston tek kryerësi në kohën e kryerjes së veprës penale atë e bën penalisht të papërgjegjshëm.

Sëmundjet mendore të përhershme apo të përkohshme janë sëmundje të sistemit nervor qendror të intensitetit të tillë që e bëjnë personin plotësisht të papërgjegjshëm, tek i cili manifestohen disfunksione dhe çrregullime në jetën shpirtërore, siç janë çrregullimet në lëmin e instiktit të ndjesisë dhe afektit, në disponimin dhe temperamentin, në funksionet intelektuale të jetës si vrojtimi, mbajtja mend, njohja e personave, të menduarit etj.³

Sëmundjet mendore mund të jenë të përhershme ose të përkohshme, ku sëmundjet e përhershme janë ato sëmundje që zgjasin për një kohë të gjatë dhe vlerësohet se përkundër mjekimit janë të pashërueshme si të tilla janë epilepsia, shizofrenia etj. Derisa sëmundjet mendore të përkohshme paraqiten në periudha të caktuara kohore dhe zgjasin një kohë të shkurtër, ku pushojnë vetvetiu apo pas mjekimit. Sëmundjet e përkohshme mendore mund të shkaktohen nga helmimet e ndryshme me anë të kërpuardhave, helmimet me alkool, me drogë, gëzimi apo hidhërimi i tepruar etj.⁴

Si rrethanë e dytë e cila e bën kryerësin penalisht të papërgjegjshëm paraqitet çrregullimi mendor i përkohshëm, i cili nënkupton çrregullime të përkohshme të shumicës së funksioneve psikike, veçanërisht vetëdijes, si pasojë e veprimit të faktorëve të jashtëm apo të brendshëm, ku çrregullimet e tilla në nivele të larta e bëjnë personin të paaftë për t’i kontrolluar sjelljet e veta. Paraqitja e çrregullimeve mendore të përkohshme mund të jetë si pasojë e hipnozës, dehjes me alkool apo drogë, temperaturat e larta, dëmtimet mekanike të trurit etj. Gjithashtu frika, trembja apo hidhërimi dhe gëzimi mund të kenë e ndikim në proceset normale psikike dhe të shkaktojnë çrregullim mendor.⁵

Rrethanë tjetër e cila e bën kryerësin penalisht të papërgjegjshëm është ngecja në zhvillim mendor apo dementia. Zhvillimi mendor i metë nënkupton

² N. Shtino dhe S. H. Lala, *Psikiatria ligjore*, Tiranë, 2011, fq.45.

³ I. Salihu, *E drejta penale, Pjesa e përgjithshme*, 2008, fq.280.

⁴ I.Salihu, vepra e cituar fq.280.

⁵ I.Salihu,vepra e cituar, fq.281.

moszhvillimin e aparatit psikik dhe si pasojë e kësaj, personi është i paaftë të gjykojë dhe të vendosë.

Ngecja në zhvillimin mendor mund të jetë pasojë e zhvillimit abnormal të fëmijës si pasojë e shkaqeve të brendshme, ose mund të jetë pasojë e shkaqeve të jashtme nëse fëmija izolohet nga rrethi social që nga dita e parë e jetës së tij.⁶

Zhvillimi i metë mendor apo prapambetja mendore, ndryshe emërtohet edhe si prapambetje intelektuale e zhvillimit, për shkak të efekteve etiketuese dhe stigmatizuese, që mbart emërtimi “prapambetje mendore.”⁷

Shkallëzimi i zhvillimit mendor të metë bëhet sipas kësaj renditje, ku në shkallën më të ulët paraqiten idiotët e shkallës së parë, jeta psikike e të cilëve është e mbështetur në instikte, pastaj janë idiotët e shkallës së dytë që kanë zhvillim mendor sa të fëmijës deri në tre vjeç. Derisa tek ata persona tek të cilët zhvillimi mendor, arrin deri në shkallën e zhvillimit mendor të fëmijës, prej tre deri gjashtë vjeç, quhen “imbecilë”. Në shkallën e katërt na paraqiten debilët, tek të cilët zhvillimi mendor arrin deri në shkallën e zhvillimit psikik të fëmijës, deri në moshën katërmëdhjetë vjeçare.⁸

Duke iu referuar shkallëzimit të zhvillimit mendor tek personat që kanë zhvillim të metë mendor, vërejmë se një gjendje e tillë e zhvillimit mendor në ndërlidhje edhe me rrethanat e tjera shoqërore mund të kushtëzojë që personi me zhvillim të metë mendor të jetë kryerës i mundshëm i veprës penale, si pasojë e paftësisë së tij për të kuptuar rëndësinë e sjelljeve të veta dhe paftësisë për t’i kontrolluar sjelljet e veta.

Nga kategoria e personave me zhvillim të metë mendor, “idiotët dhe imbecilët” paraqiten shumë rrallë si kryerës të veprave penale, derisa debilët më shumë favorizohen për të kryer vepra penale për shkak të sugjestionit dhe autosugjestionit të theksuar që kanë, sepse ata ndikohen dhe mashtrohen me lehtësi nga të tjerët.⁹

Aftësia e zvogëluar mendore përkufizohet sipas nenit 18, paragrafi 2-të i KPK-së, ku përcaktohet se: “*Person i cili ka kryer veprë penale konsiderohet se ka aftësi të zvogëluar mendore nëse në kohën e kryerjes së veprës penale aftësia e tij për të kuptuar natyrën dhe rëndësinë apo pasojën e veprimeve ose mosveprimeve të tij ka qenë esencialisht e zvogëluar për shkaqet e cekura në paragrafin 1, të këtij neni. Personi i tillë konsiderohet penalisht përgjegjës, por këto rrethana merren parasysh nga gjykata kur vendos për kohëzgjatjen dhe llojin e sanksionit ose masës së trajtimit të detyrueshëm*”

Nga dispozita e lartë cekur shohim se rrethanat të cilat shkaktojnë aftësinë e zvogëluar mendore janë sëmundjet mendore të përhershme apo të përkohshme, çrregullimi mendor apo ngecja në zhvillim mendor, por që këto rrethana nuk janë të intensitetit të lartë sa kryerësi i veprës penale të jetë plotësisht i papërgjegjshëm,

⁶ Po aty, fq.282.

⁷ N.Shtino dhe S.H.Lala, vepra e cituar, fq.167.

⁸ I.Salihu,vepra e cituar, fq.281.

⁹ N.Shtino dhe S.H.Lala,vepra e cituar, fq.170.

pra këto rrethana nuk e privojnë tërësisht kryerësin nga aftësia që të kuptojë rëndësinë e sjelljeve të veta dhe t'i kontrollojë sjelljet e veta.

Sipas kësaj dispozite aftësia duhet të jetë dukshëm e zvogëluar që do të thotë që jo çdo lloj i zvogëlimit të aftësisë mendore merret parasysh. Gjithashtu duhet të vërtetohet se, përgjegjshmëria esenciale e zvogëluar ka ekzistuar në kohën e kryerjes së veprës penale, sepse përgjegjshmëria esenciale e zvogëluar para apo pas kryerjes së veprës penale është irelevante për të drejtën penale.¹⁰

Vështrim i shkurtër historik i zrvillimit të Masave të trajtimi të detyrueshëm psikiatrik në kuadër të sanksioneve penale

Rrjedhat e zhvillimit dhe ndërtimit politik dhe shtetëror të një vendi, reflektojnë dukshëm edhe në fushën e legjislacionit dhe rregullimit të marrëdhënieve shoqërore. Zhvillimi shoqëror dhe politik kushtëzon zhvillimin e legjislacionit të një vendi. Duke ju referuar rrjedhave historike, zhvillimi i së drejtës në përgjithësi, por edhe së drejtës penale në veçanti në Kosovë ka qenë i kushtëzuar nga rrethanat historike nëpër të cilat ka kaluar Kosova.

Fillimet e rregullimit të marrëdhënieve shoqërore në Kosovë i gjejmë qysh në mesjetë¹¹, natyrisht në shkallën e zhvillimit të kësaj periudhe shoqërore në kushtet e okupimit nga pushtuesit e huaj. Gjatë periudhës së sundimit të Perandorisë Osmane në Kosovë, një rol mjaft të rëndësishëm e ka luajtur e drejta zakonore dhe në kuadër të saj edhe e drejta zakonore penale shqiptare.¹²

Pas Luftës së Dytë Botërore, Kosova edhe më tej mbeti nën sundimin e Jugosllavisë dhe nën juridiksionin e saj penal gjithashtu, ku normat penale të Kodit 1947, ishin të njohura për lejimin e analogjisë, paligjshmërisë dhe arbitrarizmit¹³, kjo deri në miratimin e Kodit Penal të vitit 1951.

Kushtetuta e ish Jugosllavisë e vitit 1974, e përcakton Kosovën si njësi konstituive të Federatës Jugosllave¹⁴, që juridikisht duhet të barazohej me njësitë e tjera të federatës¹⁵, por kjo nuk ndodhi në praktikë. Në bazë të autorizimeve legjislative që i jepte Kushtetuta e Jugosllavisë e vitit 1974, Kosova më 1 korrik të vitit 1977, miraton Ligjin e vet penal. Gjatë kësaj periudhe në fuqi ishin Ligji Penal Federativ që rregullonte çështjet e përgjithshme penale dhe vepronte në tërë territorin e ish Jugosllavisë dhe Ligji Penal i Kosovës, i cili paraqet një akt shumë të rëndësishëm për legjislacionin e Kosovës.

¹⁰ I.Salihi, *E drejta penale, Pjesa e përgjithshme*, Prishtinë 2008, fq.285.

¹¹ I.Salihi, *vep.e cituar*, fq. 110.

¹² Po aty, fq.110.

¹³ Po aty, fq.113.

¹⁴ H.Susuri, *E drejta kushtetuese e Republikës së Kosovës*, Prishtinë, 2011, fq.27.

¹⁵ Federata Jugosllave përbehej nga tetë njësi federale (Sllovenia, Kroacia, Bosnja dhe Hercegovina, Maqedonia, Serbia, Mali i Zi, Kosova dhe Vojvodina).

Në analizën e Ligjit Penal të ish Jugosllavisë dhe Ligjit Penal të Kosovës të vitit 1977, shohim se ka qenë e rregulluar edhe çështja e kryerësve penalisht të papërgjegjshëm dhe me përgjegjshmëri esenciale të zvogëluar ndaj të cilëve shqiptoheshin masat e sigurisë, si masa të posaçme penale.

Ligji Penal i ish Jugosllavisë, në kapitullin e pestë ka përcaktuar Masat e sigurisë që mund t'i shqiptohen kryerësit të veprës penale në kushtet e caktuara. Në nenin 60 të ish LPJ-së është përcaktuar qëllimi i masave të sigurisë, ku si i tillë është evitimi i gjendjeve dhe kushteve të cilat mund të ndikojnë që kryerësi të kryejë veprën penale në të ardhmen. Përcaktimi i një qëllimi të këtillë, pasqyron qëllimin preventiv të masave të sigurimit për evitimin e përsëritjes së sjelljeve kriminale.

Si masa të sigurimit¹⁶ të cilat mund t'ua shqiptonte gjykata kryerësve të veprave penale ishin:

1. Mjekimi i detyrueshëm psikiatrik dhe ruajtja në institucionin shëndetësor;
2. Mjekimi i detyrueshëm psikiatrik me lirim;
3. Mjekimi i detyrueshëm i alkoolistëve dhe narkomanëve;
4. Ndalimi i ushtrimit të profesionit, të veprimtarisë ose detyrës;
5. Ndalimi i paraqitjes në publik;
6. Ndalimi i drejtimit të automjetit;
7. Sekuestrimi i sendeve;
8. Dëbimi i të huajit nga vendi.¹⁷

Një vështrim i këtyre masave të sigurimit që mund t'i shqiptoheshin kryerësit të veprës penale, nxjerr në pah dallimin në mes Ligjit Penal të ish Jugosllavisë dhe Kodit Penal të Kosovës¹⁸, për faktin se disa nga masat e sigurimit, në Kodin Penal të Kosovës janë përcaktuar në kuadër të dënimeve plotësuese, kurse masat e sigurimit që mund t'ua shqiptoheshin kryerësve të veprave penale penalisht të papërgjegjshëm dhe kryerësve me aftësi të zvogëluar mendore në Kodin Penal të Kosovës janë emërtuar si Masa të trajtimit të detyrueshëm psikiatrik, si dhe Trajtimit të detyrueshëm përmes rehabilitimit të kryerësve të veprave penale të varur nga droga dhe alkooli.

Gjithashtu ekziston një dallim në mes legjislacionit të mëparshëm dhe legjislacionit aktual për sa i përket kushteve për shqiptimin e Masës së trajtimit të detyrueshëm me ndalimin në institucionin e kujdesit shëndetësor dhe ky dallim qëndron te dënimi i paraparë për veprën penale. Derisa neni 63 i LPJ-së¹⁹, nuk e

¹⁶ Masat të njëjta të sigurisë, me disa ndryshime të vogla i përcakton edhe Kodi Penal i Serbisë, i vitit 2006, për më shumë shih, kapitullin e gjashtë, nenet 78-90.

¹⁷ Neni 61 i Ligjit Penal të ish Jugosllavisë, Beograd, 1977.

¹⁸ Neni 3, parag. 2, Kodi Penal i Kosovës, Prishtinë, 2004.

¹⁹ Neni 63, "kryerësit i cili e ka kryer veprën penale në gjendje të papërgjegjshmërisë ose në gjendje të përgjegjshmërisë të pakësuar esencialisht, gjykata do t'i caktojë mjekimin i detyrueshëm psikiatrik dhe ruajtjen në institucionin shëndetësor, në qoftë se konstaton se kryerësi është i rrezikshëm për ambientin dhe se për

përcaktonte si kusht dënimin e paraparë për veprën penale të kryer, me rregullimin aktual ku një kusht i tillë është përcaktuar decidivisht, ku për shqiptimin e Masës së trajtimit të detyrueshëm me ndalim, kryerësi duhet të ketë kryer vepër penale të dënueshme më së paku për rreth tre vite burgim.²⁰

Ndryshimi i rrethanave shoqëro-politike, shthurja e Federatës Jugosllave dhe tentativat e shqiptarëve të Kosovës për ndarje dhe vetëqeverisje, padyshim që prekën edhe sistemin legjislativ dhe erdhi deri te suprimimi i autonomisë së Kosovës në vitin 1989, ku u suprimua edhe Ligji Penal i Kosovës. Prej vitit 1989 deri 1999, u zbatua Ligji Penal i Jugosllavisë dhe Ligji Penal i Serbisë, derisa pas çlirimit të Kosovës u rikthye në fuqi Ligji Penal i Kosovës i vitit 1977, për të mos lejuar vakumin juridik.

Padyshim që dalja e Kosovës nga Federata Jugosllave dhe ndryshimi i rrethanave shoqëro-politike në Kosovë, krijuan nevojën e mbulimit të vakumit ligjor edhe në fushën penale, gjë kjo që u konkretizua me hyrjen në fuqi të Kodit penal të Kosovës në vitin 2004, si dhe ligjeve tjera në fushën e kodit penal.

Në Kodin Penal të Kosovës të vitit 2004, në nenin 3 ishin të përcaktuara Sanksionet penale dhe masat e trajtimit të detyrueshëm, që mund t'i shqiptohen kryerësve të veprave penale ku sipas paragrafit 2 të këtij neni masat e trajtimit të detyrueshëm janë:

1. Trajtimi i detyrueshëm psikiatrik, për kryerësit e veprës penale të paaftë mendërisht;
2. Trajtimi i detyrueshëm psikiatrik, për kryerësit e veprës penale me aftësi të zvogëluar mendore dhe
3. Trajtimi i detyrueshëm përmes rehabilitimit, të kryerësve të veprave penale të varur nga droga dhe alkooli.

Sipas nenit 3 paragrafi 2, shohim se vetëm janë përcaktuar tri lloje të masave të trajtimit të detyrueshëm, të cilat mund t'i shqiptohen kryerësve të veprave penale, ndërsa në të nuk janë rregulluar kushtet për shqiptimin, procedurën e shqiptimit dhe ekzekutimin e këtyre masave, derisa sipas nenit 76 të këtij kodi "*Procedurat për urdhërimin e masave për trajtimin e detyrueshëm psikiatrik dhe për kryerësin me paaftësi mendore ose me aftësi të zvogëluar mendore ku ato do të parashihen veçantë me anë të ligjit.*" Sipas këtij neni shohim që masat e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik sipas Kodit Penal të Kosovës së vitit 2004, janë rregulluar me norma blankete, sepse përcaktohet se këto masa do të rregullohen me ligj të veçantë.

Në bazë të këtij neni në vitin 2004, është miratuar Rregullorja 2004/34 "Mbi procedurën penale ku përfshihen kryerës me çrregullime mendore" e cila e rregullon

të evituar këtë rrezik nevojitet mjekimi dhe ruajtja e tij në një institucion të tillë." Ligji Penal i të ish Jugosllavisë, Beograd, 1977.

²⁰ Neni 89, Kodi Penal i Kosovës, Prishtinë, 2012.

në mënyrë të detajuar procedurën e shqiptimit dhe ekzekutimit të masave të trajtimit të detyrueshëm psikiatrik. Edhe pse me norma e me blankete, përfshirja e masave të trajtimit të detyrueshëm psikiatrik si sanksione të posaçme penale, në Kodin Penal të Kosovës, të vitit 2004 dhe miratimi i Rregullores 2004/34, e cila në mënyrë të detajuar i përcakton kushtet për shqiptimin dhe ekzekutimin e tyre paraqet një të arritur të rëndësishme për rregullimin e pozitës së kryerësve me çrregullime mendore.

Mirëpo, një zgjidhje e tillë e ligjvënësit ishte kritikuar për mos përfshirjen e Masave të trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në kuadër të Kodit Penal, ku sipas prof. dr. Bajram Ukajt, ligjdhënësi i Kosovës nuk e ka shtruar mirë çështjen kur masat e trajtimit të detyrueshëm nuk i ka përcaktuar në Kodin Penal ose me ligj të veçantë, prandaj me rastin e ndryshimit dhe plotësimit të Kodit Penal²¹ aktual të Republikës së Kosovës, këto masa do të përcaktohen me dispozita të veçanta, në ligj të veçantë ose në një kapitull të veçantë në kuadër të Kodit Penal.²²

Një mangësi e tillë u evitua me miratimin e Kodit të ri Penal të Kosovës dhe Kodit të ri të Procedurës Penale të Kosovës, të vitit 2012, të cilët kanë hyrë në fuqi nga 1 Janari 2013, Masat e trajtimit të detyrueshëm u rregulluan qartë në Kodin Penal duke përcaktuar kushtet ligjore për shqiptimin e këtyre masave²³, derisa në Kodin e Procedurës Penale është rregulluar detajisht. Procedura penale ku përfshihen kryerës me çrregullime mendore²⁴.

Një mënyrë e tillë e rregullimit të pozitës së kryerësve me çrregullime mendore paraqet një të arritur të rëndësishme për vendin tonë, qoftë në aspektin e mbrojtjes së lirive dhe të drejtave të njeriut, qoftë për realizimin e qëllimeve të politikës ndëshkimore. Çështjen e pozitës së kryerësve të veprave penale me çrregullime mendore e kanë rregulluar në kuadër të kodit penal edhe shtetet e rajonit më të gjerë²⁵. Dallimi në mes këtyre shteteve dhe përcaktimit të Masave të trajtimit të

²¹ Kodi Penal i Kosovës, Prishtinë, 2004.

²² B. Ukaj, *Mbrojtja Juridiko-Penale e dinjitetit të kryerësve penalisht të papërgjegjshëm*, punimi është prezantuar në Konferencën Ndërkombëtare "Mbrojtja e dinjitetit njerëzor në epokën e globalizimit", mbajtur në Prishtinë, më 11-13.09.2010, fq.3.

²³ Nenet 87-91, Kodi Penal i Kosovës, Prishtinë 2012.

²⁴ Nenet 506-518, Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, Prishtinë, 2012.

²⁵ Kodi Penal i Maqedonisë i vitit 2004, në nenin 61 ka përcaktuar këto masa të sigurisë:

1) mjekimi i detyrueshëm psikiatrik dhe ruajtja në institucionin shëndetësor;

2) mjekimi i detyrueshëm psikiatrik në liri dhe

3) mjekimi i detyrueshëm i alkoolistëve dhe narkomanëve;

- Kodi Penal i Malit të Zi, i vitit 2004, nenet 69 deri 72 i rregullon masat e sigurisë :

1)Trajtimi i detyrueshëm psikiatrik dhe ruajtja në institucionin mjekësor (neni 69).

2)Trajtimi i detyrueshëm psikiatrik në liri (neni 70).

3)Trajtimi i detyrueshëm i narkomanëve dhe Trajtimi i detyrueshëm i alkoolistëve-(nenet 71 dhe 72).

-Kodi Penal i Rusisë, Moskë, 1996, Neni 99, paragraf.1, Masat e detyrueshme të natyrës mjekësore:

1)Trajtimi i detyrueshëm ambulant me vëzhgim nga një psikiatër;

2)Trajtimi i detyrueshëm në një spital të specializuar mendor;

3)Trajtimi i detyrueshëm në një spital të specializuar mendor me vëzhgim intensiv;

4)Trajtimi i detyrueshëm në një spital të specializuar psikiatrik me vëzhgim intensiv;

detyrueshëm psikiatrik sipas Kodit Penal të Kosovës, qëndron në emërtimin e këtyre masave, ku disa shtete i emërtojnë si masa të sigurisë, kurse disa të tjera si masa mjekësore.

Në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë²⁶, Masat mjekësore janë paraparë në nenin 46, paragrafi 1, ku ky nen përcakton se “Masat mjekësore mund të caktohen nga gjykata ndaj personave të papërgjegjshëm që kanë kryer veprë penale [...]”

Papërgjegjshmëria penale paraqet element esencial për shqiptimin e masave mjekësore, për shkak se në kohën e kryerjes së veprës penale, kryerësi ka vuajtur nga një turbullim psikik ose neuropsikik i cili ka prishur tërësisht ekuilibrin e tij mendor, dhe për pasojë, kryerësi nuk ka qenë në gjendje të kontrollojë veprimet ose mosveprimet e tij, e as të kuptojë se kryen veprë penale,²⁷ gjendje kjo e cila e përjashton elementin e përgjegjshësisë penale dhe pamundëson shqiptimin e sanksionit penal.

Masat mjekësore nuk janë me karakter ndëshkues, ata synojnë kurimin dhe shërimin e të sëmurit.²⁸

Në Kodin Penal aktual të Shqipërisë në nenin 46, paragrafi 2, janë përcaktuar dy lloj të masave mjekësore :

1. Mjekimi i detyruar ambulator;
2. Mjekimi i detyruar në një institucion mjekësor.

Me gjithë dallimet ekzistuese në emërtimin e këtyre masave mjekësore, në krahasim me emërtimin që përcakton Kodi Penal i Kosovës, kushtet për shqiptimin e tyre janë të ngjashme dhe i referohen kryerjes së veprës penale nga personi penalisht i papërgjegjshëm, që kryerësi të jetë i rrezikshëm për ambientin dhe rrethin ku jeton nëse ndaj tij nuk merren masa të caktuara mjekësore, ku varësisht nga shkalla e rrezikshmërisë dhe nevoja për trajtimin mjekësor shqiptohet *Mjekimi i detyruar ambulator apo Mjekimi i detyruar në një institucion mjekësor*.

Gjithashtu në krahasim me shtetet e rajonit, ekziston një specifik në Kodin Penal të Bosnje Hercegovinës, ku është përcaktuar vetëm një masë e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik²⁹, pa bërë një ndarje në trajtim të detyrueshëm psikiatrik me ndalimin në institucion dhe trajtim të detyrueshëm psikiatrik në liri, siç e përcaktojnë shumica e vendeve të tjera, ashtu si dhe vendi ynë. Dallimi tjetër ekziston tek rregullimi i cekët dhe gjithëpërfshirës, brenda një neni të vetëm për sa i përket kushteve për shqiptimin dhe ekzekutimin e kësaj mase, gjë që mund të vërshtirësoj punën e gjykatës në praktikë. Do të ishte më e arsyeshme nëse ky nen do të ishte më i detajuar dhe më i thuktë.

²⁶ Kodi Penal i Shqipërisë, Tiranë 2004.

²⁷ B. Ukaj, *Dënimet në të drejtën penale të Shqipërisë*, Prishtinë 2006, fq.285.

²⁸ Sh. Muçi, *E drejta penale*, Tiranë, 2007, fq. 259.

²⁹ Neni 68, Kodi Penal i Bosnjës dhe Hercegovinës, Sarajevë, 2003.

Masat e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik sipas Kodit Penal aktual të Kosovës³⁰

Rregullimin e çështjes së përgjegjshësisë penale të personave me çrregullime mendore dhe dhe inkorporimin e Rregullores nr. 2004/34 “Mbi procedurën penale ku përfshihen kryerës me çrregullime mendore”, në kuadër të Kodit Penal dhe në Kodin e Procedurës Penale padyshim që paraqet një të arritur të madhe në fushën e të drejtës penale, procedurës penale dhe ekzekutimit të sanksioneve penale, sepse e rregullon në mënyrë të veçantë pozitën e kryerësve me çrregullime mendore, duke iu referuar legjisacionit të mëparshëm ku këto masa ishin përfshirë në Ligjin Penal.³¹

Rëndësia e kësaj rregulloreje qëndron pikërisht tek subjektet, pozitën e të cilëve e rregullon, përpilimi i dispozitave të kësaj rregulloreje e cila është bërë në pajtim të plotë me parimin e humanitetit, aktet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe me parimet e shkencës së psikiatrisë.

Veprat penale kryejnë personat penalisht të përgjegjshëm, por edhe personat penalisht të papërgjegjshëm.³²

Kryerësit me çrregullime mendore karakterizohen nga një gjendje e veçantë psikike, e cila i bën të papërgjegjshëm për sjelljet dhe veprimet e tyre, atëherë kuptohet që trajtimi i tyre në mënyrë të njëjtë si kryerësit e përgjegjshëm penalisht e cila do të ishte në kundërshtim me të drejtat e njeriut dhe me parimin e humanitetit, prandaj përcaktimi i masave të tilla paraqet një hap shumë të rëndësishëm në fushën e legjisacionit penal.

Përcaktimi i masave të trajtimit të detyrueshëm psikiatrik është domosdoshmëri e respektimit të parimit të ligjshmërisë në aspektin e përcaktimit të sanksioneve penale me ligj, gjë që i bën të mundur gjykatës që në kuadër të këtyre masave që përcakton kjo rregullore të shqiptojë masën adekuate duke pasur parasysh edhe rrethanat tjera. Një përcaktim i qartë i rregullave të tilla e bën të pamundur arbitraritetin e organeve gjyqësore.

Masat e trajtimit të detyrueshëm apo masat mjekësore³³ i kanë disa karakteristika të përbashkëta me sanksionet penale të cilat janë se:

- u shqiptohen vetëm kryerësve të veprave penale;
- janë masa juridiko-penale qëllimi i të cilave është mbrojtja e shoqërisë nga kriminaliteti dhe mbrojtja e vlerave më vitale të individit dhe shoqërisë;

³⁰ Kodi Penal i Kosovës, i cili është në fuqi nga 1 Janar 2013, Prishtinë, 2012.

³¹ Nenet 63 dhe 64, Ligji Penal i sh RSFJ-së, Beograd, 1977.

³² B.Ukaj, punimi i cituar, Prishtinë, 2010, fq.2.

³³ Sipas kodeve penale aktuale të shumë shteteve, emërtohen si masa mjekësore.

- shqiptohen vetëm nga gjykata në procedurë të caktuar gjyqësore;
- shqiptohen nga gjykata vetëm kur janë të përcaktuara në Kodin penal apo me ligj të veçantë siç është rasti i Kosovës;
- shqiptohen në mënyrë të dhunshme ndaj kryerësit të veprës penale,³⁴

Masat e zbatueshme kryerëse me çrregullime mendore janë të përcaktuara në kapitullin e pestë të Kodit Penal të Kosovës, përkatësisht në nenin 88, ku përcaktohet qartë se: *1. Masat e trajtimit të detyrueshëm të cilat mund t'i shqiptohen kryerësit, dhe i cili nuk është penalisht përgjegjës, ka aftësi esencialisht të zvogëluar mendore apo është i varur nga droga ose alkooli janë:*

- 1.1. trajtimi i detyrueshëm psikiatrik me ndalimin në institucionin e kujdesit shëndetësor;
- 1.2. trajtimi i detyrueshëm psikiatrik në liri; dhe
- 1.3. trajtimi me anë të rehabilitimit të detyrueshëm të personave të varur nga droga ose alkooli”.

Gjithashtu në Kodin Penal rregullohet edhe çështja e shqiptimit të sanksioneve penale të kryerësve që kryejnë vepër penale në gjendje të aftësisë së zvogëluar mendore dhe atë në nenin 88 paragrafi 2, ku përcaktohet se: *“Sanksioni penal në pajtim me Kodin Penal të Kosovës, po ashtu mund t'i shqiptohet kryerësit i cili ka kryer ndonjë vepër penale në gjendje të aftësisë së zvogëluar mendore nëse ekzistojnë arsyet për shqiptimin e sanksionit të tillë.”*

Duke analizuar masat e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik, shohim se edhe pse kanë elemente të përbashkëta me sanksionet penale, këto masa kanë edhe disa specifika të cilat i dallojnë nga sanksionet penale.

Dallimi qëndron pikërisht në këto pika:

- masat e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik i shqiptohen kryerësit penalisht të papërgjegjshëm apo me përgjegjshmëri esenciale të zvogëluar;
- këto masa kanë karakter preventiv dhe atë të preventivës speciale dhe jo karakter retributiv;
- gjendja e rrezikshmërisë së kryerësit për rrethin dhe shoqërinë kushtëzon përcaktimin për njëjërën apo tjetrën masë;
- nuk janë të kufizuara në aspektin kohor, që do të thotë që shqiptohen në kohëzgjatje të pacaktuar;

Gjykata është e obliguar që të vërtetojë gjendjen psikike të kryerësit dhe atë në çdo kohë gjatë procedurës, duke përfshirë kohën gjatë shqyrtimit gjyqësor, nëse ekziston dyshimi se i pandehuri ka qenë në gjendje të paaftësisë mendore ose në

³⁴ B.Ukaj, *Dënimet në të drejtën penale të Shqipërisë*, Prishtinë, 2006, fq.281.

gjendje të aftësisë së zvogëluar mendore në kohën e kryerjes së veprës penale apo nëse ka ndonjë çrregullim mendor.

Gjykata sipas detyrës zyrtare ose me propozimin e prokurorit publik apo të mbrojtësit, mund të caktojë ekspert për të kryer ekzaminimin psikiatrik të të pandehurit për të konstatuar nëse:

- në kohën e kryerjes së veprës penale i pandehuri ka qenë në gjendje të paaftësisë mendore ose aftësisë së zvogëluar mendore ose
- i pandehuri është i paaftë për të përballuar gjykimin;³⁵

Qëllimi i ekspertimit psikiatrik është që të përcaktojë shkallën e përgjegjshmërisë së personave që merren nën përgjegjësi penale, kur ka të dhëna që mund të dyshohet për sëmundje psikike. Eksperti duhet të vlerësojë gjendjen psikike të kryerësve në kohën e kryerjes së veprave penale (moment i cili lidhet drejtpërdrejtë me përgjegjshmërinë nga pikëpamja juridiko penale) dhe në periudhën e kryerjes së ekspertimit si dhe gjendjen e atyre personave që sëmuren nga ana mendore gjatë vuajtjes së dënimit me burgim.³⁶ Rëndësia e mendimit të ekspertit psikiatrik qëndron edhe në faktin se në bazë të tij gjykata përcakton llojin e masave mjekësore, për personat që vlerësohen të papërgjegjshëm për veprat penale që kanë kryer, si dhe për ata që sëmuren pas kryerjes së krimeve apo gjatë paraburgimit apo burgimit.³⁷

Në bazë të mendimit të ekspertit psikiatrik për gjendjen e kryerësit varet edhe vazhdimi i mëtejme i procedurës penale.³⁸

Trajtimi i detyrueshëm psikiatrik me ndalim në institucion të kujdesit shëndetësor (“trajtim i detyrueshëm psikiatrik me ndalim”)

Duke iu referuar Kodit Penal të Kosovës, neni 88 paragrafi 1.1., njëra nga masat që mund t'u shqiptohen kryerësve me paaftësi mendore apo aftësi të zvogëluar mendore, është Trajtimi i detyrueshëm psikiatrik me ndalimin dhe trajtimin e kujdesit shëndetësor.

Derisa sipas nenit 89 të këtij kodi përcaktohet se: *“Gjykata mund t'i shqiptojë masën e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik me ndalim në institucionin e kujdesit shëndetësor kryerësit i cili ka kryer vepër penale në gjendje të paaftësisë mendore ose aftësisë esencialisht të zvogëluar mendore, nëse konstaton se:*

- 1.1. kryesi ka kryer vepër penale për të cilën është paraparë dënimi me së paku tre (3) vjet burgim;

³⁵ Neni 508, Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, Prishtinë, 2012.

³⁶ N.Shtino dhe S. H. Lala, vepër e cituar, fq.19.

³⁷ Po, aty. fq.19.

³⁸ Për më shumë rreth procedurës penale për kryerësit me çrregullime mendore shihen nenet 506-516, të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, Prishtinë, 2012.

- 1.2. ekziston rrezik serioz se kryerësi do të kryejë veprë tjetër penale;
- 1.3. trajtimi i detyrueshëm psikiatrik me ndalim është i nevojshëm për të shmangur kryerjen e veprës tjetër penale;
- 1.4. kryesi është i paaftë për t'u përballur me gjykimin dhe
- 1.5. trajtimi i detyrueshëm psikiatrik me ndalim është i nevojshëm për të shmangur rrezikun serioz;

Nëse bëjmë një krahasim të nenit 89 të Kodit Penal dhe të nenit 4 të Rregullores 2004/34 mbi arsyeshmërinë e shqiptimit të Masës së trajtimit të detyrueshëm me ndalim do të shohim se: ekzistojnë dallime në përcaktimin e kushteve për shqiptimin e kësaj mase ku sipas rregullores në fjalë kërkohej që: *“të ekzistojë rreziku serioz që kryerësi të kryejë veprë penale ku përfshihet akti i dhunshëm ose shkaktimi i lëndimit trupor të personit tjetër”*³⁹ derisa një kusht i tillë nuk është kërkuar nga Kodi Penal, i cili përcakton si kusht vetëm rrezikshmërinë që kryerësi i veprës penale të kryejë veprë penale tjetër.

Sipas kësaj dispozite për t'u shqiptuar kjo masë duhet të plotësohen këto kushte:

- kushti i parë i cili duhet të plotësohet është që vepra penale të jetë kryer në gjendje të paaftësisë mendore apo në gjendje të aftësisë së zvogëluar mendore;
- kushti i dytë - vepra penale të jetë e dënueshme me së paku tre vite burgim, gjë që paraqet elementin e rrezikshmërisë shoqërore si kusht esencial për të shqiptuar këtë masë; të ekzistojë rreziku serioz që kryerësi të kryejë veprë tjetër penale;

Kushti i parë i cili i referohet papërgjegjshmërisë penale apo përgjegjshmërisë esenciale të zvogëluar, është një kusht i cili duhet të vërtetohet në secilin rast konkret.

Papërgjegjshmëria e kryerësit të veprës penale vërtetohet në bazë të dy kriterëve: kriterit mjekësor dhe kriterit juridik. Kriteri mjekësor ka për qëllim përcaktimin e atyre çrregullimeve psikike që bëjnë personin të papërgjegjshëm ndaj ligjit për veprimet shoqërisht të rrezikshme që ai kryen, derisa kriteri juridik përcakton rëndësinë ose shkallën e çrregullimeve psikike dhe të prapambetjes mendore, dhe që e bën më pas personin të papërgjegjshëm për veprat penale që ai kryen.⁴⁰

Derisa kushti i veprës penale të dënueshme me më së paku tre vite burgim paraqet një kusht objektiv i cili është i lehtë të vërtetohet, duke pasur parasysh rrethanat e çdo

³⁹ Neni 4 Rregullorja 200/34, Prishtinë, 2004, “Gjykata shqipton masën e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik me ndalim ndaj kryerësit i cili ka kryer veprë penale të dënueshme me së paku tri vite në gjendje të paaftësisë mendore ose aftësisë së zvogëluar mendore nëse konstaton se: (a) ekziston rrezik serioz që kryerësi të kryejë veprë penale ku përfshihet akti i dhunshëm ose shkaktimi i lëndimit trupor personit tjetër; dhe (b) trajtimi i detyrueshëm psikiatrik me ndalim është i nevojshëm për shmangien e rrezikut të tillë.”

⁴⁰ N. Shtino dhe S.H.Lala, vepra e cituar, fq.42-43.

rasti konkret dhe duke bërë kualifikimin ligjor, vështirësitë qëndrojnë në vërtetimin e paaftësisë mendore të kryerësit si dhe shkallën e rrezikshmërisë që mund të paraqes një person i tillë për shoqërinë nëse nuk i shqiptohet një masë e tillë.

Vërtetimi i këtyre rrethanave kërkon ndihmën profesionale të personave të kualifikuar, përkatësisht ndihmën e ekspertit mjeko-ligjor nga fusha e psikiatrisë. Eksperti i psikiatrisë ka për detyrë të vlerësojë aftësinë psikike, përkatësisht gjendjen psikike të personit të caktuar, kryerës të veprës penale në raport me aktin e kryer.

Ekzistojnë një varg indikacionesh që kushtëzojnë kryerjen e ekspertimit psikiatrik siç janë: të dhënat se kryerësi ka vuajtur prej sëmundjeve psikike, gjatë procedimit penal shpreh abnormalitet në sjellje, karakteristikat e veprës penale të kryera vetvetiu çojnë te ajo se i pandehuri ka mundur të kryejë veprën në gjendje të çrregullimit psikik, dhe këtu shikojmë nëse mungon motivi për kryerjen e veprës penale etj.⁴¹

Personat e papërgjegjshëm apo me përgjegjshmëri esenciale të zvogëluar manifestojnë sjellje dhe qëndrime të cilat çojnë në dyshimin se mund të vuajnë nga sëmundje psikike, bëjnë deponime të çuditshme duke marrë përsipër vepra penale të kryera nga personat e tjerë, dhe deri tek vepra penale e kryer ku mungon motivi, apo manifestojnë një shkallë të lartë të dhunës dhe egërsisë gjatë kryerjes së veprës penale, duke copëtuar dhe duke groposur viktimat të gjalla.⁴²

Eksperti ka për detyrë të përcaktojë natyrën, llojin dhe shkallën e sëmundjes apo çrregullimit psikik, të vërtetojë se sa ka ndikuar kjo gjendje psikike e kryerësit në shkaktimin e papërgjegjshmërisë apo zvogëlimin e përgjegjshmërisë penale të kryerësit në kohën e kryerjes së veprës penale dhe të vlerësojë shkallën e rrezikshmërisë që ky person paraqet për shoqërinë.

Natyrisht, mendimin e tij, eksperti do ta japi në përputhje me parimet e fushës së psikiatrisë dhe etikës mjekësore. Konstatimi dhe mendimi i ekspertit për gjendjen psikike të kryerësit të veprës penale në korrelacion me rrethanat e tjera të rastit i jep gjykatës bazë për marrjen e vendimit gjyqësor dhe për përcaktimin e masës së trajtimit të detyrueshëm psikiatrik që do t'i shqiptohet.

Sipas prof. Z. Stojanovic: *“Zgjedhja, lloji dhe kohëzgjatja e masave të sigurisë përcaktohet në bazë të vlerësimit të rrezikshmërisë së kryerësit të veprës penale. Vepra penale as për së afërmi nuk e ka atë peshë që e ka në shqiptimin e dënimit edhe pse mund të jetë një tregues i rëndësishëm për shkallën e rrezikshmërisë së kryerësit.”*⁴³

Prandaj, mund të themi se kryerja e veprës penale dhe rrezikshmëria që kryerësi të kryejë sërish veprë penale në të ardhmen kushtëzon marrjen e

⁴¹ D.Kecmanovic, *Psihijatrija* - Beograd-Zagreb, 1989 (material i përkthyer në shqip).

⁴² N. Shtino dhe S. H. Lala, vepra e cituar, fq.21.

⁴³ Z. Stojanovic, *E drejta penale, pjesa e përgjithshme*, Beograd, 2003, fq.346.

masave ndaj tij, trajtimin e detyrueshëm psikiatrik me ndalimin apo lirinë, masa këto që kufizojnë liritë dhe të drejtat e tij, edhe pse shqiptohen me qëllim të shërimit të tij.

Arsyeshmëria e shqiptimit të masës së trajtimit të detyrueshëm psikiatrik me ndalimin qëndron në faktin se personat e tillë paraqesin rrezik për rrethin ku jetojnë, sepse gjendja e tyre psikike nuk ua mundëson që të kuptojnë rëndësinë e veprimeve të veta dhe t'i kontrollojnë veprimet e veta.

Meqenëse paaftësia mendore apo aftësia e zvogëluar mund të jetë si pasojë e një sëmundje psikike, çrregullimi mendor apo ngecje në zhvillim mendor, e cila mund të jetë në shkallë të ndryshme, atëherë në secilin rast konkret duhet të konstatohet gjendja mendore e kryerësit të veprës penale, i cili vuan nga një sëmundje mendore, çrregullim mendor apo ngecje në zhvillim mendor, në mënyrë që të vlerësohet se çfarë shkalle të rrezikut paraqet personi i tillë për të tjerët, në aspektin e të qenit i dhunshëm, në qoftë se nuk i shqiptohet një masë e tillë. Gjithashtu shqiptimi i kësaj mase arsyetohet me faktin se kryerësi i veprës penale do jetë në mbikëqyrjen e institucioneve shëndetësore dhe do t'i nënshtrohet një trajtimi adekuat në pajtim me gjendjen e kryerësit.

Si përfundim, për të shqiptuar këtë masë gjykata duhet të kualifikojë veprën penale të dënueshme me më së paku tre vite burgim, të marrë mendimin e ekspertit psikiatrik për gjendjen psikike të kryerësit dhe duke vlerësuar këtë gjendje të vlerësojë domosdoshmërinë e shqiptimit të kësaj mase. Këto rrethana gjykata i vlerëson objektivisht dhe duke u bazuar në norma pozitive.

Trajtimi i detyrueshëm psikiatrik në liri

Trajtimi i detyrueshëm psikiatrik në liri paraqet masë më të lehtë për kryerësin e veprës penale me paaftësi mendore apo aftësi të zvogëluar mendore në krahasim me trajtimin e detyrueshëm psikiatrik me ndalim, sepse me këtë masë kryerësi nuk izolohet nga rrethi ku jeton. Sipas nenit 90 të Kodit Penal të Kosovës *“Gjykata mund t'i shqiptojë masën e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në liri kryerësit i cili ka kryer veprë penale në gjendje të paaftësisë mendore ose aftësisë esencialisht të zvogëluar mendore, nëse konstaton se:*

- 1.1. ekziston rrezik serioz se kryerësi do të kryejë veprë penale;
- 1.2. trajtimi i detyrueshëm psikiatrik në liri është i nevojshëm për të shmangur kryerjen e veprës tjetër penale; dhe
- 1.3. trajtimi i detyrueshëm psikiatrik në liri është i mjaftueshëm për të shmangur rrezikun serioz”

Nga ky përcaktim ligjor shihet se, për dallimin nga masa e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik me ndalim, për trajtimin e detyrueshëm psikiatrik në liri

ku nuk parashikohet një kusht eksplicit që i referohet dënimit të paraparë për veprën penale, prandaj mund të konstatojmë se një masë e tillë shqiptohet:

- kur është kryer veprë penale e dënueshme deri në tre vite burgim;
- kur kryerës i veprës penale është personi me paaftësi mendore apo me aftësi të zvogëluar mendore;
- kur ekziston rreziku serioz që kryerësi do të kryejë veprë penale tjetër;
- kur shqiptimi i masës së tillë është i nevojshëm për shmangien e rrezikut të tillë;

Një përcaktim i tillë na jep mundësi të kuptojmë se kjo masë shqiptohet kur vlerësohet nëse shkalla e rrezikshmërisë nga kjo kategori e kryerësve nuk është e nivelit të atillë sa kryerësit të mbyllen në institucion dhe të ndahen nga mjedisi dhe rrethi ku jetojnë.

Prandaj kjo masë varet si nga rrethanat objektive që i referohen veprës penale të kryer, gjithashtu edhe nga rrethanat subjektive që i referohen gjendjes mendore të kryerësit të veprës penale dhe shkallës së rrezikshmërisë që ai manifeston.

Gjykata në kuadër të kompetencave që ia jep ligji, duke shqyrtuar rrethanat e çdo rasti konkret, si shkallën e rrezikshmërisë së kryerësit dhe vlerësimit se një masë e tillë është e mjaftueshme për shërimin e kryerësit të cilat i shqipton në këtë masë.

Arsyeshmëria e shqiptimit të masave të trajtimit të detyrueshëm psikiatrik

Në analizimin e mëtejshëm të masave të trajtimit të detyrueshëm psikiatrik me ndalim dhe në liri, padyshim që një aspekt shumë i rëndësishëm është trajtimi i arsyeshmërisë së shqiptimit të këtyre masave. Kryerja e veprës penale paraqet cenimin e të mirave juridike dhe të vlerave më vitale të individit dhe shoqërisë, gjë që është domosdoshmëri ligjore dhe shoqërore dhe që ndaj kryerësve të shqiptohen sanksione penale, qoftë si dënim për aktin e kryer, qoftë edhe për riedukimin dhe risocializimin e tyre. Humanizimi i të drejtës penale në aspektin e trajtimit të kryerësit të veprës penale shfaqet edhe me përcaktimin e masave të trajtimit të detyrueshëm psikiatrik, si masa të veçanta që mund t'i shqiptohen një kategorie të veçantë të kryerësve të veprave penale.

Padyshim që neni 87 paragrafi 1 i Kodit Penal të Kosovës, është i një rëndësie të veçantë sepse përcakton qartë se kryerësit me çrregullime mendore duhet të trajtohen me humanizëm, duke respektuar dinjitetin e tyre që ju takon si qenie njerëzore në pajtim me standardet e zbatueshme ndërkombëtare, duke u kufizuar varësisht nga nevoja dhe nga rrethanat. Kështu neni 87 paragrafi 2-të i KPK-së

përcakton se: *“Standardet ndërkombëtare të zbatueshme për personat me çrregullime mendore zbatohen për kryerësit me çrregullime mendore në shkallën më të lartë të mundshme, me vetëm disa ndryshime dhe përjashtime të kufizuara vetëm për atë që janë të nevojshme sipas rrethanave.”*

Meqenëse kryerësit e veprave penale me paaftësi mendore dhe me aftësi të zvogëluar mendore janë në një gjendje të posaçme psikike si pasojë e sëmundjes mendore të përhershme apo të përkohshme, çrregullimit mendor apo ngeçjes në zhvillimin mendor, gjë që i bëjnë të papërgjegjshëm për veprimet e tyre, të paaftë për të kuptuar rëndësinë dhe për të kontrolluar veprimet e veta, atëherë do të ishte e padrejtë dhe në kundërshtim me parimet e të drejtave të njeriut që kjo kategori e kryerësve të trajtohen të njëjtë me kryerësit penalisht të përgjegjshëm.

Gjithashtu shqiptimi i sanksioneve penale i këtyre kryerësve do të ishte i padobishëm, sepse nuk do të arrihej të realizohej qëllimi i dënimit si sanksion. Kryerësit me çrregullime mendore janë të paaftë të kuptojnë rëndësinë e veprimeve të veta dhe të paaftë për t'i kontrolluar veprimet e veta, ata nuk janë në gjendje të kuptojnë se kanë kryer veprime që janë në kundërshtim me ligjin dhe se për këtë ndaj tyre do të shqiptohet sanksioni penal. Qëllimi riedukues dhe risocializues i dënimit me burgim do të ishte e pamundur të realizohet ndaj kësaj kategorie të kryerësve të veprave penale.

Mirëpo, gjendja psikike e kësaj kategorie të kryerësve të veprave penale nuk duhet të jetë arsye që ndaj tyre të mos ndërmerret asnjë masë kur këta manifestojnë sjellje kriminale dhe paraqesin rrezikshmëri për mjedisin dhe rrethin ku ata jetojnë. Veprimet shoqërisht të rrezikshme që kryejnë të sëmurët psikik nuk kanë karakter penal, pasi ata nuk janë në gjendje të kuptojnë rëndësinë e veprimeve që kryejnë, por të sëmurët që kryejnë veprime shoqërisht të rrezikshme dhe ato deklarohen të papërgjegjshëm, ku ato nuk mund të lihen të lirë dhe jashtë kontrollit të shoqërisë.⁴⁴

Prandaj duke pasur parasysh këto rrethana që i karakterizojnë kryerësit e veprave penale me paaftësi mendore dhe aftësi të zvogëluar mendore, janë përcaktuar masat e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik, masa këto që mund t'u shqiptohen:

- vetëm kryerësve të veprave penale, penalisht të papërgjegjshëm;
- kur kryerësi paraqet rrezikshmëri për ambientin dhe rrethin ku jeton;
- shqiptimi i masave të tilla do ta mënjanonte këtë rrezik;

Trajtimi i detyrueshëm psikiatrik me ndalimin dhe në lirinë janë masa të duhura të cilat si në aspektin e subjekteve që iu shqiptohen, ashtu edhe nga qëllimi që kanë, janë të përshtatshme për mbrojtjen e shoqërisë nga kriminaliteti nga njëra anë dhe për mbrojtjen e kryerësve me çrregullime mendore nga arbitrariteti i gjykatave nga ana tjetër.

⁴⁴ N. Shtino dhe S. H. Lala, vep. e cit.fq.47.

Qëllimi i masave të trajtimit të detyrueshëm është parandalimi i kryerësit që në të ardhmen të kryejë vepra penale dhe të evitojë kushtet që mund të ndikojnë që kryerësi të kryejë sërish vepra penale.

Gjendja e kryerësve penalisht të papërgjegjshëm, rrethanat e kryerjes së veprës, shkalla e sëmundjes, çrregullimit mendore, apo ngeçjes në zhvillim mendor janë elemente kyçe në të cilat bazohet gjykata për të shqiptuar masat e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik dhe për të arsyetuar shqiptimin e masave dhe jo sanksioneve penale.

Zbatimi i dënimeve ndaj këtyre personave do të ishte i padobishëm, i papranueshëm dhe i pakuptimtë, pasi nuk mund të flitet për edukim a për riedukimin e personave që nuk janë në gjendje t'i kontrollojnë dhe t'i kuptojnë pasojat që shkaktohen nga veprimet a mosveprimet e tyre.⁴⁵

Mund të themi se përcaktimi i masave të trajtimit të detyrueshëm psikiatrik është domosdoshmëri e kohës bashkëkohore dhe në përputhje të plotë me parimet e humanizimit të së drejtës penale dhe parimet e të drejtave dhe lirive të njeriut. Sikurse do të ishte e padrejtë trajtimi i njëjtë i kryerësve penalisht të papërgjegjshëm me kryerësit penalisht të përgjegjshëm, gjithashtu do të ishte padrejtësi që ndaj kryerësve penalisht të papërgjegjshëm të mos ndërmerret asnjë masë.

Prandaj, mund të thuhet se: masat e karakterit mjekësor kanë karakter të dyfishtë, ku zbatohen njëkohësisht për të mbrojtur interesat e kryerësve të sëmurë mendërisht dhe interesat e shoqërisë prej veprimeve të tyre objektivisht të pakontrolluara.⁴⁶

Përfundime

Shqyrtimi i Masave të trajtimit të detyrueshëm psikiatrik, si masa të posaçme në kuadër të sanksioneve penale, pjesë e legjislacionit penal pozitiv të nxjerrë në pah argumentet mbi rëndësinë, arsyeshmërinë dhe domosdoshmërinë e përcaktimit me ligj dhe shqiptimit të këtyre masave. Nga analiza e përcaktimit të masave të trajtimit të detyrueshëm psikiatrik, në legjislacionin penal të vendit tonë dhe krahasimi i tyre me masat e sigurisë që përcaktojnë kodet penale të vendeve të tjera, na del se pavarësisht ndryshimeve të vogla që mund të ketë Kodi penal i një vendi nga Kodi penal i një vendi tjetër, në përgjithësi qëllimi i masave të sigurisë, kushtet për shqiptimin e tyre dhe mënyra e ekzekutimit është pothuajse e njëjtë.

Përcaktimi i Masave të trajtimit të detyrueshëm psikiatrik, si masa të posaçme në kuadër të sanksioneve penale, është një domosdoshmëri e kohës

⁴⁵ Sh. Muçi, E drejta penale, Tiranë, 2007, fq.260.

⁴⁶ Sh. Muçi, vep. e cituar, fq. 260

moderne dhe në pajtim me parimin për humanizimin e të drejtës penale. Masat e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik, të përcaktuara me Kodin Penal pasqyrojnë qartë rëndësinë e tyre si masa të posaçme penale që mund t'i shqiptohen kryerësve të veprave penale të papërgjegjshëm dhe me përgjegjshmëri esenciale të zvogëluar.

Përcaktimi ligjor për llojet e masave të trajtimit të detyrueshëm psikiatrik, për kushtet dhe procedurën gjyqësore të shqiptimit, si dhe për mënyrën e ekzekutimit të tyre në mënyrë të qartë ku ato i përcaktojnë subjektet e të cilëve u dedikohen dhe qëllimin që synohet të arrihet përmes tyre.

Përcaktimi vendimtar i llojeve të masave të trajtimit të detyrueshëm psikiatrik dhe kushteve ligjore për shqiptimin e masave të tilla, ka rëndësi të dyanshme si:

- mbrojtjen e shoqërisë nga sjelljet kriminale të personave të papërgjegjshëm dhe me përgjegjshmëri esenciale të zvogëluar dhe me
- mbrojtjen e dinjitetit të personave të papërgjegjshëm dhe me përgjegjshmëri esenciale të zvogëluar, kryerëse të veprave penale;

Duke analizuar kushtet për shqiptimin e këtyre masave dhe qëllimin që duhet të arrihet me anë të ekzekutimit të tyre shohim që papërgjegjshmëria e kryerësit të veprës penale dhe rreziku për përsëritjen e sjelljeve kriminale janë faktorë kyç për shqiptimin e masave të tilla.

Nëse i referohemi qëllimit të masave të trajtimit të detyrueshëm psikiatrik, të cilin e kanë përcaktuar shumica e vendeve, po ashtu edhe vendi ynë, vërejmë se me anë të këtyre masave shteti reagon ndaj sjelljeve kriminale të individëve, ashtu siç bën kur shqipton edhe sanksionet e tjera penale, por për shqiptimin e këtyre masave kusht është rrezikshmëria e kryerësit të veprës penale që të përsërisë veprën penale në të ardhmen dhe nevojat për trajtimin adekuat mjekësor për evitimin e këtij rreziku, derisa për shqiptimin e dënimit kusht është kryerja e veprës penale.

Përcaktimi alternativ i masave, si Masa e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik me ndalim në institucion dhe Trajtimin e detyrueshëm psikiatrik në liri ku ai i lejon organeve gjyqësore që në praktikë të bëjnë individualizimin e masës, varësisht nga rrethanat e rastit konkret, dhe rrezikshmërisë së kryerësit të veprës penale dhe shkallës së sëmundjes. Një zgjidhje e tillë, lejon shqiptimin e masës më të përshtatshme dhe eviton mundësinë për arbitraritet gjyqësor.

Jetësimi i këtyre masave realizohet pikërisht në fazën e ekzekutimit, fazë kjo shumë e rëndësishme, në të cilën synohet të arrihet qëllimi i këtyre masave. Mirëpo, kjo fazë gjithashtu është mjaft sfiduese për organet gjyqësore dhe organet kompetente të kujdesit shëndetësor, qoftë për sa i përket gjendjes së kryerësit penalisht të papërgjegjshëm, qoftë në aspektin e mungesës së institucioneve adekuate mjekësore qoftë dhe për trajtimin e kësaj kategorie të kryerësve. Prandaj,

për ekzekutimin e suksesshëm të këtyre masave, në të ardhmen kërkohet krijimi i institucioneve adekuate mjekësore dhe kuadrit mjekësor të specializuar për trajtimin e të sëmurëve mendor, dhe kryerës të veprave penale.

Megjithëse, vlerësohet se numri i veprave penale që kryejnë kryerësit me çrregullime mendore është simbolik, një vlerësim i përgjithshëm për masat e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik është se: këto masa janë pjesë e domosdoshme e politikës ndëshkimore penale për luftimin e kriminalitetit me të gjithë specifikat e tyre që i bëjnë ato të dallohen nga dënimet.

Literatura

Kode, akte ligjore dhe dokumente të tjera

- Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Prishtinë, 2008.
 Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Prishtinë, 2012.
 Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, Prishtinë, 2012.
 Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Prishtinë, 2004.
 Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, Prishtinë, 2004.
 Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, Tiranë, 2004.
 Kodi Penal i Bosnjës dhe Hercegovinës, Sarajevë, 2003.
 Kodi Penal i ish - Jugosllavisë, Beograd, 1977.
 Kodi Penal i Kroacisë, Zagreb, 1998.
 Kodi Penal i Malit të Zi, Cetinje, 2004.
 Kodi Penal i Maqedonisë, Shkup, 2004.
 Kodi Penal i Ruisë, Moskë, 1996.
 Kodi Penal i Serbisë, Beograd, 2006.
 Ligji mbi ekzekutimin e sanksioneve penale, Prishtinë, 2004.
 Ligji Penal i ish KSA-së të Kosovës, Prishtinë, 1977.
 Rregullore nr. 2004/34 "Mbi procedurën penale ku përfshihen kryerës me çrregullime mendore", Prishtinë, 2004.

Libra, artikuj shkencorë

- Bačić, F., Bavcon. Ljubo, etj. - *Komentar Krivičnog Zakona Socialističke Federative Republike Jugosllave* – Drugo Izdanje, Beograd, 1982.
 Dervinja, F. "Psikologjia forenzike", Telegrafi, Prishtinë, 19 tetor, 2010.
 Halili, R. *Kriminologjia*, Prishtinë, 2011.
 Instituti i Kërkimeve Juridike dhe Shoqërore - Fakulteti Juridik, *Përmbledhje e Ligjeve penale*, Prishtinë, 1979.
 Kecmanović, D. *Psihijatrija*, Beograd-Zagreb, 1989.
 Lazarević, L., Vučković Dr. B., Vučković Dr. V., *Komentar - Krivičnog Zakonik Crne Gore - Drugo izmijenjo I dopunjeno izdanje*, Cetinje, 2007.
 Muçi, Sh. *E drejta penale*, Tiranë, 2007.
 Osmani, A. *Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë*, Shkup, 2010.
 Sahiti, E. *E drejta e procedurës penale*, Prishtinë, 2005.
 Sahiti, E. *Psikologjia Gjyqësore*, Prishtinë, 2007.
 Salihu, I. *E drejta penale - Pjesa e përgjithshme*, Prishtinë, 1995.

- Saihu, I. *E drejta penale, pjesa e përgjithshme*, Prishtinë, 2008.
 Stojanovic, Z. *E drejta penale - Pjesa e përgjithshme*, Beograd, 2003.
 Susuri, H. *E drejta Kushtetuese e Republikës së Kosovës*, Prishtinë, 2011.
 Shtino.N., Lala, S. *Psikiatria ligjore*, Tiranë, 2011.
 Ukaj, B. *Dënimet në të drejtën penale të Shqipërisë*, Prishtinë, 2006.
 Ukaj, B. *Mbrojtja juridiko-penale e dinjitetit të kryerësve penalisht të papërgjegjshëm*, Prishtinë, 2010.

Të drejtat e dëmtuarve në procedurën penale, aspekte krahasuese Shqipëri-Kosovë. Vështrim i posaçëm për viktimat e trafikuar

Dokt. Besim Kelmendi

PROKUROR SPECIAL NË PROKURORINË SPECIALE TË REPUBLIKËS
 SË KOSOVËS; LIGJËRUES NË KOLEGJIN UNIVERSITAR "BIZNESI"
 PRISHTINË, DOKTORANT NË UET

Abstrakt

*I*dëmtuari dhe pozita e tij në procedurën penale në vitet e fundit ka zënë një vend më rëndësi në legjislacionet e Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës. Kjo ka ndodhur jo vetëm si pasojë e zhvillimeve të brendshme të këtyre dy shteteve, por edhe si pasojë e ndikimeve të akteve ndërkombëtare ligjore, të cilat për çdo ditë e më tepër po bëhen pjesë e legjislacioneve kombëtare.

Qëllimi i këtij punimi është vënia në pah e pozitës së të dëmtuarit në procedurën penale, sipas Kodeve të procedurës penale të Shqipërisë dhe Kosovës, në aspektin krahasimor, bazuar në kuadrin ligjor që rregullon të drejtat e të dëmtuarit në procedurën penale të dy vendeve.

Të drejtat e të dëmtuarve në një procedim penal janë pjesë e të drejtave të njeriut që rezultojnë nga dispozitat kushtetuese të vendeve reciproke si dhe nga normat ndërkombëtare juridike, të cilat çdo ditë e më tepër pasurohen me qasje të reja për sa i përket avancimit të të drejtave të njeriut në përgjithësi dhe të dëmtuarve nga krimi në veçanti. Trajtimi i të drejtave të të dëmtuarve në këtë punim përfshinë fazën e hetimit, fazën e akuzës, fazën e gjykimit dhe fazën e apelimit, duke përfshirë edhe çështjen e kompensimit si njërin ndër çështjet më të rëndësishme për të dëmtuarit në një procedim penal. Andaj këto të drejta në këtë punim do të trajtohen në kuadër të disa grupeve të të drejtave dhe ato: si të drejta për tu informuar, të drejta për të vepruar dhe të drejta për shpërblim apo kompensim. Gjithashtu në këtë punim në pika të shkurtra do të jepet një vështrim i veçantë, lidhur me të drejtat e viktimave të trafikuar dhe të krimeve të kryera në vitet e fundit.

Edhe pse Shqipëria dhe Kosova i përkasin një territori etnik shqiptar, sistemet juridike të këtyre dy vendeve kanë ndryshuar dhe vazhdojnë që të jenë të ndryshme në shumë fusha dhe në këtë rast edhe për sa i përket pozitës së të dëmtuarve në procedurën penale. Këto ndryshime në vend që të zvogëlohen, ato janë rritur edhe me tepër pas nxjerrjes së Kodit të ri të procedurës penale të Republikës së Kosovës.

Pavarësisht ndryshimeve procedurale, të dy vendet i kanë kushtuar vëmendje të rëndësishme të drejtave të dëmtuarve, duke parashikuar dispozita ligjore të veçanta jo vetëm në Kodet e tyre të procedurës penale, por edhe në vetë Kushtetutat e tyre dhe në ligjet e veçanta që rregullojnë çështje që kanë të bëjnë me të drejtave të dëmtuarve.

Konsideroj se ky punim është një rast i mirë që të promovohet gasja e studimeve krahasimore Shqipëri- Kosovë edhe në fushën e procedurës penale, në mënyrë që studiuesit, por edhe studentët, të kenë mundësi më të mëdha, për të njohur sistemet apo procedurat e dy vendeve dhe si rezultat i kësaj të marrin nga këto sisteme, anët më të mira të tyre, për të qenë në një hap më të përparuar gjatë rrugëtimit për integrimet kombëtare dhe Evropiane.

Fjalë kyç: *I dëmtuari (akuzues), Kodi i Procedurës Penale, viktimat të trafikimit, sistem ligjor.*

Hyrje

Koncepti i të dëmtuarit është shumëdimensional dhe kompleks, në këtë koncept përfshihen viktimat e krimit dhe kundërvajtjeve penale dhe ngjarjeve të tjera që mund të kualifikohen si vepra penale. Rëndësia e të drejtave të dëmtuarve rezulton edhe nga Kushtetutat e Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës. Prandaj sipas Kushtetutës së Shqipërisë kushdo ka të drejtë të rehabilitohet ose të zhdëmtohet në përputhje me ligjin, në rast se është dëmtuar për shkak të një akti, veprimi ose mosveprimi të paligjshëm të organeve shtetërore¹, ndërsa sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës, çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me këtë Kushtetutë ose me ligj, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur².

I dëmtuari është një person që vuan nga ndonjë e keqe, apo ndonjë forcë ose dhunë. I dëmtuari mund të dëmtohet fizikisht, moralisht dhe materialisht. Në të gjitha këto raste i dëmtuari është subjekt pasiv³. Kjo nuk do të thotë se i dëmtuari do të jetë pasiv edhe gjatë zhvillimit të procedimit penal, sepse siç do të shihet më poshtë ai ka një rol mjaft aktiv gjatë tërë procedimit penal.

¹ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 44, miratuar më Ligjin nr.8417, dt.21.10.1998, me ndryshimet deri me drr.18.09.2012

² Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 54, 2008, Prishtinë

³ Šeparović, Z, 1985, Viktimologija, studije o žrtvama, Tiskara, Zagreb, 40.

Edhe pse sipas Kodit të Procedurës penale të Republikës së Shqipërisë nuk është dhënë definimi i shprehjes “i dëmtuar”, në kreun e VI-shtë të këtij Kodi, që ka të bëjë me të dëmtuarin, paditësin dhe të paditurin civil, kur flitet për të drejtat e të dëmtuarit mund të nxjerrësh konkluzione se i dëmtuari është personi i cili është dëmtuar nga kryerja e veprës penale.⁴ Kodi i procedurës penale të Republikës së Kosovës çështjen e përkufizimeve, e ka rregulluar në një dispozitë të veçantë duke shpjeguar shprehjet e përdorura në këtë kod, sipas këtij Kodi shprehja “I dëmtuar ose viktimat” nënkupton - personin të cilit çfarëdo e drejte personale ose pasurore i është shkelur ose i është rrezikuar me veprën penale⁵.

Nga të dy Kodet e lart cekura rezulton se shprehja i dëmtuar apo viktimë nënkupton personin që është i dëmtuar nga kryerja e veprës penale dhe ky dëm përfshin dëmin fizik, moral apo material. Në këtë rast vlen të theksohet se dëmi nënkupton - dëmin që drejtpërdrejtë apo në mënyrë të tërthortë rezulton nga një veprim kriminal, duke përfshirë humbjen e pronës, humbjen e fitimit, heqjen e lirisë, dëmtimin fizik, dëmtimin psikik apo humbjen e jetës së bashkëshortit ose anëtarit të familjes së afërme, ndërsa shuma e dëmit do të vërtetohet nga përfaqësuesi i të dëmtuarit, mbrojtësi i viktimave apo prokurori i shtetit⁶.

Një përkufizim i ngjashëm për të dëmtuarin është bërë edhe më Deklaratën e Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat Themelore të Viktimave të Krimit dhe Keqpërdorimit të Pushtetit, sipas të cilës viktimat nënkuptojnë personat të cilët, individualisht apo në mënyrë kolektive kanë pësuar lëndime, duke përfshirë këtu edhe lëndimet fizike apo mentale pësimet emocionale, humbjet ekonomike apo keqësimin substancial të të drejtave të tyre themelore, nëpërmjet kryerjes së veprimeve apo moskryerjes së tyre, të cilat paraqesin shkelje të ligjeve penale në fuqi në kuadër të shteteve anëtare, duke përfshirë edhe ligjet të cilat ndikojnë në keqpërdorimin e pushtetit⁷. Siç mund të shihet në Kodin e Procedurës Penale të Republikës së Kosovës jepet kuptimi i dy shprehjeve “i dëmtuar” dhe “viktimë” si dy shprehje me të njëjtin kuptim, mirëpo, edhe pse këto dy shprehje në diskutimet juridiko-politike dhe në opinionin e përgjithshëm përdoren si sinonime, në fjalorin politik shprehja emocionale “viktimë” ka përparësi para shprehjes profesionale “i dëmtuar”, mirëpo shprehja “viktimë” është më tepër e natyrës materialo-juridike dhe kriminologjike, ndërsa shprehja “i dëmtuar” e natyrës proceduralo-juridike⁸. Në mungesë të përkufizimit të shprehjes “i dëmtuar” në Kodin shqiptar ne mund të themi se personi i dëmtuar mund të konsiderohet i dëmtuar pavarësisht nëse është identifikuar, kapur, ndjekur ose dënuar autori i veprës penale.

⁴ Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë, 2004. neni 58 paragrafi 1,

⁵ Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës, 2013, neni 19 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7

⁶ Po aty, neni 19 paragrafi 1 nënparagrafi 1.14

⁷ Deklaratën e Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat Themelore të Viktimave të Krimit dhe Keqpërdorimit të Pushtetit, 1985

⁸ Kai-Yuan, W, 2007, Die Rechtsstellung des Verbrechenopfers im staatlichen Strafverfahren am Beispiel der Nebenklage, Frankfurt am Main (u.a.), Lang, 7, sipas Šeparović, Z, 1985, Viktimologija, studije o žrtvama, Tiskara, Zagreb.

Nisur nga ndryshimet e bëra në Kodin e procedurës penale të Republikës së Kosovës, i cili ka hyrë në fuqi më 1 janar 2013, mund të nxjerrë konstatimin se roli i të dëmtuarit në procedurën penale është më i fuqishëm dhe i barabartë me palët e tjera në kuptimin e realizimit të të drejtave procedurale, pasi që ky kod bën barazimin e të dëmtuarit me palët e tjera, duke theksuar se i dëmtuari ka të drejtë dhe i lejohet të bëjë deklaratë për të gjitha faktet dhe provat që ndikojnë në të drejtat e tij dhe ka të drejtë për të bërë deklaratë mbi të gjitha faktet dhe provat. Ai ka të drejtë të marrë në pyetje dëshmitarët, t'u parashtrijë pyetje të tërthorta dëshmitarëve të palës tjetër dhe të kërkojë nga prokurori i shtetit që të thirren dëshmitarët⁹, ndërsa te kuptimi i shprehjes "Palë në procedure" përfshihen - prokurori i shtetit, i pandehuri dhe i dëmtuari¹⁰. Edhe pse Kodi i procedurës penale të Republikës së Kosovës ka parashikuar dispozitë të veçantë për barazimin e palëve - pra edhe të dëmtuarit, ky Kod nuk parashikon një të drejtë thelbësore që kishte i dëmtuari më Kodin e procedurës penale të Kosovës të vitit 2004, sipas të cilit ishte parashikuar e drejta e të dëmtuarit që në rastet kur prokurori hiqte dorë nga ndjekja penale ai e kishte për detyrë që të njoftonte të dëmtuarin i cili kishte afat ligjor prej 8 ditësh, që të vetë të ndërmerre ndjekjen penale (i dëmtuar akuzues siç parashikohet me Kodin e Shqipërisë) dhe kishte të njëjtat të drejta që i kishte prokurori, përveç atyre që i kishte prokurori si organ shtetëror¹¹. Kjo mund të duket si një cenim i të drejtës së të dëmtuarit, mirëpo në realitet i dëmtuari edhe pse me Kodin e vitit 2013, nuk e ka të drejtën e ndjekjes penale (akuzimit) ai ka rol aktiv gjatë tërë procedurës penale dhe mund të ndërmarr të gjitha veprimet procedurale për të realizuar të drejtat e tij, sikurse edhe prokurori përveç të drejtave që i takojnë prokurorit si organ shtetëror.

Në vitin 1985, Komiteti i Ministrave i Këshillit të Evropës miratoi Rekomandimin (85) 11 "Mbi Pozicionin e viktimës në kuadrin e të drejtës dhe procedurës penale", sipas të cilit drejtësia penale ka një "Funksion kyç", ajo duhet të plotësojë nevojat dhe të mbrojë interesat e viktimës. Ky funksion është i lidhur drejtpërdrejtë me rritjen e besimit të viktimave në sistemin e drejtësisë penale dhe inkurajimin e pjesëmarrjes së tyre si dëshmitarë në këtë sistem.

Të drejtat e të dëmtuarve sipas Kodeve të procedurës penale në Shqipëri dhe Kosovë

Vështrim i përgjithshëm

Përderisa me Kodin e procedurës penale të Republikës së Shqipërisë të drejtat e të dëmtuarit janë parashikuar në mënyrë më të përgjithësuar, siç janë: e drejta e

⁹ Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës, 2013, neni 9 paragrafi 3.

¹⁰ Po aty, neni 19 paragrafi 1 nënparagrafi 1.15.

¹¹ Kodi i Procedurës Penale i Kosovës, 2004, neni 62.

të dëmtuarit që të kërkojë procedimin e fajtorit dhe shpërblimin e dëmit, qoftë vetë qoftë nëpërmjet përfaqësuesit ligjor të tij, të parashtrijë kërkesa në organin procedues dhe të kërkojë marrjen e provave, ndërsa kur kërkesa e tij nuk pranohet nga prokurori, ai ka të drejtë të ankohet në gjykatë brenda 5 ditëve nga marrja në dijeni¹². Po sipas këtij Kodi të Shqipërisë, në rastet që një person është i dëmtuar nga veprat penale të parashikuara nga nenet 90, 91, 92, 112 paragrafi i parë, 119, 119/b, 120, 121, 122, 125, 127, 148, 149 dhe 254 të Kodit Penal, ai ka të drejtë që të paraqesë edhe kërkesë në gjykatë dhe të marrë pjesë në gjykim si palë për të vërtetuar akuzën dhe për të kërkuar shpërblimin e dëmit¹³. Kur janë në pyetje: i dëmtuari akuzues, paditësi civil dhe i padituri civil, ata kanë të drejtë të përfaqësohen në procedim, nëpërmjet përfaqësuesit ligjor ose një përfaqësuesi të pajisur me prokurë. Në Kodin e Procedurës penale të Republikës së Kosovës, të drejtat e të dëmtuarit, janë parashikuar në mënyrë më taksative, duke numëruar si të drejta: të drejtën që të trajtohet me respekt nga policia, prokurorët, gjyqtarët ose organi tjetër që zbaton procedurën penale, të drejtën e kontaktimit me policinë dhe prokurorinë ose organi tjetër që zbaton procedurën penale në mënyrë të arsyeshme dhe të drejtën që këto organe ta informojnë atë që është palë e dëmtuar, të drejtën që të trajtohet në cilësinë e palës në procedurë penale dhe të drejtën në kompensimin e arsyeshëm të urdhëruar nga gjykata prej të pandehurit ose të pandehurve, që kanë pranuar ose janë shpallur fajtor për dëmin material, fizik dhe emocional të shkaktuar nga kryerja e veprës penale, për të cilën i pandehuri ose të pandehurit janë shpallur fajtorë, si dhe të drejtën kur gjykata nuk mund të urdhërojë kompensimin nga i pandehuri apo të pandehurit për shkak të pamundësisë së tyre për të paguar, mungesën e kompetencës së gjykatës ose vdekjes, i dëmtuari të kërkojë nga gjykata që të dërgojë urdhrin për kompensim te koordinatori i fondit për kompensimin e viktimave¹⁴. Gjithashtu sipas këtij Kodi, i dëmtuari ka të drejtë që të përfaqësoj vetën apo të përfaqësohet nga mbrojtësi që është anëtar i Odës së Avokatëve të Kosovës ose të përfaqësohet nga mbrojtësi i viktimave¹⁵.

E drejta për t'u informuar

E drejta për tu informuar për rastin penal nënkupton të drejtën e të dëmtuarit që ai të dijë se pse është thirrur, pse është para organeve që zhvillojnë procedurën, dhe cila është pozita e tij ose e saj në atë çështje penale, duke përfshirë këtu edhe të drejtën që të informohet edhe për të drejtat që i takojnë gjatë procedurës penale. Sa i përket të drejtës së të dëmtuarit për tu informuar, Kodet e procedurës penale të Republikës së Shqipërisë dhe të Republikës së Kosovës kanë ngjashmëri por

¹² Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë, 2004 i azhurnuar më 2008, neni 58.

¹³ Po aty, neni 59 paragrafi 1.

¹⁴ Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës, 2013, neni 62.

¹⁵ Po aty, neni 63.

edhe mjaft dallime. KPP i Republikës së Shqipërisë ka parashikuar disa raste kur i dëmtuari informohet gjatë procedurës penale të cilat do të paraqiten në vijim:

Njoftimet për personin e dëmtuar nga vepra penale bëhen njëjloj si për rastet kur njoftohet për herë të parë i pandehuri i lirë, ndërsa nëse nuk dihen vendet e treguara në nenin 140 (në banesën e tij ose në vendin e punës), njoftimi bëhet me depozitim e aktit në sekretari. Kur nga aktet del se vendbanimi ose vendqëndrimi i tij ndodhen jashtë shtetit, i dëmtuari ftohet me anën e letrës rekomanduese me lajmërim marrje, me të cilën të deklarojë ose të zgjedhë banesën në territorin e shtetit shqiptar, ndërsa kur pas njëzet ditëve nga marrja e letrës rekomande nuk bëhet deklarimi ose zgjedhja e banesës, njoftimi bëhet me anën e depozitimit të aktit në sekretari¹⁶.

Kur njoftimi i personave të dëmtuar është i vështirë për shkak të numrit të tyre ose pamundësisë së identifikimit të disave prej tyre, gjykata mund të urdhërojë që ai të bëhet nëpërmjet shpalljes publike dhe njoftimi quhet i bërë kur fituesi i gjykatës depoziton në sekretari një kopje të aktit bashkë me dokumentet që vërtetojnë shpalljen publike¹⁷. Në këtë rast konsideroj se është i pranueshëm qëndrimi i kësaj dispozite kur njoftimi nuk mund të bëhet për shkak të pamundësisë së identifikimit të disa prej të dëmtuarve, mirëpo nuk mund të jetë i pranueshëm qëndrimi lidhur me rastin kur është numri i madh i të dëmtuarve, sepse kjo është në kundërshtim me parimin se çdo person ka të drejtë për tu informuar personalisht me shkresat nga pranimi ose mos pranimi i tyre rrjedhin pasoja juridike. Nëse është në pyetje shqyrtimi gjyqësor, kryetari urdhëron thirrjen e të dëmtuarit, duke respektuar një afat jo më të vogël se pesë ditë¹⁸. Kjo e drejtë nënkupton detyrimin e gjykatës që së paku 5 ditë para ditës kur i dëmtuari duhet të paraqitet në gjykatë ti dorëzojë të dëmtuarit thirrjen. Afati prej 5 ditësh në praktikën gjyqësore paraqet një problem serioz, për shkak se pothuajse është e pamundur që thirrjet të dërgohen përsëri në rastet kur thirrja nuk ka pasur mundësi që ti dorëzohet të dëmtuarit 5 ditë më herët se dita e fillimit të shqyrtimit gjyqësor. Sipas Kodit të procedurës penale të Republikës së Kosovës janë parashikuar shumë më tepër raste kur policia, prokuroria apo gjykata kanë detyrim që të informojnë të dëmtuarin gjatë procedurës penale qoftë për të drejtat, qoftë për detyrimet e tij dhe në vijim do të jepen detyrimet e këtyre organeve proceduese.

Detyrimi i policisë për të informuar të dëmtuarin

Me rastin e mbledhjes së të dhënave nga i dëmtuari, policia ka për detyrë që të informojë të dëmtuarin për të drejtat e tij (shih këto të drejta të vështirimi i përgjithshëm, për të drejtat e të dëmtuarit) dhe me kërkesën e të dëmtuarit, ka për detyrë të njoftojë Njësinë për Mbrojtje të Viktimave¹⁹.

¹⁶ Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë 2004, i azhurnuar më 2008, neni 137 paragrafi 1.

¹⁷ Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë 2004, i azhurnuar më 2008, neni 138 paragrafi 1 dhe 2.

¹⁸ Po aty, neni 376 paragrafi 2.

¹⁹ Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës, 2013, neni 77 paragrafi 1.

Detyrimi i prokurorisë për të informuar të dëmtuarin

Prokurori i shtetit ka për detyrë që të njoftojë të dëmtuarin dhe mbrojtësin e viktimave me shkrim, pesë (5) ditë më herët, lidhur me datën, kohën dhe vendin ku do të merret deklarata në procedurë paraprake²⁰, kjo paraqet njëkohësisht jo vetëm detyrimin e prokurorit të shtetit, por edhe të drejtën e të dëmtuarit për tu informuar me këto të drejta dhe siç mund të shihet Kodi i Kosovës ka parashikuar në shumicën e rasteve një afat 5 ditor që duhet të jetë më herët se dita kur i dëmtuari duhet të paraqitet para organit procedues, në këtë rast para prokurorit. Gjatë hetimit, i dëmtuari mund të kërkojë nga prokurori i shtetit që të marri ose të ruajë provat të cilat mund të tregonin apo ka arsye të pritët që provat e tilla do të tregonin demin e shkaktuar me vepër penale, dhembjen apo vuajtjen e pësuar nga viktimat, apo shpenzimet e tjera të ndërlidhura me vepër penale²¹, ndërsa në rastet e ekspertimit raporti i ekspertit i zbulohet të dëmtuarit jo më pak se pesë (5) ditë para fillimit të seancës për deklaratë në procedurë paraprake nga eksperti, por jo më vonë se dhjetë (10) ditë pasi që prokurori i shtetit të ketë pranuar raportin e ekspertit²².

Për sa i përket dëshmitarëve dhe mbikëqyrjes apo rekonstruktimit të vendit të ngjarjes, i dëmtuari gjithmonë njoftohet kur dhe në cilin vend do të merret në pyetje dëshmitari apo do të zbatohet mbikëqyrja ose rikonstruksioni dhe njoftohet se ka të drejtë të jetë i pranishëm në këto veprime²³. Gjithashtu i dëmtuari, përfaqësuesi i tij ligjor apo përfaqësuesi i autorizuar, ose mbrojtësi i viktimës kanë të drejtë të shikojnë, kopjojnë ose fotoqojnë shkresat dhe provat materiale që i disponon gjykata ose prokurori i shtetit nëse ka interes legjitim për të bërë një gjë të tillë dhe konsideroj se kjo është një ndër të drejtat më thelbësore që lidhet me të drejtën për tu informuar, sepse duke e realizuar këtë të drejtë, i dëmtuari vë në mundësi të drejtpërdrejtë që të shikoj vetë provat e siguruar nga prokurori e që, lidhen me rastin penal ku ai është i dëmtuar.

Duke marrë parasysh, se Kodi i procedurës penale i Republikës së Kosovës, ka parashikuar mundësinë e arritjes së marrëveshjes për pranimin e fajësisë, si një mënyrë alternative të zhvillimit të procedurës penale, në këto raste prokurori i shtetit është i detyruar që të informojë të dëmtuarin për marrëveshjen e arritur, pasi që marrëveshja të jetë në formën përfundimtare²⁴. Arritja e marrëveshjes në mes të prokurorit dhe të pandehurit së bashku me mbrojtësin e tij, nuk varet nga vullneti i të dëmtuarit, mirëpo ai nuk i humb të drejtat e tij, për të paraqitur mjetin juridik kundër vendimit gjyqësor, në rast se gjykata e miraton marrëveshjen e arritur në mes prokurorit dhe të pandehurit me mbrojtësin e tij.

²⁰ Po aty, neni 132 paragrafi 6.

²¹ Po aty, neni 119 paragrafi 5.

²² Po aty, neni 138 paragrafi 4.

²³ Po aty, neni 343 paragrafi 2.

²⁴ Po aty, neni 233 paragrafi 8.

Detyrimet e gjykatës për të informuar të dëmtuarin

Të drejtat e të dëmtuarit në procedurën penale jo vetëm që zbatohen por edhe mbikëqyrjen nga gjykata gjatë tërë procedurës penale, pra në fazën fillestare të hetimit, në fazën e hetimit formal si dhe në fazën pas ngritjes së akt-akuzës e deri në marrjen e vendimit përfundimtar, sepse i dëmtuari gjatë të gjitha fazave të procedurës penale e ka të drejtën që të paraqesi ankesë apo kundërshtim, nëse i shkelen të drejtat e tij, andaj gjykata detyrohet të njoftojë të dëmtuarin për të drejtat që i përkasin sipas Kodit të procedurës penale, si dhe për pasojat e mosveprimit të tij nëse ai, për shkak të mosdijes, nuk ndërmer veprimin e duhur në procedurë ose i nuk shfrytëzon të drejtat e tij.²⁵

Në shqyrtimin gjyqësor gjykata thërret të dëmtuarin dhe përfaqësuesit e tij ligjor apo përfaqësuesin e autorizuar. Përmes kësaj thirrje gjykata e njofton të dëmtuarin, i cili nuk thirret si dëshmitar, se shqyrtimi gjyqësor do të mbahet edhe pa praninë e tij dhe se deklarata e tij për kërkesën pasurore juridike do të lexohet²⁶. Gjykata e ka për detyrë që të njoftojë të dëmtuarin për kohën dhe vendin e marrjes në pyetje, nëse kjo është e mundshme, duke pasur parasysh ngutën e procedurës²⁷. Pra, gjykata ka mundësinë që në rastet kur nevojiten veprime të ngutshme, të mos e bëjë këtë njoftim dhe të konsiderojë se ky veprim i gjykatës do të ishte në kundërshtim me të drejtat e të dëmtuarit nëse gjykata pas tejkalimit të situatës së ngutshme nuk e njofton të dëmtuarin për këtë të drejtë, ndërsa është shqetësuese edhe vetë fakti se si do të vlerësohet ngutia e procedurës dhe çka nënkupton kjo nguti.

Në rastet kur i dëmtuari është i pranishëm në gjykatë dhe ende nuk ka paraqitur kërkesën pasurore juridike, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues e ka për detyrë që të udhëzojë të dëmtuarin se, mund të paraqesë propozim për realizimin e kësaj kërkesë në procedurën penale²⁸. Një risi mjaft e rëndësishme për të dëmtuarin është edhe mundësia e tij që në shqyrtimin gjyqësor të paraqesi fjalët hyrëse, si një teknikë e re e zhvillimit të përfaqësimit në gjykatë dhe në këtë rast nëse i pandehuri nuk e pranon fajësinë në fillim të shqyrtimit gjyqësor, gjyqtari i vetëm gjykues apo kryetari i trupit gjykues thërret apo njofton të dëmtuarin për të përmbledhur provat që mbështesin rastin apo kërkesën e tij²⁹. Fjala hyrëse nënkupton mundësinë e parë të të dëmtuarit në shqyrtimin gjyqësor që të paraqesi provat që shkojnë në favorin e tij, duke i treguar gjykatës se cilat janë ato prova edhe vizualisht. I dëmtuari e ka të njëjtën të drejtë edhe për sa i përket njoftimit nga gjykata për të paraqitur fjalën përfundimtare, ku i dëmtuari duke u bërë analizë provave të administruara në shqyrtimin gjyqësor argumenton tezen e tij lidhur me çështjen e tij penale. Në fund i dëmtuari ka të drejtë që të njoftohet me përfundimin e shqyrtimit gjyqësor apo vendimit në gjykatën e apelit dhe kjo

e drejtë realizohet në atë mënyrë që kopja e vërtetuar e akt-gjykimit, së bashku me udhëzimin për të drejtën në ankesë i dërgohet të dëmtuarit³⁰ dhe në këtë rast i dëmtuari mund të ushtrojë ankesë ndaj akt-gjykimit vetëm për vendimin e gjykatës lidhur me sanksionet penale për veprat penale kundër jetës dhe trupit, kundër integritetit seksual, kundër sigurisë së trafikut publik dhe për shpenzimet e procedurës penale³¹.

E drejta për të vepruar gjatë procedurës penale

Gjatë procedurës penale i dëmtuari jo vetëm që ka të drejtën për të qenë i informuar për të drejtat e tij, por ai e ka të drejtën edhe për të ndërmarr veprime të caktuara, për të realizuar të drejtat e tij që i takojnë sipas kodit të procedurës penale dhe këto veprime mund ti ushtrojë qoftë vetë, qoftë nëpërmjet trashigimtarëve apo përfaqësuesit të tij ligjor. Sipas Kodit të procedurës penale të Republikës së Shqipërisë, njëra ndër të drejtat e të dëmtuarit është edhe e drejta e tij që të paraqesë kërkesën në organin procedues për procedimin e fajtorit dhe shpërblimin e dëmit dhe të kërkojë marrjen e provave, ndërsa kur kërkesa e tij nuk pranohet nga prokurori, ai ka të drejtë të ankohet në gjykatë brenda 5 ditëve nga marrja në dijeni³² se kërkesa e tij nuk është pranuar. Kjo e drejtë i ofron siguri të dëmtuarit, sepse në rastin kur prokurori nuk e pranon kërkesën e tij ai mund ti drejtohet gjykatës që të vendos për këtë, pra gjykata është ajo që mbikëqyr realizimin e kësaj të drejte. Në rastet kur i dëmtuari është në rolin e akuzuesit për veprat penale të parashikuara nga nenet 90, 91, 92, 112 paragrafi i parë, 119, 119/b, 120, 121, 122, 125, 127, 148, 149 dhe 254 të Kodit Penal, ai ka të drejtë të paraqesë kërkesën në gjykatë dhe të marrë pjesë në gjykim si palë për të vërtetuar akuzën dhe për të kërkuar shpërblimin e dëmit³³. Siç mund të shihet i dëmtuari mund të jetë si akuzues vetëm kur janë në pyetje veprat penale të lart cekura e jo edhe për veprat e tjera penale dhe në këto raste ai paraqitet në gjykatë si palë dhe e ka të drejtën që të ndërmarr veprimet për të vërtetuar akuzën dhe për të kërkuar shpërblimin e dëmit si një e drejtë thelbësore për të dëmtuarin.

Lidhur me të drejtën e lartcekur vlen të përmendet edhe vendimi i gjykatës kushtetuese për interpretimin e nenit 73, paragrafi 2 i kushtetutës që lidhet me zbatimin e nenit 59 të Kodit të procedurës penale të Republikës së Shqipërisë dhe sipas këtij interpretimi *kërkesa për marrjen e autorizimit për ndjekjen penale të personave që gëzojnë imunitet i drejtohet Kuvendit të Republikës së Shqipërisë nga vetë gjykata, pranë së cilës është depozituar kërkesa e të dëmtuarit akuzues dhe në arsyetimin e këtij vendimi thuhet se: "fillimi i ndjekjes penale është në kompetencë të gjykatës",*

²⁵ Po aty, neni 16.

²⁶ Po aty, neni 287 paragrafi 1 dhe 2.

²⁷ Po aty, neni 290 paragrafi 2.

²⁸ Po aty, neni 322 paragrafi 2.

²⁹ Po aty, neni 328 paragrafi 1.

³⁰ Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës, 2013, neni 369 paragrafi 5.

³¹ Po aty, neni 381 paragrafi 3.

³² Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë, 2004 i azhurnuar më 2008, neni 58 paragrafi 1 dhe 3

³³ Po aty, neni 59 paragrafi 1.

“kërkesën për marrjen e autorizimit ka të drejtë ta bëjë vetëm gjykata, pa pasur nevojë për ndihmën ose ndërhyrjen e prokurorit”, “Gjykata e zakonshme është i vetmi organ procedues për veprat penale që ndiqen mbi kërkesën e të dëmtuarit akuzues”, “gjatë gjykimit të këtyre çështjeve prokurori nuk është palë në debatin gjyqësor”³⁴.

E drejta e të dëmtuarit i cili ka pësuar dëme materiale nga vepra penale, apo trashëgimtarit të tij, për të vepruar më qëllim të realizimit të të drejtave të tij gjatë procedurës penale, vjen në shprehje edhe në rastin kur ai paraqet padi civile në procesin penal kundër të pandehurit ose të paditurit civil, për të kërkuar kthimin e pasurisë dhe shpërblimin e dëmit³⁵, ndërsa legjitimimi i paditësit civil mund të bëhet nga organi procedues, derisa të mos ketë filluar shqyrtimi gjyqësor, ndërsa ky afat për legjitimim nuk mund të zgjatet³⁶.

Një e drejtë tjetër mjaft me rëndësi është edhe e drejta e të dëmtuarit si paditës civil për të paraqitur kërkesë të organit procedues, për të vendosur masën e sekuestrimit të pasurisë së të pandehurit ose të të paditurit civil për një kohë deri në përfundimin e çështjes³⁷. Kjo e drejtë mund të konsiderohet njëra ndër të drejtat që i ofrojnë siguri të dëmtuarit, sepse i dëmtuari shumë herë përpara se sa të përfundojnë çështjet penale sigurojnë mundësinë për të marrë shpërblimin për dëmin që i është shkaktuar në veprën penale. Gjithashtu sipas Kodit të Procedurës penale të Shqipërisë i dëmtuari nga vepra penale kur paraqitet si paditës civil, ka të drejtë që të kërkojë nga gjykata që të pandehurin dhe të paditurin civil, ta detyrojë që të paguajnë një shumë të përafërt me dëmin që çmohet se është provuar dhe ky detyrim ekzekutohet menjëherë³⁸. Edhe kjo e drejtë ka një rëndësi të veçantë për paditësin civil, sepse realizimi i kësaj të drejte i mundëson atij që të marrë një shpërblim edhe pa u bërë një saktësim i dëmit.

Në fund një e drejtë fundamentale e të dëmtuarve për të vepruar, sipas Kodit të procedurës penale të Republikës së Shqipërisë është edhe e drejta për të paraqitur ankesë kundër vendimeve të gjykatës, sepse kjo e drejtë i hap rrugën atij që, shqetësimet e tij për realizimin e të drejtave në procedurën penale të shqyrtohen në dy shkallshmëri para gjykatës dhe me këtë garantohet një siguri juridike më madhe të dëmtuari. Të dëmtuarit si akuzues i njihet e drejta të paraqesë ankim vetë ose nëpërmjet përfaqësuesit të tij, si për efekte penale, ashtu dhe për ato civile³⁹, ndërsa paditësi civil mund të bëjë ankim kundër pikave të vendimit të dënimit që kanë të bëjnë me padinë civile dhe në rastin e vendimit të pafajësisë vetëm për efektet e përgjegjësisë civile⁴⁰.

³⁴ Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, vendimi nr.39, dt.23.06.2000.

³⁵ Kodi i procedurës penale i Republikës së Shqipërisë, 2004, i azhurnuar më 2008, neni 61.

³⁶ Po aty, neni 62 paragrafët 1 dhe 2.

³⁷ Po aty, neni 63.

³⁸ Po aty, neni 395 paragrafi 2.

³⁹ Po aty, neni 409.

⁴⁰ Po aty, neni 411 paragrafi 1.

Edhe Kodi i procedurës penale i Republikës së Kosovës, ka parashikuar mjaft të drejta, ku i dëmtuari, përmes veprimeve realizon këto të drejta gjatë tërë procedurës penale. Në vijim do të paraqiten këto të drejta që nga fillimi i hetimit fillestar e deri të faza e ankimit. Kodi i procedurës penale i Kosovës ka mjaft dispozita që e barazojnë të dëmtuarin me palët e tjera në procedurë dhe në këtë kontekst i dëmtuari ka të drejtë dhe i lejohet të bëjë deklaratë për të gjitha faktet dhe provat që ndikojnë në të drejtat e tij. Ai ka të drejtë të marrë në pyetje dëshmitarët, t’u parashtrijë pyetje të tërthorta dëshmitarëve të palës tjetër dhe të kërkojë nga prokurori i shtetit që të thirren dëshmitarët⁴¹. Gjatë hetimit, i dëmtuari mund të kërkojë nga prokurori i shtetit që të marrë ose të ruajë provat të cilat mund të tregonin apo ka arsye të pritët që provat e tilla do të tregonin dëmin e shkaktuar me vepër penale, dhembjen apo vuajtjen e pësuar nga viktimi, apo shpenzimet e tjera të ndërlidhura me vepër penale⁴². Përveç kësaj i dëmtuari ka të drejtë që deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, të propozojë shqyrtimin e fakteve të reja, mbledhjen e provave të reja dhe përsëritjen e propozimeve të cilat gjyqtari i vetëm gjykues, kryetari i trupit gjykues ose trupi gjykues më herët i ka refuzuar⁴³. Siç mund të shihet i dëmtuari sipas këtij Kodi nuk e ka vetëm rolin e vëzhguesit të procedimit penal, por përkundrazi ka rol aktiv gjatë tërë procedimit.

Një ndër të drejtat që ja mundëson një rol aktiv të dëmtuarit gjatë procedurës penale është edhe e drejta e tij që të merr deklaratë nga dëshmitari, prandaj nëse i dëmtuari apo mbrojtësi i tij ka kërkuar që të merret deklarata në procedurë paraprake nga dëshmitari, atëherë së pari ai apo mbrojtësi i tij merr në pyetje ata dëshmitarë⁴⁴. Kjo e drejtë tregon se i dëmtuari është plotësisht i barabartë me palët e tjera në procedurë, sepse secila palë ka të drejtën që të merr deklarata nga dëshmitari, sipas rendit të përcaktuar me Kod e që nënkupton se deklaratën nga dëshmitari e merr i pari ai që e ka propozuar atë dëshmitar. I dëmtuari edhe pas caktimit të shqyrtimit gjyqësor mund të kërkojë që në shqyrtim gjyqësor të thirren dëshmitarë dhe ekspertë të rinj ose të mbledhen prova të reja. Kërkesa e palëve duhet të jetë e arsyetuar dhe të shënojë se cilat fakte duhet provuar dhe me cilat prova të propozuara⁴⁵.

Edhe kur është në pyetje ekspertimi, i dëmtuari ka mjaft të drejta që mund ti realizoj përmes kërkesave që i parashtron te organi procedues, pasi që i dëmtuari ose mbrojtësi i tij mund të kërkojë nga prokurori i shtetit që të marrë deklaratë nga eksperti⁴⁶, por gjithashtu i dëmtuari apo mbrojtësi i tij mund të kundërshtojë përzgjedhjen e ekspertit nga prokurori, bazuar në kualifikimet e tij apo konfliktin potencial të interesit duke paraqitur kundërshtimin tek gjyqtari i procedurës

⁴¹ Kodi i Procedurës penale i Republikës së Kosovës, 2013, neni 9 paragrafi 3.

⁴² Po aty, neni 119 paragrafi 5.

⁴³ Po aty, neni 329 paragrafi 3.

⁴⁴ Po aty, neni 133 paragrafi 4

⁴⁵ Po aty, neni 288 paragrafi 1.

⁴⁶ Po aty, neni 136 paragrafi 3.

paraprake⁴⁷. Kodi i procedurës penale i Republikës së Kosovës ka parashikuar edhe mundësinë hetuese të veçantë, sipas të cilës gjyqtari i procedurës paraprake merr dëshmi nga dëshmitari ose kërkon ekspertizë me qëllim të ruajtjes së provës, kur ekziston një mundësi e veçantë për marrjen e provës së rëndësishme ose kur ka rrezik të konsiderueshëm se kjo provë nuk do të mund të merrej gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe që në kuadër të kësaj i është njohur e drejta e të dëmtuarit dhe e mbrojtësit të tij, ku mund të paraqesë kërkesë të gjyqtari dhe të ketë një hetim të veçantë⁴⁸.

Është shumë me rëndësi një e drejtë që për herë të parë është parashikuar në të drejtën e procedurës penale në Kosovë, që ka të bëjë më të drejtën e të dëmtuarit për të kërkuar vazhdimin e paraburgimit. Këtë të drejtë i dëmtuari apo mbrojtësi i viktimave mund ta realizojë përmes një kërkesë formale apo joformale që i drejtohet prokurorit të shtetit⁴⁹. Edhe me Kodin e procedurës penale të Kosovës, sikurse dhe me Kodin e procedurës penale të Shqipërisë i dëmtuari mund të kërkojë nga prokurori i shtetit që të marrë prova të caktuara të cilat gjenden jashtë Kosovës dhe nëse prokurori i shtetit refuzon kërkesën për marrjen e provës, ai merr akt-vendim të arsyetuar dhe njofton të dëmtuarin, përfaqësuesin e autorizuar të palës së dëmtuar ose mbrojtësin e viktimës, të cilët mund të ankohen te gjyqtari i procedurës paraprake ndaj akt-vendimit të tillë .

Kur është në pyetje marrëveshja për pranimin e fajësisë si një ndër mënyrat alternative të procedurës penale në Kosovë, ku prokurori i shtetit dhe mbrojtësi mund të negociojnë kushtet e marrëveshjes së shkruar për pranimin e fajësisë, në bazë të së cilës i pandehuri dhe prokurori i shtetit pajtohen për akuzat e përfshira në akt-akuzë dhe i pandehuri pajtohet të pranojë fajësinë në shkëmbim për: pajtimin e prokurorit të shtetit që t'i rekomandojë gjykatës dënimin më të butë, por jo nën minimumin e paraparë me ligj ose minimumin e përcaktuar në Kod ose konsiderime tjera në interes të drejtësisë, siç është lirimi nga dënimi. Në këtë rast prokurori i shtetit informon të dëmtuarin për marrëveshjen e arritur, pasi që marrëveshja të jetë në formën përfundimtare dhe kur i dëmtuari ka paraqitur kërkesë pasurore juridike që rrjedh nga vepra penale e cekur në akt-akuzë, marrëveshja mbi pranimin e fajësisë duhet ta adresojë kërkesën e të dëmtuarit dhe prokurori i shtetit duhet të njoftojë të dëmtuarin se i pandehuri kërkon të arrijë marrëveshje mbi pranimin e fajësisë. Të dëmtuarit duhet t'i jepet rasti që t'i paraqesë deklaratë gjykatës mbi kërkesën e tillë pasurore juridike para se gjykata ta pranojë marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë⁵⁰. Siç është theksuar më lartë i dëmtuari përveç që ka të drejtë të jap fjalën hyrëse, pra vetëm prezantimin e provave që do të shqyrtohen në shqyrtimin gjyqësor, ai ka të drejtë që pas administrimit të provave në shqyrtimin gjyqësor të paraqesë edhe fjalën

përfundimtare apo përmbyllëse, sikurse edhe prokurori dhe i akuzuari me mbrojtësin e tij dhe në këtë rast i dëmtuari në fjalën e tij përfundimtare mund të shpjegojë kërkesën e tij pasurore juridike dhe potencon provat që ndërlidhen me përgjegjësinë penale të të akuzuarit⁵¹.

Sikurse Kodi i procedurës penale të Shqipërisë edhe Kodi i procedurës penale të Kosovës, i njeh të dëmtuarit të drejtën e ankimit kundër akt-gjykimit dhe atë, vetëm për vendimin e gjykatës lidhur me sanksionet penale, për veprat penale kundër jetës dhe trupit, kundër integritetit seksual, kundër sigurisë së trafikut publik dhe për shpenzimet e procedurës penale⁵². Pra, siç mund të shihet se edhe me Kodin e Kosovës i dëmtuari e ka këtë të drejtë vetëm për vepra të caktuara penale dhe vetëm për shkak të vendimit të gjykatës për sanksionet penale.

Në fund një e drejtë që nuk është parashikuar me Kodin e Shqipërisë, ndërsa është parashikuar me Kodin e Kosovës është e drejta e të dëmtuarit që merr pjesë në seancën e kolegjit të apelit⁵³, (në të cilën nuk bëhet shqyrtimi i provave siç bëhet në shkallën e parë) dhe në shqyrtimin gjyqësor (në të cilën vlejnjë rregullat e njëjta si në shqyrtimin gjyqësor në shkallë të parë) në gjykatën e apelit, në të cilën mund të paraqitet prova dhe faktet e reja⁵⁴, që nënkupton shqyrtimin e provave siç bëhet në shkallën e parë.

E drejta në shpërblim apo kompensim të dëmit

E drejta e të dëmtuarit për kompensim, për dëmin që i është shkaktuar nga kryerja e veprës penale, mund të trajtohet në një vështrim shumë të gjerë, varësisht se cili është dëmi i shkaktuar dhe varësisht nga vepra penale me të cilën është shkaktuar dëmi, mirëpo në këtë punim kjo e drejtë do të trajtohet vetëm në aspektin proceduralo-penal sipas Kodeve të procedurës penale të Shqipërisë dhe Kosovës. Kompensimi i dëmit nuk është pjesë e dënimit për atë që kryen veprën penale, kjo mund të shihet edhe në rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së kompensimit, i cili kompensohet apo shpërblehet, nuk duhet të jetë as më i madh e as më i vogël, se sa dëmi i shkaktuar me vepër penale. Këtu duhet dalluar kompensimi i dëmit moral nga ai material, ngase i pari është shumë më i vështirë që të caktohet, ndërsa i dyti është më i lehtë për tu përcaktuar, nga fakti se mund të shihet, të llogaritet apo të dokumentohet me provat e tjera materiale apo përmes dëshmitarëve.

E drejta e shpërblimit apo kompensimit të dëmit siç është theksuar më lartë është parashikuar me dy kodet e procedurave penale të Shqipërisë dhe Kosovës, mirëpo këto dy kode edhe pse përdorin shprehje të ndryshme si “shpërblim” me Kodin e Shqipërisë dhe si “kompensim” me Kodin e Kosovës, kjo nuk paraqet

⁴⁷ Po aty, neni 137 paragrafi 2.

⁴⁸ Kodi i Procedurës penale i Republikës së Kosovës, 2013, neni 149 paragrafi 1.

⁴⁹ Po aty, neni 191 paragrafi 1.

⁵⁰ Po aty, neni 233 paragrafët 1 dhe 8.

⁵¹ Po aty, neni 354.

⁵² Po aty, neni 381 paragrafi 1 dhe 3.

⁵³ Kodi i Procedurës penale i Republikës së Kosovës, 2013, neni 390 paragrafi 1.

⁵⁴ Po aty, neni 393 paragrafi 4.

ndonjë vështirësi për tu kuptuar kjo e drejtë e të dëmtuarit. Qasja e shpërblimit apo kompensimit të dëmit për të dëmtuarit me dy kodet e lart cekura është e ndryshme, për shkak të pozitës së të dëmtuarit në procedurën penale në Kosovë dhe në Shqipëri. Prandaj, siç është theksuar më lartë sipas Kodit të procedurës penale të Shqipërisë i dëmtuari mund të realizoj shpërblimin e dëmit qoftë përmes kërkesës për gjykim si i dëmtuar akuzues, qoftë përmes padisë civile në procedim penal, ndërsa sipas Kodit të procedurës penale të Kosovës i dëmtuari mund të ketë të drejtë dhe mund të realizoj përmes propozimit për realizimin e kërkesës pasurore juridike, që nënkupton kompensimin e dëmit.

Sipas Kodit të procedurës penale të Shqipërisë i dëmtuari akuzues mund të kërkoj shpërblimin e dëmit vetëm në ato raste kur në dëm të tij janë kryer veprat penale nga nenet 90, 91, 92, 112 paragrafi i parë, 119, 119/b, 120, 121, 122, 125, 127, 148, 149 dhe 254 të Kodit Penal⁵⁵, ndërsa në rastin e padisë civile në procedim penal i dëmtuari që ka pësuar dëm material nga vepra penale ose trashëgimtarët e tij mund të ngrenë padi civile në procesin penal, kundër të pandehurit ose të paditurit civil, për të kërkuar kthimin e pasurisë dhe shpërblimin e dëmit⁵⁶. Pra, me rastin e padisë civile mund të kërkohet jo vetëm shpërblimi i dëmit por edhe kthimi i pasurisë së fituar më kryerjen e veprës penale. Sipas Kodit të procedurës penale të Kosovës i dëmtuari ka të drejtën për kompensimin e dëmeve që rezultojnë drejtpërdrejtë apo në mënyrë të tërthortë nga vepra penale⁵⁷, ndërsa në rastet e sekuestrimit apo konfiskimit të pasurisë së fituar me kryerjen e veprës penale edhe sipas Kodit të Kosovës, kjo pasuri i kthehet të dëmtuarit pasi që vërtetohet se i takon atij, prandaj kjo paraqet një lloj legjitimitimi që të dëmtuarit siç i kërkohet me Kodin e Shqipërisë në rastin e padisë civile në procedim penal, por që dallon në atë se i dëmtuari sipas Kodit penal nuk paraqet padi civile për kthim të pasurisë apo shpërblim të dëmit, por kërkesë për kompensim të dëmit apo kthim të sendit, që në esencë paraqesin të njëjtën gjë.

Një çështje tjetër me rëndësi për shpërblim apo kompensim të dëmit është edhe çështja e sigurisë për kthimin e pasurisë dhe shpërblimin e dëmit, e cila çështja është rregulluar më mirë me Kodin e Shqipërisë se sa me Kodin e Kosovës, pasi Kodi i Shqipërisë ka parashikuar dispozitë të veçantë lidhur me këtë çështje në të cilën thuhet se organi procedues mund të vendosë sekuestrimin e pasurisë, së të pandehurit ose të të paditurit civil dhe se kjo masë qëndron deri në përfundimin e çështjes⁵⁸, gjithashtu me këtë Kod është parashikuar edhe mundësia që sendet e sekuestruara të ruhen në sekretari. Kur kjo nuk është e mundur ose e përshtatshme, organi procedues urdhëron që ato të ruhen në një vend tjetër, duke përcaktuar mënyrën e ruajtjes⁵⁹. Në Kodin e Kosovës flitet në mënyrë të veçantë për masat

e përkohshme për sigurimin e pasurisë për të cilën kërkohen shpenzime të jashtëzakonshme, për administrimin, mirëmbajtjen, ushqimin apo vendosjen në depo dhe në këtë rast prokurori i shtetit mund të kërkojë masë të arsyeshme që do të minimizonte shpenzimet e jashtëzakonshme por që do të ruante vlerën e pasurisë. Këto masa mund të përfshijnë shitjen e pasurisë për vlerën e saj aktuale në treg, shitjen apo prerjen e bagëtisë ose përpunimin e të lashtëve në produkte për konsum⁶⁰. Në Kosovë ekziston edhe një Agjension i veçantë për menaxhimin e pasurisë së sekuestruar apo konfiskuar, që nënkupton sendet e luajtshme, sendet e paluajtshme, paratë dhe letrat me vlerë të cilat janë në qarkullim juridik, ku e cila çdo agjenci, ruan dhe administron pasurinë e sekuestruar ose të konfiskuar në bashkëpunim me prokurorinë, gjykatën, apo organet e tjera kompetente, në pajtim me ligjin në fuqi, me përjashtim të pasurisë së konfiskuar për realizimin dhe mbledhjen e detyrimeve tatimore⁶¹. Kjo agjenci e ka edhe të drejtën e shitjes së pasurisë së sekuestruar, në rastet kur ajo mund të prishet dhe pastaj paratë nga shitja e asaj pasurie ruhen dhe në fund ku shërbejnë edhe për kompensim të të dëmtuarit. Vendosija për kërkesën dhe për shpërblimin apo kompensimin e dëmit, të dëmtuarit sipas të dy kodeve të lartcekura në procedim penal bëhet vetëm nëse kjo nuk e zvarrit apo vonon vendosjen e çështjes thelbësore penale, pra, vendosjen për fajësinë apo pafajësinë e të pandehurit.

Për sa i përket afateve për paraqitjen e kërkesës apo padisë civile për shpërblim ose kompensim të dëmit, ka dallime në mes të dy kodeve të procedurës penale respektive, sepse sipas Kodit të Shqipërisë afati për legjitimitimin e paditësit civil është deri në fillim të shqyrtimit gjyqësor⁶², ndërsa heqja dorë nga gjykimi i padisë civile mund të bëhet në çdo gjendje dhe shkallë të procedimit me një deklaratë të bërë personalisht nga paditësi ose nga përfaqësuesi i tij, në seancë ose me akt të shkruar e të depozituar në sekretarinë e gjykatës dhe të njoftuar palëve të tjera⁶³. Sipas Kodit të Kosovës, propozimi për realizimin e kërkesës pasurore-juridike mund të paraqitet jo më vonë se, deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor në gjykatën themelore⁶⁴ dhe këtë propozim mund ta tërheqim gjithashtu deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, dhe nuk mund të paraqitet përsëri⁶⁵.

Me këtë rast duhet përmendur edhe një qasje tjetër të Republikës së Shqipërisë për kompensimin e dëmit për viktimat e krimeve të dhunshme, sepse me ratifikimin e Konventës Evropiane për kompensimin e viktimave të krimeve të dhunshme, Shqipëria ka marrë detyrimin që në rastet kur kompensimi nuk mund të jepet nga burime të tjera, të ndihmon në kompensimin e atyre që kanë pësuar një dëmtim

⁶⁰ Kodi i Procedurës penale i Republikës së Kosovës, 2013, neni 269 paragrafi 2.

⁶¹ Ligji nr.03/L-141 për administrimin e pasurisë së sekuestruar apo konfiskuar, i Kosovës 2010, neni 4 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1.

⁶² Kodi i procedurës penale i Republikës së Shqipërisë, 2004, i azhurnuar më 2008, neni 62 paragrafi 1.

⁶³ Kodi i procedurës penale i Republikës së Shqipërisë, 2004, i azhurnuar më 2008, neni 64 paragrafi 1.

⁶⁴ Kodi i Procedurës penale i Republikës së Kosovës, 2013, neni 460 paragrafi 2.

⁶⁵ Po aty, neni 461 paragrafi 1.

⁵⁵ Kodi i procedurës penale i Republikës së Shqipërisë, 2004, i azhurnuar më 2008, neni 59 paragrafi 1.

⁵⁶ Po aty, neni 61 paragrafi 1.

⁵⁷ Kodi i Procedurës penale i Republikës së Kosovës, 2013, neni 19 paragrafi 1, nënparagrafi 1\13.

⁵⁸ Kodi i procedurës penale i Republikës së Shqipërisë, 2004, i azhurnuar më 2008, neni 63 paragrafi 1.

⁵⁹ Po aty, neni 214 paragrafi 1.

të rëndë trupor ose dëmtim të shëndetit, që ka rrjedhur direkt nga një krim i dhunshëm dhe të personave të varur prej personave që kanë vdekur si rezultat i një krimi të tillë. Sipas kësaj Konvente, kompensimi në rastet e mësipërme jepet edhe nëse personi që ka kryer krimin nuk mund të ndiqet penalisht ose dënohet⁶⁶. Siç mund të shihet nga Ligji i lart cekur, Shqipëria ka marrë për detyrim për të ndihmuar për kompensimin e viktimave jo vetëm kur kompensimi nuk mund të jepet nga burime të tjera, por edhe kur personi që ka kryer krimin nuk mund të ndiqet penalisht ose dënohet dhe kjo qasje paraqet një siguri për ata që nuk mund të marrin kompensimin për dëmin e shkaktuar me krimet e dhunshme. Në Kosovë siç u theksua më lartë pasuria e sekuestruar menaxhohet nga një Agjension i veçantë, mirëpo në rast të konfiskimit të përhershëm të sendeve, pasurisë apo provave ato shiten dhe të ardhurat nga këto shitje përdoren për kompensimin e të dëmtuarve dhe pjesa e mbetur derdhet në buxhetin e shtetit. Gjithashtu edhe paratë për të cilat është bërë konfiskimi i përhershëm përdoren për kompensimin e të dëmtuarve dhe pjesa e mbetur derdhet në buxhetin e shtetit⁶⁷. Qasja e Kodit të procedurës penale të Kosovës duket me e avancuar se sa Ligji për ratifikimin e Konventës Evropiane për kompensimin e viktimave të krimeve të dhunshme, sepse Kodi i Kosovës nuk kufizohet vetëm të krimet e dhunshme, por përfshinë të gjitha kategoritë e të dëmtuarve në njërin anë dhe në anën tjetër nuk ndërlidhet me mos mundësitë e tjera të kompensimit, ndërsa ky Ligj, është në përparësi kur bëhet fjalë për kompensimin e të dëmtuarit në rastin kur personi që ka kryer krimin nuk mund të ndiqet penalisht ose dënohet, sepse të dëmtuarit i jepet kompensimi edhe në këto raste.

Vështrim mbi të drejtat e viktimave të trafikuar

Edhe pse Kodet e procedurave penale të Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës nuk parashohin dispozita të veçanta të lidhura me të drejtat e viktimave të trafikuar, megjithatë Kodi i procedurës penale të Kosovës, ka dispozita që flasin për mbrojtësin e viktimave⁶⁸, duke përfshirë rastet që nga identifikimi i viktimës e deri në përfundimin e procedimit penal sipas ankimit.

Për sa i përket mbrojtësit të viktimave, sipas Kodit të Kosovës mbrojtësi i viktimave mund të përjashtohet për shkak se mund të jetë i dëmtuar me veprën

⁶⁶ Ligji Nr.9265, 2004, për ratifikimin e Konventës Evropiane për kompensimin e viktimave të krimeve të dhunshme, 1983, Strasburg.

⁶⁷ Kodi i Procedurës penale i Republikës së Kosovës, 2013, neni 115 paragrafët 3 dhe 4.

⁶⁸ Mbrojtësi i viktimave nënkupton personin e punësuar në Njësinë për mbrojtjen e viktimave, që vepron në kuadër të zyrës së Kryeprokurorit të shtetit dhe si detyrë e tij është: ofrimi i mbrojtjes dhe mbështetjes së viktimës së trafikuar, në të gjitha fazat e procedurës penale, duke përfshirë edhe përfaqësimin e viktimës para organit procedues, ndërsa nuk është e detyrueshme që të jetë jurist, prandaj mbrojtësi i viktimave nuk nënkupton avokatin i cili duhet të jetë jurist i diplomuar, të ketë të dhënë provimin e judikaturës, të jetë i regjistruar në regjistrin e Odës së avokatëve të Kosovës dhe të paguaj taksën vjetore për anëtarësim në Odën e Avokatëve.

penale, nëse është bashkëshort, bashkëshorti jashtëmartesor, person në afri gjinie në vijë të drejtpërdrejtë të çfarëdo shkalle ose në vijë anësore deri në shkallën e katërt, person në afri krushqie deri në shkallën e dytë me të pandehurin, mbrojtësin e tij, prokurorin, të dëmtuarin, përfaqësuesin e tij ligjor ose përfaqësuesin e autorizuar, është kujdestar ligjor, nën kujdestari ligjore, fëmijë i adoptuar ose prind adoptues, prind birësues ose fëmijë i birësuar i të pandehurit, mbrojtësit të tij, prokurorit ose të dëmtuarit; në çështjen e njëjtë penale ku ka marrë pjesë në procedurë si gjyqtar, prokuror, mbrojtës, ose është pyetur si dëshmitar apo ekspert; ose ekzistojnë rrethana të cilat krijojnë paraqitjen e konfliktit të interesit⁶⁹, mirëpo edhe nëse ndodhë një përjashtim i tillë, në këtë rast viktimat nuk mund të mbetet pa mbrojtës, por atij i caktohet mbrojtësi tjetër.

Është mjaft me rëndësi të theksohet një risi që është bërë më Kodin e procedurës penale të Kosovës, të vitit 2013, sipas të cilës, mbrojtësi i viktimave mund ti propozoj prokurorit të shtetit që të paraqesë kërkesë në gjykatë, në vazhdimin e paraburgimit kundër të pandehurit⁷⁰. Ai gjithashtu mund të ndihmojë të dëmtuarin në paraqitjen e deklaratës së dëmit. Zyra e mbrojtësve të viktimave mund të nxjerrë një formë standarde për deklarimin e dëmit⁷¹.

Kosova me rastin e hartimit të Kodit të procedurës penale si dhe ligjeve të tjera, ka pasur mbështetjen e ekspertëve të Bashkimit Evropian dhe të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe gjatë hartimit të tyre, ka përfshirë pothuajse të gjitha dispozitat e Konventave Ndërkombëtare, që lidhen me parandalimin dhe luftimin e trafikimit, duke përfshirë këtu edhe Direktivën e vitit 2011, të Parlamentit Evropian dhe Këshillit mbi parandalimin dhe luftimin e trafikimit më qenie njerëzore dhe mbrojtjen e viktimave të tyre dhe zëvendësimin e Vendimit të Kuadrit të Këshillit 2002/629/JHA, sipas të cilës, vendimet e Bashkimit Evropian, përcaktojnë që sistemi i drejtësisë penale duhet t'i lejojë prokurorit që të mos bëjë ndjekjen e viktimës së trafikimit me njerëz për pjesëmarrjen e saj në vepra penale⁷², prandaj edhe pse Kosova ende nuk i ka ratifikuar të gjitha dokumentet ligjore ndërkombëtare të kësaj fushe, ato dokumente janë futur në legjisllacionin e aplikueshëm të Kosovës dhe viktimat e trafikuar nuk ndiqet penalisht për veprat penale që lidhen me trafikimin e saj, si shembull kalimi ilegal i kufirit, qëndrimi ilegal në Kosovë, mbajtja e dokumenteve të falsifikuara etj. Për sa i përket Shqipërisë vlen të theksohet ratifikimi i Konventës së Këshillit të Europës, për masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore, sipas të cilës njëri nga qëllimet e saj është mbrojtja e të drejtave të viktimave të trafikimit, ndërtimi i një kuadri gjithëpërfshirës për mbrojtjen dhe ndihmën për viktimat dhe dëshmitarët, duke garantuar barazinë gjinore, si dhe duke siguruar hetimin dhe ndjekjen penale

⁶⁹ Kodi i Procedurës penale i Republikës së Kosovës, 2013, neni 45 paragrafët 3.

⁷⁰ Po aty, neni 191 paragrafi 1.

⁷¹ Po aty, neni 218 paragrafi 1.

⁷² Direktiva e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit për parandalimin dhe luftimin e trafikimit me qenie njerëzore dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit, Nenet 8 dhe 9, 2011/36/EU, 2011.

efektive⁷³, prandaj me këtë ratifikim Shqipëria ka marrë përsipër të gjitha detyrimet që dalin nga kjo konventë. Gjithashtu është shumë i rëndësishëm ratifikimi i Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar ndërkombëtar dhe dy protokolleve shtesë të saj, Protokollit kundër trafikut të migrantëve me rrugë tokësore, ajrore dhe detare dhe Protokollit për parandalimin, pengimin dhe ndëshkimin e trafikut të personave, veçanërisht të grave dhe fëmijëve⁷⁴. Qëllimi i Protokollit për parandalimin, pengimin dhe ndëshkimin e trafikut të personave, veçanërisht të grave dhe fëmijëve është të parandalojë dhe të luftojë trafikun ndërkombëtar të personave, duke i kushtuar vëmendje të veçantë grave dhe fëmijëve, të mbrojtë dhe të ndihmojë viktimat e këtij trafiku, duke respektuar të drejtat e tyre njerëzore dhe duke të nxitur dhe të lehtësuar bashkëpunimin ndërmjet Shteteve Palë, me qëllim që të realizohen këto objektiva⁷⁵.

Në këtë rast do të paraqiten detyrat që dalin për shtetet anëtare sipas Protokollit për parandalimin, pengimin dhe ndëshkimin e trafikut të personave, veçanërisht të grave dhe fëmijëve, duke marrë parasysh së ky Protokoll është pjesë e sistemit ligjor të Shqipërisë dhe secili Protokoll tani është bërë pjesë e legjislativioneve të shumë vendeve në botë dhe në të është parashikuar si në vijim:

1. Shtetet Palë duhet të mbrojnë jetën private dhe identitetin e viktimave të trafikut të personave, përfshirë, ndër të tjera, bërjen konfidenciale të procedurave ligjore, që lidhen me trafikun e personave.
2. Shtetet Palë duhet të sigurojnë që sistemi i tyre legjislativ ose administrativ të përmbajë masa të tilla që u sigurojnë viktimave të trafikut në rastet e duhura:
 - (a) informacion në lidhje me procedurat gjyqësore dhe administrative;
 - (b) asistencë, në mënyrë që të paraqesin shqetësimet dhe problemet që kanë dhe t'u merren parasysh në shkallët përkatëse të procedurave penale kundër autorëve të veprave penale, pa cenuar të drejtën e mbrojtjes.
3. Në raste të veçanta dhe masën e mundshme, Shtetet Palë duhet të marrin parasysh masat për të siguruar trajtimin fizik, psikologjik ose social të viktimave të trafikut, përfshirë këtu dhe bashkëpunimin me organizatat joqeveritare, organizatat e tjera dhe elementët e shoqërisë civile dhe, në veçanti sigurimin e:

- (a) banimit të përshtatshëm;
 - (b) këshillimin dhe informimin që ka të bëjë sidomos me të drejtat e tyre, në një gjuhë që personat e trafikuar mund ta kuptojnë;
 - (c) asistencën mjekësore, psikologjike dhe materiale; dhe
 - (d) mundësinë e punësimit, edukimit dhe trajnimit.
4. Shtetet Palë duhet të marrin parasysh, gjatë aplikimit të dispozitave të këtij neni, moshën, seksin dhe nevojat e veçanta të viktimave të trafikut dhe, në veçanti, nevojat e veçanta të fëmijëve, përfshirë banesën, arsimimin dhe kujdesin e përshtatshëm.
 5. Shtetet Palë duhet të përpiqen që të garantojnë sigurinë fizike të viktimave të trafikut nëse ato janë brenda territoreve të tyre.
 6. Shtetet Palë duhet të sigurojnë që sistemi i tyre ligjor të përfshijë masa që iu ofrojnë viktimave të trafikut të personave mundësinë e kompensimit për dëmin që u është shkaktuar⁷⁶.

Duke marrë parasysh aktet ndërkombëtare ligjore që u përmenden më lartë, në rastet e Shqipërisë dhe Kosovës, këto dy shtete kanë miratuar edhe strategjitë e tyre kombëtare si dhe planet e veprimit për zbatimin e këtyre strategjive, të cilat janë në harmoni me aktet ndërkombëtare, përveç rasteve kur ato u janë përshtatur kushteve dhe rrethanave të këtyre dy vendeve, gjë që lejohet edhe me këto akte ndërkombëtare. Në bazë të këtyre strategjive Institucionet e këtyre shteteve kanë parashikuar detyrime për secilin Institucion lidhur me mbrojtjen e të drejtave të viktimave si dhe masat për realizimin e të drejtave të tyre, jo vetëm para organeve të drejtësisë, por edhe më gjerë, siç janë fushat: sociale, arsimi, punësimit dhe mbrojtjes⁷⁷.

Bibliografia

- Deklarata e Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat Themelore të Viktimave të Krimit dhe Keqpërdorimit të Pushtetit, 1985.
- Direktiva e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit për parandalimin dhe luftimin e trafikimit me qenie njerëzore dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit, Nenet 8 dhe 9, 2011/36/EU, 2011.
- Kai-Yuan, W. 2007, Die Rechtsstellung des Verbrechensopfers im staatlichen Strafverfahren am Beispiel der Nebenklage, Frankfurt am Main (u.a.), Lang, 7, sipas Šeparović, Z, 1985 , Viktimologia, studije o žrtvama, Tiskara, Zagreb, -Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 44, miratuar me Ligjin nr.8417, dt.21.10.1998, me ndryshimet deri me dt.18.09.2012. Kodi i Procedurës Penale i Kosovës, 2004.

⁷⁶ Protokollit për parandalimin, pengimin dhe ndëshkimin e trafikut të personave, veçanërisht të grave dhe fëmijëve, neni 6, 2002, (Protokollit i Palermos).

⁷⁷ Plani Kombëtar i Veprimit për luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore si dhe Plani Kombëtar i Veprimit për luftën kundër trafikimit të fëmijëve dhe mbrojtjen e fëmijëve, viktimat të trafikimit të Shqipërisë, 2011-2013 dhe Strategjia Nacionale dhe plani i veprimit të Kosovës (SNPV), 2011-2014.

- Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës, 2013, neni 19 paragrafi, 1 nënparagrafi 1.7.
 Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë, 2004, neni 58 paragrafi 1,
 Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 54, 2008, Prishtinë.
 Ligji nr. 03/L-141 për administrimin e pasurisë së sekuestruar apo konfiskuar, i Kosovës 2010,
 neni 4, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1.
 Ligji Nr.9265, 2004, për ratifikimin e Konventës Evropiane për kompensimin e viktimave të
 krimeve të dhunshme, 1983, Strasburg.
 Ligji 9642, 2006, për Ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës për masat kundër
 trafikimit të qenieve njerëzore, 2005, ETS 197.
 Ligji 8920,2002, për ratifikimin e Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të
 Organizuar Ndërkombëtar dhe dy protokolleve shtesë të saj, Protokollit kundër trafikut të
 migrantëve me rrugë tokësore, ajrore dhe detare dhe Protokollit për parandalimin, pengimin
 dhe ndëshkimin e trafikut të personave, veçanërisht të grave dhe fëmijëve.
 Plani Kombëtar i Veprimit për luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore si dhe Plani
 Kombëtar i Veprimit për luftën kundër trafikimit të fëmijëve dhe mbrojtjen e fëmijëve,
 viktima të trafikimit të Shqipërisë, 2011-2013.
 Protokollit për parandalimin, pengimin dhe ndëshkimin e trafikut të personave, veçanërisht të
 grave dhe fëmijëve, në plotësimin e Konventës së Kombeve të bashkuara kundër Krimit të
 Organizuar Ndërkombëtar (Protokollit i Palermos), neni 2.
 Rekomandimin (85) 11 i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës, mbi pozicionin e
 viktimës në kuadrin e të drejtës dhe procedurës penale”, 1985.
 Strategjia nacionale dhe plani i veprimit të Kosovës (SNPV), 2011-2014.
 Šeparović, Z, 1985, Viktimologjia, studije o žrtvama, Tiskara, Zagreb, 40.
 Vendimi nr.39, dt.23.06.2000, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë.

Politika e Britanisë së Madhe në Shqipëri gjatë Luftës së Dytë Botërore

Dokt. Etleva Babameto

DOKTORANTE, FAKULTETI HISTORI-FILOLOGJISË, UT

Abstrakt

Më 7 Prill 1939 Shqipëria u pushtua nga Italia Fashiste. Ky pushtim solli krijimin e grupimeve dhe rritjen e rezistencës brenda vendit, – LANC, Balli Kombëtar dhe Legaliteti – të cilat patën synimet, politikat dhe specifikat e tyre në përshtatje me ecurinë e zhvillimeve në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar gjatë viteve të Luftës.

Por rezistenca shqiptare gjatë L2B nuk mund të analizohet e shkëputur nga përfshirja dhe influenca e faktorit ndërkombëtar, rëndësia strategjike dhe vëmendja që merr ky vend për të goditur dhe dëmtuar forcat e Boshtit në prapavijat e tyre, dhe në kuadrin e kësaj Luftë, nga dinamika dhe ndikimi i Politikës Britanike në Shqipëri si qendra e lojës diplomatike në shkallë botërore, në përputhje me interesat e saj të ndryshme politike dhe gjeo-strategjike në Ballkan.

Në vitin 1938 në Foreign Office (Ministria e Jashtme) ekzistonin dy qëndrime të ndryshme që duhej të mbaheshin ndaj politikës së Musolinit: qëndrimi i parë miratonte tezën se Italia duhej të shkëputej nga orbita e Gjermanisë nëpërmjet dashamirësisë dhe koncesioneve, ndërsa qëndrimi i dytë bazohej në faktin se Qeveria Fashiste Italiane ishte e vendosur në kursin e saj agresiv, dhe çdo përpjekje për të arritur një mirëkuptim me të do të interpretohej, ndër të tjera, si dobësi e Qeverisë Britanike¹. Mbizotërimi i qëndrimit të parë, mund të pranohet se shpjegon nga njëra anë qëndrimin tolerant dhe indiferent të Britanisë së Madhe ndaj pushtimit të Shqipërisë nga Italia Fashiste. Nga ana tjetër, vetë politika Britanike gjatë viteve të L2B do të sillnin pasoja të thella për këtë vend në përfundim të saj.

Fjalë kyç: Rezistenca shqiptare, pushtim, Lufta e Dytë Botërore.

¹ Petrov, B. “Great Britain and the Resistance in Albania, April 1939-1941”, f.52.

Pushtimi Italian i Shqipërisë dhe Britania e Madhe: 1939-1942

Britania e Madhe u përfshi në ngjarjet e Ballkanit në L2B kundër vullnetit të saj. Politika e saj gjatë kësaj lufte karakterizohej në pjesën më të madhe nga improvizime të minutës së fundit dhe diktohej nga faktorë të jashtëm negativë të tillë si: frika e zemërimit të Musolinit, më pas e provokimit të parakohshëm të Hitlerit si dhe frika e zemërimit të Stalinit.²

Një ditë para pushtimit të Shqipërisë më 7 Prill 1939, në Dhomën e Komunave, Kryeministri Britanik Chamberlain do të deklaronte se “Qeveria e Madhërisë së Tij nuk ka interesa direkte në Shqipëri, por interesin e përgjithshëm të paqes në të gjithë botën”³. Megjithatë në dokumentet Britanike citohet se “Qeveria Britanike është tejet e shqetësuar për pushtimin e papritur të Shqipërisë nga Italia dhe kërkon shpjegime të sinqerta dhe të plota mbi zhvillimet aktuale ndërmjet Italisë dhe Shqipërisë”⁴. A mund të konsiderohet *qëndrim* ky i Britanisë së Madhe ndaj pushtimit të Shqipërisë? E për më tepër, kur Musolini nga ana e tij, duke e siguruar kryeministrin Britanik se çështja italo-shqiptare nuk do të zhvillohej në dëm të marrëdhënieve bilaterale apo situatës ndërkombëtare në tërësi, shprehu dëshirën se “shtypi Britanik duhej të pasqyronte misionin e madh të civilizimit dhe drejtësisë që Italia Fashiste do të ushtronte në Shqipëri me pëlqimin entuziast të popullit Shqiptar!”⁵.

Populli Shqiptar nuk iu nënshtrua lehtë pushtimit Italian dhe u hodh në sulme, prita, vrasje dhe revolta të vazhdueshme, të cilat inkurajuan dhe nxitën rezistencën shqiptare gjithnjë në rritje të organizuar nga grupet guerile ndërkohë që, pushtuesit Italianë u munduan ta shtypin me terrorizëm nëpërmjet ekspeditave ndëshkuese dhe bombardimeve ajrore⁶. Ndërkohë, në pranverën e vitit 1940, kur po bëhej e qartë se Italia do të hynte në luftë, interesimi vjen nga Ministria e Luftës ku degët e organizatave të saj që vepronin në këtë kohë në territoret e Jugosllavisë dhe Greqisë, i kthyen sytë edhe nga Shqipëria⁷.

Në këtë periudhë, MI (R) dhe Seksioni “D”, Departament i vogël i Shërbimit Inteligent (më vonë i shndërruar në SOE Special Operation Executive - Drejtoria e Operacioneve të Posaçme)⁸, u ngarkua me studimin e gjendjes në Shqipëri, kushtet

e përgjithshme që mbretëronin aty, grupazhet e ndryshme dhe udhëheqësit më kryesorë, si dhe përgatitjen e planeve të ardhshme operacionale. Hapi i parë i punës së Seksionit “D” në këto vite do të ishte formimi i një lëvizjeje mbarëkombëtare shqiptare, që do të përfshinte sa më shumë armiq të Italisë, pasi ishte akoma shumë shpejt për të shpërthyer kryengritje brenda Shqipërisë⁹.

Gjithashtu edhe Foreign Office, e shqetësuar nga kërcënimi i Italisë kundër Greqisë, nisi të interesohej në Gusht të 1940 për mundësinë që t’u shkaktonte trazira italianëve në Shqipëri.¹⁰

Sulmi Italian kundër Greqisë në vjeshtën e vitit 1940 nga territori Shqiptar e rriti vëmendjen e politikëbërësve britanikë dhe ushtarakë në nxitjen e rezistencës guerile në Shqipëri, veçanërisht nga fundi i vitit ‘40 duke synuar krijimin e një Fronti të Bashkuar të rezistencës Shqiptare kundër Italisë. Në këtë situatë, Zogu propozoi në Londër që së bashku me 14.000 shqiptarë në Stamboll të organizonte një forcë që do të zbankonte në Selanik me pëlqimin e Qeverisë Greke dhe kështu të krijonte një front lufte¹¹. Ky propozim nuk u pranua nga Kryeministri Greek Metaxas me argumentin se po mos të përkrahnin Zogun, “kjo i angazhonte për rimëkëmbjen e pavarësisë së Shqipërisë pas lufte”¹², dhe për rrjedhojë, plani për zbankimin e Zogut u braktis.

Megjithatë SOE konsideronte si më të mundshme një variant tjetër, organizimin e një kryengritjeje në pjesën veriore të Shqipërisë nën drejtimin e Gani Kryeziut nëpërmjet kontakteve të tyre në Jugosllavi, plan i cili fillimisht u pranua nga Foreign Office. Por oficerët britanikë hasën në disa vështirësi në realizimin e këtij plani. Problemi kryesor ishte furnizimi me material ushtarak¹³. Por me këmbënguljen e palës Greke u vendos që në rrethanat aktuale interesi Anglo-Grek kërkonte që veprimet në Shqipëri të koordinoheshin nëpërmjet grupeve të vogla, jo të rregullta¹⁴. Përveç kësaj, prania e trupave të rregullta të ushtrisë Jugosllave, që kishin hyrë në të njëjtën zonë krijoi armiqësinë me të cilën u ndeshën oficerët ndërlidhës britanikë në veri-perëndim të maleve veriore dhe ua hoqi shanset për të pasur sukses atje¹⁵.

Për më tepër, fitorja rrufe e Vermahtit hitlerian ndaj Jugosllavisë dhe Greqisë në Prill të vitit 1941, bëri që të dështonte plani për një kryengritje në Shqipërinë e Veriut¹⁶. Bërthamat e seksioneve të SOE-së për Shqipërinë që vepronin në Beograd e Athinë u shpërndanë¹⁷.

⁹ Ibid.

¹⁰ Hibbert, R. “Fitorja e Hidhur”, f.76.

¹¹ Barker, B. *British Policy...*, f. 50-51.

¹² Puto, A. “Nëpër Analet e Diplomacisë Angleze”, burim i cituar, f.37.

¹³ Oakley-Hill, D. “Një Anglez në Shqipëri”, f.133-134; Në atë periudhë SOE nuk ishte në një pozitë të tillë sa të tërhiqte material ushtarak.

¹⁴ Puto, A. *Nëpër Analet...*, burim i cituar, f.37.

¹⁵ Oakley-Hill, D. “Një Anglez...”, f.139; Veriu i largët mendonte se oficerët britanikë ishin vegla të jugosllavëve dhe ky qe një grusht fatal për oficerët britanikë lidhur me organizimin e kryengritjes në këtë zonë.

¹⁶ Neuwirth, H. “Qëndresë dhe bashkëpunim në Shqipëri: 1939-1944”, f.37.

¹⁷ Hibbert, R. *Fitorja...*, f.79; Për rrjedhojë veprimtaria e SOE lidhur me Shqipërinë, ra mjaft poshtë për të rifilluar në pranverën e vitit 1943.

Nuk është për t'u çuditur se megjithë përpjekjet, kryengritja në Shqipëri dështoi pikërisht për faktin se Britania e Madhe ishte e ndjeshme ndaj pretendimeve Greke kundër Shqipërisë¹⁸. Këtë konkluzion e konfirmoi Eden (Sekretar i Shtetit për çështjet e jashtme) më 23 Janar 1941, kur deklaroi se, ndërsa Qeveria e Madhërisë së Tij ishte në favor të pavarësisë së Shqipërisë, për momentin politika e kësaj Qeverie duhej të përputhej me dëshirat e Grekëve¹⁹.

Megjithatë ajo që vërehet gjatë periudhës së pushtimit Italian në Shqipëri është rritja e veprimtarisë së grupeve guerile në mbarë Shqipërinë e veçanërisht në jugun e saj²⁰. Pas studimit nga ana e Britanikëve të këtyre forcave guerile rezultoi se në këtë vend ishin mbjellë dy farëra kryengritjesh: fronti i bashkuar ngritur nga përpjekjet e oficerëve britanikë dhe një celulë komuniste e përgatitur sipas tipit rus. Më 16 Tetor 1941, u themelua e para Parti politike në Shqipëri - Partia Komuniste, si një shkrirje e grupeve komuniste që ekzistonin në atë kohë (të Tiranës, Shkodrës dhe Korçës), e kryesuar nga Enver Hoxha. Në programin e saj kjo Parti (e cila udhëhoqi L.N.C), e përjashtonte çështjen kombëtare dhe rendiste si pikat më kryesore: lirinë nga pushtuesi, reformën e tokës, si dhe ndryshimin e përgjithshëm ekonomik dhe social.

Pas një viti, një grup shqiptarësh konservatorë dhe nacionalistë, armiq të mbretit Zog në mërgim, me rritjen e aktivitetit gueril në Shqipëri dhe të shqetësuar nga krijimi i Partisë Komuniste dhe ndikimi i saj në rezistencën Shqiptare, krijoi në Nëntor 1942 Ballin Kombëtar²¹ të përbërë kryesisht nga bajraktarë, çifligarë, pronarë, të bashkuar nga ndjenja nacionaliste dhe anti-komuniste. Fillimisht, Balli Kombëtar ndoqi një vijë të fuqishme patriotike anti-Italiane, megjithëse ishte po aq anti-Greke dhe anti-Jugosllave por entuziazmi i tij për luftë aktive ishte i zbehtë²². Të dhëna dokumentare arkivore na tregojnë se Balli Kombëtar ishte dakord të bashkëpunonte me L.N.C. dhe ka luftuar përkrah saj si në Vlorë ashtu edhe në Krujë²³. Por nga ana tjetër i njëjti burim thekson se Balli Kombëtar është pasiv, përpigjet të mbështesë si Gjermanët ashtu edhe Aleatët, me qëllim që ndryshe nga partizanët, t'i mbajnë Gjermanët sa më gjatë në Shqipëri pasi në këtë mënyrë ata mbajnë larg Grekët²⁴.

¹⁸ Arkivi Qendror Shtetëror (më tej: *AQSH*), Fondi 1510/1, viti 1943, dosja 97, f.1. Harry Hodgkinson collection: Shqipëria e Jugut - Pretendimet Greke.

¹⁹ Barker, E. *British Policy*, f.51.

²⁰ TNA, Allead Mission, HS 7 70, 1942-1945, *The History of the Albanian Resistance*, f.82-83, sipas këtij dokumenti në vjeshtën e vitit 1942 në gjithë Shqipërinë numëroheshin 10-12 grupe guerile ku më të rëndësishmet ishin ato të kryesuara nga M.Peza, Baba Faja, etj. Po kështu aktiviteti gueril u shtua gjithnjë e më shumë në Korçë, Skrapar, Kurvelesh ku nga mesi i muajit Janar 1943 fuqia totale guerile është vlerësuar 3.000-4.000 vetë me armë dhe pajisje të marra nga burime Italiane, Jugosllave dhe Gjermane.

²¹ Barker, E. *British Policy*, f.177.

²² Ibid.

²³ *AQSH*, Telegram i Kairos nr.2060, datë 13.10.1943, FO 371/37144, Fondi 1510/1, viti 1943, dosja 18, f.1-2.

²⁴ Ibid, Për më tepër, një BLO (British Liaison Officers - Oficerë Ndërlidhës Britanik) ka dërguar një listë me anëtarë të Ballit Kombëtar dhe L.N.C. të cilët i përkasin së njëjtës familje - baballarët dhe xhaxhallarët me Ballin Kombëtar ndërsa djemtë dhe nipërit e tyre me L.N.C.... pra, konservatorët kundrejt radikalëve.

Nga ana tjetër, në vijim të përpjekjeve të tij në Londër, Zogu do të shprehej në një intervistë me përfaqësues të Komitetit Ballkanik në Korrik 1942 se menjëherë pas çlirimit të vendit të tij, do të ishte populli i tij që do vendoste formën e Kushtetutës, nëse dëshironte Mbretëri apo Republikë, apo qoftë edhe ndonjë formë tjetër Qeverie²⁵.

Ndërkohë, në kontekstin e zhvillimeve aktuale në Shqipëri e më tej, Qeveria Britanike po përballëj me problemin e qëndrimit të saj ndaj statusit të Shqipërisë dhe Mbretit të saj në veçanti, e kështu, nga fundi i vitit 1942 dhe pikërisht më 17 Dhjetor, Qeveria Britanike bëri një Deklaratë nëpërmjet së cilës njohu Pavarësinë e Shqipërisë, pothuajse në të njëjtën kohë me Qeverinë e Bashkimit Sovjetik dhe USA. Por përsëri për të kënaqur interesat Greke, çështja e kufijve shtetërorë të Shqipërisë sipas kësaj Deklarate, do të zgjidhej pas periudhës së luftës në Konferencën e Paqes²⁶.

Roli i Britanisë së Madhe në Mbështetje të Rezistencës Shqiptare: 1943-1944

Në fillimin e vitit 1943, meqenëse vatra e luftës në Mesdhe u zhvendos nga Afrika e Veriut në Evropën e Jugut, SOE u përgatit për veprimtari të zgjeruar në Ballkan²⁷. Pikërisht në këtë periudhë, drejtuesit ushtarakë Britanikë filluan të mendonin seriozisht për ngritjen e lëvizjeve të rezistencës në Evropën Jug-Lindore dhe për përdorimin e avionëve dhe furnizimeve të nevojshme²⁸. Në këtë kuadër, gjatë këtij viti u rrit më tej interesimi dhe angazhimi i Britanisë së Madhe edhe në Shqipëri²⁹.

Për këtë qëllim, në Prill 1943, në Shqipëri zbarkuan një numër oficerësh Britanikë të SOE-së për të rritur më tej efikasitetin e rezistencës shqiptare, për të bashkërenduar dhe nxitur kundërshtimin ndaj italianëve dhe pas kapitullimit të

²⁵ *AQSH*, Letër dërguar nga Sër Eduard Boile për z. Faik Konica më 15.7.1942, FO 317/33110, Fondi 1510/1, viti 1942, dosja 78, f.1-2.

²⁶ Puto, A *Nëpër Analet* ..., 43-44.

²⁷ Hibbert, R. *Fitorja*..., f. 80-81; Si rrjedhim i vendimeve strategjike ndërmjet Anglisë e SHBA zbarkimi i Aleatëve në Afrikën e Veriut në vitin 1943 kishte hapur rrugën për operacione që do ta flaknin Italinë jashtë lufte. Gjithashtu gjatë gjysmës së dytë të këtij viti u bë e qartë se operacionet e posaçme do të ishin e vetmja formë që Aleatët do t'i kushtonin Ballkanit.

²⁸ Barker, E. *British Policy*, f.111-114. Në të vërtetë që nga fundi i vitit 1941 Eden dhe Foreign Office e konsideruan rikthimin ushtarak në Evropën Jug-Lindore ndoshta si mjetin e vetëm për të ndaluar ekspansionin e Rusëve pas lufës në këtë rajon. Ndërkohë pas hapjes së frontit të dytë në Afrikën Veriore në vitin 1942 dhe pranimit nga ana e Amerikanëve në Janar 1943 për të goditur Sicilinë me qëllim që të siguroheshin linjat Mesdhetare të komunikimit dhe të shtohet presioni mbi Italinë, politikë-bërësit Britanikë e konsideruan këtë të fundit si një sulm ndaj kontinentit Italian duke nënkuptuar edhe vendet e Evropës Jug-Lindore.

²⁹ Akademia e Shkencave të Shqipërisë, Historia e Popullit Shqiptar, *Shqiptarët gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe pas saj 1939-1990*, Vëllimi IV, f. 106; Deklaratat e tri Fuqive Aleate të Dhjetorit 1942 janë dëshmi se që nga viti 1942 Shqipëria ishte njohur si pjestare e Koalicionit Antifashist.

tyre ndaj pushtimit gjerman. Objektivi i tyre ishte që të grumbullonin informacione të fshehta, të kryenin veprime sabotimi dhe të nxitnin e përsheptonin përpjekjet e rezistencës kundër Fuqive të Boshtit³⁰. Ata u shpërndanë në të katër anët e Shqipërisë duke qenë të pranishëm në të gjitha segmentet politike të qendrës antifashiste shqiptare, pranë E. Hoxhës e A. Ermenjit, A. Kupit, Frashërit, M. Bajraktarit e G. Kryeziut.

Oficerët e SOE-së ishin udhëzuar të përkrahnin çdo grup që luftonte forcat e Boshtit pavarësisht nga besnikëria politike³¹, por duke parë organizimin dhe rritjen numerike të forcave partizane, oficerët e misioneve britanike të atashuar pranë tyre u shprehën që këtyre forcave t'i jepej përkrahja Britanike, megjithëse jo rrallë ishin të ngadalshme për bashkëpunim; madje sa herë që Misionet Britanike ndihmonin Ballin Kombëtar, akuzoheshin nga Enver Hoxha se kërkonin të forconin elementët reaksionarë në Shqipëri, duke dëshmuar kështu se udhëheqësit komunistë ishin më të interesuar për të zhdukur rivalët e tyre dhe për të marrë pushtetin politik sesa për detyrën imediate kundër pushtuesit. Ai e kërkonte mbështetjen e misioneve britanike në formën "O me ne, o me ata"³².

Në periudhën midis pranverës së vitit 1943 dhe fundit të vitit 1944 në Shqipëri, u dërguan rreth 50 oficerë anglezë. Me ardhjen e Misioneve Britanike, furnizimet e para Britanike për rezistencën shqiptare filluan më 17 Prill 1943 dhe përfunduan në Korrik 1944, me anë të avionëve Halifax të RAF (Royal Air Force - Forcat Ajrore Mbretërore)³³, të cilët sillnin furnizime me veshje, armë, ushqime, etj.

Ndërkohë, me rritjen e rezistencës partizane, në fillim të Gushtit 1943, pranë Komitetit Qendror të FNC-së ishin vendosur 4 Misione Britanike, për të organizuar dhe trajnuar Brigadën e I Partizane ku gjatë këtij muaji megjithëse trupat Italianë bënë reprezalje në Shqipërinë Jugore³⁴, rezistenca vazhdoi në një shkallë të gjerë në të gjithë Shqipërinë. Është për t'u theksuar fakti se Abaz Kupi i cili vepronte në Shqipërinë Qendrore kreu disa sulme kundër kolonave Italiane dhe më 20 Gusht 1943, 400 italianë u sulmuan në veri të Elbasanit dhe pësuan humbe të mëdha³⁵.

Gjithashtu, një ngjarje me rëndësi në këtë periudhë për zhvillimet politike në vend ishte marrëveshja e nënshkruar më 2 Gusht 1943 në fshatin e Mukjes, ndërmjet komunistëve dhe nacionalistëve³⁶. Sipas kësaj marrëveshjeje, u vendos për t'i dhënë fund armiqësive, për të bashkëpunuar në luftën kundër armikut të përbashkët dhe për të punuar sinqerisht për një Shqipëri të pavarur brenda kufijve

³⁰ Stephane Schwandner-Sievers and Bernd J. Fischer, *Albanian Identities, Myth and History*, Bailey, R. "Smoke without fire? Albania, SOE and the Communist Conspiracy Theory", f. 143-144.

³¹ Ibid.

³² Hoxha, E. "Rreziku Anglo-Amerikan për Shqipërinë", f. 111-113.

³³ TNA, Allied ..., *Sea Operations*, f.147-148.

³⁴ TNA, Allied ..., *The History of the Albanian Resistance*, f. 85-86.

³⁵ Ibid.

³⁶ AQSH, Manifest i Ballit Kombëtar, FO 371/43554, Fondi 1510/1, viti 1944, dosja 16, f.7-8.

të saj etnikë. Por pas pak ditësh, përfaqësuesit e Partisë Komuniste Jugosllave të udhëzuar nga Tito për të kontaktuar me komunistët Shqiptarë dhe Grekë, e nxitën Enver Hoxhën të denoncojë Ballin Kombëtar dhe liderët e tij që të bashkëpunojnë me armikun pasi vija e duhur ishte ndarja me të³⁷. Enver Hoxha e dënoi zyrtarisht atë. Ajo që vërehet në këtë periudhë është se po manifestohej qartë ndarja ndërmjet grupeve komuniste dhe atyre antikomuniste. Të mendojmë për një moment se si do të rridhnin ngjarjet në Shqipëri nëse marrëveshja e Mukjes do të respektohej?

Në Shtator 1943 pas armëpushimit të Italisë me Aleatët, kolonat gjermane filluan të pushtojnë Shqipërinë me veprime arbitrare duke pushtuar pika të forta, depo, magazina, baraka, duke çarmatosur oficerë dhe ushtarë italianë, shembull ky që u ndoq në të gjithë Shqipërinë. BLO-të bënë përpjekje për të koordinuar veprimet me partizanët dhe Divizionin e Gjeneral Dalmacos kundër gjermanëve dhe për të pushtuar Tiranën dhe Durrësin, plan i cili dështoi kryesisht për shkak të pavendosmërisë dhe mungesës së organizimit të forcave partizane³⁸.

Dokumente britanike të pabotuara citojnë, se pushtimi i Shqipërisë nga Gjermania solli në mënyrë të pashmangshme dallimin ndërmjet dy palëve kryesore të rezistencës: FNC-ja i cili i shpalli luftë për vdekje pushtuesve gjermanë, dhe Ballit Kombëtar një pjesë e të cilit bashkëpunoi me ta, siç ndodhi në zonën e Vlorës ku i ndihmoi për të rregulluar dëmtimet e bëra nga sabotimet e FNC-së³⁹. Pa dyshim, zhvillime të tilla na bëjnë të mendojmë se në këto qëndrime ka ndikuar edhe propaganda gjermane gjithnjë në rritje e cila: mbështeste shumë nacionalizmin shqiptar duke e shpallur veten si kampione të çështjes së Kosovës; synonte ndarjen e tre Aleatëve të mëdhenj, Britaninë e Madhe kundër Amerikës, dhe Anglo-Amerikanët kundër Ruisë; theksonte se Anglo-Amerikanët do të luftonin komunizmin Rus para mbarimit të luftës, dhe se do të arrinin marrëveshje me Gjermaninë kundër Ruisë. Rrjedhimisht, nga kjo propagandë shumica e shqiptarëve ishin të bindur se lufta e Anglo-Amerikanëve me Rusinë po shfaqej në horizont dhe ndihma Britanike do të ishte në shkallë më të gjerë dhe më shpejtë nga sa pritej⁴⁰.

Në këtë periudhë në Foreign Office akoma mendohej se vendet e Evropës Jug-Lindore do të pushtoheshin nga Britania e Madhe⁴¹. Në kuadrin e zbatimit të strategjisë së rreme (*deception strategy*) hartuar për Evropën Jug-Lindore, BLO-të në Shqipëri ishin udhëzuar të përhapnin idenë se Ballkani do të pushtohet nga Aleatët⁴².

Ndërkohë, në Nëntor 1943 pas denoncimit të marrëveshjes së Mukjes u krijua një forcë tjetër e rezistencës "Lëvizja pro-zogiste e Legalitetit", e kryesuar nga Abaz

³⁷ Barker, E. *British Policy ...*, f.177.

³⁸ TNA, Allied..., *The German Occupation of Albania*, f.68-70.

³⁹ TNA, Allied..., *The Partisan Resistance after German Occupation*, f.86-87.

⁴⁰ Ibid, Appendix M, *Propaganda*, f.1-2.

⁴¹ Barker, E. *British Policy ...*, f.122-23.

⁴² Ibid.

Kupi (i cili kishte bashkëpunuar dhe luftuar me FNC-në, por duke parë karakterin anti-kombëtar të PKSH-së, u shkëput nga FNC), i përbërë nga bajraktarë dhe elementë nga Mati, Kruja dhe Tirana të cilët kërkonin rivendosjen e monarkisë.

Po këtë muaj, duke e ndjerë kërcënimin në rritje të lëvizjes partizane shqiptare, gjermanët ndërmorën një sërë fushatash anti-partizane asgjësimi.

Ndërkaq, lëvizjet e rezistencës ishin të përçara dhe, në kushtet e pasigurisë dhe çoroditjes ideologjike të shkaktuara nga lufta, nisën përplasjet ndërmjet tre grupimeve - komuniste, zogiste dhe jo-zogiste që shpesh çuan deri në luftë civile.

Në këtë kontekst, duke synuar bashkimin e të gjithave kaheve politike kundër forcave të Boshtit, oficerët e SOE-së, bënë përpjekje për bashkimin dhe angazhimin në luftë kundër gjermanëve të të gjitha grupimeve pasi ata nuk e dëshironin vëllavrasjen⁴³. Madje në një takim të Majorit Riddell me forcat partizane kur këto të fundit i konsideronin ballistët dhe legalistët tradhëtarë, ai u ka thënë se “mund t’i bëjmë për vete dhe t’i kthejmë kundër Gjermanëve, prandaj duhet të paqësoheni e të bashkoheni me ta”⁴⁴. Gjithashtu, në momente të caktuara si dhe në përputhje me dinamikën e ngjarjeve dhe interesat e tyre strategjike, Britanikët konsideruan përdorimin e Zogut si kartë. Kështu, në Prill-Maj 1944 kur Foreign Office ishte e lëkundur për këtë çështje, një nga funksionarët e saj kishte deklaruar se: “Ministria e Jashtme ka ndër mend ta lejojë Zogun që të kthehet në Shqipëri. Në qoftë se nënkolonel Maklin mund ta provojë se prania e Zogut do të ndezë luftën në Shqipëri, Foreign Office do të jetë gati që të vërë në veprim mendimet e tij”⁴⁵.

Në këtë situatë, pasi i kishin mbijetuar ofensivës gjermane të dimrit 1943-1944, forcat partizane e rimarrin veten dhe vërehet rritje e lëvizjes së tyre. Në muajin Prill 1944 forcat partizane të cilat numëronin 12.000 vetë, arritën rezultate pozitive me disa sulme në kampet, depot dhe magazinat e armikut, në këtë periudhë, britanikët dhanë ndihmesën më të madhe për forcat partizane nëpërmjet R.A.F (Royal Air Force-Forcat Ajrore Mbretërore), e veçanërisht në Qershor 1944, kur dukej se forcat partizane po mbizotëronin rezistencën dhe ishin gati të merrnin pushtetin kur të tërhiqeshin nazistët⁴⁶.

Nga studimi i terrenit pika e parë për dërgesat nga deti ishte baza SEAVIEW në Dukat, territor i Ballit Kombëtar por politika tashmë ishte të mbështetej e të furnizohej LANC-it e njëkohësisht të mbaheshin kontakte me nacionalistët, kështu që Balli Kombëtar natyrisht nuk do dëshironte të lejonte ardhjen e furnizimeve nga deti⁴⁷.

⁴³ *AQSH*, Fondi 421, Letër e Enver Hoxhës më datë 2.11.1943, viti 1943, dosja 15/1, f.100 -109.

⁴⁴ *Ibid.*

⁴⁵ Ballvora, Sh. “*Zhvillimet politike në periudhën e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare*”, Shtëpia Botuese Dituria, 2004, f.542.

⁴⁶ *TNA*, Allied..., *Air Support to the Partisans*, f.132-134.

⁴⁷ *TNA*, Allied..., *Sea Operations*, f.147-148: Rrjedhimisht në SEAVIEW vinin vetëm furnizime për Misionin, ushqime dhe një sasi e vogël armësh për mbrojtje lokale. Ndërsa në bregdetin e Borshit, që u konsiderua pikë më e përshtatshme, më 22 Maj u hodhën 30 ton furnizime për LANC dhe 36 ton më 24 Maj. Në Qershor për LANC u dërguan 70 ton furnizime dhe në Gusht dy dërgesa me nga 70 ton

Duhet pasur parasysh se nganjëherë të dhënat dokumentare lidhur me zhvillimet në këtë periudhë janë kontradiktore; kështu sipas dokumenteve arkivore britanike, beteja e Spilesë më 29 Korrik 1944 ishte një betejë e suksesshme e Britanikëve, ndërkohë që nga burime arkivore shqiptare që lë të kuptohet se kjo betejë paraqitet si sukses i forcave Gjermane⁴⁸. Megjithatë, ajo që kuptohet qartë është se forcat Britanike, në kuadrin e zbatimit të strategjisë Aleate, i dhanë mbështetje vendimtare rezistencës partizane në këtë periudhë, ndër të tjera, edhe me hedhjen e furnizimeve nga ajri dhe deti.

Kjo mbështetje vazhdoi gjatë muajve Tetor-Nëntor 1944, në përpjekje për t’i shkaktuar armikut dëme maksimale dhe veçanërisht në Shqipërinë e Veriut për të shkatërruar planet Gjermane të evakuimit ndërkohë që gjatë kësaj kohe vazhduan furnizimet ajrore me aeroplanë Halifax ku u hodhën afërsisht 2^{1/2} ton furnizime, armë, veshje dhe ushqime dhe një sasi e madhe të hollash⁴⁹.

Në këtë kuadër, që prej datës 5 Nëntor 1944, shërbeu edhe zbatimi në Tiranë i programit të suksesshëm non-stop të bombardimeve të BAF (Balkan Air Force - Forcat Ajrore të Ballkanit)⁵⁰, ku në më shumë se 200 sulme të befasishme arritën të godisnin gjermanët e rrethuar⁵¹. Për rrjedhojë shuma totale e saktë e humbjeve gjermane është e pamundur të llogaritet, por është vlerësuar se ajo i kalon 2000 të vrarë ose të zënë rob, ndërsa humbjet nga radhët e Partizanëve në betejën e Tiranës ishin 127 të vrarë dhe 290 të plagosur⁵².

Në dritën e këtyre zhvillimeve, që prej muajit Gusht 1944 aktiviteti ushtarak gjerman ra ndjeshëm, gjë që shkoi në dobi të forcave partizane dhe në Shtator të 1944, ku rezistenca partizane po arrinte gradualisht majat e saj. Vetë oficerët ndërlidhës që po largoheshin nga Shqipëria ishin të mendimit se F.N.C. do të ishte shumë armiqësor ndaj ardhjes së forcave ushtarake të Aleatëve sapo të vendosnin kontrollin e tyre⁵³.

secila. Gjithashtu në Shtator, Spile që ishte zënë nga partizanët shërbeu si vend i sigurt ku u hodhën 200 ton furnizime në tre dërgesa. Që prej Nëntorit 1944, porti i Sarandës ishte çliruar dhe shërbeu si pikë për dërgesat ku gjatë këtij muaji zarkuan dy dërgesa me 146 ton ushqime dhe veshje. Më vonë në Vlorë, marrja e dërgesave organizohej nga BLO-të ku gjatë Nëntorit 1944 zarkuan dy dërgesa me 172 ton.

⁴⁸ *AQSH*, Fondi 154, viti 1944, dosja 178, f.111: Mbretinija Shqiptare, Telegram dërguar Komandës së Gjandarmërisë në Tiranë nga Komandanti i Qarkut të Gjandarmërisë Vlorë më 2.8.1944, Sipas këtij dokumenti në Spile u afruan dy vaporë të mëdhenj Anglezë prej tre batalionesh me afërsisht 4.000 ushtarë dhe 500 komunistë ndër të cilët shumë gra e vajza dhe 64 ushtarë Gjermanë ku pas luftimesh e përlëshesh kanë mbetur të vrarë e të plagosur rreth 1.000 Anglezë të cilët janë tërhequr.

⁴⁹ *TNA*, Allied..., *Air Support to the Partisans*, f.132-134. Sipas të njëjtit burim, si rezultat i kësaj ndihme ka të ngjarë që arritjet më të suksesshme të forcave partizane u bënë në Qershor 1944 kur forcat Gjermane u detyruan të sillnin në Shqipëri Divizionin më të mirë në SEE, Divizionin Malor I, për të eliminuar kërcënimin në rritje.

⁵⁰ Arkivi i Ministrisë së Punëve të Jashtme (më tej: *AMPJ*), Rede des Britischen Außenministers Eden auf der Jahreskonferenz der Konservativen Partei in London, 20 Maj1943 (përkthim), nr.107, viti 1943, dosja 31. f. 88/1.

⁵¹ *TNA*, Allied..., *The History of the Albanian Resistance*, f.105-106.

⁵² *Ibid.*

⁵³ *TNA*, Military Liaison-Albania, CAB 106459, *Under Command Balkan Air Force*. f.324.

Ndërkohë, në verën e vitit 1944 në qarqet drejtuese të Aleatëve ishte ngritur çështja nëse ia vlente të mbështeteshin forcat guerile nacionaliste ashtu si komunistët; apo dhe Krerët Britanikë të Aleatëve theksuan se strategjia e mashtrimit e Aleatëve për Ballkanin përfshinte jo vetëm përqendrimin e sa më shumë forcave armike në Shqipëri por edhe një sulm imagjinar (*notional assault*) në bregdetin Shqiptar⁵⁴, duke nënkuptuar mbështetje vetëm për forcat partizane. Duke pasur parasysh kompleksitetin e kësaj strategjie, mund të thuhet se pikërisht kjo situatë çorientoi vetë oficerët Britanikë të cilët e kishin të vështirë të zbulonin se çfarë ishte reale dhe çfarë ishte pjesë e planit të mbulimit (*cover plan*), duke shkaktuar kështu konfuzion dhe paqartësi në veprimet dhe qëndrimet e tyre ndaj forcave të ndryshme të Rezistencës Shqiptare.

Por pavarësisht konfuzionit dhe paqartësisë në radhët e oficerëve Britanikë, situata aktuale në vend ku vërehet se Partia Komuniste në mënyrë të dukshme po shfaqej si forca dominuese në këtë luftë, dëshmon se praktikisht Britanikët i dhanë mbështetje të gjithanshme komunistëve. Në këtë kontekst, në një raport top sekret që Ministria e Jashtme i dërgoi Ministrisë së Luftës më 7 Korrik të vitit 1944 thuhet: "... Në qoftë se dikush do të fajësohej për situatën e tanishme në të cilën lëvizjet e udhëhequra nga komunistët janë elementët më të fuqishëm në Jugosllavi, Shqipëri e Greqi, këta jemi ne vetë..."⁵⁵. Sigurisht nuk mund të themi se fuqizimi dhe epërsia e PK-së në këtë fazë të luftës i dedikohet vetëm mbështetjes Britanike, pasi nuk mund të mohohet dhe as të zbehet lufta e pakursyer që zhvilloi L.N.C. e udhëhequr nga PK; por duhet pranuar gjithashtu se përkrahja Britanike në këtë Luftë ishte vendimtare në sukseset e arritura nga kjo forcë në luftën kundër bllokut Fashist.

Nga ana tjetër, akoma në verën e këtij viti politika Britanike shfaqet konfuzë, e paqartë dhe e pavendosur lidhur me pozicionimin përfundimtar që duhet të mbajë ndaj rrymave politike në Shqipëri. Më 23 Korrik 1944 Eden i shkruan Kryeministrit Çurçill: "... L.N.C. është organizatë e krahut të majtë me element të fortë komunist... Është e vetmja organizatë në Shqipëri që lufton seriozisht kundër Gjermanëve, por influenca e saj deri tani është kufizuar në jug, ku duket se gëzon popullaritet.... E vetmja lëvizje tjetër e rezistencës është ajo nën Kupin. Ai nuk është kompromentuar me armikun por deri tani nuk ka ndërmarrë veprime aktive kundër tyre. Ne kemi oficerë ndërlidhës me Kupin dhe L.N.C. por pothuajse të gjitha furnizimet tona i shkojnë L.N.C.-së"⁵⁶. Megjithatë, duket se edhe në këtë periudhë pati përpjekje nga ana e Britanikëve për të bashkuar grupimet e ndryshme të rezistencës kundër Boshtit dhe për të shmangur në këtë mënyrë luftën civile. Për këtë arsye, në Foreign Office u shtrua gjithashtu edhe problemi i një deklaratë tripalëshe (Angli, Bashkimi Sovjetik dhe SHBA), me qëllim që të

ushtrohej presion mbi lëvizjen Nacionalçlirimtare që ajo të hiqte dorë nga lufta kundër Abaz Kupit. Por edhe ky variant nuk gjeti zbatim⁵⁷.

Nga ana tjetër, vlerat e Ballit Kombëtar dhe Legalitetit si rryma të rezistencës Shqiptare po zbeheshin gjithnjë e më shumë. Gjatë kësaj periudhe, Philip Broad, këshilltar i Foreign Office në Bari dërgoi një telegram në Londër sipas të cilit, Kupi kishte bërë më pak progres sesa parashikohej fillimisht dhe aftësitë e tij ishin mbivlerësuar⁵⁸. Po kështu, në fillim të Qershorit, Forca 266 dërgoi dy telegrame në Londër ku theksonte se "Lëvizja e Legalitetit" ishte e papjekur, nuk gëzonte popullaritet, forcat e tij të armatosura akoma nuk përbënin një faktor serioz për luftën, dhe përfshinin 5.000 dhe jo 10.000 ose 25.000 persona të cilët ishin pa peshë politike dhe vetëm me influencë lokale si dhe me shumë raste bashkëpunimi me qeverinë kuislinge në Tiranë. Ndërsa Balli Kombëtar theksohej se vepronte si milici e Qeverisë kukull⁵⁹. Sipas disa oficerëve Britanikë, operacionet kundër armikut u zhvilluan vetëm nga partizanët dhe Oficerët Ndërlidhës të Aleatëve⁶⁰ të cilët që prej muajit Prill të 1943 deri në Nëntor 1944, i shkaktuan gjermanëve 6-7.000 të vrarë dhe 500 të plagosur.

Megjithatë disa oficerë Britanikë përkrahës të Kampit nationalist dhe të atashuar pranë tij, e shpjeguan humbjen e forcave nacionaliste shqiptare kryesisht dhe vetëm si tradhti e Britanisë së Madhe dhe ishin mjaft aktivë në akuzat e tyre duke pretenduar se me qëndrimin dhe mbështetjen materiale të dhënë, vendi i tyre i kishte shërbyer fitores së komunizmit⁶¹.

Gjatë muajit Shtator 1944, ballistët dhe zogistët ndërmorën një seri lëvizjesh kundër gjermanëve, veçanërisht prita në rrugën Shkodër-Tiranë⁶², veprime që Britanikët i konsideruan të vonuara në kohë, të parëndësishme dhe mjaft apatike, për rrjedhojë, ata vendosën që këto grupime të mos furnizoheshin me armë, duke i dhënë fund kështu variantit tjetër - propozimit të bërë nga SOE, për krijimin e Kupit si një kundërpeshë reale të Hoxhës. Për këtë arsye, kërkesa në rritje për të mbështetur LANÇ-in përkonte me kundërshtimin në rritje për të mos mbështetur Kupin⁶³.

Sidoqoftë, më 26 Shtator, Foreign Office ishte e detyruar të pranonte të vërtetën e hidhur se pas luftës Shqipëria do të binte nën regjimin e Hoxhës⁶⁴. Po në këtë datë, Sir Orme Sargent i cili kishte kryesuar mbledhjen e nivelit të lartë në Foreign Office më 19 Shtator dhe ku morën pjesë përfaqësues të Ministrisë së Luftës, SOE-ja, dhe

⁵⁷ Ballvora, Sh. *Zhvillimet politike...*, burim i cituar, f.555.

⁵⁸ Petrov, B. "Great Britain and the Resistance in Albania, 1943-1944", (Ettudes Balkaniques, no.2. Bulgaria: 2006), f.105.

⁵⁹ Ibid, f.107.

⁶⁰ TNA, Allied..., *Special Forces*, f. 135; *Partizan Resistance after German Occupation*, f.107.

⁶¹ Petrov, B. *Great Britain...*, no.2, f.115-117.

⁶² Ibid.

⁶³ Stephane Schwandner-Sievers and Bernd J. Fischer, *Albanian Identities, Myth and History*, Bailey, R. "Smoke without fire? Albania, SOE and the Communist Conspiracy Theory", f.152.

⁶⁴ Petrov, B. *Great Britain...*, no.2, f.115.

⁵⁴ Barker, E. *British Policy...*, f.123.

⁵⁵ Ballvora, Sh. *Zhvillimet politike...*, f.182.

⁵⁶ Pearson, O. "Albania in Occupation and War 1940-1945", f.372.

M.I.6, shënoi konkluzionet e takimit në një procesverbal të kësaj date të përgatitur për Sekretarin e Jashtëm, Anthony Eden: “Të gjitha përpjekjet tona për të arritur një marrëveshje ndërmjet Kupit dhe L.N.C kanë dështuar dhe nuk ka më perspektivë që të kemi sukses në këtë drejtim.... parashikohet që udhëheqësit komunistë të L.N.C do të drejtohen nga Rusia...”⁶⁵. Rrjedhimisht në Foreign Office u vendos që mbështetja duhej të kalonte tërësisht për LNÇL, si e vetmja forcë që luftonte kundër gjermanëve. Vetë Enver Hoxha do të shprehej më vonë se “Aleatët e kanë çmuar me të drejtë kontributin që ne i jepnim luftës së përbashkët. Dhe, qysh prej Qershorit 1943 ata dërguan pranë shtat-madhërisë së përgjithshme të ushtrisë sonë çlirimtare misione ushtarake dhe ndihma materiale të hedhura me parashutë...”⁶⁶.

Po në Shtator 1944, Palmer u shpreh: “Do të doja që në Shqipëri të zbrakonim dy brigada. Sigurisht nëse dëshirojmë të kemi një lloj kontrolli këtu pas lufte”⁶⁷. Sigurisht, një forcë okupuese Aleate në momentin e duhur në Shqipëri do të kishte ndryshuar rrjedhën e ngjarjeve. Shembulli i mirë për këtë është Greqia ku trupat Britanike hynë dhe u treguan të gatshme të pengonin grushtin komunist, por siç rezultoi, Shqipëria ishte një nga zonat ku politika Britanike kishte planifikuar zbatimin e “*deception strategy*”.

Si epilog i çështjes së Ballkanit, shërbeu marrëveshja e njohur e “përqindjes” e nënshkruar nga Churchill dhe Stalini në Tetor 1944, ku përcaktuan sferat e tyre të ndikimit në këtë rajon pas lufte. Në të vërtetë, kjo marrëveshje dëshmoi njohjen dhe pranimin nga ana e Britanikëve të dominimit Sovjetik në Evropën Qendrore dhe Lindore⁶⁸.

Me epërsinë dhe fitoren e dukshme tashmë të L.N.C. të udhëhequr nga PK, mbyllej edhe varianti i përdorimit të Zogut si kartë e mundshme duke finalizuar fitoren e komunizmit në Shqipëri. Më 16 Nëntor 1944, Denis Laskey i Departamentit Jugor të Foreign Officerit, raportoi në një procesverbal si më poshtë: “Mbreti Zog do të kishte qenë sunduesi më i mirë si nga pikëpamja e Shqipërisë ashtu edhe nga pikëpamja jonë, por një gjë e tillë tashmë është bërë e pamundur nga epërsia e L.N.C.-së. Prandaj duket se nuk ka alternativë që Mbreti Zog të mbetet në skenë, megjithëse gjithmonë ekziston mundësia që ai të kthehet në fuqi nëse përmbysset L.N.C..... Nuk ka arsye të dyshohet në bindjet e tij pro-Britanike, dhe influenca jonë në Shqipëri do të ishte shumë më e fortë me të si Mbret sesa me qeverinë (komuniste) të L.N.C.-së. Fatkeqësisht ai tashmë ka pak mbështetje në vend”⁶⁹.

Kështu dita e afërt e fitores u kurorëzua me ardhjen në pushtet të L.N.C. e udhëhequr nga Partia Komuniste.

⁶⁵ Pearson, O. *Albania in Occupation ...*, f.391.

⁶⁶ AMPJ, Dosja 162, viti 1946, f.210-211, (Referuar fjalimit të Enver Hoxhës në Konferencën e Paqes në Paris, Seanca plenare e datës 21.08.1946).

⁶⁷ Bailey, R. *The Wildest Province: SOE ...*, f.319.

⁶⁸ Agnes, B. “*British Confederation Plans concerning Central and Eastern Europe, 1939-1945*”.

⁶⁹ Pearson, O. *Albania in Occupation ...*, f.408.

Konkluzion

Si viktimë e parë e agresionit fashist, Shqipëria nuk e radhiti veten në asnjë moment në Boshtin Fashist.

Pushtimi Italian i Shqipërisë, njohu krijimin, rritjen dhe intensifikimin e rezistencës shqiptare e cila u përfaqësua nga tre grupime të ndryshme politike - Partia Komuniste, Balli Kombëtar dhe Legaliteti - secili me një program të përcaktuar qartë, por që nuk arritën të bashkohen dhe të bashkërendojnë luftën e tyre kundër pushtuesit të përbashkët. Këto lëvizje u karakterizuan nga rivaliteti, konflikti, akuza dhe përçarja, deri në luftën civile ndërmjet tyre. Balli Kombëtar dhe Legaliteti nuk arritën të bëhen faktor serioz dhe me influencë politike në luftë. Ajo që fitoi mbështetje më të gjerë popullore, që pati epërsinë ushtarake dhe peshën politike ishte L.N.C. e udhëhequr nga PK.

Por zhvillimet e brendshme, ishin të lidhura ngushtë me influencën e faktorit ndërkombëtar. Shqipëria u rendit e tëra në Aleancën Antifashiste që nga fillimi i Luftës e deri në fund. Objekti kryesor i Britanisë së Madhe, në kuadrin e planeve të Treshes së Madhe Aleate gjatë L2B ishte Gjermania, duke bërë që vendimet mbi Shqipërinë (ashtu si në vendet e tjera të Ballkanit) të mos merreshin mbi bazën e planeve politike afatgjata por strategjive ushtarake afat-shkurtra. Megjithatë, në dritën e strategjisë së përgjithshme të L2B-së kjo politikë kishte logjikën e saj.

Pas qëndrimit indiferent ndaj pushtimit Italian të Shqipërisë dhe pas dështimit për të organizuar një kryengritje të përgjithshme në Shqipërinë e Veriut në vitet 1940-1941, skena politike kishte ndryshuar në vitin 1943 kur vatra e luftës në Mesdhe u zhvendos nga Afrika e Veriut në Evropën e Jugut. Në kuadrin e strategjisë aktuale të luftës, misionet Britanike të dërguara në Shqipëri për të nxitur luftën guerile, sabotimin dhe shqetësimin e armikut në prapavijat e tij, kishin detyrë të mbështetnin çdo forcë rezistence që do të zhvillonte luftë aktive kundër armikut. Këta oficerë dërgonin raporte lidhur me gjendjen në Shqipëri duke u bazuar në opinionet personale sipas grupimeve ku ishin atashuar: oficerët britanikë pranë forcave të L.N.C. mbështesnin luftën partizane dhe ato pranë Abaz Kupit mbështesnin luftën e forcave nacionaliste. Madje pati nga ata të cilët fitoren e komunizmit në Shqipëri e quanin “tradhti” të Britanisë së Madhe. Për rrjedhojë, shpesh raportet e tyre ishin kontradiktore duke krijuar konfuzion dhe paqartësi në ambientet e Foreign Office dhe SOE-së, lidhur me ecurinë e zhvillimeve aktuale në Shqipëri.

Megjithatë, pavarësisht dilemave dhe paqartësive të herëpashershme lidhur me rrymat politike që duhej të mbështetnin, përdorimin e figurës së Zogut, përpjekjet për bashkimin e të gjitha forcave të rezistencës, shmangien e luftës civile, kërcënimin sovjetik në SEE, etj., ajo që del qartë është se Shqipëria nuk bënte

pjesë në listën e prioriteteve politike afat-gjata të Britanisë së Madhe. Vendimet e marra për Shqipërinë dhe zhvillimin e planeve Britanike aty gjatë L2B-së ishin në përputhje me strategjitë aktuale ushtarake të përqendruara vetëm në fitoren ndaj forcave të Boshtit.

Konkretisht, Politika Britanike vendosi se forca kryesore aktive në luftën kundër Boshtit ishte L.N.C. dhe për rrjedhojë i ofroi mbështetjen e suksesshme nëpërmjet furnizimeve me armë, të holla, veshje, ushqime, etj., nga deti e ajri. Kjo mbështetje materiale, por edhe politike e morale, ndikoi në mënyrë vendimtare në fitoren e komunistëve të cilët instaluan pushtetin e tyre diktatorial e izolacionist për vite të tëra në vazhdim.

Bibliografia

- Arkivi Qendror Shtetëror (AQSH);
 Arkivi Ministrisë së Punëve të Jashtme (AMPJ);
 The National Archives, (TNA), Allied Mission, HS 7 70, 1942-1945;
 The National Archives, (TNA), Military Liaison-Albania, CAB 106459;
 "Documents on British Foreign Policy 1919-1939", Vëllimi V, Her Majesty's Stationery Office, London: 1962;
 Barker, E. "British Policy in South-East Europe in the Second World War", The Macmillan Press LTD, 1976;
 Bailey, R. "The Wildest Province: SOE in the Land of Eagle", Vintage Book, London: 2008;
 Neuwirth, H. "Qëndresë dhe bashkëpunim në Shqipëri: 1939-1944", Instituti i Dialogut dhe Komunikimit, Tiranë, 2006.
 Puto, A. "Shqipëria Politike", Botimet Toena, Tiranë 2009;
 Pearson, O. "Albania in Occupation and War 1940-1945", The Centre for Albanian Studies, 2005;
 Puto, A. "Nëpër Analet e Diplomacisë Angleze", burim i cituar, albin, Tiranë: 2001;
 Oakley-Hill, D. "Një Anglez në Shqipëri", Botimet Koçi, Tiranë, 2006;
 Akademia e Shkencave të Shqipërisë, "Historia e Popullit Shqiptar-Shqiptarët gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe pas saj 1939-1990", Vëllimi IV, Toena, 2009;
 Hibbert, R. "Fitorja e Hidbur", Pinter Publisher, London and New York, 1991;
 Hoxha, E. "Rreziku Anglo-Amerikan për Shqipërinë", Shtëpia botuese "8 Nëntori", 1982;
 Stephane Schwandner-Sievers and Bernd J. Fischer, *Albanian Identities, Myth and History*; Bailey, R. "Smoke without fire? Albania, SOE and the Communist Conspiracy Theory", C. Hurst & Company, London, 2002;
 Vickers, M. "Shqiptarët: një histori moderne", London; New York: I.B. Tauris, 2011;
 Ballvora, Sh. "Zhvillimet politike në periudhën e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare", Shtëpia Botuese Dituria, 2004;
 Petrov, B. "Great Britain and the Resistance in Albania, April 1939-1941", *Ettudes Balkaniques*, no.1. Bulgaria: 2004;
 Petrov, B. "Great Britain and the Resistance in Albania, 1943-1944", *Ettudes Balkaniques*, no.2. Bulgaria: 2006;
 Agnes, B. "British Confederation Plans concerning Central and Eastern Europe, 1939-1945", <http://www.koed.hu/penta/agnes.pdf>.

OPINION

Reforma në drejtësi duhet të kalojë nëpërmjet një kushtetute të re _____

(Disa pikëpamje mbi reformën në drejtësi dhe rolin e institucioneve përkatëse)

_____ **Dr. Çlirim Gjata** _____

Abstrakt

Në këtë punim nuk është se do të gjenden ide tejet të reja, të parrahura më parë. Këto pikëpamje janë diskutuar, goftë edhe përciptazi kah ora, por janë mendime me të cilat unë jam pajtuar e i përkrah për shkak edhe të përvojës dhe studimeve të mia në këtë fushë. Ndaj dhe kam argumentuar se duhet një kushtetutë e re që të kemi një ndërtim të një sistemi drejtësie të ri. Nuk mundet ky raport kushtetues, që qëndron mbi drejtësinë, të garantojë një rindërtim të sajë. Koha e provoi këtë, sepse ishte ky ndërtim kushtetues që i mundësoi drejtësisë të vinte në gjendjen e sotme, sa të kërkohet një ndryshim kaq rrënjësor. Ky është dhe thelbi i shkrimit, ndaj jam përqendruar në një Kushtetutë të re, institucionet e larta të drejtësisë, Gjykata e Lartë, KLD-ja, Ministria e Drejtësisë, arsimit juridik, etj. Është e pamundur të analizohen të gjitha dhe artikulli asesi nuk pretendon të jetë shterues. Përkundrazi duhen hapur debate të mëdha publike për secilën fushë më vehte. Gjithashtu mungojnë detajet, sepse ndryshe nuk do të mjaftonte e gjithë revista, ndaj dhe shpresoj që juristët apo dhe të interesuarit, që do ta lexojnë shkrimin, të më kuptojnë. Më shumë se gjithçka nga ky artikull pretendoj të hap një debat, duke shpresuar që, reforma në drejtësi të mos mbyllet shumë shpejt si gjithmonë dhe pas ca viteve, kur të shohim rezultatet, përsëri ti kthehemi nga e para. A nuk po ndodh edhe sot e njëjta gjë?

Duke parë punën dhe diskutimet që po bëhen në lidhje me reformën në drejtësi, si dhe faktin që po kërkohen mendime profesionale, po mundohem në mënyrë koncize të paraqes disa pikëpamje të miat.

Së pari, duke lexuar strategjinë e reformës dhe plan veprimin e grupit të ekspertëve, të publikuara në rrugë elektronike, nga media, apo diskutime të ndryshme në panele (i kam ndjekur me vëmendje), bie në sy transparenca që po karakterizon këtë reformë në ndryshim nga deri tani, ku ndërhyhej në ligje shumë të rëndësishme për drejtësinë siç janë p.sh. Kodet - Penale, Civile, Procedurale, etj., dhe juristët i mësonin vetëm në Fletoret Zyrtare pas botimit.

Së dyti, do të ishte më e vlefshme për reformën, nëse merren mendime dhe nga ata që e zbatojnë të drejtën në terren dhe sjellin përvojën e madhe nga praktika, siç mund të jenë gjyqtarët, prokurorët apo avokatët me përvojë, si dhe punonjës të administratës së lartë apo lokale të cilët mund të parashtrajnë problematika që vetëm jeta e përditshme mund ti krijojë dhe që vetëm ata mund ti parashikojnë.

Kështu për shkak të transparencës dhe debatit publik që po zhvillohet mësova që do të ndërhyhet në Kushtetutë me ndryshime në lidhje me KLD-në, rolin e Presidentit gjyqësor, Gjykatën e Lartë, etj.

Momentet më delikate, mendoj unë, në këto ndryshime do të jenë pikërisht procedura e përzgjedhjes së atyre që do të shërbejnë në këto institucione, si dhe funksionimi i institucioneve që do drejtohen nga këta të përzgjedhur.

Në këtë artikull nuk do të shtjelloj mbi projektet që paraqiten, as në mënyrë kritike madje. Por do të paraqes thjeshtë idetë për disa nga elementët e kësaj reforme. Gjithsesi ky shtjellim nuk mund të jetë shterues dhe paraqitet tejet sipërfaqësor për të gjitha përcaktimet e mëposhtme, të cilat mendoj se janë të nevojshme për reformën në drejtësi. Kjo pasi është e pamundur të hysh deri në detajet më të vogla sepse s'do kishte fund.

Ndryshimet Kushtetuese

Mendoj që duhet një Kushtetutë e re, nga e para. Një Kushtetutë të re ku të parashikohet Senati si dhomë e lartë e parlamentit, dhe Presidenti i zgjedhur nga populli.

Kuptohet kjo kërkon një kompromis të madh politik, por këtu duhet të fillojë reforma për të kaluar në drejtësi. Pra, një reformë rrënjësore shtetërore ku do të bazohet ajo në drejtësi.

Kushtetuta jonë është miratuar nga Parlamenti dhe pastaj është ratifikuar me referendumin popullor në nëntor 1998 (hyrë në fuqi më 28 nëntor 1998). Që nga kjo ditë e deri më sot kanë kaluar gati 17 vite. Pra, kemi një Kushtetutë tejet të re, që po ta krahasojmë me një makinë fabrike të blerë me zero-km, do të thotë që nuk është e pashtuar akoma.

Por për një kohë kaq të shkurtër kjo Kushtetutë është ndryshuar tre herë dhe po përgatitet e katërta, të cilat kanë prekur strukturën bazë shtetërore, parimet bazë të ndarjes së pushteteve, raportet ndër-institucionale, *check and balance*-en (sidomos ai i 2008-ës). Pra, vetëm për 17 vite kemi ndërhyrë në themelet e shtetit katër herë.

Po të marrim shembullin me makinën e re, është si të ndërhysh në motorin e saj katër herë - është shumë për një makinë fabrike - pra, diçka është bërë me defekt në këtë makinë. Kështu edhe Kushtetuta jonë e ndryshuar katër herë për 17 vite - është shumë për një Kushtetutë të re demokratike - e cila tregon jo vetëm që në vitin 1998 gjërat nuk janë bërë mirë, por edhe paqëndrueshmërinë e demokracisë tonë.

Nga kjo përvojë kush garanton se pas pak vitesh Kushtetuta nuk do të ndryshojë përsëri, për të pestën, ose të gjashtën apo 20-tën herë. Do vihej bast për këtë dhe do të fitohej. Kushtetuta jonë përditë e më shumë po harnohet dhe kjo ngjan me pantallonat e atij të varfrit që kaq shumë ishin harnuar sa nuk gjendej copa origjinale. Dhe, po vazhdoi kështu, nuk do jetë e largët dita kur edhe Kushtetutës sonë nuk do ti gjendet pjesa origjinale e '98-ës.

Në këto kushte mendoj që ndoshta duhet një Kushtetutë e re, nga e para. Kuptohet kjo kërkon një kompromis të madh politik, por kompromis vetëm për atë që do të kemi një kushtetutë të re. Ndërsa, për sa i takon vetë kushtetutës në përmbajtje, duhen ekspertët teknikienë, të cilët duhet të shfrytëzojnë të gjithë përvojën pozitive e negative të këtyre 17 viteve dhe politika, sipas pikëpamjes së drejtë, do të qëndrojnë larg. Miratimi duhet t'i kapërcejë kufijtë e parlamentit dhe të organizohet një Asamble Kushtetuese e më pas mund të kalohet në referendum.

Gjithashtu ka edhe një paradoks që po shoqëron këtë reformë në opinionin publik. Atë, që e thënë në mënyrë metaforike - *a do ta presë politika me sëpatë degën e pemës ku është mbështetur vetë?* Pra, politika do krijojë me ligjet e miratuara, një drejtësi aq të pavarur sa ta dënojë atë-politikën. Ngjan e pabesueshme. Ndaj duhet ndryshimi i madh pikërisht për të eliminuar këtë paragjykim.

Ndaj mendoj se duhet një transformim rrënjësor duke hartuar një Kushtetutë të re pikërisht me institucione të tilla që të mos kenë lidhje dhe as mundësi lidhjeje me politikën e sotme.

Mendoj se kjo Kushtetutë duhet të konsistojë në ndryshime të mëdha strukturore nga sot, sidomos në ato të mënyrës së përzgjedhjes dhe organizimit të pushteteve. Ne duhet të krijojmë parlamentin me dy dhoma, të ngremë Senatin dhe Presidentin që të zgjidhet nga populli. Na rezulton se populli është mbajtur mjaft larg çështjeve themelore të pushtetit.

Parlamenti me një dhomë siç është i organizuar tani nuk ka dhënë rezultatet e pritshme. Ne kemi të sanksionuar në Kushtetutë konceptin "*Republikë Parlamentare*". Por a ka sjellë parlamentarizmi rezultatet e pritshme? Jo më kot, Kushtetuta për kaq kohë është ndryshuar tre herë dhe po përgatitet e katërta. Dhe nuk ka asnjë kushtetutë në Europën Perëndimore që ta ketë një përcaktim të tillë të sanksionuar, megjithëse Republika parlamentare ka plot.

Duke sanksionuar sistemin e "*Republikës Parlamentare*" në Kushtetutë, ku nënkuptohet se Parlamenti është organi më i lartë i pushtetit shtetëror, siç ka qenë e sanksionuar në Kushtetutën e vitit 1976. Në vend të kësaj mjafton të kemi parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve.

Ndërkohë Parlamenti jonë është mbarsur me kompetenca të shumta të cilat kanë çuar në një centralizëm të tipit të vjetër dhe cenim të ndarjes e të balancimit me pushtetet e tjera. E pra, demokracia jonë ngecën vazhdimisht dhe ndërhyjnë ndërkombëtarët për të zgjidhur konfliktet. Përse këto konflikte nuk gjejnë zgjidhje në Kushtetutë?

Jo vetëm kaq, por a ka shërbyer Kushtetuta jonë edhe si burim krizash e konfliktesh, deri atje sa është bllokuar funksionimi i komunikimit institucional Parlament-President. Apo në të kaluarën kur ka pasur edhe bllokime të marrëdhënieve Parlament-Qeveri deri për emërim ministrash, ku as qeveria nuk binte, as parlamenti nuk tërhiqej. Këtë mundësi ta jep kjo Kushtetutë. Si mund të qeveriset kështu??

Votimi me 84 vota nuk e zëvendëson asesi Senatin në asnjë aspekt. Përvoja e gjithë këtyre viteve ka treguar se Parlamenti jonë përfaqësohet nga mazhoranca dhe mazhoranca nga kryetari. Pra, Senati së pari do të sillte një decentralizim, aq të nevojshëm, për funksionimin e shtetit në demokraci. Kuptohet, që Senati detyrimisht duhet të përfaqësohet nga elita politike, intelektuale e morale e vendit nëpërmjet një sistemi zgjedhor, që mundëson këtë, atëherë gjërat do të jenë ndryshe.

Kështu, do të rritej kontrolli mbi parlamentin (mazhorancën dhe drejtuesin e saj, kushdo qoftë ky); cilësia e ligjeve do përmirësohej, të paktën ligjet do shpëtonin nga hartimi për interesa të momentit të politikës; të gjithë ato emërimet nëpër institucionet e pavaruara, që sot bëhen nga parlamenti, duke iu nënshtruar Senatit të paktën mund të shpëtojnë nga militantizmi partiak që shoqëron rëndom mazhorancat tona parlamentare për interesat e tyre politike dhe elektorale.

Ndërsa për sa i takon Presidentit, më duket më me vend që të zgjidhet nga populli. Nuk është zgjidhje ajo, që një herë i hiqen disa kompetenca në një krah e një herë në një tjetër. Përvoja ka treguar se ky tip Presidenti këto 17 vite nuk ka funksionuar, por ka sjellë përplasje politike. Dhe kjo nuk është çështje faji, por mënyre se si funksionon konstitucionalisht një President.

Kjo kushtetutë ka sjellë konflikt që nga mënyra e zgjedhjes së Presidentit, të funksionimi i tij si institucion tejet i rëndësishëm e deri te raporti i tij, me institucionet e tjera kushtetuese. Si shembull të thjesht po përmendim mosmiratimin nga ana e këtij parlamenti të asnjë dekreti të këtij presidenti, për dy vite rresht. Kush garanton në përmirësim të këtyre raporteve, apo mos përsëritjen në të ardhmen edhe kur të kemi një president tjetër? Dhe gjërat nuk rregullohen duke shmangur kushtetutshmërisht Presidentin (duke e zhveshur nga kompetencat), pasi, normalisht pse do na duhej një President?! Duke i hequr kompetencat Presidentit do t'i krijohej një gjendje pasigurie e mosbesimi në masë.

Po ndaloj vetëm të zgjedhja e presidentit. Me 84 vota apo 71vota (në Gjermani Presidenti zgjidhet me shumicë të thjeshtë - a nuk është Gjermania

një shtet demokratik??). Është shpenzuar kohë e energji ekspertësh për këtë sa është kthyer në një banalitet. Në vend që të shpenzohej kjo energji profesionale për kompetencat e presidentit dhe raportit të tij me pushtetet e tjera, që të mos kishte konflikt, ose të paktën të parashikoheshin zgjidhje kushtetuese konflikti, kemi kaq vite që merremi me numrat e zgjedhjes së tij nga parlamenti.

A nuk duket paradoksale që të shkohet në zgjedhje parlamentare të parakohshme, madje disa të tilla, për të arritur në zgjedhjen e një Presidenti. Ndërkohë që fare mirë mund të bëhen vetëm një palë zgjedhje presidenciale nga populli.

Dhe nëse kemi një Parlament të zgjedhur nga populli, një Senat po nga populli - elitë kontrolluese mbi parlamentin dhe një President gjithashtu direkt nga populli, atëherë do të funksiononte shumë më ndryshe ajo që demokracia ka më shumë nevojë, decentralizimi dhe kontrolli i pushteteve. Mazhorancat politike nuk do të mund të abuzonin kaq lirë sa sot me pushtetin. Kuptohet kjo duhet shoqëruar edhe me balancimin e pushteteve sepse ç'kuptim do të kishte, që një pushtet të ketë 100 kompetenca dhe tjetri vetëm një.

Le të shohim tashmë më konkretisht raportin e kësaj që parashtrua më lart me drejtësinë në favor të së cilës po realizohet reforma.

Në raport me drejtësinë këto institucione si Senat - President do të ishin garantuese të përzgjedhjes së funksionarëve me integritet të lartë profesional e moral që do të shërbenin në organet e larta të drejtësisë, pasi përvoja ka treguar që të zgjedhurit nga parlamenti jo gjithmonë i kanë shpëtuar militantizmit partiak, apo dhe interesave klanore.

Gjithashtu mendoj që Presidenti krijon një Këshill Konsultativ i cili komunikon me Gjykatën e Lartë e Prokurorin e Përgjithshëm në lidhje me kontrollin e gjyqësorit dhe prokurorisë e cila shqyrton masat e paraqitura nga kjo e fundit dhe Prokurori i Përgjithshëm, pasi është konsultuar me Këshillin Konsultativ (mund të quhet edhe ndryshe).

Drejtësia që përfaqësohet nga pushteti gjyqësor, detyrimisht duhet të udhëhiqet nga parimi i madh i pavarësisë dhe paanësisë, parim ky pa të cilin nuk ka drejtësi. Por nëse drejtësia nuk është e pavarur nga pushtetet e tjera sidomos ato politike, nuk ka si të jetë e paanshme me palët në gjykim. Dhe këtë na e mëson përvoja, ata gjyqtarë që zbatojnë urdhrat politike në trajtimin e çështjeve, janë edhe gjyqtarët më të korruptuar.

Si mund të ngrihet një pushtet gjyqësor i pavarur; d.m.th. një sistem gjyqësor, ku mundësia e varësisë dhe korrupsionit të bëhen ekstremisht të pamundura. Ndaj duhet nisur që nga procedurat e përzgjedhjes, funksionimit, kontrollit dhe të përgjegjësisë së pushtetit gjyqësor. Ky sistem që kemi sot, jo vetëm që nuk mundëson pavarësinë dhe paanësinë e gjyqësorit por madje edhe ushqen mundësinë e korrupsionit. Kjo tashmë është e provuar, përndryshe përse po ndërmerret kjo reformë në drejtësi.

Institucionet e larta të drejtësisë

Funksionarët e lartë të drejtësisë që shërbejnë në organet kushtetuese të drejtësisë, si anëtarët e Gjykatës së Lartë asaj Kushtetuese me Kryetarët respektiv, Prokurori i Përgjithshëm, apo dhe drejtuesit e institucioneve ose agjencive të pavarura të emëroheshin nga Senati me Presidentin sipas një procedure kushtetuese.

Do të ishte e udhës që të fillohej nga institucionet e larta të drejtësisë, ato që parashikohen direkt në kushtetutë. Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, asaj Kushtetuese së bashku me Kryetarët respektivë, si dhe Prokurori i Përgjithshëm sot emërohen me dekret të Presidentit dhe pëlqehen nga parlamenti. Kjo procedurë ka sjellë konflikt President-Parlament dhe bllokimin e institucioneve pasi mëse njëherë nuk miratohen kandidaturat për arsye të ditura.

Mendoj që përzgjedhja e kandidaturave në këto funksione të realizohet nëpërmjet Senatit dhe Presidentit. Senati ti propozonte Presidentit 3 deri në 5 kandidatura për një funksion të lartë në drejtësi, pas një konkurrimi transparent, moral dhe profesional, mbi bazë kriteresh të rrepta kushtetuese dhe Presidenti dekretonte njërin dhe ky bën betimin (po jap vetëm një zgjidhje tepër të thjeshtëzuar teknike, pasi këto procedurat e vogla mund të diskutohen pa fund). Por e rëndësishme është që ti emërojë Senati me Presidentin.

Për sa i takon Gjykatës Kushtetuese, mendoj se duhet parë nën prizmin e funksionit më tepër se në atë të përzgjedhjes. Përzgjedhja mund të realizohet me të njëjtën procedurë si më lart e kam parashtruar, Senat -President. Ndërsa funksionimi duhet studiuar në efektivitetin e punës së kësaj Gjykate sot si institucion kushtetues.

Gjykata Kushtetuese nuk është pjesë e sistemit të drejtësisë. Ajo u formua për të pasur një kontroll kushtetues në mbrojtjen e të drejtave të njeriut në demokraci, nga abuzimi i mundshëm i legjislativit dhe ekzekutivit e këtu u përfshi edhe puna e gjyqësorit.

Po të studiohet puna e kësaj Gjykate nën frymën e statistikave na rezultojnë një pjesë e vogël e punës së saj vjetore iu takon kontrollit të ligjeve apo VKM-ve për kushtetutshmëri. Ndërsa shumica e punës vjetore i takon kontrollit kushtetues të vendimeve gjyqësore për procedurë të rregullt. Pra, Gjykata Kushtetuese është kthyer në një *quasi* gjykatë e shkallës së katërt. Ndërkohë që palët për këtë shkojnë edhe në GJEDNJ, Strasbourg.

Është e papranueshme që Gjykata Kushtetuese të analizoje provat si gjykatë fakti, për proces të parregullt gjyqësor, siç ka ndodhur në mëse një rast. Apo të shqyrtojë Vendimet Unifikuese të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, gjë që për mendimin tim është antikushtetuese pasi Vendimi Unifikues vetë, parashikohet nga Kushtetuta. Kjo sjell përplasje institucionale mes gjykatave.

Mund të organizohen të dy gjykatat në një, në formën e një *supreme court*. Por kjo nuk përbën ndonjë emergjence në problemet që paraqiten në reformën e drejtësisë. Por meqë kam mendimin për një Kushtetutë të re e përmenda edhe këtë.

Prokurori i përgjithshëm gjithashtu duhet ti nënshtrohet të njëjtës procedurë zgjedhjeje, Senat – President. Për më gjatë duhet të flasin ekspertët e prokurorisë.

Por ajo që paraqet jo pak interes, është mënyra e shkarkimit të tyre. *Së pari* të gjithë funksionarët kushtetues duhet të kenë mandat kohor funksionimi. Personalisht jam kundër gjyqtarit të përjetshëm në Gjykatën e Lartë. Po kështu çdo drejtues institucioni i lartë që zgjidhet nga formula Senat-President duhet të ketë mandat. Mandati është garanci.

Formula e parashikuar sot në Kushtetutë është një formulë e drejtë dhe garanton paprekshmërinë abuzive të funksionarëve të lartë të drejtësisë (shkarkohen nga parlamenti për shkaqe të parashikuara në Kushtetutë, me jo më pak se 2/3 e votave dhe shqyrtohet ky shkarkim direkt nga Gj. K.), me përjashtim të Prokurorit të Përgjithshëm i cili shkarkohet edhe me 71 vota dhe pa mbrojtje në Gj. K.

Shkarkimi mendoj, është po aq i rëndësishëm sa edhe emërimi. Sepse mund të emërohet një personalitet moral dhe profesional në drejtësi, i pavarur dhe i pa korruptueshëm. Por nëse parlamenti *alias* politika mund ta shkarkojë kurdo me shumicë të thjeshtë, atëherë mungon garancia për vendin e punës dhe si i tillë bie i gjithë personaliteti dhe pavarësia.

Ndaj kjo formulë shkarkimi, nëse reformohet duhet të dalë jashtë Parlamentit dhe të shkojë më në favor të funksionarëve duke u kufizuar shkarkimi vetëm nga Gjykata Kushtetuese, ose e Lartë. Gjithashtu duhet shtrirë mbi të gjithë drejtuesit e institucioneve të pavarura, vetëm kështu ata do të kishin garanci për pavarësinë e tyre në ushtrimin e funksioneve. Edhe politika në këtë mënyrë do jepte shenja garancie, që është e gatshme të pranojë një shtet ligjor.

Funksioni i Gjykatës së Lartë

Gjykata e Lartë duhet sanksionuar si një gjykatë që vendos kolonat e drejtësisë, si një gjykatë që bën doktrinë, që bën shkencë, që shtron themelet ku do të mbështet i gjithë gjyqësori ynë në zbatimin e drejtësisë. Po nuk kuptuam këtë është e kotë të flasim për organizimin e gjyqësorit. Pas kësaj mund të përcaktohet emri “*i lartë, kasacioni*” etj.

Kjo sepse drejtësia duhet të fillojë nga Gjykata e Lartë. Është kjo e fundit që me vendimet, praktikën doktrinën e hartuar nga ajo, vendos shtyllat e funksionimit të drejtësisë në shkallët më të ulëta. Prandaj është shumë e rëndësishme mënyra se si ndërtohet kjo gjykatë, kompetencat, funksionet që ajo duhet të ndërmarrë.

Le të merret si shembull sanksionimi i bërë në Kushtetutën e Greqisë mbi Gjykatën e Lartë - po citoj: “Gjykata e Lartë udhëheq kontrollin dhe është direkt

e interesuar për mbarëvajtjen e veprimtarisë së gjykatave”. Nga kjo do të rezultonte se parandalimi i shkeljes së ligjit është shumëfish më i vlefshëm nga sanksioni kundër shkeljes.

Prandaj edhe një herë e theksoj se përzgjedhja e anëtarëve të Gjykatës së Lartë duhet të kalojë nëpërmjet Senatit dhe Presidentit. Ndërsa, sa i takon funksionimit të saj në lëndë duhet të kemi parasysh faktin se, Gjykata e Lartë nuk duhet konsideruar si një gjykatë që zgjidh ngushtësisht konfliktet mes palëve - të tipit, fiton A dhe humb B dhe siç konsiderohen me të drejtë gjykatat e shkallës së parë apo të Apelit. Ajo duhet të dalë nga ky “kurth” i drejtësisë.

Si funksionon sot praktikisht Gjykata e Lartë? Çdo qytetar që ndodhet në një proces gjyqësor (palë), civil a penal, ka të drejtë ligjërish të drejtë Gjykatës së Lartë me rekurs. Kështu të gjitha gjykimet në Republikën e Shqipërisë, potencialisht përfundojnë për shqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Pra, e gjithë Shqipëria vjen në Gjykatën e Lartë, pasi është gjykuar në 30 gjykata rrethi dhe 8 Gjykata Apeli. Kemi krijuar kështu *de facto* sistemin e drejtësisë me tre shkallë që nuk ekziston askund. Kjo s'ka logjikë, sepse puna e gjithë gjykatave të vendit duhet të kalojë nëpërmjet një gjykate të vetme, që është Gjykata e Lartë. Në këto kushte Gjykata e Lartë për efekt cilësie edhe kohe, është kthyer në një “fabrikë që grin” dosje pa fund, ndërkohë që kontrolli pothuajse nuk ekziston, duke bërë që niveli i gjyqësorit poshtë të paraqitet tejet i ulët.

Prandaj në funksionimin e sajë, përpara se ta emërtojmë Gjykatën e Lartë, duhet ndryshuar dhe hequr procedura e ankimit me rekurs 30 ditor nga kushdo si një e drejtë e pakufizuar dhe të kthehet procedura e kontrollit për shkak të cenimit të ligjit, me një mjet procedural siç është Rekursi në Interes të Ligjit, mund të quhet gjithsesi. Kjo do ta rriste cilësinë e vendimeve të sajë, fuqinë e kontrollit mbi shkallët më të ulëta në gjyqësor e prokurori dhe për pasojë do të rriste edhe nivelin e cilësisë së punës së tyre.

Gjithashtu i duhet dhënë një rol të veçantë rregullimit ligjor mbi mënyrën e funksionimit të Kolegjeve të Bashkuara, sidomos në marrjen e vendimeve unifikuese si precedent shkencor. P.sh. nuk mund të konsiderohet vendim unifikues ai që merret me 10 vota pro e 9 kundër. Të paktën të veprojë edhe këtu parimi i votimit të cilësuar me 3/5 e votave.

Kontrolli nga Gjykata e Lartë

Mendoj që kontrollin mbi gjykatat të bëhet nga Gjykata e Lartë, sepse kjo kontrollon vendimet e atyre më të ulëta, gjithashtu edhe punën e prokurorisë, pasi kjo paraqitet në gjykatë. Dhe kur vëren shkelje të rënda nga ana e gjykatësit ia dërgon këshillit konsultativ të Presidentit për masë, i cili vazhdon procedurat e veta (e kam prekur më lart).

Që të kemi një kontroll sa më efikas mbi cilësinë e punës në gjyqësor, Gjykata e Lartë duhet të vihet në lëvizje jo me mjet ankimor siç është rekursi për një çështje gjyqësore, por pasi çështja është kontrolluar nga inspektorët e Gjykatës së Lartë ushtrohet nëpërmjet një procedure e drejta e rishqyrtimit, që mund të jetë nga Kryetari ose nga një koleg prej 3 anëtarësh (këto janë teknikalitete që rregullohen me ligj) dhe më pas kolegji prej 5 anëtarësh e gjykon, apo kur është rasti për vendime unifikuese nga Kolegjet e Bashkuara. Kështu del në pah edhe cilësia e punës së gjyqtarit përkatës konkretisht me emër.

Suprimimi i KLD

Mendoj që KLD-ja duhet të suprimohet dhe jo të reformohet. Në vend të saj Presidenti krijon një organ konsultativ, i përcaktuar ky ligjërish, dhe në bashkëpunim me Gjykatën e Lartë, Shkollën e Magjistraturës apo dhe Ministrin e Drejtësisë si dhe mbi bazën e konkurrencimit transparent bën emërimet në dy shkallët e gjyqësorit.

Për sa i takon KLD-së, qytetarët e kanë humbur besimin në këtë institucion. Kjo duket deri te përgjigjet që nëpunësit e KLD-së ju kthejnë ankesave të tyre. Krejtësisht kompjuterike, uniforme, ku ndryshojnë vetëm emrat dhe vetëm zgjidhje nuk ka.

Edhe parti politike, apo figura të ekstremit nacionalist kanë dalë nga ky institucion, por kontrolli mbi gjykatat nuk ka funksionuar dhe gjyqësori ka shkuar keq e më keq.

Duke filluar që nga kontrollat jo efektive dhe jo të plota, KLD-ja nuk e ka justifikuar ekzistencën e saj si organ kushtetues. Në kushtet ku ndodhet gjyqësori sot, tejet i korruptuar dhe i paaftë, çfarë ka bërë KLD-ja për të përmbushur misionin e tij? Për 8 vitet e fundit ky institucion nuk ka shkarkuar asnjë gjykatës si pasojë e kontrollit të tij mbi punën e gjykatave, por vetëm ato raste kur janë kapur në korrupsion nga emisionet e TV-ve me kamera të fshehta, pra jashtë KLD-së. Mendoj se KLD-ja ka rënë si institucion.

Nuk mund të mos përmendet edhe raporti Ministër i Drejtësisë (MD) - KLD, në organizim dhe funksion. Kontrollin që KLD-ja ushtron ndaj gjyqtarëve, inicohet nga Ministri i Drejtësisë, i cili i propozon KLD-së masën përkatëse për gjyqtarin. Dhe rezultatet janë këto që janë dhe që dihen. Ministri i Drejtësisë dhe KLD-ja e kanë parë njëri tjetrin më shumë si kundërshtarë politikë, se sa bashkëpunues në një mision. Është e pavend që Ministri i Drejtësisë, si përfaqësues i ekzekutivit, të propozojë masa disiplinore për gjyqtarët. Kjo vjen krejtësisht në kundërshtim me parimin e ndarjes së pushteteve.

Një kontraditë tjetër është edhe fakti se a mund të kontrollohet një vendim gjykatë nga KLD-ja apo MD-ja, kur ai akoma nuk është shqyrtuar nga gjykata e

Apelit, apo është në shqyrtim në Gjykatën e Lartë? Ndërkohë parimi është që, një vendim i një gjykate më të ulët kontrollohet vetëm nga një gjykatë më e lartë në rrugë ankimore. Kontrolli nga KLD-ja dhe MD-ja pa kaluar shkallët e gjyqësorit shton abuzimin dhe mban peng gjyqtarin. Kjo përbën ndërhyrje dhe presion mbi gjyqësorin ku dhe është në kundërshtim me Kushtetutën.

Prandaj jam për suprimimin e KLD-së, si dhe për organin dhe kontrollin nga Gjykata e Lartë. Sepse kjo e fundit e kontrollon një vendim gjyqësor në thelbin e vet, aty ku nuk mund të fshihet asgjë. Puna e gjyqtarit konkretizohet te vendimi dhe pikërisht te arsyetimi i vendimit gjyqësor. Arsyetimi i vendimit është pasqyra e punës së gjyqtarit, aty ku një gjyqtar nuk shpëton dot për gjithë jetën.

Nga arsyetimi rezulton nëse një gjyqtar është i korruptuar ose i paaftë, apo i ndershëm dhe profesionist dhe këtë mund ta kontrollojë vetëm Gjykata e Lartë. Nuk ka nevojë për kamera të fshehta një herë në 10 vjet, për të kapur një gjyqtar të korruptuar. Kontrollo vendimin. Kur e ka bërë këtë KLD-ja dhe pse nuk e bën?

Një arsye tjetër pse mendoj që KLD-ja të suprimohet, si organ është edhe mënyra e organizimit dhe funksionimit të tij, që ndodhet në konflikt të hapur interesi. Gjyqtarët zgjedhin gjyqtarët si anëtarë të KLD-së, dhe kontrollohen prej tyre. Gjithashtu anëtarë të KLD-së që janë gjyqtarë apo dhe kryetarë gjykatash i bie të kontrollohen nga vetja e tyre. Politika është munduar ta reformojë disa herë KLD-në, por nuk ja ka arritur. Atëherë duhet transformuar.

Gjyqësori në dy shkallët e gjykimit

Duhet të rishikohen rrënjësisht funksionet dhe përgjegjësia e gjyqtarëve të të dy shkallëve, nën një këndvështrim të ri tashmë. Gjithashtu të shkëputet administrata gjyqësore nga Ministri i Drejtësisë dhe të mbetet plotësisht në varësi të gjykatës.

Për sa u takon pushtetit gjyqësor në Rrethet Gjyqësore dhe Apele duhet shikuar mundësia e hartimit të një ligji të ri të organizimit dhe funksionimit të pushtetit gjyqësor, nën frymën tashmë të ndryshimeve të reja kushtetuese dhe ligjore (apo Kushtetute të re) për organet e larta të drejtësisë duke u vendosur kështu një raport i ri i rregulluar rrënjësisht me ligj mes këtyre organeve.

Kjo kërkon jo vetëm ligje të reja organike por edhe ndërhyrje në Kodet e Procedurave apo Kodet e tjera ku ndërthuret organizimi me procedurën e veprimit gjyqësor. Një element tejet i rëndësishëm është përcaktimi i kriterëve të qarta ligjore për karrierën në gjyqësor.

Duhet parë se ku çalon pushteti gjyqësor poshtë. Korrupsioni, paaftësia, zvarritja e proceseve. Të tria këto mund të luftohen nëpërmjet atij kontrolli nga Gjykata e Lartë që në mënyrë të përmbledhur kam përshkruar më lart dhe vënia para përgjegjësive së gjyqtarit përkatës puna e të cilit, do të binte ndesh jo vetëm me ligjin por edhe me drejtimit dhe parimet e sanksionuara në vendimet e Gjykatës së Lartë.

Një nga problematikat kryesore në funksionimin e pushtetit gjyqësor poshtë është edhe centralizimi i administratës gjyqësore. Administrata gjyqësore në të dy shkallët emërohet nga MD-ja. Megjithëse ka një VGJK-së kundër kësaj, akoma nuk ka një zgjidhje fikse ligjore dhe vazhdon praktika e emërimit nga MD-ja ku ka pasur raste emërimesh të militantëve partiakë, aspak profesionistë.

Pozita e kryetarit të gjykatës dhe e gjyqtarit në raport me administratën është tejet problematike. Shpesh për mangësi në punën e tyre ata justifikohen me faktin se *s'kemi ç'ti bëjmë administratës, pasi nuk është në dorën tonë*.

Në ligjin e ri organik mbi organizimin dhe funksionimin e pushtetit gjyqësor, duhet parashikuar detyrimisht kapitulli mbi administratën gjyqësore. Ky ligj do të ketë në themel të tij parimin e decentralizimit të administratës gjyqësore me qëllimin për ta vënë Gjyqtarin dhe Kryetarin e Gjykatës plotësisht para përgjegjësive për punën e tij.

Kompetencat funksionale të Kryetarit të Gjykatës duhen shtuar sidomos në lidhje me administratën gjyqësore. Kjo konsiston që Kryetari i Gjykatës të emërojë vetë, mbi kriteret të rrepta ligjore mbi profesionalizmin dhe moralitetin, administratën e tij (stafin), që nga kancelari e deri te punonjësit që janë në shërbim të gjykatës ku është kryetar, dhe jo këta ti jepen paketë si deri më sot nga MD-ja. Kështu do ti kërkohe llogari e plotë mbi funksionimin normal të gjykatës që ai drejton.

Po kështu edhe për gjykatësin përkatëse. *Së pari* të rindërtohet ligjërisht figura e sekretarit të gjyqtarit, duke mos u konsideruar më *sekretar* që vetëm shkruan e zbardh vendime (5 veprime gjithsej) por të krijohet koordinatori i gjyqtarit, tek i cili të përfshihet këshilltari, ndihmësi dhe sekretari i gjyqtarit. Pra, ky person të jetë jurist me përvojë ku puna e të cilit të shkojë deri në këshillimin e gjyqtarit.

Dhe këtë person gjyqtari ta emërojë vetë mbi bazë kriteresh të rrepta ligjore (ja propozon Kryetarit të Gjykatës për emërim i cili kontrollon kriteret). Në këto kushte si Kryetari i Gjykatës si gjyqtarët do të viheshin përpara përgjegjësive së plotë pa asnjë justifikim. Këto emërimet mund të kontrollohen nga MD, i cili kur konstaton shkelje i kërkon Presidentit marrjen e masave. Dhe kam besim se ky decentralizim do ta rriste ndjeshëm cilësinë e punës në gjykatat tona.

Kjo do të rriste edhe autoritetin e personalitetin e një kryetari gjykate apo dhe gjyqtarit të thjeshtë në opinion dhe jo si deri me sot që janë konsideruar nga Ministrat e Drejtësisë si nëpunës rrogëtarë. Në fund të fundit, përderisa po flasim për gjyqësor të pavarur, gjyqtari duhet ta zgjedhë vetë stafin e tij.

Roli i Ministrit të Drejtësisë

Duhet rishikuar raporti i Ministrit të Drejtësisë me gjyqësorin. Në kushtet që është sot mund të shërbejë shumë mirë për një ndërvarje të gjyqësorit nga politika, apo ndërhyrje të ekzekutivit në gjyqësor. Thjeshtë cenon parimin e pavarësisë së gjyqësorit.

Mënyra se si operon Ministri i Drejtësisë në gjyqësor është pak të thuash e papranueshme. Jo vetëm me emërimin e stafit administrativ të gjykatave, por edhe me të drejtën për inicimin e procedimit disiplinor ndaj gjyqtarëve. Kjo çon ujë në mullirin e qeverisë, nënshtrimin e gjyqësorit nga ekzekutivi. Nëse një gjyqtar i bindet një urdhri politik të qeverisë, atëherë përse Ministri i Drejtësisë do të iniciojë një procedim disiplinor për të?? Si mund ta shkarkojë ai gjyqtarin që i bindet atij?

Pa folur pastaj për kompetencën e fundit ligjore që qeveria të caktojë ndihmësit e gjyqtarëve të Gjykatës Administrative. Pikërisht aty ku përplasen konfliktet e qeverisë me individin, si do të ankohet individit te Ministri kur qeveria fiton gjyqin?? Mendoj se ky raport është primitiv.

Arsimi juridik

Arsimi juridik mendoj se duhet reformuar duke filluar që nga Fakulteti Juridik, e deri te Shkolla e Magjistraturës, e më pas me Master Shkencor, profesional e doktoratura.

Arsimi jonë juridik është në sistemin 3+2, pra 3 vite me sistem bachelor dhe 2 vite Master Shkencor, apo profesional që të konsiderohet diploma e plotë. Pastaj vjen magjistratura 3 vjet për gjyqtarë e prokurorë, ose shkolla-konkurs për avokati.

Mendoj se e meta e parë e këtij sistemi është ai i ndarjes në 3+2. Pasi me 3 vite bachelor nuk fiton asgjë, thjeshtë një diplomë që nuk vlen profesionalisht por sa për tu regjistruar në master. Pra, me bachelor nuk del asgjë, me master del "shkencëtar", sepse quhet Master Shkencor.

Reformim i këtij arsimimi mendoj se duhet bërë nga 3+2 në 5+2. Nga bachelor plus master, të kalojë në diplomim 5 vjeçar të plotë e të pandarë plus 2 vite avokati. Gjithashtu të reformohet Shkolla e Magjistraturës në një Master Profesional me pjesëmarrje të lirë, pa planifikim.

Ndaj për këtë do sillja si shembull funksionimin e fakultetit juridik në Pavia, Milano-Itali (një nga fakultetet më të mira dhe të vjetra në Europë). Këtu fakulteti është 5 vjet i plotë e i pandarë dhe pas këtij 5 vjeçari juristi i diplomuar duhet të punojë detyrimisht pranë një avokati për 2 vite të tjera në praktikë dhe të kalojë provimin e avokatisë, pa të cilin nuk e ushtron dot profesionin për të gjithë jetën. Pas këtij 7 vjeçari teoriko praktik quhet i diplomuar jurist dhe mund të konkurrojë për magjistraturë, për master e më pas edhe për doktoraturë. Pse të mos implementojmë një sistem të tillë në arsimin tonë juridik??

Për sa i takon shkollës së magjistraturës, nuk e kuptoj se përse mbahet një shkollë e tillë për 6 gjyqtarë dhe 5 prokurorë në vit, ndoshta edhe më pak. Kjo pasi gjithçka planifikohet. Madje kjo ka sjellë edhe një bllokim të sistemit të emërimit në gjykatat e rretheve dhe të prokurorit. Nuk mund të emërohet gjyqtari rreth një

avokati që mund të ketë 20 vjet përvojë pune, sepse është planifikuar për gjyqtarët e magjistraturës.

Mendoj se shkolla e magjistraturës duhet të kthehet në një Master Profesional (teknikisht ka plot ide) ku të mund të shkollohet-kundrejt pagesës së tij tashmë dhe jo të shtetit-cilido jurist që ka përfunduar atë 7 vjeçar in që përmenda më lart. Dhe pas kësaj të konkurrojnë për në gjyqësor apo prokurori.

Ka shumë për të folur për reformën në drejtësi, si për arsimin juridik - një temë mjaft delikate kjo, edhe për profesionet e lira Avokati-Noteri, për organizimin e Shkollës së Magjistraturës, Konferencën Gjyqësore, hierarkinë e ligjeve, e deri te raportet e administratës me gjyqësorin, po për të miturin në gjyqësor, hipotekën, përmbarrimin, arbitrazhin, etj., etj., etj. Por, është e pamundur t'i prekësh të gjitha në një artikull.

Për të gjitha këto mendime, megjithëse jam zgjatur, janë dhënë në mënyrë tejet të përmbledhur, pasi shtjellimi i tyre deri në detajet më të vogla e të diskutueshme jo vetëm që do kërkonte disa qindra faqe material, por rrezik nuk ka fund.

Kësaj herë reforma në drejtësi nuk mund të jetë gjysmake, por e plotë, themeltare, sepse pas disa vitesh kur ti kthehem përsëri termit reformë për shkak të mangësive të sotme, publiku me të drejtë do ta perceptojë këtë të tanishmen - sikur s'paskan bërë asgjë.

Duhet pasur parasysh se trajtimi i kësaj teme, me karakter politiko-juridik, përmban gjithmonë mundësinë e kundërshtimit apo të ballafaqimit me variante të tjera të ndryshme, do të ishte me vlerë, që të zgjerohej debati publik mbi disa variante.

RECENSË

Për librin "Për Tokën dhe Detin e Shqipërisë – qasje juridiko-ndërkombëtare" të autorit Ksenofon Krisafi

Moikom Zeqo

Ksenofon Krisafi është një personalitet i vërtetë i rrafshëve politike, historike dhe juridike. Mund të shtoj se ngrihet mbi shumë të tjerë për kohezionin moral dhe shkencor, për vizionin dhe qartësinë. Dituria e tij universalizohet si konceptualizim i kulturës juridike. Qytetërimi modern është në thelb qytetërim juridik. Kjo është optika e Krisafit. Mekanizmi mendor i ideve dhe i artikulimeve ballafaqese. Libri i tij *Për Tokën dhe Detin e Shqipërisë* është pa dyshim - e them me bindje të thellë këtë gjë - një nga librat më të rëndësishëm të këtyre 20 viteve të fundit në Shqipëri. Rëndësia është predikat dhe perspektivë e temës madhore, e integritetit gjeografik dhe shtetëror të Shqipërisë. Temë me përparësi të padiskutueshme. Temë e rëndë testamentale për sot dhe për tërë gjeneratat. Përtej çdo retorike folklorike Krisafi parashtron, nyjton, strukturën e ndërlikuar të problematikës me një kthjelltësi përfundimtare dhe të paepur, të logjikës përcaktuese juridike, sidomos të së drejtës ndërkombëtare, ku ai spikat si njohës i thellë dhe mjeshtër i analizave komplementare mbi çdo boshllëk, trillim dhe doktrinë të rreme antishqiptare.

Ky libër i vërtetë dhe i mrekullueshëm merret me historitë e trishta (do të nënvizojë edhe të tmerrshme) të shekullit XX të cedimeve (padrejtësive) të territoreve shqiptare. Kjo është një çështje kapitale, asnjë indiferencë, apo intrigë, apo komplot i quintave apo prapaskenave të sofistikuar nuk ka tagër mbi të! Absolutisht jo! Është e pabesueshme të mendosh se si ndaj kombit shqiptar janë tjerur pezhishka merimangash, përbindëshe, për të alambikuar "teori" të rreme dhe kriminale kundër ekzistencës së kombit shqiptar, të copëtimit prokustian të trojeve shqiptare.

KsenofonKrisafi i denoncon këto shtjellime groteske antishqiptare me çiltërsinë, me të vërtetën e pambuluar të djalit që tha: *mbreti është lakuriq!*. Dhe ne, nuk jemi

në përrallën e famshme të Andersenit, por në realitetin e egër dhe të rrezikshëm të shekullit XX.

Autori bën kirurgjinë mendore të marrëveshjeve të EsatToptanit me Pashiçin dhe Jovanoviçin si dhe të marrëveshjes së Zogut me Pashiçin- ndoshta ndër dokumentet më të turpshme në historinë europiane të politikës, ku formulat antishqiptare dhe antikombëtare të tëashtuquajturave nene juridike (në fakt anti-juridike) të këtyre marrëveshjeve të kobshme conceptualizonin zhdukjen, apo zhbërjen e kombit shqiptar dhe për më tepër të institucionit të shtetit shqiptar, që historia jonë, identiteti ynë i shekujve të formalizohej si *anti-histori* dhe si *anti-identitet*. E pabesueshme! Por në këtë betejë ekzistenciale dhe mendore shqiptarët nuk u mposhtën – *por, mbijetuan!*

Historia e shekullit XX megjithatë është historia reale, ndonëse e ndërlikuar, e shtetit shqiptar si afirmim konkret, realitet juridik kombëtar dhe ndërkombëtar.

Në librin e çmuar dhe të domosdoshëm të Krisafit flitet edhe për luftën italo-greke dhe absurdin e ligjit grek të luftës me Shqipërinë duke iu referuar librit të Arben Puto *Lufta italo-greke, diktatorë dhe kuislingë* - një nga librat më të rëndësishëm të historiografisë sonë. Aty flitet edhe për disa të vërteta për incidentin e Kanalit të Korfuzit - 65 vjet më parë.

Autori operon me të drejtën ndërkombëtare si një e drejtë institucionale dhe universale. Por substanca kryesore e librit të Krisafit lidhet me ngjarjen më tronditëse që njihet si Pakti Detar, *një akt më i rëndë se pazaret diabolike të Zogut dhe dajës së tij, EsatToptanit*. Ky i ashtuquajtur Pakt i Detit, një cenim i rëndë i kufijve jugorë të Shqipërisë, u skualifikua nga Gjykata Kushtetuese dhe është një gjë epokale, një triumf i së drejtës.

Mendimtari francez *PaulValery* ka thënë se *historia ciklon tautologjitë*. Pakti Detar që një *tautologji e vonuar*. Por edhe e dështuar. Dhe duhet thënë se në strukturimin e të dhënave juridike kontributi i KsenofonKrisafit ka qenë real, substancial, ndonëse për këtë vepër ai, më modesti, i është larguar protagonizmit të bujës mediatike. Por, ky libër është *scriptamanent*.

Ky libër sintetizon zhvillimet aktuale në vështrimin juridiko-ndërkombëtar, flet për Vendimin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, të 22 Korrikut 2010, që u shpreh në favor të së drejtës së Kosovës për shpalljen e njëanshme të shtetit të vet të pavarur, e cila ishte një ngjarje me përmasa të jashtëzakonshme për të ardhmen e popullit shqiptar. Ai flet për shkeljen e konventave ndërkombëtare nga ana e Maqedonisë për vënien dorë në ujërat e lumit Radika, duke prekur kështu interesat e shqiptarëve, për aspektin juridik të bllofit, iniciativës false dhe ireale për dhënien e shtetësisë të të gjithë shqiptarëve, kudo që jetojnë, si dhe për aneksimin rus të Krimesë në këndvështrimin e së drejtës ndërkombëtare.

Libri i Krisafit është libri i polemikës së madhe. Jo vetëm për të kaluarën, por edhe për të ardhmen, kundër falsifikimeve historike.

Në shekullin XVII dijetari i madh shqiptar Frang Bardhi shkroi si polemikë madhështore dhe model të polemikës shkencore librin e tij për Skënderbeun, kundër atyre që e mohonin shqiptarësinë e heroit tonë kombëtar. Frang Bardhi thotë se, në histori kanë rëndësi dy gjëra: *metoda dhe e vërteta*. Ai e shkencëzon historiografinë, e zhvesh nga mitet dhe fantazmagoritë dinake dhe shoviniste. Libri i Frang Bardhit krijoi epokë. Vizionarizimi i tij është dhe në qenien e çdo shqiptari të vërtetë si dhe në qenien intelektuale të KsenofonKrisafit. Është diçka e pashmangshme. Krisafi ka botuar disa libra në këtë hulli. Jo libra çikërimash, jo libra për veten, por libra për shkencën dhe Shqipërinë. Këto janë libra që i shërbejnë integritetit emancipues evropian, një integritet që parakupton edhe dinjitetin dhe personalitetin historik të shqiptarëve.

E drejta ndërkombëtare kështu konceptohet, si sublimim i këtij integritetit, si një histori e vërtetë, larg tërë klisheve të vjetra dhe të gënjeshtër. Qytetërimi juridik dhe demokratik është e vetmja kahje e zhvillimit dhe e progresit modern. Shqiptarët si komb dhe si kulturë lëvizin drejt kësaj kahjeje. Ata nuk mund të ecin kuturu, ose të jenë të paditur. Padituria dikur ka qenë një e keqe e humneshme për shqiptarët. Por në Mijëvjeçarin e Tretë, shqiptarët përjetojnë një histori të diturisë dhe të dinjitetit, *për të qenë shqiptarë dhe njëkohësisht qytetarë të lirë të Europës dhe të botës*.

ABSTRACTS

The Protection Of Minors In International Law

Bledar Mustafaraj & Mirgen Preçe

More and more attention is recently being paid to childhood and the child's rights. At the end of the XIX century and the beginning of the XX century, human sciences suchlike pedagogy, psychology and sociology became aware to this regard and affirmed that this stage of life plays a very important role into the development of humans, moreover, reasoning that children are human beings as well.

For centuries on end, minors have remained to the same position, comparable to that of women, sick people and convicts, being considered as the society's "weak subjects". Enough to consider about what the Declaration of 1789 of the French Revolution maintained for the free man of the revolution, defining him as a male and a proprietor citizen, by so entailing that the "weak subjects" could not enjoy the rights and freedoms conferred by revolution since they were exempted from the property rights.

In the actual society, the adults opinion about children has changed profoundly and, at least, by word of mouth, they are prone to accept that children are as much individuals as the adults and as much bearer of human rights. The need to consider the protection of the child's rights, especially on international level, has been emerging by since the last century. The problems regarding child's rights in international level would take more emphasis during the period of industrialization since they were closely linked with the issues regarding the exploitation of the child's labor. From that period and on, minors have become a reference point of the political acts of the international, regional and world organisms which, although via a long, awkward and tiring route, have progressively enabled children to become subjects of the law.

Key words: *Children, protection, international law, CRC, the best interest of the children, the juvenile law.*

Gender equality as a cornerstone in the development processes of the country

Brikena (Buda) Dhuli

Various studies have addressed and analyzed data on the family, the nucleus of the society. In this paper we will pose in a critical perspective the existing gender data for the family classified under the following categories:

Political environment.

Institutional Environment.

The entire Albanian legal system is based on the principle of equality and non-discrimination. Life, marriage, family enjoy special protection by the state. Law “On gender equality in society” has presented difficulties for its practical implementation with regard to institutional mechanisms and responsibilities.

Opportunities to appeal in the case of gender discrimination and other aspects, although it provides the duty of the government and the public administration the collection of gender statistics in public administration and in the private sector, it does not define certain state structures for performing this task and timeliness for its realization. For the implementation of a conscious policy regarding gender, it is required a conscious institutional environment to fulfill the particular needs of boys and girls. Therefore, to what degree is this environment conscious to implement programs that address gender inequalities and promote equality. The social institutions shall form the basis upon which the social life is built. They are vital regulators of the relationships which human beings create with each other through which the continuity of generations is ensured.

A structural condition that impairs the strength of the women in the family and contributes to the strength of her husband and his family is the widespread patriarchal practice, in which the new wife moves to her husband’s house.

Key words: *Political environment, legal system, non-discrimination, institutional environment.*

Undue Payment in the Albanian Civil Code. The Albanian Judicial Practise. A Comparative Analysis

Endira Bushati

Undue Payment is one of the most important cases of unjustified enrichment and one of the first recognized and studied. The institute is especially evident in Civil Law countries. In the Roman Law, when there was no still a general action for the unjust enrichment cases, it was provided and disciplined a specific action for what was paid without cause. Even at Common Law, one of the first actions recognized *in law of restitution* was *money had and received*, aimed the return of the sums of money received unjustly. However there is a difference between Civil Law and Common Law countries. While in the Civil Law, the concept of *undue payment* refers not only to the payment of sums of money, but in general for any kind of property, to the Common Law, *money had and received* is strictly limited to the amounts of money. In fact, the difference is formal. Undue Payment is provided in Title VI in articles 653 to 654 of the Albanian Civil Code.

In the Albanian literature, *Undue Payment* is qualified as a case of unjust enrichment. Any payment presumes the existence of an obligation, and taking something for which there is no obligation is qualified as unjust enrichment.

The paper analyzes Albanian legislation in comparison with other legislations, part of Civil Law countries. This analysis is illustrated with cases by the Albanian judicial practice, providing specific recommendations, aiming to resolve the confusion observed in practice between the unjust enrichment and undue payment.

Key words: *Obligation, unjust enrichment, undue payment, law of restitution.*

Securities Market in Albania and the Balkans

Edi Spaho

In its proper sense, securities market in the Balkans have started with Belgrade Stock Exchange, which was reopened in 1989, according to the law on capital market and money. Bulgarian Stock Exchange - Sofia AD (BSE) was reopened in 1991, after the adoption of the Commercial Law. Creating stock was closely associated with deep structural changes economic and social situation, since 1989. Croatia have created two stock exchanges: the Zagreb Stock Exchange (ZSE) and Varazdin Stock Exchange (VSE). The biggest one is ZSE, which is recreated in 1991 and serves as a marketing platform for its members and their clients. Montenegro Stock Exchange was created in June 1993 by four banks, according to the law on capital market and money. It was licensed by the Federal Ministry of Finance for short-term securities trading Yugoslavia's Central Bank and the Federal Commission for the Securities term trading of securities. Macedonian Stock Exchange (MSE) was established in September 13, 1995 and officially began its activities on 28 March 1996, organized as the main market of securities and the first in the history of Macedonia. Romania Stock Exchange (BSE) was officially reopened on 21 April 1995, as a public institution. Trading on BSE performed on a modern electronic platform and expand upon a set of rules and procedures, related to trading, clearing, settlement activity and registration of securities. In this architecture of the system and financial infrastructure, what's up there just as institutional scheme is Tirana Stock Exchange, designed to serve as an organized market of securities in Albania since 1996. Even after so many years after the official opening to her it has failed to provide the service that a normal market securities should provide: sale of shares of Albanian companies, without talking about its operation and trading platform for long-term bonds or securities. Tirana Stock Exchange (BT), as the first stock exchange in Albania in its financial system, opened on May 2, 1996, in the form of a department of the Bank of Albania, as its integral part.

Key words: *Stock Exchange securities, securities market, joint stock company, treasure bonds, bonds.*

The influence of natural law after World War II. (The case of International Court of Nuremberg)

Irisi Topalli

Natural law is a set of inherent rights and based on the nature and existence of every man. Everyone has equal natural rights (such the right to live and physical inviolability or personal freedom) irrespective of gender and his age, his position in society, time, place and order of the state in which he/she lives. Natural law is one universal right, applicable to all men and all times. Natural rights are *pre* and *on-state*, and therefore inalienable right of "permanent". They differ from law and other legal norms, historically variable, set by the state (positive law). In this paper we shall focus on the influence of natural law after World War II, since this is the period in which it had a great influence, especially in regard to the doctrine of international law and human rights. Focus of the study will also be its role in postwar national courts and especially the case of International Court of Nuremberg.

Key words: *Moral, human rights, natural law, positive right.*

Parliamentary Control of the Kosovo Government Through Parliamentary Committees

Shukrje Stublla-Shabani

As a body elected by the people, Parliament is the main carrier of the most important functions of the state and political structures. Parliament is the institution that conducts the discussions and voting laws, approving the state budget, from which selected members of other bodies, as well as supervise the work of the government. Historically is known the tendency of parliaments to extend the powers against the executive power, but today parliamentarianism is more representative form of regime in which Parliament is considered the leading institution in relation to other institutions, but always within the constitutional and legal frameworks. Parallel with representative and legislative functions, overseeing the government and holding it as accountable are seen as some of the main responsibilities of democratic parliaments. Function of supervision in parliamentary commissions of parliaments of countries is exercised only within the countries with parliamentary system, because in these countries the executive body is elected by parliament, so from here stems the right of Parliament to exercise constant control and to unburden the government in certain cases. Parliamentary committees are mechanisms that make the draft laws amendment, the control of government and other institutions activities, and as well interact with the public.

Key words: *Parliamentary control, parliament, executive, parliamentary committees, constitution, law.*

The undercover agent in the “chat” rooms

Eurela Mujaj

The development of the internet has brought about new and unprecedented forms of crime. Just like any new technology which becomes available to everyone, it has its advantages and benefits and of course a number of shortcomings. The use of such technology with the purpose of committing a crime leads to what we call a cybernetic crime (cybercrime). In the everyday practice there are two types of attitude towards the cybercrime which are encountered more frequently. There are the ordinary users of the web who stay indifferent assuming they are immune to any risk, and on the other hand there are the experts who analyze this phenomenon carefully and try to understand how it works. Scott Peck, a well known American psychiatrist and author says: “*The only way to feel safe in life is to know the insecurity*”.

Among the many manifestations of the cybernetic crime who have found a fertile soil to “bloom”, is pedophilia. Given that the new technologies are subjected to a constant process of evolution and so are the relevant risks, the question which naturally poses itself is:

- Do the techniques of crime investigation and prevention keep up with the same rhythm?

Through the present paper i seek to make a criminological analysis of one of the forms of cybernetic crime - pedophilia and the investigative methods employed by many states for its prevention. The focus is a relatively new means of investigation such as the infiltration of an undercover agent in the chat rooms.

Key words: *Internet, cybernetic crime, infiltrated agent, pedophilia.*

Private versus state bailiff service _____

_____ *Valentina Memini* _____

Execution of court decisions is and remains one of the basic elements of the rule of law, where, in his absence, the natural or legal person (the creditor) can not exercise the rights and legitimate interests. In order to improve the legal framework that aims to increase the number of execution of court decisions, strengthening the public image of the bailiff service in Albania, increased effectiveness, transparency, professionalism and financial budget of this service, the Albanian legislator adopted the Law no.10 031, dated 11.12.2008 “On the private bailiff service”. This law presents a dual system of exercise Bailiff, under which enforcement functions performed by private operators tested and certified for this purpose, or rather we provide alternative private bailiff state alongside him. The concept of allowing it at the same time as a private and state causes that the creditor has the right to vote according to his own, without limitation, require the execution of a private enforcement or state, as well as a private enforcement agent is free to accept or not to execute an issue. Providing a more efficient system for the enforcement of court decisions is an effective means of ensuring access to justice, as the execution and outcome of the decision is sought by individuals who turn to the judicial system. Responsibility begins at the time the contract is concluded between the bailiff and the creditor and ends once the executive title is executed.

Key words: *Bailiff service, law, debtor, creditor, private bailiff, state bailiff, executive tittle.*

Legal Position of offenders with mental disorders, according to the Criminal Code of Kosovo _____

_____ *Adelina Rakaj* _____

In criminal etiology mental disorders are included, i.e. mental illnesses, which give a special status to persons who commit a criminal offense under the influence of mental illnesses. These special conditions determine the legal position and treatment of offenders under “Measures of mandatory psychiatric treatment” as the response to offenses that they commit. Also, the conditions for the imposition of these measures and the manner of their execution are subject to the state of mind of the perpetrator. Since this category of offenders, are in a special psychic state which make them not accountable for their behavior and their actions, and precisely this situation appears as the main cause of the offense, then their treatment in the criminal procedure and the penal policy towards them should differ from that held against the perpetrators criminally responsible. The evolution of criminal law in general and in terms of sanctioning policy in particular, towards the efforts to humanize the penalty and goal setting to be achieved by criminal sanctions, has highlighted the special measures which must be were imposed to those offenders criminally irresponsible.

Key words: *criminal responsibility, mental disorders, mandatory treatment, Penal Code*

*The rights of injured parties in
criminal procedure, comparative aspects
Albania – Kosovo. A particular review
on trafficked victims* _____

_____ *Besim Kelmendi* _____

The injured party and its position in criminal procedure in recent years took an important place in the legislation of Republic of Albania and Republic of Kosovo. This occurred not only as a result of internal developments of these two states but also as a result of influences of international legislative acts, which continuously are becoming part of national legislations.

The aim of this paper is to emphasize the position of injured parties in criminal procedures according to Codes of criminal procedures of Albania and Kosovo in comparative aspect, based upon legal framework which regulates the rights of injured parties in criminal procedures of these two countries.

The rights of injured parties in a criminal procedure are part of human rights resulting from constitutional dispositions of respective countries as well as from international legal norms, which are continuously enriched in regard to human rights in general and injured parties in particular.

The treatment of rights of injured parties in this paper includes the investigation phase, prosecution phase, trial phase and appeal phase, including the issue of indemnity as one of the most significant issues for the injured party in a criminal procedure. Thus, these rights in this paper will be treated in the frame of several groups of rights, and these are: the right to be informed, the right to act and the right to remuneration of indemnity. Also, this paper will briefly expose a particular review in relation to the rights of trafficked victims.

Even though Albania and Kosovo belong to an ethnic Albanian territory, the legal systems of these two states have changed and continue to be different in many fields and in this case, related to the position of injured parties in criminal

procedures. Instead of diminishing, these differences have been even increased after the issuance of new Code of Criminal Procedure of Republic of Kosovo.

Despite procedural differences, the two countries paid particular attention to the rights of injured parties, determining special legal dispositions not only in their Codes of Criminal Procedure, but also in their very Constitutions and particular laws which regulate the issues that deal with the rights of injured parties.

I believe that this paper is a good opportunity to promote the approach of comparative study Albania – Kosovo also in the field of criminal procedure, so that both researchers and students would have more opportunities to get to know systems or procedures of the two countries and as a result to gain the best from these systems in order to be more advanced in the pathway towards national and European integrations.

Key words: Injured party, Code of Criminal Procedures, victims of trafficking, legal system.

The Politics of Great Britain in Albania During the Second World War

Etleva Babameto

On 7 April 1939, Albania was invaded and occupied by fascist Italy. The invasion led to the creation of clusters and increasing resistance domestically - LANC, Legaliteti and Balli Kombëtar (National Front) - which had their goals, policies and specifications in accordance with the progress of developments in national and international level during the War.

But the Albanian resistance during World War II, can not be analyzed separated from the involvement and influence of the international factor, strategic importance of our country, and in view of this war, the dynamics and policy influence of British diplomacy in Albania, in accordance with its various interests of political and geo-strategic position in the Balkans.

In 1938, at the Foreign Office (Ministry of Foreign Affairs) there were two different approaches that should be held towards the policy of Mussolini: the first approach approved the thesis that Italy should break away from the orbit of Germany through goodwill and concessions, while the second one was based on the attitude that Italian Fascist government was firm in its aggressive course, and any attempt to reach a good understanding and compromise with it will be interpreted, among others, as a weakness of the British Government. The prevalence of the first approach explains the tolerant and indifferent attitude of Great Britain against occupation of Albania by fascist Italy. On the other hand, the British policy during Second World War would bring its consequences for the country at the end of the war.

Key words: *Albanian resistance, Invasion, Second World War.*

Justice reform must pass through a new constitution

Çlirim Gjata

Justice reform must pass through a new constitution. Therefore, I have argued that a new constitution is needed to have a new justice system. Time proved that the constitutional model of justice was not so effective in practice, thus it was questioned the need to reform the justice system. In this article I focus on a need for a new Constitution that will reconstruct the institutions of justice system, such as: the High Council of Justice, the Supreme Court, the Ministry of Justice, legal education, etc. It is impossible to analyze it all in one single paper, and I do not pretend to be exhaustive. Rather it is a large open public debate for each area separately that deserves the attention of lawyers and other interested practitioners to be part of such debate on this reform. More than anything in this article I pretend to open a debate, hoping that justice reform does not close very quickly as always and after a few years, when we see the results, we go back again and start from scratch.

Key words: *justice reform, constitution, Supreme Court, High Council of Justice.*

*On the book “On the Land and Sea
of Albania – international juridical
approach” by author Ksenofon Krisafi* _____

_____ *Moikom Zeqo* _____

His book “On the Land and Sea of Albania” is no doubt - it is my deep conviction this - one of the most important books of the last 20 years in Albania in this field. Importance is that the subject perspective focuses on the geographical and state integrity of Albania. Indisputably – a priority topic for today and for all generations. Beyond rhetorical folklore, author Krisafi sets a structure of complex problems with a lucidity and unrelenting logic defining legal approach especially in international law, where it stands as a master of analysis complimentary on every gap, fabrication and anti false doctrine.

The history of XX century, however, is the real story, described in its complexity, of the Albanian state as a concrete affirmation, as a national and international legal reality. Legal and democratic civilization is the only direction of modern development and progress. Albanians as a nation and as a culture are moving towards that approach. Ignorance was once an evil for Albanians. But in the Third Millennium, Albanians experience a story of wisdom and dignity, for Albanians also being free citizens of Europe and world.

